

BIBLIOTEKA

Teodor KEKO

PROSTITUTA

Tregime e novela



8SH-32
K43

PROSTITUTA

Tregime e novela



Teodor Keko

LUMTURI ME VEL TË ZI

= sinonimi
DHimitër P. 2030

-NOVELË-

Ndoshta kishte një orë që Fred Boga qëndronte përballë xhamit të pa pastruar të dritares. Nuk shihte asgjë, sepse ishte natë, natë pis dhe e pa larë, vetëm ndjente shushurimën e shiut që binte pa pushim nga mëngjesi. Atje, kundrejt xhamit, në mes të vetmisë, Fredi pati kujtuar fluturimthi gjatë një ore lindjen e dy vajzave, fejesën me Ritën, sherret e kota me Ritën, martesën, mbrojtjen e disertacionit, lavdinë, titujt dhe atë, ngjarjen më të fundit, 40-vjetorin e qelbur të lindjes, me njerëz që qeshin si idiotë për fatkeqësinë e tjetrit dhe me Ritën, e bukur e të përmbajtur në krah, të trishtuar përbrenda e pikëlluese nga jashtë. Fredi psherëtiu. Gjithëcka i dukej e kotë në këtë botë ku jeta ishte pa kuptim drejt humbjes, si ky shi, që përbalte gjithëcka dhe veç trishtim vadiste e triste në shpirt. Fare kot, fare kot, shushurinte parreshtur gati prej një ore në tru dhe kotësija bëhej më e prekshme e materiale, teksa ai vërente portretin e tij në xham, atë portret ish-interesant, tani me dhjetë dhëmbë mangut e të inkuadruar në një kokë tullace, si mobilje, që mjaftonte një leckë e thatë për t'i marrë pluhrat e për ta bërë të shkëlqente. Psherëtiu përsëri, pastaj murmuriti "nesër" dhe i ktheu shpinën dritares. Shkarraviti në një letër "Rita, do vonohem pak", hodhi letrën në tryezë, veshi pardesynë e doli. Pse do të vonohem, pyeti veten nëpër shkallë. Askush nuk e priste, kërkënd nuk donte të takonte në këtë natë që sapo kishte filluar ciklin e saj e që një perëndi e merrte vesh kur do të përfundonte mbaj këtë vend ku edhe harta përngjasonte çuditërisht me formën e arkivolit. Ndjehej i dërmuar. Në të vërtetë, nuk kishte asnjë punë. Asgjë nuk i interesonte më, as mali me libra e as pirgu me dorëshkrime, që dukej sikur e tallte nga dosjet e vendosura në bibliotekë; vetëm kotësia e të jetuarit në

këtë vend të humbur i interesonte, kjo kotësi që e mbante me shpresë se mund të dukej një tip ekzotik para Zotit, kur të vinte dita.

I.

Ishte pranë hotel "Dajtit", kur i zuri syri një afishe që lajmëronte se pikërisht sonte fillonte java e filmit rus dhe Fredi vendosi të kalonte një herë nga Qendra e Kulturës. Mbante mend akoma ca fjalë rusisht nga shkolla, ose, më saktë, mbante ende në kujtesë disa copëra nga Pushkini, Lermontovi e Gorki. Iu duk vërtet ide e mirë të fuste kokën një herë në sallën e filmit dhe nuk dyzoi më. Patí fat. Te dera hyrëse një i njohuri i tij ia hapi rrugën pa i kërkuar ftesë dhe Fredi sakaq u ndodh në holl, në një holl me pak njerëz të veshur bukur, që mbanin nëpër duar ca gota farfuritëse. Kishte filluar kokteji dhe Fredi u nis për nga banaku. Mori një vodka, zuri një skaj dhe që atje ia nisi të kundronte me rradhë të pranishmit. Nuk njihite thujse asnjërin, përveç atyre që ua shihite ndonjëherë fytyrën në TV dhe ndoshta kaq mjaftoi që t'i mbushej mendja për t'ia mbathur në çast. Ishin ca fytyra të përmalluara, me sy disi të lëngëzuar, që në më të shumtën e kohës flisnin rusisht, një rusishte të vjetër tashmë, të konservuar prej gati 40 vjetësh në kafkat e tyre të zbardhura. Po, ti, çdo këtu, pyeti veten, mirëpo nuk arriti ta linte gotën e të ikte, sepse atë kohë ndjeu një dorë në sup.

- Mirëmbërëma, profesor! - dëgjoi një zë të gëzuar e tallës. - Që kur keni vendosur të kulturoni qelizat tuaja matematike?

Ishte Helena, ajo Helenë e bukur, e cila dhjetë vjet më parë mori dy katra prej tij, një në qershor e një në gusht, për t'i dhënë lamtumirën matematikës, e për t'u hedhur që të dilte në pah andej nga artet.

Fredi e përqafoi pa i folur. Ndjeu buzët e saj në faqe dhe iu kujtua se pikërisht kështu ishin ndarë atë gusht, kur Helena e xhindosur e pati sharë nën zë "legen".

- Ç'është gjithë ky trishtim? - pyeti Helena, atë çast kur filloi një rrëmujë e vockël në holl, që lidhej me ardhjen e një ministri në ceremoni.

- Pse mos jem i trishtuar? - ia ktheu Fredi.

- Po! - tha Helena. - Mut!

- Vodka? - pyeti Fredi.

Helena tundi kokën.

- Vodka, - tha, - mbase bëhet bota me ngjyra.

Fredi shkoi të mernte dy vodka në banak, por kur u kthye Helena nuk ishte më vetëm. Po puthej me një bionde që i dukeshin nga pas vetëm këmbët e

gjata dhe trupi i bukur. Fredi i qëndroi pa folur nga pas biondes, e priti të kthehej, t'i thoshte "më fal" dhe sakaq u trondit. Asgjë nuk dëgjoi nga prezantimi që i bëri Helena tjetrës, vetëm kërkon me ngut ta gjente ku e kishte parë këtë vajzë.

Vajza diçka ndjeu.

- S'besoj të më keni parë ndonjëherë. - qeshi. - Unë kam studiuar për sociologji dhe nuk kam marrë as edhe një leksion të vetëm matematike ...

Fredi s'foli. Pastaj, si u mendua pak, e hapi gojën e tha:

- Nuk jemi takuar, por ti më kujton diçka të shtrenjtë.

Nuk e dija që dy njerëz të panjohur mund të ngjajnë kaq shumë ...

- Kujt i ngjaj? - pyeti vajza.

- Dhjetë vjet përpara. - filloi Fredi. Pastaj befas e la fjalën në mes. Bëri një shenjë me dorë dhe iu kthye vajzës:

- Po juve si ju quajnë?

Vajza qeshi.

- Ilda. E martuar. Një fëmijë. Pa punë. Vajzë teze e Helenës ...

- Mirë! - tha Fredi. Ama sytë nuk ia ndante. Iu afrua pak vajzës, sikur të donte t'i kumtonte diçka në vesh, pastaj u largua përsëri. - Mirë. - përsëriti, - Lalik!

Ilda nënqeshi tallëse nën buzë.

- Fallco! - tha. - Aromatike, sidoqoftë, ëë! - shtoi.

Dhe atë çast njerëzit filluan të hyjnë në sallë.

- Unë po ia mbath, - tha Fredi, - dy vodka i piva, njeri optimist nuk gjeta

... Ika!

Dhe iku vërtet.

2.

- Ç'tip! - tha Ilda, tek po hynte në sallën e kinemasë me Helenën, bash atë kohë kur një ambasador evropian po kundronte gjoksën e saj të plotë me një lakmi tipike kapitaliste.

- Ky është fatkeq, - ia ktheu Helena dhe psherëtiu tamam kur iu kujtua Fredi i parë, ai Fred që ia pat nxirrë jetën një vit të mirë me ato ironitë e tij asgjësuese. Ilda ishte kurioze të dinte se për kë e kishte fjalën, për ambasadorin që nuk ia ndante sytë e lëngëzuar, apo për profesion. Tjetra qeshi. Fliste për Fredin.

I pat thënë një herë para gjithë auditorit se ajo nuk vlente as për shitëse zarzavatesh. Dhe mendo: ishte koha kur në dyqan s'gjeje zarzavate dhe, të punoje shitëse, do të thoshte të ishte njeriu më i pa punë i botës. Dy mbledhje të qelbura

matematike elementare në ditë do të bëje, në rastin më të mirë!

- Me kë i ngjava? - ia preu rrjedhën e kujtimeve trishtuese Ilda.

Helena ia nguli sytë mirë.

- Nuk e di, -tha pastaj. - Ndoshta, - shtoi, - me ndonjë matematiciene që ai takon nëpër konferencat në botë, ndoshta me ndonjë dashuri të vjetër, që tani duhet të jetë kthyer në një kufomë të dekompozuar...Tip sinusoidi, pra...

- Do më lesh rehat!- u nxeh Ilda. Asaj se pse iu duk sinusoidi një gjë e thatë dhe e shtrembër.

Tani po e bezdiste edhe ai ambasadori që nuk ia ndante sytë dhe psherëtiu e lehtësuar kur u fikën dritat në sallë. I harroi të gjitha, por atë fjalinë "ky është fatkeq" s'po e harronte dot.

Po unë nuk jam fatkeqe? - u nxeh me veten. Jetohet në këtë vend të pisë, ku të gjithë s'të njohin nga fytyra, por nga këmbët, ku burri qelbet erë alkool dhe numëron lekët një qind herë ditën si ata katundarët klasikë, ku mami të thotë një mijë herë në vaktit "si lum ti, o mam, që more burrë të pasur", dhe ku një sociologe e sapodiplomuar i mbron disertacionet duke pastruar papushim shtëpinë e duke rritur një fëmijë të bukur që vetëm qan? ... Dhe mjaftoi kaq që Ilda të përqëndrohet në ekranin e madh. Harroi gjithçka.

3.

Fredi u kthye vërtet vonë në darkë. Vajzat flinin. Vetëm Rita priste në kuzhinë me një gazetë në dorë. Kishte kohë që gruaja e tij e bukur nuk qeshte më me shpirt. Dhe Fredi s'e kuptonte dot trishtimin e saj.

- Nga ishe? - pyeti Rita. S'ishte provokuese, ose më saktë, dukej sikur përtonte të bënte sherr.

- Vërdallë, - tha ai.

- Pse nuk punon?- këshilloi butë ajo dhe kaq mjaftoi që Fredit t'i kërcenin xhindet.

-Pse të punoj? - uluriu. -Kush ka nevojë për studimet e mija në këtë vend ku na iku jeta dëm?

- Ule zërin, - tha Rita, - po s' deshe të punosh për të tjerët, puno për veten tënde, puno për ne, për mua...

Fredi u nxi.

- Po ti, kush je, - i tha ironik, - që të meritosh sakrifica sublime? ...

Rita u ngrit në këmbë.

- Mjaft! - thirri. - Unë jam gruaja jote, e diplomuar kimiste, jam nëna e fëmijëve të tu dhe jetoj po ashtu si ty në këtë vend që ti e quan të qelbur. Ti je

egoist, kujton se vuan vetëm ti, sepse s' llogarit njeri për të gjallë. Ti kërkon kushte ta jetosh jetën si të pëlqen, kërkon liri, përkëdhelje nga të gjithë, ty të është mërziur familja ...

Shfrynte.

- Bëj ç' të kesh qejf! - tha më në fund. - Po mos u bë shumë idealist. As ti nuk je më i pari ...

I kaloi m'u përpara këmbëve Fredit pa i hedhur sytë dhe u nis për në dhomën e vajzave.

- Ti flet poshtërsira, vetëm poshtërsira! - uluriu Fredi.

Po Rita nuk u përgjigj.

Hajde jeto në këtë vend, shkumbëzoi Fredi. Shtriga plakë, shau pastaj të shoqen, duke u betuar se këtë herë do t'ia nxirrte të gjitha për hundësh.

Ra të flinte në divanin e kuzhinës pa zhveshur as pantallonat e as këmishën, gjithë duke shkumbëzuar e duke mallkuar këtë jetë të turbullt e pa kuptim, pastaj, nëpër atë gjumë tejet të trazuar mbajti mend që pa Ildën. E pa ashtu, siç i shohin zakonisht meshkujt nëpër ëndrra gratë e bukura dhe nga tronditja u zgjua. Ora ishte pesë pa një çerek e mëngjesit. Po kjo çdo në këtë mes, pyeti veten i tronditur Fredi. Ama, iu fiksu që Ilda kishte një gjoks të bukur, të gjerë e të plotë. Këtë e mbajti mend. E kishte parë në ëndërr.

4.

Fredi nuk i foli të nesërmen Ritës dhe kjo gjë sikur e qetësoi. Prej kohësh ndjente një irritim të brendshëm, të pashpjegueshëm nga Rita, diçka që gjithmonë e më shumë e bindte se ishte edhe ajo fajtore që bota rreth tij ishte bërë gri, aq gri, sa edhe karafilat nuk mbanin më erë si dikur e tani s' ishte çudi të hante qeni i shtëpisë vetë të zotin e tij. Filloi të mbyllej pasdrekave deri vonë në laborator, ku endej si somnambul mes pajisjeve e librave, pastaj, pas një jave u nis për në Londër. Puthi vajzat, iu tha atyre se ku do të shkonte, mori çantën e rrugës dhe u zhduk në bërrylin e shkallës.

Rita nuk u ndje. Vetëm i vetëtiu një dritë e keqe në sy, kur vajzat i thanë se babi ishte nisur për në Londër. Ajo e dinte datën e konferencës dhe pati shpresuar se kjo zënkë e rrallë me Fredin do shuhej me këtë rast, shpejt e shpejt, si gjithmonë, por ishte gabuar. Iku kokëvarur në dhomë dhe atje, pa kuptuar as vetë, filloi të zhvishej lakuriq. Qëndroi e skuqur nga turpi e nga inati bashkë para pasqyrës. Kishte ende një trup të plotë gruaje të kolme. Ende mishrat nuk qenë squllur. Atëherë, ç'kërkonte ai më shumë? Ç' e pandehte veten profesori tullac, që sapo i

kishte mbushur të 40-tat e dukej sikur ishte 50 vjeç?

I hypi një e qarë e rëndë. Iu kujtua Fredi i parë i zgjuar e moskokeçarës, ai Fred pa një lek në xhep dhe prapë më i pasuri nga të gjithë. Iu kujtuan ato sakrifica pa fund kur ai punonte ditë e natë mbi disertacionet dhe ajo rriste vajzat. Paska qenë gjithçka kot, fare kot, psherëtiu. Gjithë këto sakrifica e ndershmëri për t'u shkërmoqur kështu, pa asnjë arsye, në një ditë të bukur. Dhe qau përsëri. Le të bëhet si të jetë shkruar, i dha fund pastaj. Ndoshta është i sëmurë e shërohet andej nga Londra!

5.

Kurse ai nuk gjeti as më të voglin ngushëllim në Londër. U xhindos që në aeroportin Hithrou, ku me të paraqitur pasaportën shqiptare iu desh të kalonte në fund të pasagjerëve e ta kapërcente kufirin vetëm pasi e kontrolluan imtësisht. Kaq u desh që të mbetj i mbyllur brenda guackës së tij dhe ta braktiste fare konferencën, duke u sorollatur i vetmuar në Pikadil e muzera shkrimtarësh. Dhe për fatin e tij të keq, apo të mirë, pa përsëri Ildën në ëndërr. Këtë herë ajo nuk u zhvesh. U takuan nën këmbët e Big Benit dhe Ilda i foli me një pamje ironike nëpër mollëza:

- Ç'po bëni në Londër, profesor?

- Një konferencë, -iu përgjigj ai.

- E për kë kulturohesh, profesor? Kujt i duhet matematika, shqiptarëve?!
Llogaritë tona më të komplikuar do të jenë maksimumi sa bëjnë pesë edhe pesë.

Po dite kaq, në rregull jemi ne andej... E pe si ta bënë anglezët në aeroport, profesor?

Të thanë: jeni kot fare ju shqiptarët! Virus kolere jeni ...

- Dëgjo, Ilda, - u përpoq të mbrohej ai.

- Lëre, profesor! E ç'faj ke ti, që jeton në një vend ku asnjë nuk rrezikon e investon? Ti je fatkeq, profesor, dhe megjithëse e di këtë gjë, prapë nuk lufton dot të bëhesh i lumtur. Nuk ta mban, profesor ...

Dhe u zhduk.

Fredi u zgjua sakaq. E kishte gojën helm. U ngrit e vajti në vaskë e atje, i dremitur nën shkumën e shampove filloi të mendojë për ëndrën, për ato fjalë cinike të thëna shqip nga një vajzë që i ngjante aq shumë Ildës.

Ajo ka të drejtë, mendoi. Iu kujtua Shqipëria, fakulteti i matematikës me koridoret që mbanin erë urine, materniteti përballë me fëmijë që lindin e priten në

mungesë të çarçafëve me gazeta, plehrat dhe kolera, pastaj periferia e tmerrshme, e zymtë dhe e pa e shpresë, limontija shpirtërore dhe politikanët banalë, ata uzurpatorë karrigesh pa vizion e pa sens perspektive, hajdutë kriminalë ... Atje s'ka më asnjë shpresë, mërmëriti, asnjë shpresë. Po, ndoshta, shpirtin tim mund ta qetësoj, tha, do të bëhem edhe unë si ata politikanë, me kolerë te dera e me para nëpër xhepa... Tashmë Ilda i rrinte në mendje, ajo Ildë e bukur, me ato flokë të verdhë dhe u drodh nga ideja se gjatë një jave në Londër s'i kishte kujtuar asnjëherë as Ritën e as fëmijët. Diçka po ndodh, tha ai, dhe unë këtë herë nuk do të pyes më për opinionin. Pas kësaj ra paqja, një gjumë i thellë atë ditë. Fredi u vodh shpejt nga konferenca. Doli nëpër parkun mbretëror, priti sa të kalonte garda legjendare angleze, pastaj vendosi të blejë diçka për vajzat. Në xhep kishte boll stërlina dhe ai nuk u kursye për të zgjedhur nja dy kukulla të mëdha, që flisnin e ecnin sa herë t'iu shtypje pultin. Po tek dilte nga dyqani vetëtitës iu kujtuan doganierët anglezë, ajo fyerja e tyre për shqiptarët, pastaj kukullat pa shpirt e me gojë dhe arriti ta pyesë veten qetësisht: po unë, kam shpirt? Ma morën, u mbrojt. Por prapë nuk gjeti ngushëllim. Ma morën, pyeti sërisht veten, apo ua dhashë unë me qart e mja? Vështroi edhe një herë kukullat, pastaj vendosi të kthehej në hotel. Edhe Londra po i dukej kot fare dhe seç vinte edhe këtu një erë urine nga Tamizi i qelbur ngjyrë plumbi.

6.

Fredi e mbajti kumtesën e tij ditën e fundit në konferencë. Pas asaj shprehjes pa shprehje "Fred Boga, Albania" ai ndjeu një lloj përskuqje turpi që ishte shqiptar në atë sallë farfuritëse me matematicienë akademikë, që do t'iu duhej nga një furgon për të transportuar titujt e diplomat, nëse do t'iu kërkohej të paraqisnin origjinalet në konferencë. Dy net më parë CCN kishte transmetuar disa pamje të llahtarshme nga spitalet psikiatrike të Shqipërisë dhe kaq mjaftonte që Fredit t'i dukej vetja përpara auditorit si njeri me bisht. Doli i nervozuar në podiume pastaj ia nisi me një lexim monoton kumtesës së tij, duke uruar të mbaronte sa më shpejt. Lexonte pa e pasur mendjen. Një herë zihej me Ritën mes rreshtave, një herë mbulohej me re pluhuri ... Pastaj erdhi ajo "Faleminderit" magjiplotë dhe Fredi u bë gati t'ia mbathte nga podiumi i mallkuar, ku i dukej vetja si një qenie jashtë tokësore. Por papritur i erdhi një zhurmë e hallakatur në vesh... "Ç'po bëni, klithi me gulç shpirti, unë jam nga Shqipëria!" ... U nis i turbulluar për në vendin e tij, duke iu përgjigjur përshëndetjeve të profesorëve, por akoma nuk kuptonte se përse salla kishte duartrokitur. Ra një heshtje e rëndë dhe atëherë ai kuptoi

diçka.

- Kolegu ynë Boga nga Shqipëria hapi një dritare të re sot për të gjithë ne , - tha drejtuesi i seancës, - ndoshta nesër disa nga ne do ta kristalizojnë këtë pamje ende të mjegullt...

Kishte fituar, por nuk dinte ç'të bënte me fitoren. Atij nuk i duhej. Kuj t'ia falte? Ai e dinte ç'do të thoshte ky zbulim. Tani duhej të punonte përsëri, 2-orë në ditë, torturë, por për çfarë gjithë kjo sakrificë? Ndjente të përziëra dhe dol në koridor për të pirë diçka. Teksa mori gotën me lëng portokalli, një çmim Nobe iu shfaq përbri. E lëshoi gotën instiktivisht në tryezë dhe i lut profesorit se m çfarë mund t'i shërbente. Profesori s'ia ndante sytë.

- Përgëzime, - i tha pastaj, - Punë e shkëlqyer...

Fredi s'fliste dot.

- Ti punon në Shqipëri? - pyeti profesori.

Mori një pohim me kokë.

- Pashë dy ditë më parë CCN, - tha profesori. - Tmerr! Dhe tmerr! më madh që atje punojnë kapacitete si ty... E doni ju atë vend apo e urreni? - pyet befas, por i dukej qartë nervozizmi.

- Nuk e di, - iu përgjigj sinqerisht Fredi.

Dhe, vërtet, nuk e dinte. Profesori nuk ia ndante sytë. Ai kishte qenë një herë në Shqipëri dhe nuk mund ta kuptonte se një vend i vogël me një grus! njerëzish, me një det, me natyrë ende të virgjër, mund të ndodhej në prag katastrofës!

- Atje nuk ka shtet! - i tha prerë Fredi. - Atje ka autokrati, secili për vetë...

- Mjerë ju që pajtoheni me atë realitet! - tundi kokën trishtueshën profesori. - Mjerë ju! ...

Në mbrëmje Fredi iu bë jehonë në stacionet kryesore televizive dhe t nesërmen në drekë, pas dy leksioneve urgjente në Universitetet e Londrës, ai ishte shqiptar i pasur dhe profesor i jashtëm i Universitetit të Londrës.

Fredi vendosi zarfin plot me stërlina në tryezën e dhomës së hotelit dhe herë vështronte paratë, herë kukullat e mëdha. Ndjente një boshllëk. I dukej vetj si një njeri i shpallur hero pas vdekjes. Stërlinat nuk i ngjallnin dot dashurinë vjetër për Ritën, nuk ia nxirrnin dot flokët, nuk ia mbysin dot trishtimin ... Punë muti, shau Fredi dhe si u zhvesh me shpejtësi, u fut në vaskë. Të paktën të nxjerr pisllëkun, mërmëriti.

Në banjën vezulluese Fredin e pushtoi një gjysmëdremtije dhe diku përpara, mes avujve e mjegullnajës së brishtë, iu rishfaq vetvetja në rininë e rrëmbyer edhe buzëqeshjen, edhe gëzimin. Ishte ai djalë i ri përballë, Fred Boga

dikurshëm, dikur-ishi, që dashuronte një biondinë me emrin Fiona, që i fishkëllente nën pallat, që e priste te cepi i pallatit, përballë bibliotekës, që merrte pastaj një refuzim të prerë e qante i vetmuar nën shi. Ku ishte sot ajo Fionë e bukur, ish-studentja e mjekësisë, kriminele dhe e pamëshirshme me dashurinë e tij? Kishte ikur dhe atij i pati lënë një konservë dashurije, l u ishte mbyllur përjetë ajo fytyrë e zgjuar vajze me sytë e mëdhenj e buzët e plota. Gjithçka do të jepte ta rifitonte në Fionë ...

Befas u drodh. Ngjasonte tmerrësisht me Ildën Fiona, a thua kishte një adërzim mes tyre. Megjithatë, Fiona ishte tjetër gjë, mendoi turbull Fredi dhe dremitja e kaptoi përsëri. Ndjehej i lodhur. Ndoshta kapitjen ia patën sjellë kujtimet, ato kujtime që të bënin të vije kujtën sa herë i kujtoje!

7.

Në aeroportin e Rinasit Fredin e priste një grup televiziv me kamerat dhe mikrofonët gati. Ishte ende ditë dhe Fredit iu përzie nga ai peizazh i verdhëllemë në godinën e vogël të doganës përballë dhe me ca doganierë të parruar e të veshur pas qejfit nëpër këmbë. Një gomar kulloste i qetë pranë kontrollit doganor dhe Fredi qeshi hidhur. Ai e kuptoi se jehona e kanaleve televizive kishte pushtuar dhe vendin e tij të vogël. Tani lajmi do të transmetohej e ri transmetohej disa herë për të gjitha edicionet e lajmeve me krenarinë primitive të një fëmije që ka me farë të çudisë dynjanë e madhe. I bllokuar nga ekipi televiziv Fredi bëri përpjekjen fundit për t'iu shpëtuar gazetarëve, mirëpo nuk mundi. Intervistuesja, një akuroshe e gjatë, i tha se tanimë kronika ishte planifikuar të transmetohej në gjmet e mbrëmjes.

- Pse, ju punoni me plan? - bëri të habitur Fredi.

- Patjetër, profesor, - qeshi vajza. - Jemi apo nuk jemi në Evropë?
Fredi tundi kokën.

- Po, - tha, - jemi.

Pastaj, si e peshoi mirë me sy vajzën, e pyeti befas krejt qetësisht:

- Po ju ç'plan keni sonte në mbrëmje?

- Bosh! - qeshi vajza. - Vetmi tipike shqiptare ...

- A mund t'iu ofroj unë një darkë atëherë? - pyeti Fredi.

- Sonte?! - zgurdulloi sytë vajza.

- Sonte, - tha Fredi.

- Dakort, - ngriti supet vajza pas pak çastesh. Por merrej vesh që ishte e

befasuar.

Fredi iu përgjigj pyetjeve shkurt, pastaj ia pikëtakimin me gazetaren dhe, si mbloodhi çantat, kaloi derën e doganës. Kishte kaluar pak ditë më parë krejt i panjohur këtë doganë të ndriçuar keq dhe po kthehej si shqiptari më i famshëm, por prapë nuk ndjente asnjë kohaqësi. Ndjente një boshllëk në shpirt dhe nuk arrinte ta kuptonte përse e ftoi bukuroshen pa i ditur ende as emrin. Shau veten që nuk iu përgjigj ftesës për të mbajtur disa leksione edhe në Milano, mori nga doganierët pasaportën e vulosur dhe prentoi një taksì. Ora ishte pesëmbëdhjetë. Shumë shpejt, mëmëriti dhe vendosi të shkojë në Durrës. Shkonte mbrapsht gjithçka. Ia la kukullat një mikut të tij dhe iu lut t'ia çonte në shtëpi.

- Vi i marr nesër, - tha Fredi. - Mua më duhet sot të shkoj deri në Durrës.

- Sot? - u habit tjetri.

- Sot, - ia ktheu Fredi. Dalloi gazetaren në sheshin e aeroportit dhe nxitoi drejt saj.

- Më falni ... - nisi Fredi.

- Alma, - qeshi vajza.

Ai e kapi lehtë për krahu vajzën dhe e tërhoqi veç.

- A mund t'iu pres në plazh, - iu lut, - mua më duhet të shkoj deri te Hotel "Adriatiku". Mund të vijë t'iu marrë taksia ime...

As Alma nuk e kuptoi pse pranoi.

- Dakort, - i tha. - Në tetë të mbrëmjes jam te "Adriatiku"...

U ndanë dhe në orën tetë, kur Alma hyri në lokalin e zbratur, kuptoi se profesori kishte një trishtim të madh. Rrinte i strukur në një kolltuk të madh para një gote me uiski me vështrimin të tretur përtej dritareve të mëdha, andej nga vinte një zhurmë e mbytur dallgësh, që sillnin ca copëra dritash të trageteve në radë deri në në breg. Nuk e ndjeu Almën as kur i erdhi te këmbët dhe vetëm zëri i saj e sollë në gjendjen reale.

- Shkencë? - pyeti Alma duke u ulur.

Ai s'iu përgjigj. E pa se si ishte veshur. Qe ndërruar e tëra. Një fund i shkurtër i nixirte në pah kofshët e bukura, ndërkohë që gjoksi i gjerë e i plotë spikaste nën bluzën e mëndafshhtë.

- Jo! - tha pastaj Fredi. - Trishtim i madh ...

Alma kukurisi.

- Nga Londra në plazhin pisanjos të Durrësit, në plazhin pa Tualet të Durrësit ... Ju sikur e njihni realizmin, profesor?

- Tani s'njoh më as vetveten, - tha Fredi. - Di vetëm se më quajnë Fredi Boga, që jam 40 vjeç, dhe ... kaq! Po ne nuk jemi këtu për të filozofuar rreth trishtimit, - shtoi me ngut, - shkojmë te Shtëpia Blu?

Alma qeshi prapë.

- Shtrenjtë, - tha.

- Për ne, jo! - ia ktheu Fredi. - Unë tani jam i pasur ...

Ata dolën nga dera e lokalit, që të nxirrte përmes terracës nga ana e bregut, dhe pas pak çapeve nëpër atë errësirë të kaltër Alma nuk arriti të kuptonte se si e kishte kapur për krahu Fredin. Ndoshta errësira, ndoshta ajo hapësirë e egër boshe me ca zogj e qenër nëpër këmbë. I erdhi turp nga vetja, por tanimë s'gjenete as një mënyrë se si ta korigjonte gabimin. Ajo pa qartë se si e ktheu Fredi portretin nga ana e saj, se si i mërmëriti me një portret të shpartalluar "jam shumë i vetmuar", sesi ia afroi buzët pastaj, si e puthi pa e pushtuar në trup dhe si përsëriti një çast më pas "jam shumë i vetmuar, Alma".

- Unë prandaj erdha, - tha me një zë të mbytur Alma, - por do të lutem mos e keqkupto ardhjen time ... Unë nuk jam ashtu, - shtoi, me zë të ulët, - nuk është faji im që vetmia jote ka forcë manjetike...

Atëherë ai e pushtoi tamam. E puthi gjatë në buzë, në qafë, në sy, në veshë, në kraharor dhe e lëshoi vetëm kur Alma e shtyu butë dhe iu lut:

- Të lutem, jo këtu Fredi ...

Thuajse s'folën fare në atë copë rrugë që iu kishte mbetur. Alma leu përsëri buzët, kreuhi flokët e gjatë dhe kur hynë në hollin e Shtëpisë Blu dukeshin seriozë. Njëri nga pronarët, arkitekt, ish-student i Fredit, nuk i la të hynin në sallë.

- Rrini më mirë në katin e dytë, profesor, - iu lut. - Poshtë do t'iu shqetësojnë klientët...

Fredi pranoi me kënaqësi. Arkitekti hapi një dhomë të katit të dytë dhe Alma u mahnit nga ambienti. Ishte një apartament që meritonte "një qerre me yje", siç u shpreh më pas ajo, me një bar të bukur përbri e me një tavolinë plot me lule e qirinj.

- Do t'iu shërbej unë, - tha arkitekti, - pijet i keni në bar, për çdo nevojë mund t'i bini ziles dhe mund të qëndroni të qetë sa të keni dëshirë ... Dhe, urime, profesor, - shtoi pastaj, - pashë Euronjuzin. Do të kisha dëshirë t'ua afroja unë darkën sonte ...

Porositën peshk, shumë lloje peshku porositën, dhe diku nga mesnata Alma filloi të kukurisë shpesh e më shpesh. Vera e bardhë greke po e jepte efektin e saj. Fredi kërkoi në raftin e disqeve një muzikë për momentin dhe e la kërkimin kur hasi Xho Kokerin. Tingujt mbushën dhomën me magjinë e tyre. Atëherë Alma e vëzhgoi seriozisht Fredin.


- Me kë të ngjaj? - e pyeti.

- Me Kim Basinger, - iu përgjigj thatë Fredi. Nuk gënjente.

- Ti do që unë të bëj striptizëm?

Mori një pohim me kokë.

- Unë sonte do të bëj ç'të duash ti, por vetëm sonte!



U ngrit në këmbë dhe vetëm kur fluturuan këpucët me bluzën e mëndafshhtë, kur u shfaq gjithmonë e më i lakuriqtë ai trup vajze me forma të përsosura, Fredi ndjeu se diçka po ndodhte. Dy minuta më pas rënkonin të dy në shtratin e gjerë të apartamentit, rënkonin sikur po përlesheshin me vdekjen, putheshin, lëpilheshin e kafshoheshin, flisnin nëpër përçartjet e orgazmave, ndaheshin e ribashkoheshin prapë. Vonë, shumë vonë, kur pastroheshin të dy në dushin e ngrohtë, ajo e puthi në ballë dhe i tha gati duke dënesur:

- Ishe i mrekullueshëm, por harroje këtë natë!

Dhe, fatkeqësisht, ishte e vërtetë. Kur u zgjua, në mesditë, Alma nuk ndodhej më në dhomë. Në një copë letër ai lexoi ngadalë, si miop, "Faleminderit për të gjitha! Alma Luku, Tel. 341-41!" Grisi letrën pasi fiksoi gjithçka në kokë dhe filloi të vishej. Ishte gdhirë një ditë e re. Një zot e dinte ç'ditë ishte!

Nga dritaret dukej një peizazh gri, me një det që shkumëzonte paksa e që i afrohej si me përtim bregut, a thua e shtynin me zor drejt kësaj hapësire të pakuptimtë. Fredi u end një copë herë nëpër plazh. Këtu dikur mbyste dhimbjen për braktisjen e Fionës, këtu fantazonte lloj-lloj takimesh me Fionën, sikur ajo dilte nga deti, sikur i vinte përballë, sikur ... ç'jetë! E gjitha e ndërtuar mbi "sikur"-e! Asgjë reale, përveç një përleshjeje të pafundme opinionesh bizantine, ku çdo veprim aq i dashur frenohej nga një "po sikur?"... Fatkeqësisht, kështu kishte qenë dhe ishte po kështu. Ai e kapi veten gafil duke pyetur vetveten "po sikur ta mernte vesh këtë histori Rita?" - dhe u xhindos keq. Shau hajvan veten, tha edhe një herë se do të ishte mirë SIKUR të gjente andej nga "Adriatiku" ndonjë taksì për në Tiranë dhe u drejtua për nga hoteli. I pihej një kafë, por SIKUR nuk i shijonte vetëm. Ah, SIKUR ta kishte tani në krah Fionën, ata Fionë që dikur i pati kushtuar vargjet tragjikomike:

Kur unë të vdes, o Zot, sa më shpejt,
Trupin tim të bukur ia fal Fionës së mirë
Që të shohë sa e kam dashur atë çast
Kur me thika, gërshërë e sharra të më bëjë autopsinë ...

Autopsinë! Fredit iu qesh. Ç'autopsi zeza! E ku gjen gjë në këto kufoma
- gërmadha të harruara, përveçse ndonjë merimange.

8.

Në apartament Fredin e priste një heshtje varri. Vajza e madhe nuk ishte kthyer nga shkolla, nga ajo shkollë pa xhama e pa banjo përballë dritares së

ballkonit, ndërkohë që e vogla vetëm sa ngriti sytë e bukur, duke vazhduar lojën. Rita diçka po përgatiste në aneks. Pa e nxjerrë kokën, ajo foli ngadalë që andej:

- Mbrëmë ju ishit i ftuar për darkë nga kryeministri, por unë, si njeriu më pak i informuar për personin tuaj, dija vetëm që ju kishit mbërritur dje në Rinas me "Alitalian". Ku fjetët mbrëmë, te Presidenti?

Fredin e acaroi shumësi. Në tryezë ishin nja dy fakse që e ftonin urgjentisht në Paris. Pasnesër. Leksione. Konferencë. Laborator.

- Po! - u përgjigj Fredi.

Vajza ngriti edhe një herë sytë, këtë herë i shkëlqenin.

- Vërtet babi? Ishte bukur? ...

Atëherë Rita nxori kokën.

- Në kësi takimesh është gjithmonë bukur, - ironizoi ajo.

Fredi nuk foli. Vetëm se u kthye e duke veshur pardesynë në koridor, foli mbytur:

- Bukur ishte!

Pas dhjetë sekondash ndodhej në rrugë. Po binte muzgu, një muzg manushaqe, i ftohtë e i errët, në qytetin që nuk i kishte ndezur dritat akoma. Krejtësisht bosh, profesor Boga vendosi të shkojë në laborator, por kur mendoi se atje mund të gjente studentë, u pendua. E kush iu përgjigjej kurioziteteve të tyre? Ndjente një tërbim ndaj Ritës, ndaj fjalë-mallkimeve të saj të hedhura alla mesjetarshë nëpër shkallë pas shpinës së tij, ndaj këtij përbindëshi të mallkuar vigjilent, që telefononte edhe nëpër agjencitë e fluturimeve ajrore dhe kaq mjaftoi t'i kujtohej telefoni i Almës. Pa u menduar asnjë çast Fredi hyri në hollin e Ministrisë së Turizmit dhe atje iu lut dezurnit ta lejonte të bënte një telefon. Pas dy sinjaleve dëgjoji zërin e Almës.

- Jam keq! - tha.

- Ku ndodhesh tani? - pyeti tjetra.

- Dy hapa larg, në Ministrinë e Turizmit ...

- Më prit, se erdha! - tha Alma.

Ai doli në bulevard, ndezi një cigare dhe çfryu përbrenda duke kundruar pishat përbri: Si po shkon kjo punë! ... Shkonte fjollë, si minë me sahat shkonte, hë të plaste këtu, hë të plaste atje, ndërkohë që ai nuk dinte ku të flinte sonte. E pati vendosur të nisej pasnesër për në Paris, por ishin edhe dy net në këtë kryeqytet të errët e të pisët, me kolerën nëpër këmbë, si ato lypsarët, që kërkonte jetë. Atëherë ai pa Almën të kapërcente rrugën.

Ishte e bukur, tmerrësisht e kolme dhe ecte duke u shoqëruar nga koka njerëzish të uritur që ktheheshin si me urdhër drejt saj.

- Ç'kemi, profesor? - e pyeti, sikur të mos kishte ndodhur asgjë një natë më parë, kur ata puthnin gjymtyrët e njeri-tjetrit dhe ku thithat e vogla të gjinjeve

të saj të bukur shpesh mungonin në inventarin e atij trupi të përsosur femëror.

- Kryevepër! - tha Fredi. - Më plehrë s'ka ku bëhet!

Alma i ra lehtë me pëllëmbë në sup.

- Të lutem, profesor! Mbas dy orësh e gjysëm duhet të dal në transmetim.

E mendoni ç'mund të ndodhë?

- Po, - tha ai. - Mund të prishet ekologjia e këtij vendi pa ekologji, por me

ministër ekologjie ...

Alma i futi lehtë krahun, thjesht për ta qetësuar, por aq duhej që ai të ndjente gjirin e saj të madh e të fortë diku pranë supit. Po e tërhiqte drejt një kafeje anës rrugës me flamurin shqiptar e atë amerikan në ballë të kryqëzuar e ngatërruar si për dreq, aq sa dukej sikur shqiponja po hante yjet e amerikanëve dhe atë kohë ai dëgjoji që ajo po fliste:

- ... Ti nuk je mirë ... Mërzitur ... Unë ... Mbrëmë ... Më ke lënë dhe shenja

...

- Ku? - pyeti Fredi.

Ajo qeshi. Nuk e mbante më për krahu.

- Vend sekret! - tha. - Mirë që më shpëtoi fytyra!

Në kafe ishte qetësi.

- Mbrëmë ke qenë e mrekullueshme, - tha ai. - Magjike dhe pa paragjykime

...

Alma pinte çaj.

- Unë jam e turpshme, - tha. - Mbrëmë e bëra vetëm për ty dhe ta dish që jam penduar...

- Unë nuk dua të kthehem më në shtëpi! - tha Fredi.

- Luftë?

- Po! Pasesër nisem për në Paris ...

Shpalosi fakset në tryezë.

- Paris, leksione, shkencë, honorare ...

- Ty nuk të duhen këto! Ti je i mërzitur, - tha Alma, - ti nuk je mirë ...

Fredi luante me fakset.

- Mbrëmë ishte vërtet nata e fundit?

Alma tundi kokën.

Tha: Po! Dhe shtoi: Unë pyeta sot për ty. Më thanë që ke një grua shumë të mirë dhe se tradhëtitë bashkëshortore nuk kanë qenë kurrë në natyrën tënde ... Ç'ka ndodhur me ty, Fredi, pyeti befas me një zë gati të përlotur.

Fredi shihte i përhumbur flamurin amerikan që valëvitej në qejf të tij e që s'merrej vesh ç'deshte në ballë të këtij lokali me klientë të pashpresë.

- U mërzita në këtë vend, - tha më në fund Fredi. - Më mërziti kotësija, më shkatërroi edhe ajo, me ato përkujdesjet e saja absurde ... Çdo gjë këtu më

duket gri ... Dua ta ndërroj jetën ... Eshtë jeta ime në këtë mes, dreqi ta hajë! Nuk paskam të drejtë të jetoj dy ditë, dy ditë të vetme tamam!

Atëherë Fredin e befaso! Alma.

- Pse nuk e ndërro me ndonjë moshataren tënde, profesor?

Unë nuk e ndërroj me ty! Je shumë egoist, profesor! Mbas 20 vjetëve kujtohesh që nuk ke gjetur ende dashurinë ideale?! Pse nuk pret edhe pak?... Ti je shkencëtar i madh, por s'arrin të kuptosh se paqja u shpik kur njerëzimi kuptoi se idealja nuk arrihet kurrë!...

- Nuk jemi kuptuar, - u mbrojti Fredi.

Alma u tendos në tryezë. Tanimë kurba e gjinjve i dukej më mirë, por ai e ndjeu se ato gjinj nuk i përkisnin më atij.

- Unë të kuptoj mirë, - tha Alma. - Ty të është mërziur familja. Do ta prishësh. Prishe! Me kë do ta ndërrosh? Me mua? Po a më kënaq, ti, mua, që jam 18 vjet më e vogël se ty? Unë dua të shkoj në koncert, me shërbim, në diskoteka, më pëlqen moda ... Nuk je realist, profesor! - përfundoi ajo.

Kur dolën në rrugë kishte rënë nata përfundimisht. Një natë e errët, e rëndë. Fredi iu lut Almës të qëndronte edhe pak, por ajo tundi kokën. Emisioni! Pastaj, tek po e puthte në faqe në ndarje, i tha ngadalë:

- Ti nuk më mërzi kur më telefonon, profesor, por mirë është t'i harrosh të gjitha. Ne u njohëm dje në aeroport, vetëm sepse ishte i sëmurë gazetari i rradhës ... Përndryshe ...

Dhe iku. Në atë vetmi aq të lakmueshme një muaj më parë dhe aq të urryer tani, Fredi nuk dinte se nga duhet të shkonte. Të mbytej në përroin e Lanës, të dehej në lokalet buzë Lanës, të flinte në hotelet buzë Lanës, të arratisë duke lundruar nëpër atë rrjedhë verdhamane e të pjerdhur të Lanës ... Mut, shau profesori dhe u nis për nga hotel "Dajti".

Rruga ishte thujse bosh, e shkretë, me ca vetura që vinin vërdallë dhe me një grup policësh që bënin në mes të shëtitores muhabet për qejf të tyre. Tamam përpara Hotel "Dajtit" Fredi ndjeu një zë ta thërriste. Ishte Helena. Ajo Helenë që s'dihej pse denjonte t'i fliste, po të kishte parasysh se si ia pat marrë shpirtin ca vjet të shkuara.

- Urime, profesor! - tha Helena duke i dhënë dorën. - Jam shumë e lumtur që më jepet rasti sot të takoj shqiptarin më të shquar ...

Fredi nuk iu përgjigj. Ishte vërtet më shquar, ishte një unazë super - e - shtrenjtë me brilante, por që askush nuk mund ta blinte në këtë vend të varfër. Kur ia tha këtë gjë Helenës, po pinin kafë në lokalin e Hotel "Dajtit". Helena vetëm sa buzëqeshi pak, shumë pak.

- Si të gjithë, - tha pastaj.

Pikërisht atë çast Fredi e pyeti Helenën për Ildën. Ku fshihej ajo bukuri e

çuditshme, që atij i ringjallte si me magji pikërisht atë dashuri ideale, që kishte parë e stërparë deri në detaje në mijëra ëndrra me sy mbyllur e sy hapur.

- Rrit fëmijën, - iu përgjigj Helena.

- Do kisha qejf ta takoja, - tha Fredi. - Mbase do të na e hiqte këtë mërzi të mallkuar që kemi...

Helena rrotullonte filxhanin e kafes nëpër suprinën e tryezës.

- Ilda është tip i komplikuar, profesor, - tha pastaj, - kam përshtypjen se nuk i pëlqen shumë shoqëria. S'i ka ecur martesë shumë ...

- Nuk bëra asnjë aluzion, - tha Fredi. - Pohova vetëm se më jep kënaqësi ai konstrukt femëror dhe ky nuk është mëkat. Por unë pasnesër do të shkoj rreth dy javë në Paris, mbase na humb mërzitia andej dhe nuk e shqetësojmë më as Ildën ...

Por ai e kishte përmendur në pesë fjali katër herë emrin e Ildës dhe Helena, që e njihte profesorin mirë, zgurdulloi sytë, pastaj u ngrit e shkoi në banak. Fredi e pa se si ajo kërkoi telefonin, si formuloi një numër dhe si ftoi pastaj qetësisht Ildën për të pirë një kafë në Hotel "Dajti". Kur erdhi në tryezë, tha thatë:

- Ilda vjen pas gjysmë ore këtu!

Fredi ndjeu një si të ftohtë përbrenda dhe u drodh. U drodh me kujdes, por përsëri Helena e ndjeu.

- Mos u emociononi dhe mos shpreso shumë, profesor!

Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi ... E kujt i duhesh ti kaq i mërzitur, - qeshi pastaj. - Të ikin orët e takimet vetëm duke u marrë me ngushëllime. Bëhesh aktor i mbaruar estrade ...

Fredi bëri me dorë një shenjë të papërcaktuar.

- Unë nuk jam i mërzitur, - tha, - unë jam fatkeq që më iku gjithë jeta dëm këtu, mes varfërisë dhe meskinitetit. I kam të gjitha dhe s'më duhet asgjë! Shiko! - ngriti zërin. Futu duart në xhepa dhe pas dy sekondave përplasi në tryezë një grusht me stërlina, dollarë e lireta. - Këto janë miliona! Miliona! Janë vetëm pare xhepi! Ku t'i prish! Pse t'i prish? Ç'do fitoj!...

Ishin vërtet shumë lekë, ishin shumë! Në atë çast ia behu në lokal Ilda, e cila u mek. pak nga profesori e pak nga grumbulli i kartmonedhave. Fredi i rifuti paratë nëpër xhepa dhe u ngrit t'i jepte dorën Ildës. I tërbuar, i rënë në grackën e inatit, nuk kishte më asnjë dëshirë të qëndronte më.

- Unë po ik! - tha prerë.- Po iu lë vetëm...

Helenës i iku goja. Po s'arriti të flasë asnjë fjalë, sepse ai ishte zhdukur. Ra si e sharruar në kolltuk dhe arriti të artikulojë vetëm një fjalë:

- Po ky, ç'pati?!

Ilda shihte e hutuar. Ajo s'po kuptonte asgjë. Kishte ardhur të pinte kafë me Helenën dhe për të më mirë që profesori kishte ikur. Por Helena tundi kokën

mohueshëm.

- Unë të telefonova, sepse ai kishte dëshirë të të takonte. Ne u ulëm për të pirë një kafë dhe ai fliste vetëm për ty ...

- Për mua?! - u tendos Ilda. - Po ç'punë ka ai me mua?!

Mirëpo në çast iu rikujtua në kujtesë mbrëmja e filmit rus dhe ajo ndarje e çuditshme.

- Ai diçka ka, - tha Helena. - Eshtë shumë i mërzitur dhe sonte më shpjegoi se ti mishëron atë dashuri ideale që ai ka ëndërruar gjithë jetën ...

- Budallallëqe, - qeshi Ilda.

Kam mjaftoi që të binte heshtja. Por shumë shpejt e theu Helena.

- Ti, e pe Euronjuzin para ca ditësh?

- Nuk e shikoj kurrë! - tha Ilda.

Helena tundi kokën.

- Nxorën Fredin, - tha pastaj. - Ka bërë një zbulim të madh dhe mund të marrë edhe Nobel pas ca vjetësh ...

- Ti ia fut kot, - qeshi Ilda, - gjithmonë ke qenë një tip i llahtarshëm eksagjerues ...

- Jo! - tha Helena. - E ka parë e gjithë Tirana. E kishte ftuar edhe kryeministri për darkë, po Fredi nuk kishte shkuar ...

Ra prapë heshtja dhe këtë herë ishte Ilda që foli e para:

- Po unë ç'hyj në këtë mes?

Helena ngriti supet. Edhe ajo ishte konfuzë. Në të vërtetë, s'kuptonte asgjë se ç'bëhej dhe gjithçka do t'i ngatërrohej më keq, sikur të kishte mundësi e ta shikonte Fredin atë çast duke pirë vodka te kafë "VIP" me një studenten e tij bukuroshe, gjë që ai s'e kishte bërë kurrë në jetën e tij si profesor.

Ilda me Helenën qëndruan edhe pak, pastaj u ngritën. Në atë copë rrugë që i ngeli për ta bërë vetë me këmbë, Ildës iu rishfaq Fredi, ai portret i zgjuar e ironik njëherësh, ajo gojë që bezdisej kur hapej për të folur dhe syri që nuk i shpëtonte asgjë. Qeshi lehtë, pastaj u ribë serioze kur kapërceu pragun e apartamentit.

9.

Te "VIP"-i ishte rrëmujë. Zëri i Fred Merkurit ngatërrohej me zërat e klientëve që hynin e dilnin parreshtur dhe me ato të kamerierëve që hidhnin bonot në banak. I ulur në një nga stolat rrotullues të banakut, Fredi pinte vodka përkrah

me studenten e tij shkodrane të vitit të dytë. Ajo ishte një vajzë e talentuar dhe një brune e bukur, që kishte konkurruar një herë për miss Albania, por që skualifikuar menjëherë, pasi i kishte thënë regjisores së spektaklit se të preferuarat e saj se pse vinin erë urine e sperme njëherësh. Ishte një djall i vogël, hollak, që gjerbte kampari soda dhe tallej gjithë lezet me Fredin. Profesori nuk ndjehej. Vetëm atëherë kur puna po bëhej fare baltë, iu kthye studentes dhe i tha ngadalë:

- Faleminderit për shoqërinë. Tani unë po ik. Po të duash të pish ndonjë gjë tjetër, porosite, se do të paguaj ... Provimin nuk do ta japësh me mua...

Zeshkania u fye. E ndjeu se ujku plak e kishte paguar thjesht për shoqërim. Tip prostitute, pra! Apo, damë kalorësiake shoqërimi? Merrej vesh, nuk i pëlqeu aromatiku mesjetar.

- Profesor, edhe unë do të dal, - tha ajo, megjithëse nga një tavolinë përbri një djalë i bënte vazhdimisht shenja.

Fredi pagoi dhe dolën. Ora ishte 21. Orë muti, shau ai me vete, duke kuptuar për herë të parë qartë dhe dhimbshurisht fatkeqësinë e çifutëve të mbetur 2000 vjet pa shtëpi. I vetëm, në orën 21.00, ishte si i dënuar me shfarosje në këtë qytet.

- Ku do vesh, profesor?- pyeti zeshkania.

- Në laborator, - tha Fredi dhe citoi Naimin gjithë qejf e pasion: Punëpunë natë e ditë, që të shohim pakëz dritë ... Dritë leshi, tha pastaj, në këtë qytet ku kolera të përshëndet "mirëmëngjes, i dashur", "mirëmbërëma, bir"...

- Do punoni? - pyeti tjetra.

Fredi qeshi hidhur. Alkooli i kishte rënë në kokë dhe i ftohti po bënte punën e vet.

- Jo, - tha me ton patetik, - do të bëj dashuri me instrumentet!

- Të mërzis po të vi edhe unë me ju? - pyeti zeshkania. - Më duket shumë interesant hobi i juaj...

Ku ka hobi në këtë vend, mermëriti me vete ai, duke sjellë si argument për tezën e tij vetë fjalën e huaj "hobi". Shqipja sikur nuk kishte qejf ta formonte ende në këtë fundshekulli një fjalë të sajën për të emërtuar këtë fenomen pannjerëzor.

- Pse jo! - tha Fredi. - Ti je studente e mirë. Po mos ishte në këtë batak, do të ishte gjeni, në ndonjë laborator bërthamor. Veç në laborator bën shumë ftohtë, - shtoi ai.

Dhe i vetmi element bërthamor në atë punishte ishte shprazja e gazrave njerëzorë!

Zeshkania nuk foli. Ajo i futi krahun profesorit aq të

largët e kozmik në fakultet dhe e drejtoi për nga laboratori. Fredi mori ca pako lajthi cigare e një shishe "Kampari", pastaj hapi derën, që gërrvinte nga

ndryshku.

- Hajde, xhan! - ftoi zeshkanen.

Brenda ishte ftohtë, por, pasi ai ndezi rezistencat, laboratori u ngroh. Zeshkania lau nja dy epruveta dhe gjithë duke u dridhur e duke futur duart në gjinj u ul përballë tij. Fredi nuk ia ndante sytë. Pastaj pa duart e tij.

- Unë kam ftohtë, - tha, duke kujtuar gjyshen e tij në kohën e fëminisë, që ia mernte duart e mardhura dhe ia fuste në gjinjtë e rreshkur. - Si t'i ngroh duart?

Zeshkania nuk foli, vetëm u ngrit nga vendi i saj, i erdhi Fredi përballë, iu ul në gjunjë dhe ia mori duart. Ngriti ngadalë bluzën me gjithë kanotiere dhe ia çoi duart e flohta te gjinjtë e saj të ngrohtë. Kishte gjinj të vegjël e të fortë, ndryshe nga të Almës, mendoj turbull Fredi. Ndjeu t'i ngroheshin duart dhe shpirti njëherësh. Ai shtrëngoi ngadalë ata gjinj të fortë vajze, pastaj u zgjat drejt zeshkanes. E puthi dhe befaz u përplot. Ndjeu në qafën e vajzës atë aromë trupi e flokësh të veçantë, atë aromë që përfundimisht nuk i takonte më atij, kujtoi se pikërisht një aromë të tillë shpërndante edhe Rita e tij 20 vjet më parë, dhe gëlltiti lotët përbrenda. Pastaj tërhoqi duart, vuri pëllëmbët e hapura në trupin e zeshkanes të eksituar e habitur njëherësh dhe tha ngadalë:

- Ky është gabim! Është faji im! Të lutem, më fal!...

Zeshkania nuk kishte ndërmend të tërhiqej. Ajo ia rrëmbeu kokën me vrull dhe nëpër ato puthje të zjarra Fredi iu dorëzua sërish pasionit. Bashkimi i tyre ishte i egër. Vajza kafshonte buzët që mos nxirrte asnjë tingull nga goja, pastaj, kur ndjeu se orgazma po afrohej, u tërhoq vrulltas dhe i ktheu shpinën profesorit. Fredi i pa kofshët e bukura, vithet të përkulura në mënyrë provokative dhe megjithëse e kuptoi se vajza po pastrohej, u ngrit e iu ngjiti ngadalë nga pas. Këtë herë vajza rënkoi. Lëvizjet e saj ishin magjike, i buronin nga shpirti dhe gjithë kjo mrekulli këtë herë vazhdoi gjatë.

E lodhur, e bukur, e prerë, vajza iu ul përsëri në prehër Fredit. Mbante një epruvetë me kampari në gishtërinjtë e hollë, e gjerbte herë pas here, pastaj kujtoi provimin ...

- Më fal! - i tha Fredi.

Vajza e ktheu kamparin me fund.

- Ju keni të drejtë, - tha pastaj, - që ne jemi fatkeqë në këtë vend. Këtu nuk ka vlerë as mençuria, as bukuria... Mua më propozoi një ministër hajvan me surrat diagonal të punoja si sekretare e tij me një rrogë legale e ilegale fantastike ... Pse më zgjodhi mua? Që t'ia fshija me trupin tim pluhurat e tapetit e të tavolinavë... Për seks më ftoi ... Këtu janë të gjithë të uritur, profesor, uria pastaj i ka bërë hajdutë ... Vjedhin para, seks, gjithëcka...

Zeshkania ishte e përplotur. Fshiu sytë me mëngën e trikos, ndolli hundët, pastaj bëri të ngrihet. Fredi e shtrëngoi.

- Prit! - i tha. - Unë do të shkoj pasnesër në Paris. Mund të rregulloj ndonjë bursë për ty...

Tjetra qeshi hidhur.

- Jo, profesor! Ta zëmë që u zgjidh halli im. Po i joti, po i të tjerëve ... Lëre, - bëri pastaj me dorë duke ndjellur hundët rishtaz, - ne jemi të gjithë të humbur! Puna është të ndryshojmë diçka në këtë vend ... Edhe andej, veç për prostituta na duan, tani na doli nami...

Fredi dëshironte ta qetësonte vajzën.

- Unë jam optimist, - tha.

Por mori si përgjigje një tundje koke mohuese, ndërkohë që vithet e vajzës po bëheshin sërish provokuese.

- E di ç'më kanë parë sytë para një jave? - e pyeti ajo. - Shkuam me kursin në malin e Dajtit. Rugës na bllokoj bora e papritur. Mbetën në grackë rreth 40 makina. Ne dolëm e po luanim sa të hapej rruga dhe filluam të shohim edhe ata që kishin ngelur bashkë me ne në dëborë. Unë kam parë atje ministra, drejtorë të mëdhenj, deputetë ... Të gjithë ata këрма fodullë me dashnoret, ca vogëlushe që ata horra nuk i kishin parë as në ëndërr... Këta nuk e ndryshojnë dot Shqipërinë, profesor! ... Janë të gjithë imoralë!...

Ai nuk kishte argumente për ta kundërshtuar këtë krijesë që të dukej aq futurake e moskokçarëse në koridoret e fakultetit. Asgjë ngushëlluese nuk mund t'i artikulonte, përveç se ta shkrinte, nëse do të mundte, edhe një herë në ekstazën e harresës. Duart e tij rifilluan të enden ngadalë nëpër kofshët e tendosura, nëpër ato guva të fshehta këmbësh e krahësh dhe kur buzët e tij filluan të thithin si foshnje gjinjtë e saj, vajza u përpoq ta largonte. Por Fredi nuk dëgjonte më. Kishte vetëm një kuje brenda trupit të tij, që nuk donte ta nxirrte e t'ia shihte kush.

Ishte mesnatë. Vajza rënkonte e lidhur pas trupit të tij, duke u ngrohur e ftohur nëpër këtë orgazmë të vonuar prej mashkulli të lodhur dhe papritur tha atë fjali që Fredi nuk e priste:

- Profesor, të lutem, mos i trego kujt!...

- Unë nuk jam si ata, plehrë, - rënkoj Fredi. Pastaj e pushtoi si të donte t'ia thyente eshtrat dhe ajo ndjeu peshën e këtij mashkulli tragjik në trupin e saj. Rënkoj përsëri, këtë herë e pushtuar nga epshi, dhe s'u përmbajti më. Gulçet dhe pasthirmat e saj mbushën laboratorin e vogël, hynë nëpër raftet e shkencëtarëve të harruar, bënë lëmsh studimet dhe në fund i bekuan me një britmë "O Zot"!

Edhe Zoti kujtohej e respektohej veç kur bëhej ajo punë. Kishte mbaruar gjithçka. Dihasinin të dy. Më në fund vajza u ngrit, u pastrua, tha "rruga e mbarë, për Paris", u mblodh kutullaq në një kolltuk dhe sakaq fjeti. Flinte. Fjeti e trishtuar, mendoj Fredi.

Ai qëndronte duar hapur, me organin seksual jashtë, kokëvarur dhe ai,

qëndronte në një hapësirë boshe ku kujtesa nuk afronte asgjë. Pastaj edhe ai mërmëriti "rruga e mbarë, për Paris" dhe fjeti. Në mëngjes e zgjoi vajza. Zeshkania dukej përsëri e freskët, po ndjehej që diçka kapërdinte me mund.

- Profesor, - foli më në fund. - Do t'ju lutem për diçka...

Parisi, mendoj gjakftohtë Fredi.

- Patjetër!

- Mbrëmë unë nuk të kisha profesor, ty! Do të ishte shumë fyese për mua, po të mendoje se fjete me një nxënësen tënde...

Fredi u prek. E tërhoqi drejt vetes, e mblodhi në gjoks si mikun e vet më të ngushtë dhe i mërmëriti nëpër flokët e dendur:

- As, ti, mos e shko nëpër mend që unë isha mbrëmë profesori jot!...

-Amen! - bekoi vajza.

Ajo ishte katolike. Kurse unë jam një idiot që nuk kuptoj asgjë, mendoj ai, një idiot i gozhduar te ideja se të gjithë duan të përfitojnë prej meje dhe, kështu, kthehem e shndërrohem në një iriq, për të ruajtur hiçin tim të madh, deri sa të asfiksohem nën gjembat e pafund.

10.

Amen, tha dhe Rita. Ajo ishte ortodokse dhe s'kishte besuar kurrë, por ftohja e Fredit, irritimi i tij, arratisja e fundit e bashkëshortit të njohur, arratisja absurde, që s'kish ndodhur kurrë, e patën detyruar të shkojë te një fallxheshë. Ajo ishte mesogrua, me ca sy vëngëroshë dhe veshë pallaveshë. Ia pa filxhanin pa ia hedhur sytë, gllabëroi lekët në xhep, pastaj i tha ngadalë:

- Ke një burrë të famshëm. S'është në shtëpi. Ai bredh. Por do të kthehet shpejt. Mos e prit ti! Nxirri vajzat! Dhe mos i bëj sherr, se do të qajë ai i pari... Ke një armik, një "I" e madhe të del. Kjo ta ka zënë rrugën për në shtëpi të burrit. Je dhe shumë e pasur! Kaq! - tha fallxhorja.

-Amen - ia ktheu Rita duke gëlltitur lotët. I vinte turp që ishte ulur kaq poshtë, sa të paguante para për të parë fatin e saj, kishte frikë nga kjo grua e egër të qante, po fjalët i pëlqyen.

Sikur të ishte ashtu! Kur u kthye në shtëpi, Rita gjeti vajzat duke luajtur me dy kukulla të mëdha, të bukura e llapazane, që sa herë i ngrinje ndenjuri flisnin. Vajza e vogël, me një sy të madh e të zgjuar, i tha shkurt Ritës:

- Babi! Ka lënë një zarf te frigoriferi!

Rita mori zarfin me duar të dridhura. E grisi me kujdes dhe pa ç'kishte brenda. Rrëshqitën një mijë stërlina, kartmonedha që ajo nuk i kishte parë kurrë, pastaj një copë pusullë. "Unë nuk kthehem më. Sot u nisa për Paris. Fredi. PS. Puthi vajzat, të lutem".

- Çfarë ka shkruajtur? - pyeti vajza e madhe, kur pa Ritën ta fuste letrën në xhep.

- Që të rrini urtë të dyja! - tha prerë Rita.

Pastaj ajo mori telefonin. I dashuri i saj i mallkuar do të udhëtonte me "Suisair"-in. E hëngri turpin me bukë, kur luajti rolin e budallait dhe pyeti se kur do të kthehej i shoqi. Iu përgjigjën se ai kishte marrë një biletë të hapur. Por vajza matanë linjës u tregua e gatshme ta lajmëronte, duke kërkuar emrin e Fredit në listat e kompjuterit, gjithmonë nëse ai do të kthehej me "Suisair"-in. Rita e falenderoi. Mbylli telefonin dhe qau në koridor, që mos e shihnin vajzat. Kishte folur në telefon me Ildën.

Ajo vajzë e bukur në skajin tjetër hodhi sytë nga Muzeu Historik Kombëtar. Ishte dita e parë që kishte filluar punën pranë kësaj shoqërie ajrore dhe gjithçka pati nisur ters. Hodhi emrin e Fred Bogës në kompjuter, ia zgjati sekretares së zviceranit hollak dhe iu lut ta lajmëronte menjëherë, me të figuruar në listën e pasagjerëve që do të ktheheshin në Tiranë. E kërkonte kryeministri. Ishte kohë e keqe, kohë e ndyrë, kohë mizerabël. Gri dynjaja. Ildës iu kujtua profesori i famshëm, ato largimet e tij të çuditshme, biseda e lënë përgjysëm për ngjashmërinë e saj me dikë, Helena dhe kaq mjaftoi mos i punohej më. Gjithçka konsumohej në boshllëk. Zvicerani e shihte nga këmbët, vjehrra e shihte nga sytë, i shoqi e shihte si vishej, vajza ia nxinte jetën... Kujtoi dëshirën e saj në fakultet për t'u bërë sociologe, ëndërrat e bukura për t'u ngjitur në lartësitë më të mëdha, si paralajmëruese e fenomeneve që do të ndodhnin nesër, pa fytyrat e lodhura që çapiteshin në rrugë apo pinin birrë të qelbur në lokalet e pafundme dhe sepse iu kujtua DIVORCI. Kjo botë po shkonte drejt divorcit. Me dashurinë, me prindërit, me miqtë DIVORC. Kjo ishte gjithçka. Ajo mori telefonin dhe formuloi një numër. Fred Boga duhej të telefononte menjëherë në zyrën e "Suisair"-it në Tiranë. Dy orë më pas, kur ai telefoni nga aeroporti i Parisit, Ilda ndjehej e dërrmuar. Tani i qe mbushur mendja se DIVORCI nuk ishte zgjidhje fort negative, por puna ngelej te fakti i thjeshtë, se shqiptarët vetëm DIVORC nuk kishin guxim të bënin, bile, që këtu rridhnin gjithë fatkeqësitë... Dy orë kishte menduar se si vritej bukuria në këtë vend të stërvjetër me plot politikë dhe shumë grotesk dhe me aq shumë moralizime e dëshmorë moralsa, që kompesonin mungesën totale të moralit... Kishte parë trupin e saj në sfilatat e botës, fotografët përreth dhe kishte dëgjuar zërin e të shoqit t'i hakërruhej: "u bë dhe bytha jote..." Gjithçka ishte kot. Një më hu e një më kërcu! Martohu,

lind kalamaj, aborto, laj e shpëlah, fshi bythën me diplomën dhe gjuhët e huaja...

- Këtu "Suisair"- tha ajo me të ngritur receptorin.

- Jam Fred Boga, - u dëgjua një zë fare i afërt, - më thanë të telefonoj në këtë numër ...

- Zoti Boga, - ia nisi Ilda, - bashkëshortja juaj dëshironte të dinte datën tuaj të kthimit, sepse kryeministri ynë ka për të planifikuar një takim me ju ...

- Po ta dija, do t'ua thosha, - foli tjetri pas një pauze, - por një përgjigje mund të ishte edhe që Boga s'kthehet më ...

Ilda qeshi.

- Këtë nuk e besoj! Mos keni harruar gjë patriotizmin në avion, megjithëse unë nuk kam asnjë sinjalizim këtu...

- Pse jeni kaq e sigurt që edhe unë jam patriot? - pyeti Fredi.

- Sepse ju do të pini një kafe me mua ...

- Si iu quajmë, - tha Fredi.

Ilda qeshi përsëri.

- Më quajmë Ilda Mazreku, - tha pastaj, - jam vajza e tezes së Helenës ...

- Më mirë hajde, ti, në Paris, - u gjallërua Fredi. - Gjithçka është gratis ...

- Jo! - tha Ilda. - Unë nuk shijoj dot asgjë larg Shqipërisë. Nuk më shijon kafeja pa kolerë e pisllek...

Dhe nuk e merрте vesh se pse i hyri gjithë këtyre koketërirave.

- Mirë! - pranoi Fredi. - Ndoshta pas tre javëve do të kthehem. Megjithëse kryeministri ynë nuk ka ndonjë punë, unë do t'iu telefonoj nga Parisi para nisjes ... Ju diçka më kujtoni...

- Edhe mua personi i juaj, profesor!

- Çfarë? - pyeti Fredi.

- Mirupafshim! - tha Ilda dhe mbylli receptorin.

Jo! S'ishte gjithçka gri. Se nga buronte një si dritë, që ngjyroste gjithçka përreth. Ilda ishte e eksituar e gjitha. I vinte për të qeshur e qarë njëherësh, i vinte turp nga vetja e miklohej nga koketërija që kishte treguar. Nuk do të ndodhte asgjë, natyrisht, një kafe edhe mund t'ia pinte profesorit, por kjo nuk përbënte asgjë të amoralshme. E, megjithatë, pak turp ishte. I ndodhte për herë të parë kësaj vajze që e la virgjërinë tre vjet më parë natën e martesës në hotelin e Pogradecit, në një natë ters, ku në dhomë mungonte edhe uji për t'u pastruar dhe duart e të shoqit mbanin erë peshk... E përçmonte seksin dhe vetëm nëna i kishte thënë një herë si shkarazi se përvoja do të ëmbëlsonte gjithçka. Po profesori? Ai me siguri ka përvojë, mendoi turbull. Gjithë ato admiruese të reja nëpër këmbë... Pastaj shau veten "idiote!" E ç'i hynte në punë asaj? Ama, të shoqit iu hakërrua në drekë, kur tentoi t'i afrohej në shtrat. Ndërsa në ëndërr...

Ilda nuk i tregoi Helenës për telefonatën, por, kur shtypi shqiptar shkroi editoriale për gjeniun Boga dhe sukseset e tij në Paris, ajo fiksoi atë që tha Helena:

- Ai nuk i ka mirë punët me gruan ...

- Si të gjithë,- ia ktheu Ilda shpërfillshëm,- ne të tjerët bëjmë sikur i kemi mirë, si demagogë klasikë që jemi ...

Veç diçka donte të dinte.

- E di që je zbukuruar, - vërejtí Helena.

Ilda bëri një shenjé shpërfillshëm me dorë.

- Se mos ka vlerë bukuria këtu! - tha.- Këtu bukurija të duhet vetëm për të hyrë në punë...

Por kur Fredi telefonoi nga Parisi dhe e lajmëroi se do të vinte të nesërmen, ajo u pa vetëtimthi në pasqyrën e madhe të zyrës. Iu lidhën fjalët dhe atë çast kuptoi ç'budallallëk kishte bërë atë ditë në telefon. Tjetri duket diçka ndjeu, megjithëse ndodhej aq larg.

- Me kryeministrin do ha darkë, - qeshi, - me ty ... një kafe! - tha pastaj. Dhe shtoi gjithë duke u tallur: Me bandë do të më prisni?

Ilda u gëlltit.

- Më vjen keq që nuk do të ndodhem në ceremoninë zyrtare, - qeshi, - por orari i punës ...

- Mos u mundo, - e këshilloi tjetri, - do të vi unë vete pranë personit tuaj. Kam edhe një dhuratë simbolike për ju...Kurse bandën mos e thërrisni kot: ata nuk i kanë rënë kurrë dy herë njësoj Hymnit Kombëtar. Ka rrezik të më presin me ndonjë këngë rakije, sa t'ia mbathë edhe shqiponja nga flamuri...

Ishte mbyllur telefoni dhe Ilda e kapi veten duke u parë në pasqyrë.

Dhuratë simbolike ... Kafe ... I merrreshin mentë dhe i vinte si të përzier. Ndjente frikë nga profesori. Ndjente një frikë të pashpjegueshme nga gjithçka. U ngrit për të shkuar në banjë, por edhe atje e kapi veten duke kundruar kofshët ende të pazbardhura mirë nga dielli i verës së shkuar. E hëngra, më duket, mëmëriti, veç, nga ana tjetër u betua se me profesorin do të pinte vetëm një kafe, një kafe të vetme! Ildës nuk i punohej më. Ajo priti me vetëmohim orarin e mbylljes së zyrës dhe menjëherë zbriti te kafe "Çaplin". Ishte muzg, me dy-tre tavolina me klientë dhe me një muzikë klasike që gati-gati të vinte në gjumë. Ajo dëgjoí turbull porosinë e tavolinës më pranë...Një kafe, një konjak me limon, një birra të madhe, një lëng qershije, një lëng molle...Të gjithë veç, kurse vargu i parë i Hymnit Kombëtar:

ç'absurditet! "Rreth flamurit të përbashkuar"...E ku bashkohej njeri këtu, jo më të përbashkohej! S'dinte ku të shkonte. Ladi, i shoqi, ishte nisur mbrëmë për në Sofie. Ai merrej diçka me tregti dhe Ilda u pendua që nuk shkoi me Ladin në Bullgari. Tani shihte muzgun që bëhej gjithë e më i errët, më pis, pa ditur si t'i shtynte orët e vdekura, ndërkohë që në Paris Fred Boga sapo kishte zgjedhur një komplet rrobash të brendshme të mëndafshita për femra, aq të shtrenjta, sa shitësja e butikut e pa me admirim. Edhe ai nuk dinte ç'të bënte në kryeqytetin e madh të pushtuar nga dritat. Mirë do të ishte t'i hypte ndonjë avioni e t'ia mbathte qysh atë moment për në Shqipëri. Po duhej të priste deri nesër. U ul në një restorant italian, porositi verë me picë kalabreze dhe s'mendoi më për asgjë.

Ndjehej i lodhur. Dhe kishte ankth. Një ankth e padurim të pashpjegueshëm.

12.

Dy ditë më pas Fredi u shfaq në zyrat e "Suisair"-it. Kishte veshur një kostum elegant, që vetëdinte nën pardesynë e shtrenjtë. Ilda u trondit kur e pa dhe nëpër atë alarm vendosi mos t'i afrohej shumë. Por s'pati forcë ta largonte profesorin, kur ai e përqafoi dhe e puthi në faqe, duke i dhënë dorën. Fredi la një pako në tryezë, nuk u ul, i kërkoi falje që duhej të ishte pas pesë minutave në leksion, i premtoi se do ta merrte në telefon dhe sakaq ishte zhdukur. Ilda ra si e sharruar në kolltuk. Pastaj jo pa kuriozitet hapi pakon e madhe, por e mbylli e tronditur në çast. Një minutë më vonë ndodhej e kyçur në banjë. Këmisha e natës, reçipetat, mbathjet e mëndafshita i rrëshqisnin në gishtërinj. S'kishte parë kurrë veshje kaq të bukura, as në filma dhe i erdhi për të qeshur kur konstatoi se masat ishin tamam të sajat. Qeshi edhe një herë, pastaj u betua se tanimë as një kafë nuk do të pranonte të pinte me Fredin. Tani punët ishin me rrezik! Shumë intim po bëhej profesori dhe, ç'ishte më e keqja, ia pati bërë anatominë mirë fare, a thua e kishte zbërthyer copa-copa...Numuri i rexhipetave: tre e gjysmë...Fiks! Por masat e trupit një femre ia njeht saktësisht vetëm mashkulli që e dashuron!... Kurse Fredi hynte moskokçarës në leksion. Ai dalloj zeshkanen diku andej nga fundi, i qeshi lehtë dhe filloi leksionin. Një orë e gjysmë më pas, ndërsa auditori boshatisej, ai e ftoi vajzën për drekë. Shkuan në një restorant luksoz diku pranë, dhe, teksa bëhej gati të paguante, Fredi nxori një palë vathë të florinjte nga xhepi. Ia zgjati tjetrës me një pamje prej fajtori dhe gati iu lut, kur i tha.

- Po të pëlqyen, pranoji!

Vajza nuk foli. I nguli vathët në veshë dhe i tha po aq ngadalë:

- Nuk do të lejoj njeri të më puthë ne veshë! Betimi: vath në vesh!

Fredi e falenderoi. Pastaj pa orën dhe iu lut të ngriheshin. E prisnin në Televizion për të regjistruar një emision. Ai u tall pak me veten dhe vajza lëshoi një gurgullimë të qeshurash. I tundeshin vathët nëpër veshë.

- E dini, profesor, - tha pastaj tek po ndaheshin, - meqë s'do ta jap me ju provimin, jam në dispozicionin tuaj kur të dëshironi! Por jo më në laborator! Akoma e kam trupin plagë...

Mori një buzëqeshje si përgjigje. Vajza e shoqëroi një copë rrugë me sy, pastaj u nis drejt konviktit. Ishte i mirë ky njeri, por pa fat. I trishtuar. I sëmurë nga mërzia. Kaq dinte ajo! Ajo nuk dinte që atë kohë Alma po grimohej në studion e ftohtë televizive, duke pritur Fredin. Do ta intervistonte dhe ndjente një bezdi e padurim. Kur Fredi kapërceu pragun e studios, bëri sikur nuk e njihte Almën. Iu përgjigj gjithë kortezi kërkesës së saj për të konsultuar pyetjet dhe kërkoi me mirësjellje që emisioni të kishte sa më pak politikë.

Alma e pa njëherë rrëshqitazi, pastaj qeshi lehtë.

- Dakort! - tha.

Regjistrimi kaloi mirë. Mbas një ore Fredi ishte përsëri i lirë. Ai mori në telefon vajzat dhe i ftoi për darkë.

- Po mami? - pyeti e madhja.

- Patjetër! - tha Fredi. Ishte në qejf.

- Në orën shtatë iu pres te kafe "Evropa", - tha, - por mos u vononi! ...

Ndjeu se dikush po e vëzhgonte në atë holl të zbehtë të Televizionit dhe, kur ktheu kokën, dalloi Almën.

- Paqe? - pyeti ajo.

- Paqe s'ka kurrë mbi dhë, - profetizoi Fredi, - paqe ka vetëm në varr! Një kafe? - pyeti pastaj.

- Jo! - refuzoi Alma, - Kam plan tjetër!

Ajo i bëri një "mirë u pafshim" me dorë, por pas dy hapave u kthye përsëri.

- Mos na telefono vetëm kur je i mërziur! - tha. Dhe iku.

Fredi pa orën. Duhej edhe një orë që të dilte Rita me vajzat. S'kishte asnjë dëshirë t'i fliste Ritës, por nuk donte t'i trishtonte vajzat. Rita tani i dukej e largët, thjesht një kujtim i hidhur, një prangë në jetën e tij me kaq pak liri e gëzime. Ai u nis drejt "Kafe Evropës" dhe gjëja e fundit që mendoi ishte Ilda. Ç'kishte menduar për dhuratën e tij idiote? Atë që unë jam hajvan, iu përgjigj vetes. E imagjinoi atë trup të zhveshur e të futur në ato mrekulli mëndafshi pikërisht atë kohë kur Ilda sapo kishte veshur dhuratat e tij dhe po shihej në pasqyrë. Shkëlqente

e tëra dhe pikërisht ky shkëlqim e mërziit vajzën e bukur. Në tokë ishin ndërresat e saj modeste, dhuratë e kësaj bote të vjetër për të, ndërresat e saj të përjetshme, që modernizoheshin aq ngadalë në modë e cilësi. Ajo e ndau mendjen që t'i thoshte Ladit se gjithçka e kishte blerë të "Benetoni" dhe, përpara se të rindërrohej, iu kujtua përsëri fakti i çuditshëm, që profesori nuk kishte gabuar në numrin e tyre. Gjithçka ishte e saktë! Pikërisht në orën shtatë të mbrëmjes Fredi pa vajzat të hynin në kafe. Ishin vetëm. Ritës i dhimbe koka dhe s'dilte dot. Fredi nuk foli. Mori vajzat përdore, duke u drejtuar nga restaurant "Perla". Hëngri me oreks, i la kamerieres një bakshish të mirë dhe vendosi që të kërkonte duke filluar nga e nesërmja një apartament me qira diku në qendër. Boll më, tha me vete.

13.

Dhjetë ditë më pas, kur Fredi i telefonoi Ildës dhe i kërkoi një rezervim bilete, ai kishte kaluar në apartamentin e zënë me qira për një vit. Zeshkania me disa shoqet e saj ishin robëtuar, deri sa i pastruan çdo rrëzë atij apartamenti të vockël e komod, pranë Parkut Kombëtar. Hapësirën boshe mes mureve, të braktisur dy vjet më parë nga një familje refugjatësh, zeshkania e mbushi me lule e piktura. Ajo vuri edhe një portret të saj, që ia kishte vizatuar një piktor i njohur, edhe ai refugjat tani në Itali, ndërsa Fredi bleu një dhomë gjumi dhe instaloi në kuzhinë kompjuterin me faksin. I pa shqetësuar tashmë nga askush, ai i ishte rikthyer punës.

Kur Fredi u ul para Ildës dhe, teksa i përgjigjej formaliteteve, i tregoi adresën e re, ajo ngriti sytë dhe e pa me dyshim.

- Jeni zgjeruar me shtëpi? - e pyeti,

- Jo! - tha Fredi. - Por tani mua më duhet të punoj shumë dhe kështu që banoj në studio ...

- S'ka si puna, të qetëson! - u tall Ilda.

- Po, - tundi kokën ai, duke bërë sikur nuk e kuptoi ironinë, - the një gjë të zgjuar!

Ilda ndërkohë e kishte plotësuar biletën. Ajo ia zgjati dhe teksa ai ia kapi lehtas gishtërinjtë duke e ftuar për një kafe, mori një përgjigje mohuese me kokë.

- Edhe unë kam shumë punë, - qeshi ajo. - Këtë herë mos u harxhoni me dhurata simbolike, profesor!...

Fredi ishte ngritur në këmbë. Edhe ai mendonte se puna duhej respektuar, por ai po e priste te kafe "Çaplini", deri sa ajo të lirohej. Dhe iku. E habiste ky njeri Ildën. Kishte një sjellje të çuditshme, jashtë këtij vendi. Nuk ofendohej kollaj

dhe e luante për bukuri rolin e budallait. Ajo e ndoqi me sy deri sa ai hyri në kafën luksoze me xhama të errët dhe, kur pa që ai shtyu portën e qelqtë, ndjeu një ngushtim në gjoks. Pastaj u mundua t'i jepte zemër vetes, tek e uroi tjetrin: "Të bëftë mirë!" Nuk do të shkonte, por shumë shpejt e kuptoi se ishte ajo që po vëzhgonte derën e kafes. E pse mos shkoj, pyeti veten pas një ore, ulje për mua nuk është, sepse unë nuk i thashë që nuk do të vij!...

Ajo u vesh ngadalë, bëri pak tualet gjithë aq ngadalë, duke shpresuar se tjetri do të mërzhitej e do të ikte, dhe më në fund doli. Në kafe ishte vetëm Fredi. Ai luante me një çakmak në gishtërinj, me një xhin të madh e vezullues përpara. Kur e pa Ildën të vinte, u ngrit në këmbë. I dha dorën tjetrës, pastaj e puthi vrulltas në qafë, a thua s'ishin parë prej muajsh. Ajo u drodh e u skuq njëherësh.

- Ç'bën, profesor? - e pyeti me një zë të trembur, duke u ulur me ngut. Fredi heshti.

- Unë të dua! - tha pastaj krejt befas, ashtu, qetësisht, siç e porositi pak çaste më pas një "Martini" për Ildën.

Ilda priti të largohej kamerieri.

- Kjo nuk ka kuptim, - tha me një zë të mbytur. - Ju nuk më njihni mua.

Unë s'iu kam dhënë asnjë shenjë ... Pastaj ... të dy kemi familje - shtoi në fund.

- Unë të dua! - përsëriti Fredi.

Ç't'i thoshte tjetër kësaj zonje të re? Që e kishte ëndërruar gjithë jetën, që e shihte në ëndërr, që vetëm kujtimi i emrit të saj e trondiste? Që nuk i shkohej më në shtëpi pikërisht prej kësaj Ilde? ... Pse mos ia tregoj të gjitha, pyeti veten pastaj. Dhe kaq mjaftoi që të hapej i gjithi. Kur Fredi mbaroi, Ilda nuk i ngrinte sytë. Ndihej e rraskapitur. E lumtur dhe fajtores.

Më në fund ajo foli një fjali. Tha:

- Kam shumë frikë, Fredi!

Dhe në çast u ngrit e iku. Rruga i vinte turbull në sy. Diçka edhe rrotullohej, ndërkohë që zemra i kërciste, aq sa rrezik ia dëgjonin kalimtarët. S'dinte ç'të bënte me këtë njeri të çmendur! Me logjikë s'merrte vesh, me brutalitet, jo se jo! Të vinte e të puthte në mes të zyrës! Ajo e ndjeu në alarm se kishte vetëm katër ditë pushim, katër ditë që ai do të ishte në Amsterdam dhe vendosi t'i lutej Ladit mos e merrte me vete javën e ardhme në Turqi, andej nga bridhte për të peshkuar ato plehurat e tij të tregtisë.

14.

Po Ladi nuk e merrte dot me vete. Ai do të udhëtonte me ortakët dhe s'kishin vend në makinë. Ilda bëri sherr, ndërkohë që tjetri shqeu sytë nga habia:

- Je në terezi, - i tha, - apo ke luajtur menç?! Me çfarë të të marr në Turqi?
- Me aeroplan! - ia ktheu Ilda. - Ç'ke, ti?! Vizën e kam, biletën e udhëtimit
e kam falas për një udhëtim...

- Me aeroplanin e nënës tënde! - ngriti zërin Ladi dhe doli duke përplasur
derën.

Ilda qau. Palçua i ndyrë, shau të shoqin, legen e maskara! Ka ndonjë
dashnore andej nga Turqia dhe më bën mua dër-dër...

Të nesërmen, kur dëgjoji zërin e Fredit nga Amsterdami, ajo u shushat
fare.

- Të lutem, - u qaravit Ilda, - asgjë në telefon!

- E di! - i tha tjetri. Pastaj qeshi. - Këta budallenjtë këtej më kanë emëruar
profesor në fakultetin më të madh të matematikës. Rrogë, kushte fantastike...

- Vërtet? - bëri sikur u gëzua Ilda. Pastaj i hypën xhindet me jetën e saj
dhe shtoi: Bëj qejf, ti, bëj!

- Për çfarë më porosite, ti, se harrova, - i tha Fredi.

Ilda nuk e kuptoi se pse iu përgjigj: "Ndonjë çokollatë!" Tjetri i tha se
pas dy ditëve do të kthehej dhe, kur Ilda mbylli telefonin, u kujtua se pas tre
ditëve Ladi nisej. Qelbësira! Po e linte pikërisht tani vetëm. Në atë terr të menduari,
ajo e preu se do të ishte mirë të bisedonte një herë shtruar me Helenën për Fredin,
por kur të dyja po pinin çaj përballë "Dajtit", ndërroi mendim. Diçka nuk e lejonte
t'i hapej Helenës së saj të afërt. E ndjente se Helena nuk do të besonte në pafajësinë
e saj. Ilda ia filloi ca bisedave fluore për modele veshjesh e ushqime të skaduara,
por kur filloi të shajë Ladin për ato brutalitetet e tij prej tregtari vulgar, tjetra u bë
e vëmendshme. Nuk e kishte dëgjuar kurrë vajzën e tezes së saj të fliste kështu.

- Lëre rehat, Ladin! - i tha Ildës. - Kush është faji i tij? Që të sjell dollarë
me grushta në shtëpi? Apo që të rregulloi punën te "Suisair" me miqtë e tij?...
Dollarit nuk i shihet vulgariteti apo delikatesa!...

Ilda tundi kokën.

- Më mirë mos t'i kisha ato lekë, vetëm të isha e qetë! - përfundoi me një
vështrim të përhumur përtej xhamave, andej nga shfaqeshin si farë karkaleci
fëmijët që shisnin cigare e çakmakë.

Ishte nervozuar befas. Shihte degët e pishave që i përkulte era, letrat që
ngriheshin si avionë të vegjël nga toka dhe shfrynte me një inat kozmik të
paadresuar kund herë pas here. Ftoi tjetrën të paguanin e të iknin. S'i rrihej
më as në këtë lokal të vogël, ku burrat i shihnin pareshtur me ca vështrime të
pacipa. U ndanë që te dera e lokalit. Ilda do të shkonte të flinte nga shtëpia e
prindërve. Ajo filloi të ecë në shëtitoren e madhe dhe, tek pa ish-piedestalet e
Leninit e Stalinit, tanimë bosh, mendoj turbull se këtu mund t'i ngrinin nesër një
monument Fred Bogës, këtij shqiptari të shquar që e desh i aq shumë atdheun e tij

copë-copë. Kot s'ma lenë mua, mendoi, do ta konceptoja pa kokë, pa atë kokë të mallkuar që ka e që i bën punët e tjetrit lëmsh...Megjithëse koka e tij e rrumbullakët dhe tullace kishte më pak punë për t'u kompozuar nga çdo pjesë tjetër e trupit. Një top futboll i rrasur në baltë dhe iku koka!... I mendonte të gjitha këto, kur zeshkania po i thoshte e nxehur Fredit se kot s'ma besojnë mua ta drejtoj Shqipërinë! Po nuk i bëra të pasur e dinjitozë për dy vjet këta morracakë, po plaç!...

Qëndronin të dy të shtrirë në shtratin e madh dhe ai ndjeu se vajza e kishte barkun e ngrohtë, kurse shpinën të ftohtë. As vetë nuk e kuptoi pse e shtrëngoi vajzën, duke e mbajtur në gjoksën e tij të gjerë. E mbajti gjatë ashtu. Pastaj, kur vajza filloi ta lëpinte si mace, duke zbritur gjithmonë e më poshtë e duke u zhdukur nën mbulesat e pastra, ai mendoi turbull lldën. Po ajo ...

Zeshkania e ndjeu se diçka nuk shkonte. Ajo i la përkëdhelitë në mes.

- Ku e ke mendjen, profesor? - e pyeti.

Fredi shihte përhumbshëm tavanin.

- Kam rënë në dashuri me një vajzë tjetër, - tha pastaj i trishtuar, a thua kishte bërë faj.

Vajza nuk foli. Duket mendohej. Ajo s'kishte ushqyer asnjë iluzion për të ardhmen e saj me profesorin. Megjithatë, u ngrit e filloi të vishej. Ai ia shihte trupin e zeshkët të lakuriqtë nga pas, atë trup që e kishte bërë të lumtur në momentet kur ai kishte menduar edhe vetëvrasjen dhe e kuptoi se po humbiste edhe një njeri. Vajza ishte veshur. Ajo i ra rrotull shtratit, e puthi Fredin lehtë në faqe, i tha "mirë u pafshim", pastaj iku. Ishte vetëm tani, tmerrësisht vetëm në këtë vetmi aq të lakmuar. Nuk dinte ç'të bënte me këtë vetmi. Nuk dinte me kë ta thyente sado pak këtë vetmi torturuese.

Fredi u ngrit dhe i telefonoi Almës. As ajo nuk ishte. La një mesazh, pastaj u ul i dërrmuar para kompjuterit. Hapi ekranin dhe, sapo shkruajti formulën e parë, harroi gjithçka. Dy orë më pas, kur do të dëgjonte zërin e Almës në telefon, fillimisht do të habitej. Ngadalë, fare ngadalë do të kthjellohej dhe do t'i thoshte tjetrës:

- Të mora në telefon thjesht për t'iu pyetur se mos kishte nevojë trupi juaj për një masazhator si unë...

Alma qeshi.

- Jam në formë të shkëlqyer, - tha, - por nëqoftëse ti nuk ke klientelë, kemi nja dy plaka këtu në Televizion që vuajnë nga reumatizma...

- Je fantastike! - e përgëzoi Fredi. - Me një menaxher si ty unë nuk vdes kurrë për bukë... Pse s'hidhesh një herë në studion time? Jemi dhe afër, - propozoi befaz Fredi.

Alma u mendua një hop.

- Je serioz? - e pyeti.

- Po! - tha tjetri.- Kurrë nuk kam qenë kaq serioz sa sot, bile, sot më ka kapur mania për të qenë serioz!...

- Betohu!

- Nuk jam betuar kurrë! - thirri Fredi.

- Mirë, - tha Alma, - ma trego tamam ku e ke studion dhe më thuaj ç'të sjell me vete...

Gjysmë ore më pas Alma ishte ulur në kuzhinë përballë Fredit. Pinin uiski e hanin çokollata fantastike, siç i quajti ajo, duke qeshur me lot me budallallëqet e gazetarëve të TV-së e të politikanëve shqiptarë, që Alma i tregonte aq bukur. Vonë, aty nga mesnata, Alma briti kur pa orën. U ngrit të ikte, po Fredi iu lut të rrinte. Ajo kishte pirë pak dhe prindërve nuk do t'u vinte mirë po ta shihnin të pirë. Tjetra e pa me dyshim. Por Fredi e qetësoi. Asnjë ekspeditë nëpër trupin femëror. U ulën përsëri dhe Fredi u shkri fare kur Alma i tregoi për planet e saj, që të bënte një film dokumentar për pluralizmin në varreza. Atje të vdekurit ishin të gjithë bashkë dhe ndërronin qirinj e cigare me njëri-tjetrin pa dasira partiake. Mos harro të intervistosh edhe krimbat, tha Fredi, kur i krruhet trupi një kufome, i lutet fqinjët t'i japë hua një krimb ...

- Kryevepër! - uluriu Alma dhe kërcëu nga e qeshura. Por kur ra përsëri në kolltuk, fundi i ishte ngritur shumë lart. Ajo e kapi Fredin duke ia vëzhguar i përhumbur këmbët. Uli sytë, i pa dhe ajo kofshët e saj, pastaj pyeti Fredin:

- Të pëlqejnë?

Tjetri tundi kokën. Po!

Alma u ngrit dhe shkoi në banjë. Kur u kthye, kishte në trup vetëm një këmishë të Fredit. Nuk hyri në kuzhinë, shkoi drejt e në dhomë. Në mëngjes ajo u ngrit e para. Përgatiti dy kafe me qumësht dhe ia çoi tabakanë në shtrat. E mëkoi si fëmijë të vockël, ia hoqi cigaren e ndezur esëll, pastaj iu lut Fredit t'ia falte këmishën.

- Patjetër! - i tha Fredi. - Po pse atë që është e përdorur?

- E dua kujtim nga ty! Nuk e dua për ta veshur, - u tall Alma.

Pastaj, duke e rrasur këmishën e bërë shuk në çantën e krahut, Alma i foli gjithë duke e parë nga pasqyra.

- Fredi, me mua ti je sjellë shkëlqyeshëm. Ti je vërtet i mrekullueshëm, por mua nuk më pëlqen zgjidhja jote. Ti s'bashkëjeton më me familjen tënde, tallësh me vetveten, me Shqipërinë, po se po, bën jetë boheme dhe je i famshëm ... Ti je shqiptar, Fredi, si unë, pra, s'të ka faj gruaja dhe Atdheu që ti nuk ndjehesh i lirë dhe i lumtur. Po ne të tjerët, që na shohin sytë e na dëgjojnë veshët më shumë se ty, që s'kemi bukë të hamë, rroba të vishemi, një libër për të lexuar e një dhomë më vete për fjetur, ç'duhet të bënim?... Ty, po nuk të pëlqeu kjo qeveri, luftoje e rrëzoje, sepse i ke mundësitë, je i famshëm, ama, ne të tjerëve na ler të qetë!...

Ajo i ra pastaj rrumbullak shtratit, si zeshkania, e puthi në faqe, si zeshkania, i tha "mirë u pafshim", si zeshkania dhe iku.

Fredi kishte mbetur përsëri i vetëm, vetëm fare. Të gjithë që më njohin mirë, më thonë "mirë u pafshim", meditoi ai. Kjo fjalë e mallkuar! Rita kështu, zeshkania kështu, Alma kështu, Ilda ... Ilda! Vetëm ky emër nuk dihej ç'do të thoshte, kjo bukuri që i dilte e gjallë në ëndërr dhe në ekranin e kompjuterit, në Paris e në rrugët e Tiranës ... Fredi pa orën. Ishte nëntë. Dhe data dhjetë shkurt. Duke u veshur, ai u mundua të kujtonte se ç'i kishte ndodhur në këtë ditë vitet e shkuar. Kujtesa nuk funksiononte. Ajo mëmërsite vetëm ASGJE. Kjo ishte e natyrshme.

15.

Një orë më pas Fredi i telefonoi Ildës. Ishte një bisedë e turbullt, pa kokë e pa këmbë. Ilda ishte konfuze, njëherë qeshte, një çast më pas bëhej gati për të qarë. Po kur Fredi i tha se i duhej një hamall për t'ia sjellë çokollatat e premtuara, ajo qeshi mbytur. E kam ditur që nuk je normal, pëshpëriti.

Biseda sikur po ngrohej dhe Fredi, gjithë duke kullotur sytë në peizazhin e zhveshur përtej dritares, i afroi një kafe. Po të pranonte ta pinte në studion e tij, do të ishte më mirë, pasi kështu mund të merrte edhe çokollatat. Ilda qeshi.

- Dëgjo, - i tha pastaj me një zë tërësisht të transformuar, - unë e di se ç'nënkupton vizita ime në studion tënde. Jam e ndërgegjeshme. Nëqoftëse vi, në orën katër mbasdite më ke atje. Po nuk erdha, do të të lutem mos më merr në telefon... Edhe unë ndjej diçka për ty, - shtoi mbytur, - por kjo nuk ka shumë rëndësi ... Ti nuk je i pari që unë ndjej për hesap tim...

Telefoni ishte mbyllur. Fredi ndjeu t'i lëvizte gjaku vrulltas dhe u bë gati të puthte kompjuterin. O Zot, mëmëriti, edhe unë diçka ndjej për ty! Pastaj vuri re se në park kishin çelur mimozat e para dhe u vesh me ngut. Në park ishte qetësi. Ai ndjeu erën e tokës, një erë e ngrohtë, dhe iu qa kur e pa ashtu pa bar, të lënë vetëm, pa një dorë njeriu pranë, veç me jashtëqitje kafshësh e njerëzish, që ktheheshin ngadalë në pleh organik e rrisnin ndonjë lule brilante, si për t'i kujtuar kësaj bote se kryeveprën e lindte vetëm jashtëqitja, intelektuale e fizike... Ai i mbushi të gjitha gotat e apartamentit me mimoza, me ato krijesa bionde, të bukura, të freskëta e të brishta, pastaj pa orën. Ishte 12. Edhe katër orë për t'u bashkuar me perëndinë e tij, me ëndrrën e tij, që ia kishte bërë pa asnjë vlerë familjen dhe famën, pasurinë dhe jetën, suksesin dhe dëshirën ...

Edhe katër orë, mërmëriti në krahun tjetër Ilda. Ajo ishte zbehur. I dridheshin duart, aq sa mezi gjente tastat e kompjuterit e s'arrinte të gjente gërmat e gjuhës mëmë, kur mbushte biletat. Kishte dy orë që thoshte "s'do shkoj", "do shkoj" dhe tani pati vendosur që të vepronte si t'ia thoshte shpirti çastin e fundit. Aty nga ora 14 ajo vendosi të shkonte dhe t'i shpjegonte Fredit qetësisht, se, pavarësisht nga ndjenjat, ajo kishte familje, si dhe ai, prandaj të mbeteshin miq. Ai kishte logjikë. Do ta dëgjonte. Pastaj ajo e kishte veten në dorë. Po mos deshte, ç'do t'i bënte? Dhe, që ta çonte në vend gjithçka, që tjetri mos ushqente iluzione, Ilda i telefonoi.

- Do të vi në orën katër, - i tha prerë, - por, të lutem, sillu mirë!

Deri në orën katër ajo u pendua dhe e përgëzoi një mijë herë veten për telefonatën, por, kur po ngjiste shkallët e pallatit ku ndodhej studiuja e Fredit, u ndje keq. Një fajtoje, një kurvickë ilegale, një ...

Të kthehem, vendosi me alarm, por e tmerruan fare hapat e dikujt që po ngjitej pas saj. Ajo s'kishte bërë asgjë dhe nuk do të bënte asgjë, kurse i panjohuri do ta njihte dhe do të fliste nëpër Tiranë. E terrorizuar, Ilda u ndodh para portës së Fredit. Trokiti me rrëmbim dhe po aq rrufeshëm, me t'u hapur dera, u ndodh brenda me shpinë të mbështetur në derën tashmë të mbyllur. S'mernte dot frymë, i qahej dhe i vinte ta shqyente vetveten. Rrinin përballë njëri-tjetrit, dihasnin të dy, të mbërthyer njëherësh nga dashuria, turpi, ëndrra e realiteti dhe Ilda u përpoq ta shtynte kur ai iu afrua. Por kur buzët e tij u puthitën egërsisht mbi të sajat, ajo s'pati më pikë fuqije. Mbylli sytë, ndjeu duart e tij në gjinjte e saj, ndjeu një përvëlím të brendshëm e një tollovi të jashtme, nëpër ato xixëllima që i nxirrnin sytë dhe e humbi peshën. Kur i hapi sytë, ndodhej në shtratin e Fredit, gjysmë e zhveshur, me Fredin sipër që e eksitonte më keq pas çdo prekjeje e puthjeje.

- Mos! Të lutem, Fredi, mos! - belbëzonte.

Por tani ishte ajo që e puthte si e tërbuar tjetrin. Pastaj ... pastaj erdhi mëkati i madh me Fredin brenda trupit të saj dhe Ilda e humbi kontrollin e vetes. Këlthiste vazhdimisht "o ma", si një fëmijë që kërkon bukë. Ishte e uritur. Ishte e pangopur. E lëshoi veten në duart e tjetrit dhe iu bind për gjithçka në atë verbëri të pashoqe, pastaj, kur nata e kishte pushtuar tërësisht atë dhomë mëkati dhe të dy, të lodhur, qëndronin të përqaftuar, ajo qau shtruar. I binin lotët nëpër mollëzat e bukura si kokrra diamantësh nën reflekset hënore.

- Kot erdha! - tha më në fund. - U tregova idiote!...

Fredi ia lëpiu lotët. I vinte ta rrëmbente e ta fuste në shpirt këtë bukuri të çmuar, këtë ëngjëll që askund s'e pati hasur në ato bredhjet e tij të pafundme në botë.

- Unë nuk të kërkoj falje, - iu shpjegua ngadalë Fredi, - unë të dua! ... Nuk jetoj dot pa ty!...

Tjetra heshtonte.

- ... Që atë ditë kur të pashë me Helenën, unë e kuptova fatkeqësinë dhe lumturinë time ... Ishe ti ...

S'mernte asnjë përgjigje.

- ... Nuk ta kisha parë ende fytyrën ... Ti ndodheshe me shpinë nga unë ... Ilda psherëtiu.

- Edhe mua, Fredi, e njëjta gjë më ndodhi, - tha më në fund dhe, duke iu futur në gjoks, shpërtheu përsëri në një të qarë të rëndë. Ndodhej mirë, ndjehej kaq e lumtur në këtë gjoks të gjerë e të fortë burri, por kishte frikë, i rrotullohej si ciklon i tmerrshëm një panik marramendës.

Fredi ndjeu atë masë mishi të fortë e të lëmuar t'i ngjitej ngadalë në trup, ata gjinj të mrekullueshëm, vithet e bukura të Ildës në pëllëmbët e tij dhe dy çaste më pas dhoma ishte e mbushur përsëri me rënkimet e tyre. Njëra thërriste nënën dhe tjetri, ateisti i kulluar, Zotin, në atë bashkim plot lumturi e pa fund, derisa Ilda ndjeu zbrazjen e qetë të Fredit në vaginën e saj dhe kafshoi buzët nga kënaqësia. Kishte mbaruar gjithçka mrekullisht, por ajo s'kishte dëshirë të ngrihej. Dëgjoi zhurmën e dushit që kishte hapur Fredi, pastaj, kur pa orën në komodinë, kuptoi se patën kaluar tre orë. U çua dhe ajo dhe, kur hyri në banjë, Fredi pa për herë të parë qartë trupin e saj të mrekullueshëm me flokët që i vareshin mbi kupat e gjinjve të fortë. Ishte një përrallë! Ia liroi vendin në dush dhe tek po dilte nga banja dëgjoi i tronditur Ildën t'i thoshte nga pas:

- Ishte një përrallë, Fred!

16. .

Ilda i telefonoi të nesërmen. Ndjehej e terrorizuar. Gjithë natën nuk kishte fjetur, nga frika e ëndrrave të frikshme dhe iu lut tjetrit ta besonte se gjithë sa ndodhi ishte një premierë në jetën e saj. Ajo dëshironte të bisedonte shtruar me të, por do të vinte të nesërmen në mëngjes, që e kishte ditë pushimi. Fredi iu lut të vishte dhuratat simbolike.

- Dua të bisedojmë, - briti tjetra, - jo të bëjmë ashtu!

- Një dëshirë shfaq, - u shfaqësua tjetri.

- I di unë dëshirat e tua! Gjithmonë të realizohen ...

Përkëdhelej ajo vajzë e bukur e dashuruar. Dhe gjithçka i shkante mrekullisht. Përkëdhelu, mermëriti i lumtur Fredi. Ishte një telefonatë e gjatë, pa kokë e pa këmbë, telefonatë dashurije. Kështu i pati ndodhur edhe atij njëzet vjet më parë me Ritën, me gjakprishësen klasike që tani një perëndi e dinte me ç'merrej.

Fredi ndjeu mall për vajzat. Ai mbushi një qese me çokollata, ndau veç një grusht me kartmonedha dhe vendosi të priste vajzat te dera e shkollës e të hante drekë me to. Në orën 12 ai ndodhej në oborrin e shkollës. Nuk e pa Ritën si i erdhi nga pas e si u kthye menjëherë, me ta dalluar Fredin në atë zbrazëti asfalti e hekurash. Vetëm iu qa kur vajzat britën nga gëzimi dhe iu varën në qafë.

- Kur u ktheve? - pyeti e vogla.

Fredi e kuptoi që ishte gjithmonë jashtë shtetit.

- Mbrëmë! - iu përgjigj Fredi.

- Po pse nuk erdhe në shtëpi? - këmbënguli e vogla.

E madhja e pickoi të voglën.

- Babi kishte shumë punë, - tha ajo, duke i hedhur një shikim plot nëntekst të atit. - Sonte duhet të niset prapë jashtë shtetit ...

Ai i mori të dyja për dore dhe, gjithë duke i vëzhguar, u nis për nga qendra. Ishin të bukura e të pastra të dyja. I futi në një butik të shtrenjtë dhe i urdhëroi të zgjidhnin ç'të donin. Gjysmë ore më pas, pasi e kishin kthyer mbrapsht dyqanin, vajzat qenë ndërruar tërësisht. E vogla kërkoi edhe këpucë. Nuk shkonin as xhupi, as bluza, as fustani me këpucët e vjetra. Fredi pohoi me kokë. Dy hapa pranë ishte dyqani italian i këpucëve. Iu bleu këpucë të mira vajzave dhe, tek po ua fuste në qese këpucët e përdorura, vuri re se Rita ua pati riparuar te këpucari të dyjave. Po fillonte jeta e vështirë për këta fëmijë të bukur! Kaq duhej që atij t'i mbetej buka në fyt te restorant "Piacca". Vajzat hanin, qeshnin kot, shkonin çdo dy minuta në banjë, por Fredi e kuptoi që ato krijesa ëngjëjllore deshën t'i tregonin gjithë klientelës së lokalit se kishin baba, alamat babai kishin, që u kishte blerë gjithë ato rroba të reja.

- Mjaft, tani! - tha dikur Fredi. - Hani! Kur të kthehem do t'iu sjell gjëra më të bukura! Ju vetëm hani, mësoni dhe rriini urtë!...

- Në shtëpi do të na i sjellësh? - pyeti e madhja.

Fredi e puthi.

- Po! - tha.

Të madhes i dha zemër e puthura. Ajo guxoi të mendojë ta pyesë babin se a ka ndonjë shoqe në Televizion, por çastin e fundit ndërroi mendje. Po sikur të mos qenë të vërteta ato që i thanë shoqet në klasë?...

17.

Në orën nëntë të mëngjesit, kur trokiti dera, Fredi ndodhej në dush. Ai veshi robdëshambrin - fshirës dhe doli me vrap. Më e bukur se kurrë te dera ndodhej Ilda. I kishte bërë flokët gërshet dhe e verdha i shkonte për mrekulli me pallton e

kuqe. Ishte skuqur e tëra nga acari i rrugës, nxirrte ende avuj nga goja dhe kur dalloi që Fredi sa kishte dalë nga dushi, u lumturua.

- Ne s'kishim drita, - tha, - as ujë. Mos m'u afro se jam e pa larë!...

Përkëdhelej! Përkëdhelej mrekullisht! Ajo hoqi pallton, pastaj hyri në banjë. I gjithë koridori u mbush me aromën e saj dhe Fredi ndjeu një tundim të tmerrshëm ta ndiqte pas. Hyri ngadalë në banjë, në atë banjë që qiramarrësi e kishte rregulluar mrekullisht dhe filloi të kundrojë Ildën që fërkohej me sfungjer mjegulluar nga avujt e ujit të ngrohtë. Ilda ia nguli sytë. Tani gërsheti s'ekzistonte më dhe flokët i binin herë pas here si nëpërka mbi gjinjtë e plotë. Fredi e ndjeu fortësinë e gjinjeve të tjetres. Ajo po e priste. Hoqi robdëshambrin dhe kur u gjend bri saj nën vrushkujt e ujit uli pak kokën e i puthi lehtë shpatullat e bukura.

- Të dua!- belbëzoi.

Pak çaste më pas Ilda gjendej kulpër në trupin e tij. Ai ndjente vithet e saj të kërcyera në pëllëmbët e tij, përkëdheljet e asaj goje të plotë e të bukur dhe u ndje njeriu më i lumtur në botë. Gjithçka u bë vrullshëm dhe Ilda tha "Lamë nam", tek po pastrohej sërish. Pastaj iu lut ta priste matanë. Fredi mbushi një pjatë me çokollata, ia vuri te komodina buzë kokës, pastaj u shtri. O Zot, sa bukur pat nisur kjo ditë e hirtë! Jashtë kishte filluar shiu, një shi luftarak e këmbëngulës. Atij iu kujtua befaz Roma, Fontana e Trevit, figura e tij tragjike e kthyer me shpinë nga shatërvani magjik, dëshira e shprehur përbrenda që Ilda të bëhej një ditë e tija dhe monedha që fluturonte pas ... Çfarë kërkove të të bëhet realitet? - e kishte pyetur shoqëruesja e tij, një fizikane e re, asistente në Fakultetin e Romës ... Më pëlqen shumë një vajzë shqiptare, ia kishte kthyer ai shpërfillshëm, por ajo nuk m'i hedh as sytë ... Italtania pat shqyer sytë. I dinte shqiptarët krejt pa dinjitet ... Kur Ilda hyri në dhomë, atë gati po e pushtonte dremitja. Ajo kishte veshur dhuratat simbolike. Mungonin reçipetat, por më mirë kështu. Shkëlqente magjishëm fare dhe flokët e tharë me ngut në banjë ishin lidhur sërish gërshet. Këtë herë qenë formuar dy gërsheta. O Zot, sa e bukur ishte! Ajo u pa shkarazi në pasqyrë, iu ngërdhesh vetes foshnjërisht me gjuhë, pastaj u kthye nga Fredi.

- Më vjen shumë turp për dje!

Fredi e qetësoi.

- Unë jam njeriu që të do më shumë!...Ti më fyen, po të kesh turp nga unë!...

Ilda nuk i hiqte sytë nga shembëllimi i atij qelqi farfuritës:

- Bëra ndonjë idiotësi dje? E di, shumë çaste nuk më kujtohen fare!...

- Po! - qeshi Fredi. - Ma vure dorën këtu, më lave trupin me të puthura dhe kërkoje vazhdimisht mamin...

Ajo tani ndodhej në shtrat, dora e saj ndodhej te penisi i tij, që u fry menjëherë nga prekja e asaj pëllëmbë të brishtë.

- O Zot, - u skuq Ilda, - turp!

Po dorën nuk e hoqi. I vinte mirë tek mbante mes gishtërinjte atë gjë të fortë që s'e kishte prekur kurrë më parë.

- Nuk është turp! - e qetësoi Fredi

Ilda u mendua një hop. Nuk dinte si të bënte, të fliste apo jo?

- Po ... në shtrat, si isha ... se unë nuk di fare? - pyeti e përskuqur tjetrin.

- E mrekullueshme! - tha Fredi. - Sepse nuk kishe turpin absurd të njeriut që shtyn diçka, të cilën e pëlqen ...

- Po ti mund të mësosh! - tha gjithë duke u përtypur Ilda.

Fredi e tërhoqi pranë. Dora e saj poshtë mbulesave e kishte bërë punën e saj. Ai ia hoqi mbathjet ngadalë, pastaj filloi ta puthë atë trup që fërgëllonte e puprohej nga majat e gishtërinjve. Kur arriti në mesin e kofshëve dhe iu lut t'i hapte paksa këmbët, Ilda ndjeu magjinë e seksit të saj. U mbush me djersë nga lumturia, rënkonte me gjuhën jashtë lëpinte vetveten. S'duronte dot më.

- Tani! - i tha Fredit.

Tjetri e ktheu sipër vetes. E la ta kryente bashkimin ajo dhe iu dorëzua i tëri. Ishte një bashkim magjik nën atë rënkim të ujërave në dritare e të shpirtrave njerëzorë në dhomë. O Zot, tha Fredi. Tani Ilda rënkonte lehtë, e lumtur bri tij. Ndjehej e ngopur.

- Të dua! - i tha Fredit dhe qau.

Jashtë binte shi. Shi me gjyma. Shi i shtruar. Shi mbi fatin e saj. S'dinte se ç' do të ndodhte. Fredi. Ladi. Prindërit, shoqet... Mut! Mut në shi! Dashuri ilegale e pafundme, nuk bëhej. Divorc? ... Mut! Mut në shi!...

- Si do të shkojë puna jonë, Fred? - pyeti me zë të mbytur. - Nuk mjafton vetëm të dashurohesh reciprokisht!...

- Ikim! - tha Fredi. - Punë kemi, lekë kemi...

Ishte ide e bukur, kaq e bukur, sa nuk realizohej dot!...

- Po fëmijët? - pyeti Ilda. - Egoizmi ka një cak!...

- Po! - tha Fredi. -Fëmijët! Ky është një problem...

Edhe atij i vinte për të qarë. I qahej, sepse tani që lumturia i pati hyrë deri në shtrat, përsëri nuk bëhej dot pronë e tij. I qahej, sepse ajo që ai kishte ëndërruar e lakmuar gjithë jetën, tani po i kalonte para syve dhe ai nuk e mbërthente dot. I ra një lot dhe aq duhej që Ilda të vinte kujën, kur e pa atë burrë të ftohtë e të fortë të dorëzohej.

- Ç' do të bëjmë, Fred? - thirri mes lotëve. - Pse më thirrë kot? Pse nuk më le të qetë në atë qelbsirllëkun tim? ... Ç'të bëra, Fredi, - rënkoi pastaj, - që ma punove kaq keq?... Ku të futem unë tani?...

- Të lutem, - i tha Fredi, - qetësohu! Mos më dëno mua kaq keq!...

Ilda qante me ngashërima.

- Unë të dua, Fredi, - tha pastaj, - po dashuria nuk qenka e jona. Ajo i ktheu krahët. U mbloodh kruspull dhe nuk i foli më. Jashtë binte shi. Tani ujërat rridhnin me ngut drejt detit. Të më marrë edhe mua lumi e të më çojë rrakapjerthi në det, mallkoi veten Ilda.

18.

Deri në fillim të marsit, kur Fredi u bë gati të nisej në Paris për leksionet e rradhës, Ilda shkoi shpesh në apartamentin e vogël buzë Parkut të madh. Takimet e tyre të magjishme, ku dashuria e pastër ngatërrohej jo rrallë keqas me erotizmin e skajshëm, përfundonin shpesh e më shpesh me lot. Ildën e tërhiqte si me magji ky mesoburrë i zgjuar e i kulturuar, ajo ndjehej e qetë me këtë shkencëtar që nuk dinte të fyente dhe e njihte respektin, por tanimë ajo ndjehej e persekutuar nga ndjenja e fajit. Sajonte në mendjen e saj gjithfarë alibish e rugësh shpëtimi. Arratisej me Fredin në Afrikën e Jugut. Deklamonte në mes të Tiranës dashurinë e saj. Trimërohej ... Por më kot! Kishte shumë frikë nga ajo që po ndodhte. Ditën e fundit, para nisjes së Fredit, ajo qëndroi gjatë në studio. Nuk u zhvesh si zakonisht, por u mbloodh grusht në një nga kolltuqet e kuzhinës dhe shihte tjetrin se si përgatiste valixhen. Printeri nxirrte pa pushim letra dhe, kur ai i lidhi të gjitha leksionet bashkë e i futi në çantën e dorës, ajo iu lut t'i telefononte nga Parisi. Fredi pohoi me kokë. Këtë herë do të rrinte më gjatë. Ai nuk i pati treguar Ildës për problemet e tij, s'i kishte thënë asgjë për vajzën e madhe që qau një javë më parë në restaurant, meqë babi nuk e donte me mamin dhe prandaj nuk kthehej në shtëpi. Nuk i kishte folur për vetminë dhe boshllëkun vrasës që ndjente ... Po t'ia rrëfente të gjitha këto, Ilda mund të çmendej fare. Ai iu ul afër. Ilda ishte rinuar befas. Me gërshetin e madh, me tualetin fare të lehtë, me veshjet sportive, ajo ngjante me një vajzë maturante. Gjithë kjo dashuri e vrullshme e pati rigjeneruar tërësisht.

- Të lutem, mos u mërzit pa mua! - i tha Fredi.

Tjetra gëlltiti lotët.

- Nuk mërzitem, - ia ktheu, ama, atë nuk e shikonte. Vështrimin e kishte nga Parku. - Vetëm s'di se si do t'i shtyj këto javë! Unë nuk desha të lidhesha kaq shumë, po tani veç teje s'më hyn më asgjë në sy ... Dhe kam shumë frikë, - shtoi. - Më duket se të gjithë e dinë lidhjen tonë, më duket sikur gjysma e Tiranës më përflet pas shpine ... Kam frikë nga Ladi ... O Zot, unë të bredh gjyqeve për tradhëti bashkëshortore!...

I merrej goja. Mezi i lidhte fjalët.

- Gjithçka do të shkojë mirë! - e ngushëlloi tjetri. Ai i trembej gjithë këtij

kaosi të Ildës. S'kishte ajo as moshë e as fuqi ta përballonte e vetme gjithë këtë pasion.

- Edhe unë atë uroj! - bëlbëzoi Ilda.

E puthi befas fort, aq fort, sa Fredi i muarr fryma, e kafshoi në gjoks sa i dhëmbi shpirti, i tha "mirë u pafshim" dhe krejt çmendurisht iku. Fredi e ndoqi i pa gojë ikjen e tjetrës me biçikletë në rrugën plot me pellgje dhe për herë të parë e kuptoi se gjërat po komplikoheshin seriozisht. I dhimbte gjoksi. Atje ishte ende e kuqerremtë shenja e dhëmbëve të Ildës. Do të nevojiteshin javë, ndoshta aq sa do të zgjaste udhëtimi, që ajo shenjë të zhdukej gradualisht nga kraharori. Kurse ai nuk i la asnjë kujtim. Gërmoi nëpër sirtare, më në fund gjeti atë që kërkonte. Ishte një karficë e florinjte, që ia patën dhuruar në Amsterdam për Ritën. Shkruajti në kompjuter një copë pusullë: "Mos u mërzi! Karficën që të më kujtosh", e futi letrën dhe karficën në një zarf të madh, pastaj telefonoi në Institut për makinën. Le të vinte tani! Ora ishte 11. Mbas pesë orëve duhej të fluturonte. Gjysmë ore më pas, kur u ndjenë boritë e veturës, Fredi ishte gati. Por ishte gjithashtu shumë i zbehtë, me një ide të çmendur për ta braktisur këtë udhëtim makabër.

- Nga e kemi drejtimin? - pyeti shoferi.

- Çojmë një herë një zarf te zyrat e "Suisair"-it! - tha Fredi.

Ai priti në makinë, duke kundruar në boshllëk atë lëvizje kaotike të njerëzve që iknin e vinin, pastaj dalloi Ildën me shoferin. Ajo bëri një "mirë u pafshim" me dorë dhe u zhduk po ashtu siç u shfaq. Endërr, mëmëriti Fredi. Endërr në këtë vend ku edhe 24 orë të qëndroje në vaskë e të fërkoheshe me gjithë shampot më të mira të botës së sofistikuar, nuk e hiqje dot zhulin nga trupi. I tha shoferi ta çonte në Institutin e Higjenës dhe s'foli më. Në atë mjedis të heshtur, me kolerë nëpër epruveta e gjithëfarë mikrobesh të ndyra që ngrinin kokë për ditë nëpër aparatura, ai kërkoi Ritën. Dy minuta më pas ajo u shfaq si një fantazmë, e zbehtë dhe e tjetërsuar. Ca koka të shëmtuara femërore ndiqnin me kuriozitet këtë takim të çuditshëm dhe sytë u shqyen krejt kur Fredi i futi krahun Ritës dhe e tërhoqi drejt daljes.

- Ç'do? - mëmëriti ajo.

- Sot nisem një muaj për Paris, - i tha Fredi, - desha të bisedonim pak.

- Ik! - tha Rita. - Unë nuk dua të bisedoj me ty! Po të jesh ti i qetë, unë jam e lumtur!...

Ajo s'hodhi më hap përpara. Ishte e kotë të ushqeje iluzione për t'i kthyer mendjen atij njeriu që e kishte të vështirë deri sa të shqiptonte "jo".

- Ti, mund të durosh pesë minuta, për hir të vajzave! - tha Fredi me ton të ftohtë.

Rita qeshi hidhur.

- Nuk e kuptoj, ç'kërkon, tí, nga unë? - iu përgjigj po aq ftohtë Rita. -

Kërkove liri? Ta dhashë me pash! Kërkove vetmi? T'u hoqa qafe? Deshe të ikje nga shtëpia dhe të zije një apartament me qira, për turpin tim, unë s'e hapa gojën!... Të gjitha që kërkove, i more! ... Ti harrove se unë nuk jam inferiore ndaj teje! Ti harrove se edhe unë isha studente e shkëlqyer, por e sakrifikova shkencën që të rrisja vajzat e tua dhe që të studioje ti! Kurse, ti ... Ti i harrove të gjitha, sepse nuk ndjeheshe i lumtur, s'kishte relaks!... Unë kam qenë më e trishtuar, më pak e lumtur se sa ty, që bredh gjashtë muaj nëpër botë, por jo s'fola, as mendova kurrë për ato liritë e tua të fëlliqura! ... Ti nuk ekziston më për mua, zoti Boga! Dhe mirë bën mos vish më në shtëpi, sepse, po erdhe ti, do të ik unë!...

- Ti i thjeshton gjërat, - tha i lodhur Fredi.

- Epo unë kështu jam, e thjeshtë, - ironizoi tjetra. - Hap këmbët dhe bëj atë punë, kur të pëlqen ty! Marr tenxhere dhe gatua, atë që kërkon oreksi yt! Shikoj në TV ç'stacion do ti dhe fle e zgjohem sipas ziles së orën tënde!... Ik, mos na hap barkun! - u nxeh Rita.

Fredi i bëri një shenjë me dorë. Do të ik, thoshte ajo lëvizje, mos u mërzit! Ia solli zorrët në gojë ky rol melodramatik i tjetrës. Po bëhej si Medea e Euripidit! Kujtonte se po nxirrte xhevahire të padëgjua nga goja.

- Mund të të le diçka për vajzat? - pyeti ai.

- Patjetër! - tha Rita. - Ato janë edhe të tuat!...

Fredi nxori një grusht kartmonedhash dhe ia zgjati Ritës. Tjetra i mori pa sherr, i futi në xhepin e përparësës së bardhë të punës dhe tha qetësisht:

- Janë shumë, ndoshta dalin për një vit, por baba për vajzat s'bëhen dot!...

Ai e pa figurën e saj të zhdukej në hollin e bardhë dhe ndjeu një gërryerje në gjoks. Mizerje! E ashpër kishte qenë gjithmonë kjo femër. Serioze edhe në shtrat! Mut u bëfsh, shau profesori dhe u kthye. Kishte ardhur pranvera, po nuk kishte aromë. Pränverë leshi, tha Fredi duke hyrë në veturë. Dhëntë Zoti, ai po i mbathte për ca kohë.

19.

Kur Fredi hyri në auditorin e madh të Sorbonës për të dhënë leksionin e parë, njohjen ia bëri një akademik i shquar plak me ca flokë të bardhë si kashtë dhe një fytyrë të kuqe nga vera. Jam i lumtur, përfundoi mes të qeshurave plaku, që unë, ish-profesori i këtij djali, sot do ta dëgjoj mes jush plot kureshtje, kuptohet, siç dëgjon studentë profesorin e tij ...

Gjithçka pat filluar kryevepër. Në atë sallë klasike Fredi shtjelloi teorinë e tij, pastaj, në fund, tha:

- Dikur kjo që shpjegova ishte ëndërr, sot është hipotezë. Le ta bëjmë bashkë realitet ...

Fredi mbylli dosjen me një lëvizje të lodhur dhe tha:

- Faleminderit për vëmendjen! Kaq për sot!...

Ndjehej vërtet i lodhur në këtë qytet larg vendit të tij, larg Ildës dhe gjithçkaje të dashur. Kishte ftohtë dhe vazhdimisht dëshironte të telefononte në Shqipëri. Ai doli në koridor, por ndali në çast i mahnitur. Përballë qeshte Alma, qeshte në mënyrë pak tallëse, me vrimëzat në faqe dhe buzët e plota pak shtrembër.

- Po ti?! - u mahnit Fredi.

- Evropa e lirë! - tha Alma. - Spikerja e emisioneve në gjuhën shqipe, tre muaj në Paris ... Edhe ne kemi talent, profesor!

- Po! - tha Fredi. - Talenti s'të mohohet ...

Almës po i vinte vërdallë një gazetar francez, elegant e interesant, por ajo s'ia vuri veshin. I futi krahun Fredit dhe e pyeti ç'plane kishte. Fredi punonte pa plan. Donte vetëm të bënte nja dy telefonata me Tiranën. Almës i pëlqente të hanin drekë bashkë. Fredi qeshi. I hahej, për t'u ngrënë, por i hahej Alma.

- Sade? - pyeti Alma.

- Jo! - ia ktheu tjetri. - Me kontorno striptizmi...

- Jam e sëmurë! - përshpëriti tjetra e lumtur dhe, pasi hynë në metro, ia mbathën nga sheshi i Marsit. Fredi zgjodhi një restorant italian, pastaj doli për një telefonatë. I mbuluar nga pemët, në një gabinë ndanë rrugës, ai formoi numrin e Ildës. Ajo nuk ishte. Një vajzë i tha se Ilda duhej të qe e sëmurë. Dje pati paraqitur një raport mjekësor. I vetëm, nën hijen e kullës Eifel, Fredi u ndje keq. Bleu një loto në kthim, e gërvishti, s'fitoi asgjë as atje dhe kaq duhej ta ndjente fatkeqësinë tamam. Ç'do të bënte tre javë në këtë vend? Mbase sëmurem edhe unë, mendoi duke hyrë në restorant. Vuri një maskë dhe u ul i qeshur përballë Almës.

Dy orë më pas, të trullësuar nga vera e bardhë, ata hynë përkrahu në një kinema pranë hotelit ku flinte Fredi. Ishin ndër spektatorët e vetëm në atë sallë të madhe dhe, me të filluar filmi, Alma ndjeu dorën e Fredit në gjinjtë e saj.

- Për hir të zakonit? - e pyeti.

- Jo! - tha Fredi. - Respekt për gjoksin tuaj fantastik!...

U puthën dhe pas gjysmë ore, tërësisht të eksituar, ia mbathën nga kinemaja për në hotel. Në dhomën komode u shtrinë në tapet dhe, të ndërthurrur e të bërë lëmsh, arritën ta bëjnë lëmsh edhe dhomën.

- E di, - i tha Alma kur mbaruan, - unë nuk kthehem më në Shqipëri! Fredi s'fliste.

- Ti sikur ishte sëmurë? - e pyeti ai.

- Thashë kot, - ia ktheu Alma, - të gënjeva, sepse nuk dëshiroja të kisha më kontakte me shqiptarët ...

- As me mua?

- As me ty! - tha tjetra. - Megjithëse ti dallon, je gjithashtu tepër i lodhshëm!

Ai preku ato gjinj të mrekullueshëm, ato gjinj që s'i kishte parë në asnjë trup tjetër femëror, tha: "Lum kush do t'i gëzojë!", u përpoq të gjente perimetrin, lartësinë dhe vëllimin e atyre kryeveprave, pastaj e ngriti në krahë dhe e shtriu në shtrat.

- Ç'po bën? - pyeti tjetra e habitur.

- Po e bëj për herë të fundit me ty! - i tha Fredi.

Dhe e bëri mirë.

20.

Gjatë tre javëve që Fredi qëndroi në Paris nuk arriti asnjëherë të bisedonte me Ildën. Ajo ishte e sëmurë. As Alma nuk u duk më. Ndonjëherë ai ia dëgjonte zërin në lajmet radiofonike tek komentonte të rejtat e fundit e paqes evropiane, por gjithçka mbetej fare pak për ta mbytur vetminë torturoese. Ai numëroi mijëra herë ditët e mbetura dhe kthimi e gjeti të rraskapitur e me nerva të shkatërruara. Fredi shkoi nga aeroporti drejt e në apartamentin studio. Iu telefonoi vajzave, la një takim me to dhe, si ngarkoi dhuratat, u nis drejt qendrës. I zhurmshëm dhe i pisët, qyteti e trullosi Fredin, si një gotë e madhe me uiski e pirë me eks. Iu duk e habitshme që nuk njihite më asnjëri në rrugë dhe për herë të parë e tmerroi ideja se pa Ildën ai do të mbetej vetëm fare. I ulur në verandën e "Piacës" Fredi priti me durim vajzat, pastaj, kur i pa tek po vinin me vrap, iu qa. Ishin ëngjëjllore! Ato e lanë me të puthura, iu varën në qafë dhe nuk pushonin së foluri. Shkolla ... Mësimet ... Shoqet ... Mami ... Mami! Po!

- Si është mami? - i pyeti Fredi.

- Mirë! - tha e vogla, por e madhja e pickoi.

- I dhimbte koka! - u hodh e tha syllur ajo ëngjëll i pafaj.

- Nuk duhet ta linit vetëm! - i këshilloi Fredi.

Ato s'folën. Pastaj e vogla e hapí gojën.

- O ba, - pyeti, - ti ke punë që nuk vjen në shtëpi, apo nuk e do më

mamin?

- Ç'janë këto budallallëqe?! - tha Fredi, - nesër do të mbaroj të gjitha punët dhe do të kthehem në shtëpi ...

E vogla u hodh përpetë nga gëzimi, po e madhja e urdhëroi të pushojë. Ndoshteshin në lokal! Ajo ishte pjekur këto kohë. I mbante sytë ulur mbi pjatë dhe nuk e shikonte babin. Ngjante me Ritën dhe me siguri do të bëhet e bukur, mendoi

Fredi. Ai iu premtoi përsëri vajzave që do të vinte nesër në shtëpi dhe i përcolli. I mbetur vetëm përsëri, Fredi u nis drejt Hotel "Dajtit". Dhe pikërisht atje, si ca muaj më parë, u përball me Helenën.

Helena ndjehej e lumtur. Dy javë më parë ishte fejuar me një italian dhe do të shkonte në Milano. Ishte me fat!... Ik edhe ti, mërmëriti Fredi ... Po Ilda, pyeti me zë... Ilda ishte mirë. Te "Suisair". Alamet rroge, burrin tregëtar ...

Fredit i thehri zemra.

Domethënë ... s'ka dashur të flasë me mua në telefon, mendoi. Fatkeqësisht, ishte e vërtetë. Të nesërmen në mëngjes, kur do të ishte përballë me një Ildë të zbehtë e të frikur, ai do të kuptonte qartas gjithçka, atë, që kishte mbaruar gjithçka.

- Jam menduar gjatë, - tha Ilda, - s'ka më kuptim! Unë të dua, po sa do të zgjasë kjo dashuri? Të dy kemi familje, kemi fëmijë ... Edhe aq sa sakrifikuam, bëmë gabim, Fredi!...

- Je e bindur? - e pyeti ai.

Tjetra tundi kokën.


- Po! - tha prerë. - Unë nuk mund të jem e lumtur duke bërë fatqe vajzën. Ik, Fredi!...

Ku të mbytem, tha me vete Fredi. E kush ma hap mua derën tani? Alma ishte në Paris, zeshkania kush e di në ç'paradis dhe Ilda po ikte e fundit, pa "mirë u pafshim", vetëm me një "ik" të thjeshtë e të verdhë nëpër dhëmbë. Ik! Ik! Ik! Ku? ... I dukej sikur kjo "ik", "ik" ishte thjeshtë kënga e një gjeli budalla e kënduar së prapthi, por ...

Ai kujtoi ato ditë të mrekullueshme me Ildën, atë ekstazë të papërmbajtur, atë lumturi e prehje pa cak dhe mbylli sytë që t'i mbante lotët përbrenda. Por një lot i madh i ra. Edhe Ilda qau. Pastaj, pas dy sekondave, ajo s'ishte më. Ai e pa turbull tek ikte me shpatullat që i tundeshin nga dënesat, duke ndjerë kthjelltas se ai poeti ia pati futur kot kur shkruajti "mbi rrënojat e botës së vjetër do të ngremë botën e re..." Ku egziston lumturia në këtë kolerë, tha, dhe pasi la lekët në tryezë doli në rrugë. Ishte vetëm, ndillte hundët, qurravec, i lirë, siç kishte ëndërruar, dhe vetëm. Ishte një gjethe e lirë, e shkëputur nga pema, që valëvitej gjithë trille në ajër, që do të binte gjithashtu shumë shpejt në tokë. Pastaj, atje...Gjëja e fundit që mendoi në atë vazhdë logjike ishte vdekja.

Ndoshta më varros bashkia, uroi. Por garanci nuk kishte ...

1994
*TIRANË, BUKURESHT, BUDAPEST,
ROMË, MILANO, MONOPOLI*



LETRA DASHURIEJE PËR MARIJEN

Megjithëse në bar mbretëronte një rrëmujë e tollovi e përzier me tymra të lloj-llojshme duhanrash, Marijen vazhdonte ta tërhiqte ajo fytyra e hequr, e verdhë, si prej të vdekuri atje në cep, që po merrej gati prej një ore me gotën e konjakut e nuk po ia ndante sytë portës së madhe nga hynin klientët. Ai ishte një klarinetist nga Tirana. Pati ardhur në qytetin e saj me një grup artistik, që ajo nuk e dinte se kujt institucioni i përkiste dhe Marijen tani po e habiste zbehtësia dhe rraskapitja e atij njeriu. Si shenjtor qenka dreqi, mendoi ajo, tek iu drejtua si për të pastruar tavolinën dhe tavllën e mbushur plot me bishta cigaresh.

Marija ishte një zeshkane e bukur, tipike, si ato zadrimoret me nam për hirin e tyre, me një lëkurë vetëtitëse, thua sapo e kishte lyer me vaj, dhe me këmbë të gdhendura mjeshhtërisht nga ndonjë gen estetik, që t'i zinin sytë në çark, sapo ia shikoje. Ajo u përkul pak më shumë nga ç' ishte e domosdoshme mbi tryezë, për të kryer ritin formal të pastrimit, dhe ai arriti ta dallojë atë shteg tundues mes gjinjve, që të tregonte qartë se ç'kraharon i bukur fshihej nën trikon e hollë, por ndjehej aq i kapitur, sa nuk i luajti as një qerpik dhe Marija mendoi se ky duhet të qe ndonjë tip kallkan, që, jo ajo, po as Sofia Loreni aq në modë, nuk do ta shkëpuste nga bota e tij.

- Pret njeri?- vendosi ta ngacmojë ashtu si kot Marija.

- Jo ty!- ia ktheu thatë tjetri në atë farë feje, që nuk linte shteg për ta vazhduar dialogun.

- Më marrsh të ligat!- u hakërrye ajo.- Pika mua me cilin tregohem e kulturuar!...

Ajo iku duke çarë moskokëçarëse atë rrëmujë familjare tashmë dhe e harroi. E fshiu nga kujtesa edhe ai. I hahej. I hahej aq shumë, sa i qenë zbehur sytë dhe vendosi të ngrihej, sa pa i rënë të fikët në lokal e të linte kokrrën e namit

pastaj, si ai aktori që u shtri si lopë sa gjerë-gjatë në skenën e Teatrit Popullor...Ajo e pa se si ia mbathi tjetri pa i hedhur as edhe një vështrim dhe iu kthye përsëri rritit të larjes së gotave e filxhanëve.

Kurse ai doli nëpër shiun e imët që binte duke u drejtuar për nga hoteli. E quanin Sefer, ishte vërtet klarinetist dhe kishte lënë të gjitha lekët në poker përgjatë një seance 12 orëshe. Tani i hahej, po s'kishte as edhe një qindarkë në xhep dhe, veç kësaj, duhet t'i binte klarinetës në darkë në Teatrin e qytetit. Po nuk më dhanë drekë të ha, nuk do shkoj fare, e ndau mendjen ai dhe, si i dërgoi lajm regjisorit për vendimin e marrë me një elektrikist, u shtri i qetë në shtrat.

E zuri menjëherë gjumi, si të ishte njeriu më pa halle në botë dhe, me atë mendje që e kishte blatur perëndia, vërtet që nuk kishte asnjë hall. Borxhet i lante rrallë e për mall dhe shkonte mrekullisht me moton se gjumi nuk duhet të zinte atë që i kishte dhënë borxh në poker, e jo Seferin e shkretë që i pat marrë...Kurse humbja e Shkodrës i takonte babait! Pse ia dha ai lekët për të blerë lavatriçe? Dihej që në Shkodër s'kishte lavatriçe!...Paratë e babait ishin dhe aspirinat le t'i pinte ai, po t'i dhimbe koka!...Seferit vetë asgjë nuk i dhimbe, vetëm i hahej bukë...

E zgjuan aty nga ora pesë, tek po shihte ca ëndrra të ngatërruara me floshe e karera damash...I kishin sjellë një pjatë me biftekë te koka dhe një kanë me ujë, ndërkohë që regjisorin nuk ia ndante ato sytë e shpëlarë, që e detyronin Seferin ta thërriste me përkëdheli faqe botës "sysapuni".

- Eштë hera e fundit që ma bën këtë punë,- kërcënoi regjisorin,- dhe lekët e drekës do m'i kthesh në Tiranë, sepse i pagova unë!

- Lekët që nuk kanë lidhje me bixhozin unë i laj,- ia ktheu tjetri gjithë krenari e me një pamje prej të fyeri në fytyrë.- Po ndonjë gotë verë të kuqe s'kishte?- u ankua pastaj me mirëdashje ai.

- Farmakos, atje!- u nxe regjisorin.- Trupa po të pret e ngrëfur ty, se në këtë orë duhet të ndodheshim në teatër, bytha jote na dashka edhe verë!...

Seferi nuk ia ktheu. Nuk donte sherr, bile, e urrente! Vetëm bukë hëngri ngadalë e më qejf të tij, fshiu pjatën me një kafshatë bukë mirë e mirë, gogësiu, psherëtiu "gatuajnë mirë këtu", u mbyll edhe nja dhjetë minuta në banjë, se qe kaps, pra, e më në fund ishte gati. Të luante mendsh ky injorant dhe regjisorin do ta kishte flakur me shkelma me kohë e vakt, sikur palaçua mos ishte aq virtuoz në klarinetë, sa ta mbante edhe tek pullë i vetëm gjithë shfaqjen.

1.

Kur mbaroi shfaqja, Seferin po e grinte uria prapë. Ai publik i poshtër ta merrte shpirtin me biset pa fund dhe, sikur mos qenë vetëm trillet e spektatorëve

të ngeshëm, regjisori ia fuste gjithmonë nga një të shtyrë që mbrapa kuintave, që e nxirrte atë si majmun në skenë. Kishte vetëm tre lekë të reja në xhep, që ai e dinte si ia xhvati Letës, duke ia ngritur në qiell gjoksin gunga-gunga, si topuz jeniçeri. I dha dum me atë mendjen e tij t'i fuste një kafë e një konjak e pastaj t'ia këpuste gjumit dhe, meqë nuk iu duk ide e keqe, mori gjithë qejf për nga klubi.

Ishte po ajo rrëmujë e po ai tym duhani i palëvizshëm mbi kokat e njerëzve që kishte lënë në mëngjes, po atij aq i bënte. Kapi një qoshe në banak, por, pa e hapur gojën akoma, Marija i vuri përpara një dopio konjak e një kafë të hidhur. Seferin e habiti bujaria e tjetrës, po ajo bëri me dorë nga mesi i sallës, ku po përkuleshin si kinezë tre burra.

- Janë kënaqur me ty sonte dhe vendosën të të qerasin,- e sqaroi ajo.

- Zoti ua shtoftë inatin!- uroi Seferi dhe e ngriti gotën.

Nuk ishte më aq i zbehtë sa në mëngjes. Tani ajo dalloi një fytyrë eshtake, me dy sy dinakë, që nuk të jepnin asnjë shenjë se për çfarë po mendonin, dhe, kur ia ndjeu shikimin t'i bridhte paturpësisht nëpër trupin e saj, u kthye e vendosi ta ngacmojë klientin kryeqytetas:

- Si po të dukem?

- Si klarinetë!- ia ktheu Seferi qetë-qetë, atë çast që po llogariste me mendje se sa vrima në trup duhet të kishte kjo femër.

Ajo u zgërdhi. Nuk e priste një përgjigje të tillë.

- E ç'punë ka klarineta me mua?

- Unë asaj di t'i bije...Dhe i bije mirë!

Marijes iu shpif e qeshura. Ç'hajvan i lezetshëm që ishte shenjtori! Nuk mbante mend ndonjë klient t'i kishte folur me këtë gjuhë dhe kulmi arriti në mbrëmje vonë, kur Seferi, duke marrë zemër nga konjakët e pirë qyl e nga muhabeti i ngrohtë me Marijen, i propozoi të martoheshin bashkë...Hajde, në Tiranë, i pat sugjeruar me ton bujar, unë jam djalë i vetëm, shtëpinë e kam timen, me oborr, sa të luash edhe futboll, po deshe, lekë fitoj sa të kem qejf nëpër dasma, bezdi kam t'i numuroj me llapën jashtë, se nuk më mjafton pështyma, pra, do kënaqesh, me pak llafe, si zonjë në vaktit do jesh e ka për të të marrë malli të lash ndonjë gotë...Ik, o dreq, mos u tall!- kishte qeshur ajo...Për nur të Allahut e për gjak të Krishtit e kam me gjithë mend, u betua ai. Mos më rri më në këtë qelbësirllëk! Ti nuk je për këtë punë, moj zemër! Ti ke lindur për t'u bërë shën Mari!...Po ti je mysliman, or dreq, e pat larguar me neveri ajo...Ti, hajde një herë në Tiranë, vërej si e kënaq mullën myslimani Sefer, pastaj ndaje lulëfythin e mendjes...Mos e dhëntë Zoti me derra, tha ajo...Amin, ia ktheu paqtor Seferi, po unë po t'i nis dy gisht letër nga Tirana, se në këtë qytet të qelbët nuk jam duke ardhur më, edhe sikur të ma mbushin dyshekun me pare. Ti shif e bëj...

Në fakt, Seferi dy klasë shkollë kishte, dhe ato me dajak i mbaroi, e një

Zot e dinte në njihje më gërmat e alfabetit, apo jo, por ai e kishte një shok shkrimtar dhe dy letra do t'ia qëndiste ai. sikur qameti të bëhej!...

Kështu vajti ajo bisedë, ky hidh grepin e ajo tallu dhe Seferi, si piu edhe tre lekshin e vet, ia mbathi i lumtur nga lokali. I pati rënë në kokë Marija! Ku do ta gjente ai një 20 vjeçe peri, si ajo? Duhej një nuse tani në shtëpi, për t'iu vënë kapak gjithë prapësive e andrrallave pambarim që u kishte krijuar pleqve dhe Marija ishte fiks fare për këtë punë. Hajde, për hajër, o Sefer, uroi veten teksa po mbyllte sytë, a thua gjithçka qe vendosur, dhe i këputi një kokërr gjumi të ëmbël, që nuk e pat shijuar nga koha e rusit.

2.

- Do t'ia qëndisësh dy letra vëllait tënd,- po i lutej me përgjërim Seferi Agostinit.

Ata ishin bërë miq të ngushtë në ca seanca pokeri, nga të cilat Agostini hoqi dorë me t'u fejuar, po shkrimtari e donte këtë biçim budallai, që sikur kishte lindur me klarinetë në gojë dhe në poker të bënte ca bllofe, që të vinte ta vrisje me dorën tënde m'u në tavolinë.

- Apo nuk i qan, ti!- vazhdonte avazin tjetri.- Kësaj times ia gjen tak-fak pikat e dobëta, se e ke edhe katolike...Cfarë kanë qejf katolikët? Mos lahen!...Shkruajti, në shtëpi ne bëjmë banjë një herë në tre muaj, kurse dhëmbët i lajmë vetëm për festën e Republikës!...Shkruajti, dhitemi duke pirë verë, na u grisën këpucët nëpër ballo...Futja, më qafsh!...Këtë herë e hëngra, kam rënë brenda keq!- psherëtiu më në fund Seferi.

Agostini qeshte me të më madhe tek i shpjegonte tjetri zakonet e katolikëve dhe mbante ijet me dorë, duke iu lutur Seferit pas çdo fraze që t'ia përsëriste edhe një herë. Po pinte kafë me një mikun e tij piktor, edhe ky katolik, kur e mbërtheu Seferi, dhe piktori, gjithë duke u shtrirë barkas për vete, shtoi se katolikët vdesin edhe për pikturën e muzikën...Po t'i jap edhe unë nja dy skica, ti futi nga një firmë poshtë dhe nisja motrës, shtoi ai mes të qeshurave...Seferit iu duk se kapi qiellin me dorë. Letrën e siguroi, pikturat, po ashtu, në muzikë, po, qe esnaf vetë...Mbaroi dhe kjo punë, tha...Do kthehej në shën Seferino para shën Marisë!...

Fol e zgërdhiu dhe Agostini ia nisi letrës. Në fillim jepnin mend të gjithë, por, si i kërcyen kacabujtë Gustit, ata e mbyllën gojën. Fundja ai është mjeshtër për mashtrime, u tërhoq i pari në paqe Seferi, që nuk ia harronte se si ia pati futur atëherë me dhjetë mijë lekë në tavolinë me një dy per të qelbur dhe ia kishte përvëluar ful damën, duke e mbajtur në gojën e këtij mileti pa din e imam si peshk që e ha kur të kesh qejf, vetëm ta trembësh pak...

“ E dashura ime, Mari! Më fal që nuk po ta shkruaj emrin siç e meriton, shën Mari, siç m’u shfaqe atë mbrëmje të paharruar, kur ti ishe i vetmi yll që rrezatoje dritë shprese në atë lokal mizor, plot pijanecë e vulgaritet të pashoq, por më kupto që mezi gjej fjalët e gjuhës sime, kur të shkruaj ty. Jam shumë i emocionuar. E ndjej se jeta ime nuk ka kuptim pa praninë tënde, pa ato sytë e tu të thellë, që po verbohesh në atë mjedis plot tym duhani. Nuk mund ta ndaj mendjen asnjë çast nga ty, më vjen për të qarë kur imagjinoj një princeshë të lindur për të zbukuruar botën, tek lan shpirtcopëtuar, me ato duar të brishta e delikate, si Hirushja e përrallës, gotat e pijanecëve ordinerë. Zemra ime ndodhet pranë teje, ajo rreh me zemrën tënde, aq sa kam kompozuar një këngë të re dhe kam rifilluar të merrem pas kaq kohësh prapë me pikturën (po t’i dërgoj për kujtim nja dy skica!)...”

- Bëji edhe, ti, ato drej shkarravinash!- iu hakërrye Seferi piktorit.- Puno edhe, ti, si shoku yt! Nuk kemi kohë për të tallur bythën sot! S’e merr vesh, që po iki nga trutë e kokës!...

“...Prindërit e mi u gëzuan shumë që unë kam rënë në dashuri me një vajzë katolike dhe më treguan se në tavolinë e në shtrat (fjalën e fundit e shtoi Seferi!) shqiptari nuk ka pasur kurrë fe, aq më tepër që, dihet nga historia e vërtetë, se ne kemi qenë para tre qind vjetësh të gjithë katolikë, por pushtuesi i mallkuar otoman na ndau nëpër fera (këtu ndërhyri Seferi e tha se historia një mut të madh dinte, por, për hatër të Marijes, le të bëhej edhe plaku me plakën e tij katolikë, që as fjalën “derr” nuk e dinin!)...Ata janë dakort që fëmijët tanë t’i pagëzosh ti, veç jo po lindi fëmija i parë vajzë, se asaj dua t’ia emrin vetë; dëshiroj t’i ve emrin tënd, Mari, që të bëhet e bukur dhe shenjtore, si ty!...”

Dhe kështu doli një alamet letre e gjatë, me princesha, pleq, kalamaj, personazhe, që do t’ia bënte mendjen dhallë kujtdo e që e rradhiste Seferin automatikisht në njerëzit më të talentuar të botës artistiko-letrare shqiptare. Piktori ia mbathi në banjë, se nuk po duronte dot më, dhe, kur u kthye, ishte akoma i kuq nga ajo e qeshur pa fund, që, rëndom, të del për keq. Veç Seferi nuk e prishi terezinë. Do mbaronte se s’bën kjo punë, se me dashurinë nuk bëhej kollaj shaka!

- Ma shkruaj edhe një letër rezervë!- iu lut Seferi Gustit, po tjetri ia ktheu me të qeshur se do t’ia shkruante, pasi të kthehej përgjigjia prej Marijes dhe Seferi, si firmosi me një barrë mund poshtë letrës e skicave, rراسi një biçim partiture të një kabaje që pat luajtur dikur në Francë, dhe postoi rekomandë letrën e parë. Pak shtrenjtë ishte, po hajde, tha ai, për dashurinë bëhen edhe sakrifica!

Në krye të dy javëve Marija ktheu përgjigje. Ajo i lutej gjithë mirësjellje që ai të mos e shqetësonte kot. Nuk e urrente Seferin, përkundrazi, por ai ishte mysliman dhe ajo nuk mund të martohej me një njeri të kësaj feje. Edhe ajo e kishte kujtuar Seferin, bile edhe e pati parë në një ëndërr, që i vinte turp t’ia përshkruante në letër, por...

- Ka rënë brenda! Dhe keq fare!- i tha prerë Seferi Gustit, që po ia diktonte letrën.

Ai vërtet nuk dinte të lexonte rrjedhshëm, ama, për komente të thante piten!

- Shpejt, letrën e dytë dhe shkruaji se pas një muaji do shkoj ta takoj në Lezhë!

- Pse jo në Shkodër?- pyeti Gusti që nuk rreshte së habituri me shpikjet gjigande të tjetrit.

- I jam betuar që nuk do të shkel më në Shkodër, në atë qytet kriminel që po shkatërron atë bukuri vajzërore...Mbah fjalën, pra,- qeshi mbytur.- Jemi burra zakoni apo jo?...Pastaj kam edhe një dasëm me shumë lekë në Milot, kështu që një rrugë e dy punë!...

Letrën e dytë Gusti e shkruajti shpirtkëputëse, me një afsh të parrëfyer, aq sa ndjeu se diçka po i forcohej në mes të këmbëve, kur filloi t'i përshkruajë Marijes se si e kishte parë në ëndërr dy ditë më parë, me atë trup të mrekullueshëm të lakuriqtë që i qëndronte përballë me hënën mbi sup, me thithat e vogla të gjinjve që i qëndronin lart krenarisht dhe me ijet e veshura me një djersë të lehtë, që kundërmonin aromë trëndafili...

- Po na bën t'ia mbathim në banjë,- tha Seferi,- unë për vete nuk duroj dot më!...

Dhe si i fiksuan të gjitha, datën, orën, qytetin, vendin e takimit dhe ca hollësira të tjera, Seferi iu lut shkrimtarit që të shkruante në fund të letrës se tani ai po nisej për një turne të gjatë në jug të vendit, nga ku do të kthehej direkt e në Lezhë.

- Na mbyti puna,- psherëtiu ai. I futi një llapë zarfit dhe letra e dytë u nis drejt Marijes.

Njëzet e shtatë ditë më pas ai priste në Ishull të Lezhës, duke bërë ec e jake me një zemër që sa nuk po i plaste nga emocionet. Priste Marijen. Xhepat i qenë mufat nga shukat e lekëve. I kishte rënë klarinetës në dasmën e mbrëmshme në Milot në atë farë feje, sa edhe xhepat ua grisi dasmorëve, edhe emri nuk do t'i harrohej, derisa të mbetej edhe një milots i vetëm në këto anë, dhe mezi iu shpëtoi pokeristëve, që e kishin gjurmuar nga mbrapa me taksi si zagarë.

Të gjitha punët shkonin vaj, vetëm Marija nuk po dukej dhe ai sa nuk e theu me sy xhamin e orës së dorës. Filloi të rikujtojë këshillat e Gustit lidhur me vetëpërmbytjen dhe me kafshimin e gjuhës, që mos llapte shumë, me demek, i hodhi një sy plaçkave të trupit dhe pikërisht atë çast u duk Marija në rruginën e mbuluar me shelgje. Ishte vërtet marramendëse me ato flokët pis të zinj, të gjatë deri në brez e të lidhur gërshet, me trupin e derdhur, që duhej të të rreshqiste si gjarpër në pëllëmbë...

Ajo erdhi me një frymë drejt tij, e trembur, me një vërtitje të pakuptimtë sysh përreth dhe tha shpejt e shpejt, duke i zgjatur dorën hollake, se shumë pak kohë kishte në dispozicion dhe pat dalë në takim, veç me qenë korrekte, se nuk dinte ku ta gjente për ta lajmëruar që mos vinte në Lezhë...

Gri, ti, gri, tha me vete Seferi. Kishte rënë brenda egërsira e vockël dhe nuk dilte dot më nga kurthi. Ata hynë në lokal dhe ai i tha Marijes të porosiste ç' t' i dëshironte kokrra e qejfit. Priti me durim tjetrën derisa përfundoi tortën, pastaj nxori topin e madh të lekëve si për të paguar, i la një bakshish të majmë kamerierit, që e hutoi fare Marijen, dhe i propozoi tjetrës të bënin një shëtitje në oborrin e hotelit.

Dolën të dy, ai fodull e ajo kokëulur dhe, me t' u gjendur në atë park të madh, plot pemë e të shkretë nga njerëzit, Seferi i harroi këshillat e shkrimtarit: e përfshiu tjetrën brutalisht për beli dhe ia rrsi buzët, si pompë që liron lavamanin, aq sa asaj po i merrej seriozisht fryma. Pak çaste më pas ajo qëndronte e kërlëshur dhe e xhindosur tre metra larg, e fyer nga ky idiot dhe ulurinte zëulët si refren: "Kafshë e keqe, kafshë e keqe, kafshë e keqe!..." Pastaj u zhduk gati me vrap, duke e lënë Seferin si një statujë prej jashtëqitjeje jo fort cilësore në mes të atij parku të virgjër, që nuk e njihite prej vitesh dorën e njeriut. Qe treguar idiot! Po, punë që rregullohen, i dha zemër vetes ai, i kënaqur sidoqoftë që kishte provuar nga afër ato buzë e gjinj fantastikë të Marijes. Pastaj ndjeu se qe lagur në të mbathura dhe kërkoi banjën. I vinte plasja nga ajo ikja budallaqe e saj, por puthja vandale e ngushëllonte. Kaq donin shqiptaret për t' u lidhur me mashkullin. Tani Marija po qante hallin se mos ai i tregonte kujt... Ia nisi një fishkëllime në hesap të vet e filloi të vrasë mendjen se ku duhet të qenë mbyll ata dreq pokeristësh dhe kështu sikur e harroi Marijen.

3.

Agostini u shtri në tryezën e madhe si lopë dhe qeshte ime të madhe.

- Po si të porosita unë, o gomar!- i thoshte tjetrit me lotët që i rridhnin rrëke tek fliste. Nuk arrinte të mbaronte dot asnjë fjali nga e qeshura.

- Ehu, se mos u ndodhe ti atje dhe nuk iu vërsule,- mbrohej Seferi.- Ke parë ti gjoks që të qëndrojë si çadër?...Një kile buzë, komplet tul, ke parë?...Po sy që të rras ne dhe, si eskavator, tak-fak, ke rastis?...Ti ma bëj letrën shpejt, të keqen vëllai, se m' u bë syri gëlldoq nga pagjumësia, po të tjerat i gatis vetë una!...

- Po tina prapë do ta prishësh punën,- qeshte Gusti,- si kalaja e Rozafës u bë kjo punë: unë e ngre ditën, tina e prish natën...Ik, o Sefer vëllai, se kam punë sot!...

- Gjallë s' iki pa letrën!- u betua Seferi.

Dhe merrej vesh që e kishte seriozisht.

Pa, ç'pa shkrintari, i la punët e tjera dhe ia nisi të shkruajë letrën e tretë të Seferit. Kjo letër të bënte të qaje, edhe sikur të ishte shpirtkazëm. E mbushur plot me fjalë e përgjërime, me justifikimin se ai nuk e kishte veten në dorë në atë çast, por faji që i dashurisë së marrë, letra e bëri Seferin të deklaronte se tani duhet të dilte me vrap te Zogu i Zi për të pritur Marijen, që do merrte vrapin e do të vinte me brekë e kanatiere në Tiranë!...Ishte treguar budalla që nuk i dërgoi edhe një skicë të saktë të vendndodhjes së shtëpisë së tij. Do ngatërrohej keq e shkreta!...Hajde ta mbaje kur t'i hidhej përqafe në sy të plakut e të vinte kujen: "Mos më ler, Seferi im!..." Ia prishi pak Gusti në fund, kur nuk shkruajti se ai do ta vriste veten, po mos i përgjigjej dashurisë së tij Marija, po, edhe ashtu siç që sajuar, letra edhe gurin e bënte të vinte kujen...

Letra e preku thellë Marijen. Ajo u përlot përsëri natën vonë në shtrat, tek rilexonte ato fjalë magjike e njerëzore, të cilat sikur i kishte shkruajtur dikush tjetër e jo ai barbar, që sa nuk e përdhunoi faqe botës e që ia nxiu buzën e poshtme. Veçanërisht Marijen e shkriu në vaj ajo fjalia nga fundi i letrës: "Këtu të gjithë janë të lumtur, përveç meje..."

Zot i madh, bëri kryqin ajo, tamam poezi!...

Po edhe fundi mund të quhej i tmerrshëm:

"...Tani bije shi, një shi shpëtimtar vetëm për mua dhe unë mund të dal i qetë në oborr e të qaj shtruar për ty, nëpër ujëvarën që më varet në trup, pa u trembur nga askush. Askush, Mari e dashur, nuk e pret me kaq ankth shiun sa unë, pasi unë përditë vajtoj me lot për ty! Nëqoftëse më do, ti duhet të më falësh pa hezitim, sepse falja është ajo që e dallon dashurinë nga ndjenjat e tjera. Përndryshe, ne do të ishim qenie të ftohta, me gjak gjarpëri, pa ëndrrat tona të përbashkëta e pa këta margaritarë lotësh, që na bëjnë njerëzit më të pasur të botës. Po, Mari! Unë sot jam më i pasuri i botës, sepse jam në gjendje të qaj!..."

Edhe Marija qau. Pastaj ajo mori një letër dhe nisi të shkruajë me kaligrafinë e saj të kujdesshme: "Këtë herë, po të fal, por ajo sjellje nuk duhet të përsëritet më nga ty! Ne tani jemi miq dhe për dashuri mes nesh ende nuk mund të bëhet fjalë, aq më tepër që ti e di mendimin tim për shokun e jetës, por..."

- Ia hodhe edhe këtë herë! - i ra supeve Gusti.- Po mos e përsërit më, o Sefer, se gjallë nuk të shkruaj më letër tjetër!

Kështu Gusti u ul e shkruajti letrën e katërt. Kjo ishte një filozofi e gjallë nga e cila Feri nuk shgrapi asgjë! Pengesën e fesë e kaluan me shembulin e Anglisë. A nuk kishte pasur koloni ajo? Sa të duash! Bile, ajo i krijoi, hasëll-hasëll, kolonitë! A ishte betuar mos t'i lëshonte kurrë kolonitë? Një milion herë ishte betuar! Iu dha pavarësi, kur ia kërkuan? Po! Sepse kështu i mbante më mirë në zap!...Bota evoluon(ç' fjalë të bezdisura ishin këto për Seferin!) në strategjinë e saj dhe ne

nuk mund të ecim kundër teorisë së zhvillimit, kurse besa, ajo ishte tipar primitivizmi, që, për hir të një betimi, nuk të lejonte të shijojë frytet e së resë...Problemi i vetëpërmbytjes para syve të njerëzve ishte tmerrsisht i drejtë dhe ai i betohej se nuk do ta përsëriste kurrë më, por këtu nuk duhej të harrohej edhe ndjenja hyjnore e dashurisë për Marijen, që atë nganjëherë e kthente në makinë pa frena... Unë do të jap një recital këtë fund muaji në Teatrin e Operas dhe Baletit, përfundonte letra. Këtë koncert të ëndërruar prej vitesh ia kushtoj vetëm lumturisë pa kufi që më ke dhuruar ti dhe përmes artit tim, ti, Mari, do kuptosh realisht se sa të dashuroj. Eja më dëgjo dhe pastaj vendos vetë!...”

Një tjetër pështymë seferiane dhe kështu u nis edhe letra e katërt. Marija u mendua gjatë. Nuk qe fort i keq ky drej Seferi, bile, kur shkruante, kthehej në magjistar! Ta bënte mendjen çorap dhe ajo vendosi më në fund të hidhej një herë deri në Tiranë, ta shihte koncertin e, me atë sebeb, po iu bënte nga një vizitë edhe dy hallave atje...Kështu, si në mjegull, ajo i hypi trenit ditën e koncerti të Seferit. Marija u ndje e vogël dhe e trembur në atë sallë të mbushur plot me njerëz të fisëm e të veshur shik, që dëgjonin pa marrë frymë çudirat e Seferit të saj në skenë. Ajo shihte dhjetëra gra të bukura që e ndiqnin gjithë afsh Seferin dhe u ngroh që zemra e tij kishte zgjedhur pikërisht atë mes gjithë këtyre primadonave...Edhe Gusti po mahnitej nga një cep i sallës me këtë hajvan, që e mblihte gjithë botën në atë hinkë të ngushtë e të errët si pus dhe e mbushte sallën pastaj plot tinguj të mrekullueshëm, që e kthenin atë hapësirë të veshur me egelit në një pyll plot drurë, erëra e këngë zogjsh...Askush nuk mund ta mohonte tani se Seferi ishte mbreti i klarinetës, se ai mund të ngjallte edhe të vdekurin nga varri e se mund të bënte të lumtur këdo...

Marijes i shkanë lotë, tek pa atë fytyrë të përvuajtur, sy mbyllur e bulçi fryrë, mbuluar nga djersët, që, tani, me siguri, ëndërronin atë vetë! Nuk qe fort i keq, ta hante dreqi, veç që pat qëlluar mysliman!...Ajo shihte gishtat e tij të fortë të mbuluar nga qimet e zeza, pastaj mendoi gjoksin e tij dhe u turbullua...Të hëngërt mortja, shau veten, ama, sa mbaroi koncerti, nuk iku, siç e pati bërë ndërmend, po ndejti e priti me durim sa të dilte Seferi. Mirë ishte ta uronte, ishte njerëzillëk! Por nuk arriti as t'ia jepte dorën tamam, sepse, sa ia zgjati, u gjend në krahët e tij, a thua se nuk ndodhej para njeriut që i qe lutur me afsh ta falte e i qe betuar se nuk do të bënte më skandale të tilla! Ajo i ndjeu edhe një herë buzët e tij në gojën e saj, e kuptoi se nuk i shpëtonte dot dhe tha “të bëhet si të bëhet!”, kur ia ktheu për herë të parë puthjen.

Atë natë ata fjetën te Hotel “Peza”. Bënë dashuri, sa i nxorën ujin e zi, siç shprehej plaka e Seferit, ajo qëndroi nja dy orë të mira me këmbët përpjetë e me atë goxha peshë burri sipër, dhe, si arriti ta kuptojë qartë se ky njeri ishte magjistar kur luante në klarinetë, apo shkruante letra, e komplet hajvan, kur fliste, vendosi

t'i dorëzohej fatit e të mos kthehej më në Shkodër. Hyri nuse në shtëpinë e Seferit e kështu ra rehat edhe Gusti, të cilit tani po i dilte nami se i qante letrat e dashurisë. Seferi u zhduk nga rrugët ca kohë e tani pokeristët po ia harronin fytyrën. U bë djalë i rregullt. I sillte lekët e dasmave në shtëpi, ia dorëzonte Marijes dhe filloi të shëndoshej. Vetëm fëmijë nuk po bënte dot, se nuk i mbushej mendja Marijes dhe kështu kaloi një vit. derisa u hap lajmi se Seferi u nda me Marijen, me atë femër që e kishin mallkuar me gjithë shpirt pokeristë e orkestrantë dasmash, nga që ua kishte hequr nga dora copën e floririt. Ajo kishte hedhur rrënjë në apartamentin e tyre të vogël, kurse Seferi ishte kthyer në shtëpinë e prindërve, tani me nam in që e kishte spermën ujë e veç ndonjë bretkocë mund të fekondonte...

Gusti e mori vesh vonë lajmin, kur gjithçka ishte vulosur e firmosur në gjykatë dhe ai tha duke qeshur se ajo punë ashtu do të përfundonte. Në fillim u tremb pak, kur mendoi se Seferi mund t'ia fillonte prapë avazit me letra, po klarinetisti nuk e kishte më atë mendje. I pat hyrë prapë me qejf pokerit e dukej po i ecte, deri sa ndarjen e kishte kapërcyer pa dramë me frazën: Nuk i bihet në një vrimë kavallit!...

Të paktën, Seferi kishte bërë qejf nja një vit dhe ai nuk ishte tip që i përjetonte gjatë tragjeditë, siç e kishte krijuar mëma natyrë realisht.

4.

Nja gjashtë muaj më pas, kur rrugëve të Tiranës kishin lulëzuar blinjtë e ditët nuk shtyheshin më klubeve gjithë tym duhani e bërçolle derri, Gustin e kërkoi një bashkëpunëto re në gazetë. Ai e priti më përtesë në zyrën ku mbretëronte kaosi dhe po uronte që tjetra të mos i kërkonte ndonjë dorëshkrim, që kush e di në ç'vrimë qe futur. Por bashkëpunëto rja ishte tip i urtë e komod. Ajo vetëm iu lut Gustit t'i shihnte një tregim, që sapo e kishte përfunduar. Mbase botohej.

- Ah, më vjen keq, por unë nuk jam redaktor i tregimit,- e bëri dalje Gusti.

- E di,- u tërhoq butë tjetra,- po unë e desha mendimin nga ju...Le të mos botohet tregimi...Unë kam shumë respekt për ju, si shkrimtar...Jeni nga të rrallët që pëlqej, mos them i vetmi...

Agostini u lumturua. I hodhi një sy femrës së kolme, që nuk mund t'i gjeje asnjë të metë, ia mori tregimin, e uli tjetrën pranë vetes dhe filloi t'ia lexojë krijimin. Ishte një tregim mizerabël, me një nga ato fabulat sentimentale të viteve '30 dhe ai filloi t'ia hidhte poshtë me kujdes e gjithë edukatë. Ajo e respektoi e as ai nuk po donte ta fyente. Ia kishte ndërë flokët fare pranë dhe kofshën, që ia prekte kofshën e tij gjatë leximit, dhe sikur nuk qe ndërë keq.

- Unë e ndjej që ky tregim nuk vlen,- tha ajo,- por më pëlqen të shkruaj

dhe ndoshta ju mund të më ndihmoni, sa të mësoj alfën e kësaj pune...

S'është me të mësuar, moj xhan, kjo punë, tha me vete ai, por pse t'ia prishte? I rekomandoi si fillim të lexonte sa më shumë, për të kuptuar thelbin e asaj magjije që quhej letërsi, i tregoi se si mund të mësonte sekretet që e ngjiznin një vepër, i rekomandoi "Dekameronin" për ta lexuar dhe i tha të vinte përsëri pasi ta kishte lexuar, që ai ta merrte vesh se sa profesioniste ishte treguar në lexim.

- Po kur shkruani ju a mund të jem ndonjëherë e pranishme, në qoftëse nuk iu bezdis?- e pyeti papritur gjithë turp ajo, me një purpur të kuq në fytyrë.

Gustit i ngriu buzëqeshja në gojë.

- Patjetër!- pranoi ai.- Unë kam një studio, ku punoj çdo pasdite dhe ti je e mirëpritur të vish kur të duash. Me këtë rast, mund të më shërbesh ndonjëherë edhe si model, kur të kem ndonjë subjekt me një personazhe simpatike, si ty...

Tjetra u skuq.

- Faleminderit!- tha dhe u ngrit.

Iku pa zhurmë, siç pati hyrë. Gusti ngeli një kohë, duke parë derën, nga kishte dalë kokëulur ajo bukuri përralle, derisa një kolegia e tij futi kokën e saj të zezë brenda.

- C'ishte ajo peri, Gust!

- Tregimtare...

- Ajo t'i shlodhte sytë, Gust!

Tjetri i bëri një shenjë me dorë. Nuk i punohej më. La adresë se ndodhej në Teatrin Popullor dhe ia mbathi.

5.

Gustit i ngeli mendja te ajo femër e habitshme, me atë sensualitet që i shpërthente nga çdo pjesë e trupit dhe me përvulësinë e çuditshme e të pashpjegueshme, a thua e dinte veten për ndonjë femër të humbur e që nuk ishte parë kurrë në pasqyrë. Po edhe tjetra nuk e la të priste gjatë e të shihte ëndrra me sy hapur në garsonierin-studio, kur ai nuk kishte shkruajtur asnjë rresht që nga dalja në skenë e asaj shenjtojeje. Tre ditë më pas, kur muzgu po binte ngadalë, ai ndjeu një trokitje magjike në portë. Ishte ajo. E turpshme, me një fund të ngushtë, që ia nxirrte mirë kofshët në pah, e me një triko të punuar me dorë, ku ngjyrat qenë kombinuar mjeshtërisht, ajo hyri brenda dhe u struk në një qoshe kolltuku këmbëmbledhur në një krah, sikur të ndihej e penduar që e kapërceu atë prag tip Rubikoni.

Ai u habit edhe më shumë kur e pa me librin e tij të fundit në dorë dhe nxitoi të krijonte pak ambient, duke hapur një shishe vere e një kuti konserve, që nuk dihej kush e kishte harruar në studio. Preu pak gishtin nga emocioni, tek po

hapte me thikë konservën, dhe ajo klithi:

- Unë e kam fajin!...Ti ndoshta po punoje, po unë bleva librin tënd dhe kisha dëshirë të më vije një autograf...Prit, të ta lidh unë gishtin!...

Gusti mbushi gotat, i uroi tjetrës mirëseardhjen, piu pak verë, pastaj mori librin. Si mund t'ia shkuante autografin kësaj femre, që as emrin nuk i dinte e as ç'punë bënte?

Ajo ia kapi dilemën.

- Mund ta shkruash si të duash. Unë nuk kam njeri që ta lexojë...

I shqiptoi këto fjalë dhe nënqeshi lehtë, si me turp, po Gusti kuptoi gjithçka. Ai e firmosi librin "me shumë respekt etj." dhe, kur ajo e pyeti se ç'nënkuptonte kjo "e të tjera", ai e tërhoqi ëmbëlsisht në gjoksin e tij, e puthi disa herë në qafë atë statujë që nuk e njihte fjalën "mos" dhe, si ia kundroi fytyrën e skuqur nga pasioni, i tha me zë të dridhur:

- Më ke lënë pa punë gjithë këto ditë dhe mos mungo më kaq gjatë!...

Pastaj ndodhi ajo që ndodh zakonisht në të tilla raste. Të xhveshur, siç i kishin lindur nënat respektive, ata do të rënkoinin mbi kolltuk nën valët e epshit. Kështu, rënko e zbrazu, pi cigare e ribashkohu iku ajo mbrëmje dhe nga ajo ditë mysafirja u bë njeri i shtëpisë në atë hyrje të vogël, që po iu falte aq gëzim. Ajo ishte e mrekullueshme në shtrat, prehëse, tunduese, me ato puthjet dhe gjinj të që i forcoheshin nën valën e epshit. Ishte e urtë, si një kone. Nuk të bezdiste kurrë dhe, kur ia fuste thithat e gjinjve në gojë, ai shkrihej i tëri, duke harruar gjithçka.

Agostinit nuk i kishte rastisur të njihte një femër të tillë, që nuk dinte t'i kërkonte gjë e që nuk qahej kurrë. Vinte si hije, e admironte kur e gjente duke punuar, pastaj xhvishej e shtrihej në divan dhe priste ato ledhatimet e tij të pafundme me kukurisje të lehta, që dalëngadalë ktheheshin në rënkime të dala nga shpirti. Vetëm një gjë kërkoi ajo prej tij: të shkruante sa më shumë e përditë, gjatë kohës që ishin bashkë, ndryshe...Ajo nuk e pati mbaruar fjalinë, por nga sytë merrej vesh gjithçka. Agostini e dëgjoji. Pasditeve ajo lexonte e kënaqur ç'kishte shkruajtur ai, nuk bënte kurrë vërejtje dhe ditën që ai botoi romanin "Tre metra larg rrugës", atë roman të mrekullueshëm, që më pas i nxori aq telashe, ajo ishte njeriu më i lumtur i botës. Kishte të drejtë, pasi Gusti nuk kishte hedhur asnjë rresht nga ajo mrekulli para njohjes me të dhe ishte kryevepra e krijuar në të vërtetë prej saj me kërcënimin e shpërbërjes së asaj lumturije të pafundme, që e detyruan këtë njeri të talentuar, indiferent e dembel bashkë të ulej në skrivani.

Kishte ardhur dimri, kur Gusti botoi romanin dhe ishte gjithashtu dimër, kur ajo iu lut të pinin diku një kafe. Ai e ndjeu se po ndodhte diçka e rëndësishme, derisa ajo druhej ta bënte bisedën në studio. Nuk ia prishi. Ata u ulën një ditë me shi në kafën e boshatisur të Hotel "Tiranës" dhe ajo filloi të fshijë lotët pa shqiptuar ende asnjë fjalë.

- Pse qan?- e pyeti Gusti me pyetjen më formale për të tilla raste.
 Nuk mori përgjigje. Vetëm pasi ajo ishte shkarkuar e tëra, dëgjoji gjënë më të paimagjinueshme:

- Boll, Gusti! U zgjat shumë kjo punë...Ti je edhe i martuar, me fëmijë...
 Ishte vërtet e bukur.

-...Ti nuk ke asnjë ide kush jam unë dhe përse erdha vetë te ty...Të kujtohet Seferi, ai klarinetisti...

- Po,- tha ai i hutuar e pa kuptuar asgjë.

- Unë jam Marija, ajo vajza nga Shkodra, që ti ia shkruaje në emër të Seferit ato letra të mrekullueshme...

- Jo!- tha Gusti.

- Lere, Gust, se unë jam! Ato letra i di akoma përmendësh e i ruaj si gjërat më të shtrenjta. Vdiqa, deri sa ia nxora sekretin Seferit!...Prandaj erdha te ty, sepse isha e bindur se ti ishe i vetmi njeri që më dashuroje tamam, punë e madhe se nuk më njihje...Ne nuk do të takohemi më bashkë, Gusti, por unë do të të lutesha që ti të shkruaje gjithmonë, si këto kohë, sepse ti je më i talentuari e më magjistari nga të gjithë, derisa ma mbushe mendjen mua të martohesha me atë gomar, që i dëgjoheshin pëllitjet një orë larg...

Gustit i shpërtheu një e qeshur, që nuk e mbante dot. Pastaj kapi kokën me duar e tha:

- Paske vuajtur edhe ti! Paske qenë heroinë!...

Qeshi edhe ajo.

- Varrit do t'ia tregoj, po nuk jam pishman. Ja, të njoha ty!...

Pak çaste më vonë ajo u ngrit. Gusti e shoqëroi me sy tek ikte nëpër ato rrëke shiu, kujtoi ato pasdite të mrekullueshme që kishin kaluar bashkë, atë paqe e prehje pa fund, që nuk do ta gjente më kurrë, dhe porositi një dopio uiski. Kjo punë u qelb, mërmëriti, tek porositi dopjon e dytë. Ekuilibri nuk ka më asnjë vlerë! Shën Marija ishte ngjitur sërish në qiell dhe kush e di se kur do të kthehej, për të bërë të lumtur ndonjë fatkeq tjetër.

KANË, KORRIK 1995

KUR ENGJËJT NDALIN FLUTURIMIN

Ferdinand Kosturi është në një moshë të tillë, ku jo çdo send fluturues hahet. Ai ka qenë një herë banor shembullor i këtij vendi me emrin "Shqipëri", u përpoq ta deshte këtë vend dhe, tani që sapo ka mbushur 50 vjeç, gjithë duke e kundruar vendin e tij nga dritarja e vogël e koordinatorit të trenave, ndjen një si lloj keqardhje për njerëzit e lodhur në ec e jaket e tyre të pafundme. Ka vite që përpara syve të tij të mjegullt kalon një kalvar i tërë, gjithmonë i ngarkuar, gjithmonë gri. I duket se më shumë nga shtetet, regjimet e individët në pushtet, këta njerëz lodhin vetveten me atë mendje që kanë: nuk e kanë fort për zemër qetësinë personale, mos flasim pastaj për urrejtjen patologjike që kanë për paqen e tjetrit. Që kur u inagurua stacioni i vjetër i trenit në kryeqytet, ai ka punuar koordinator dhe vetëm zyrën ndërroi, kur u transferuan në stacionin e ri. Personalisht, Ferdi është i bindur se ka ardhur në jetë për të vuajtur. Ai lindi ditën, kur kapitulloi fashizmi, kështu që asnjë nuk u gëzua tamam për ardhjen e tij në jetë. Pastaj, në fillim të viteve '50-të, i arrestuan gjyshin dhe, si e bënë lëmsh gjithë shtëpinë, çanë oxhakun e madh, nga ku ranë breshër florinj pa mbarim, frutet e punës së disa brezave të familjes së tij, që i kishin mbledhur pak nga pak, si plaga qelbin. Ai qëndronte në prehërin e gjyshes me macen laramane në prehërin e tij dhe mbajti mend që gjyshja psherëtiu: "Tani, mbaruam! Uji u derdh në det!..." Pastaj, në fillim të viteve '60, sapo gjyshja vdiq, ua morën edhe shtëpinë e bukur, me oborrin e madh e shatërvanin e mermertë, që nuk dihej kush mjeshtër e pat skalitur aty nga fillimi i shekullit. Shtëpia u kthye në ambasadë për një vend mik aziatik, kurse ata i flakarinë në një apartament të vockël në Kombinat dhe, kështu, i lanë fare lakuriq. Ferdi ishte fëmijë i vetëm. Pas gjithë atyre gjëmave, askush

nuk mendonte më për fëmijë tjetër, por ai pati një fat të madh: arriti të bëhet një futbollist i shkëlqyer dhe kjo e ndihmoi ta lejonin ta kryente shkollën e mesme pa i nxjerrë gogolin e biografisë përpara, të kryente ushtrinë formalisht në Tiranë, të gjente një punë, të siguronte një nuse e një apartament të vogël në qendër të kryeqytetit. Nja dhjetë vjet ky njeri i heshtur e i butë, mbase i edukuar kështu nga tmerret e prekura me dorë që këlysh, ishte si mbret në Tiranë. Golat e tij mbetën në histori. Vërtet që jashtë shtetit nuk e lejuan kurrë të luante me përfaqësuesen, por në Tiranë ishte gjithmonë titullar dhe, sa herë ekzekutohej Hymni Kombëtar i vendit, që ia kishte nxirë nxirshmërisht jetën, ai qante duke gëlltitur lotët. Pastaj theu keq këmbën, për t'i dhënë lamtumirën futbollit. Nuk shkoi më në stadium, nuk e goditi më topin me këmbë, u struk në kabinën e koordinatorit të trenave dhe priti rrjedhën e jetës mes sirenave të pafundme të trenave në ikje e në kthim. Djali i madh i vdiq në fillim të viteve '80 nga leucemia, pastaj vdiq edhe gruaja nga një sëmundje grash dhe ai mbeti vetëm me vajzën, Monikën e tij të vogël, një bukuri që t'i këpusje kokën dhe që e gjetën ndryshimet e mëdha të viteve '90-të maturante në gjimnaz. Ajo pati fatin të shkonte në Universitet, studioi për gjuhë të huaja, por shqiptarët i urrente. Teoria e saj ishte se Enver Hoxha nuk mund të shkatërronte aq shumë jetë, pa ndihmën e një kontributi vullnetar mbarëkombëtar. Ajo nuk ua falte shqiptarëve të saj gjithë ato vdekje e vuajtje dhe, si bashkëjetoi nja dy vjet me një diplomat francez, vendosi të martohet me të dhe iku në Londër, ku tani punonte bashkë me të shoqin. Kështu Ferdi mbeti fare vetëm, në pritje të pensionit e në shoqërinë e atyre bilanceve të tija të pafundme, ku gjithmonë përfundimi ishte një mal me trishtim. Ekonomikisht ai nuk është keq. Ia kthyen shtëpinë e madhe bashkë me disa prona, dhe, pasi shiti apartamentin e tij, ai e restauroi dhe e bëri të re atë shtëpi me nam, për arkitekturën e saj. Pastaj iu lëshoi disa dhoma të katit të dytë më qira dy kompanive të mëdha amerikane dhe tani kishte goxha dollarë në bankë. Por nuk ndjente gëzim. I kujtohej gjyshi, gjyshja, babai, nëna, djali, gruaja, vajza,- të gjithë të vdekur kot fare e njëra e ikur gjithë inat, pa e kthyer as vështrimin pas, dhe i vinte keq për Shqipërinë. Pse duhej të vdisnin e të iknin gjithë këta njerëz të mençur, të talentuar e të bukur? Tani, që ai vëzhgon turmën laramane t'i parakalojë para syve, i duket vetja si banor indigjen. Për këta primitivë një pasqyrë vlente më shumë se gjithë ari i botës. Kështu ia patën vlerësuar e shkëmbyer edhe atij familjen: të gjithë, ju, do të ndërroheni me HIÇIN!...Por ai, zemërbutë e pa hakmarrje tashmë, sërisht shpreson se do të ndryshojnë punët për mirë e se Zoti i madh do ta shohë vendin e tij. Ja, edhe kjo turmë laramane, dëshmon ndryshim. Ajo nuk është më uniforme, gri, si më parë: po ato këpucë, po ato këmisha, po ato xhaketa, po ato copa fustanesh, a thua kishin dalë dy skuadra futbollit në fushë...Tani studentet e zhurmshme duken si topmodele dhe atë e merr nganjëherë malli t'i lutet ndonjëres t'ia hedhë një herë sytë edhe atij. Ferdi ka

shpresë se njerëzit po e mposhtin egërsinë, bashkë me atë huqin e të futurit të hundëve në punët e të tjerëve. dhe kjo shpresë sikur e mban gjallë. Atij nuk i pëlqen që thujtse të gjithë ankohen për të kaluarën e kërkojnë kompesime pa hesap nëpër greva urije e artikuj gazetash. Për veten e tij, asgjë nuk mund t'ia rivlerësojë humbjet e pësuar në këto 50 vjet. Ato jo vetëm ishin vdekje të tmerrshme, por edhe të fushin në borxhe! Ehu, bën me vete ai, kush i kujton!...Atij i ringjallen ato vite të paharruara, kur këndonte i përlotur hymnin në stadium, golat e tij spektakolarë, fotografitë e tij në muzeun e sapo ngritur të futbollit, dhe mendon se nuk duhet humbur kohë me ankesa e se momentet e bukura duhen krijuar sa më shpejt. Dhe, gjithë duke vëzhguar i heshtur turmën që parakalon, bëhet gjithmonë e më optimist. Kështu, deri ditën, kur syri i tij prej specialisti, që e ndan në çast turmën copa-copa dhe dallon çdo veçansi interesante brenda saj, fokuson dy të rinj që puthen mirë e mirë gjithë afsh mes lumit të pasagjerëve. Duket sikur ata po presin njëri-tjetrin, po Ferdi nuk e ha këtë rreng. Ai e kupton se të dy janë studentë, dy studentë të trembur nga fjalët pa fund të turmës po aq pa fund, që kthehen nga familjet në shkollë dhe kjo merret vesh nga ca shenjës, siç janë veshjet e trupit, çantat e tejmbushura të shpinës, ato fjalë naive që thonë "si ishte gjyshja", pa harruar lodhjen e lehtë, por që nuk fshihet kurrë, të udhëtarit. Ata puthen mirë e mirë në atë rrëmujë, ku askujt nuk i shkon mendja te tjetri, pastaj ndahen në dalje të stacionit e bëjnë sikur nuk e njohin njëri-tjetrin. Kjo punë përsëritet çdo të dielë mbasdite dhe Ferdi e kupton se këta të dy janë ose pasagjerë të Fierit, o të Vlorës, o të Jugut. Ai habitet e fillon bëhet i vëmendshëm për këto puthje plot afsh ilegale, që shkëmbehen në mënyrë kaq paradoksale, shoqëruar me fjalë malli për ca pleq, që rrezik nuk jetojnë më, në një kohë kur duket se askush nuk ka frikë më ta shpallë dashurinë e tij e se puthja ka marrë pasaportë legale. Ndosht gjithmonë mot a mot! Djali duket tip komandues. Ai duhet të jetë lab, e ndan mendjen Ferdi, tek e sheh se si urdhëron nëpër dhëmbë, pa e parë tjetren në sy. Vajza ka një trup të hajthëm, një ecje prej sportisteje, flokë të gjatë e të zinj dhe një hundë kapriçioze. Ajo është shumë e bukur, por duket njeri i kërrusur nga drojtja e damkosja. Ferdit i vjen keq për të, kur e sheh se si i fshin lotët me shpinën e lëmuar të pëllëmbës në ndarje e si ikën kokëulur drejt stacionit të urbanit. I duket shumë e re, për të vuajtur. As ai, me gjithë ato halle e hije, në moshën e saj nuk ishte i trishtuar. Gjente pak diell edhe në mes të rrebeshit. Kalon një vit kështu dhe hyn viti 1995. Tani Ferdi ka një nip franko-shqiptar me emrin e tij, por me një "o" evropiane tepër në fund. Ai ka lindur në Londër e mbase i bie të jetë qytetar anglez e, në i pat ngjarë gjyshit, mbas nja njëzet viteve do këndojë Hymnin e Anglisë nëpër stadiume. Po iu tek Monikës të lindë ndonjë fëmijë tjetër, ky mund të jetë ndonjë nënshtetas aziatik a afrikan...Me dy fjalë, rrokopujë gjakrash, gjuhërash, zakonesh e origjinash...Kjo e trishton Ferdin. Mirë

që flamur shqiptar nuk shikon kund, por edhe nipi i tij i vetëm nuk do të jetë shqiptar...Tani trenat ikin plot e kthehen bosh! Atij i kujtohet koha e eksodeve të mëdha, trenat e tejmbushur me gjithë atë rini në rrugën e fundit drejt Durrësit...Shumë kishin ikur, shumë!...Ëndërrimtarë, të trishtuar, inatçorë, dhe të gjithë- pa asgjë me vete, rrezik edhe pa kujtesë! I mendon të gjitha këto, pastaj papritur bëhet sy e veshë. Ja, djali, i vetëm në turmë! Ai çan njerëzit moskokëçarës, me fodullëkun e të riut në sy. Me çantën në sup e duart në xhepa, ai bën sikur përplaset me vajzat e reja që i kalojnë përbri ...Ja, edhe vajza atje larg! Ata nuk puthen më gjithë afsh mes turmës e as që ia hedhin sytë njëri-tjetrit. Vajza duket e trishtuar, e zbehtë, djali moskokëçarës...U zutë edhe ju, trishton Ferdi. Tani ai nuk i duron më tragjeditë e nuk pranon as të shohë në TV filma me subjekt të tillë. Ndihet i tejngopur me to, i veleritur...Portreti i vajzës atij sepse i kujton portretin e tij 30 vjet më parë, kur e përzunë si qen nga shtëpia e Mondës, vetëm pse guxoi ta kërkonte për grua. Ishte treguar i ndershëm atëherë, nuk e shfrytëzoi si rrugaç atë vajzë që e deshte aq shumë, sa nuk linte as edhe një seancë stërvitore të tij pa e ndjekur. Kurse ata...E fshikëlluan më biografinë e tij, e poshtëruan, e pështynë, pastaj një shkelm bythëve prej futbollisti futbollistit dhe...Por e ndjen se përqsaja është idiote. Tani kohët kanë ndërruar dhe njerëzit nuk bashkohen e ndahen më për motivet e kohës së tij. Sidoqoftë, ata janë NDARË dhe NDARJA është gjithmonë me të njëjtat pasoja, si goli! Ai, që ia njuh shijen mirë kësaj pune, trishtohet. Dhe, si kalojnë edhe nja tre muaj kështu, me këtë pamje pikëlluese, ai vendos të dalë para kohe në pension. Kush rri e punon edhe gjithë ato vjet e muaj të tjera kot, duke kullotur sytë nëpër peizazhin e trishtuar, kur ka një qerre me dollarë, sa të duash e të përtosh t'i numërosh ka, e kur koha që i ka mbetur për të jetuar nuk duhet të zerë pluhur trishtimi? Ferdi shkruan një mbrëmje kërkesën. Shkruan me një kaligrafi të bukur. Falenderon ndërrimarrjen që e ka trajtuar mrekullisht për gati 30 vjet, shpjegon shkaqet e largimit dhe afron një kohë në dispozicion, për t'ia kaluar përvojën zëvendësuesit. Këtë e bën që të jetë i qetë me ndërgjegjen. Nuk i pëlqen të dëgjojë nesër për ndonjë xing trenash në hyrje të stacionit. Një ditë të martë, tek vëzhgon platformën bosh, Ferdi dallon mes turmës së pakët të pasagjerëve, që presin trenin e linjës së tyre të nisen, vajzën. Ajo është vetëm, e mbështetur në një mur pranë zyrës së tij. Ka ftohtë në atë hapësirë ku era bën ligjin, mban duart të rrasura në xhepat e palltos, ngre herë pas here shallin për t'ia mbuluar gojën dhe ai vendos ta ftojë të ngrohet brenda. Duket zërin e ka tepër njerëzor, përderisa vajza menjëherë pranon të vijë. Ajo ulet përballë Ferdit dhe ata ia nisin një bisede të lehtë. Vajza studion për ekonomi, por nuk e ka qejf shkollën. I duket një shpenzim i tepërt e kohë e harxhuar kot, për të marrë një diplomë, e cila ndoshta nuk do t'i hyjë kurrë në punë. Tani privatët nuk shohin shumë diplomën, shton e trishtuar ajo, gjithë duke hedhur sytë andej nga platforma,

në pritje të trenit të saj. Ajo di greqisht dhe anglisht, flet mirë italisht, po kujt i duhen të gjitha këto?...Ferdit e sheh dhe mendohet. Më në fund vendos ta hapë gojën. I tregon vajzës për gjithë ç'kanë parë sytë e tij në platformë dhe ajo, në fillim belbëzon "mbaroi tani ajo histori", pastaj nis e qan dhe as vetë nuk e merr vesh pse i rrëfëhet Ferdit. Ajo është nga Fieri. Që kur ishte dymbëdhjetë vjeç, babai ia ndau nënën, sepse ajo ishte imorale. Që atëherë vajzën, që e ka emrin Iris, e kanë thirrur "vajza e kurvës", paçka se ajo e urrente për këtë profesion nënën. Ajo i tregon Ferdit për llahtarën që i kanë parë sytë në atë shtëpi, me kollovare pa fund e britma epushore, me sy të qelbur që e ndillnin pa turp në shtrat dhe thith hundët e zëna nga lotimi...Kur erdhi demokracia, e ëma ia mbathi në Greqi. E la Irisin të banonte me gjyshen, për ta ushtruar tani me shkencë zanatin e vet në vendin e buzuqeve. Para tre vjetësh iu rrotullua edhe Irisit ta merrte në Greqi, gjoja për të kryer studimet, po Irisi e dinte për çfarë studimesh bëhej fjalë dhe nuk shkoi. Tani studioonte me një bursë të vogël e me ndonjë ndihmë të nënës. Por emrin gjithmonë e kishte "vajza e kurvës"...Ai djali vetë i qe rrotulluar e i ishte qepur si rrodhe nja një vit nga mbrapa, por, pasi ajo e besoi e ai arriti gjithë çfarë deshë, luajti rolin e budallait, duke bërë sikur po e dëgjonte për herë të parë se vajza e kujt ishte Irisi. Unë seriozisht e ai me mendjen e ndarë që kjo lidhje ishte krijuar për qejf dhe u prish puna, tha ajo mes lotëve të kristaltë, që i vareshin si rruaza faqeve. Dukej se ishte goditur keq, pikërisht kur mendoj se gjithçka u kthye për mirë, por, mesa dukej, e keqja vetëm sapo kishte filluar e ajo do të lante gjithë jetën me jetën e saj borxhet e të ëmës...Ferdit u përpoq ta qetësonte. Ai i tregoi jetën e tij, renditi gjithë ato vuajtje që përfundonin skematikisht, me vdekje e humbje. Nuk ia vlente të qaje. I binte të qaje pambarimisht e prapë të mbeteshe borxh, për punë konsumimi lotësh, kur të vdisje!...Irisi i dha të drejtë. Më në fund, u dëgjua sirena e trenit të saj, ajo i premtoi Ferdit se do vinte ta takonte pasnesër, me të zbritur nga treni, dhe kështu u ndanë.

Dy ditë Ferdit e priti me ankth tjetrën. Iu ngrit mendja se mos Irisi nuk vinte. Trembej se mos ajo bënte ndonjë budallallëk të pariparueshëm...Diç kishte vendosur me mendjen e tij, marrëzi, merret vesh, por vendimi qe marrë! Priste me ankth trenat e linjës së Vlorës dhe, kur peroni boshatisej e ajo nuk dukej kund, ulej i raskapitur në karrigen e tij të vjetër...Kur ai dalloj më në fund Irisin të vinte drejt zyrës së tij, e ndjeu që po i merrej fryma. E bukur, e përskuqur nga i ftohti, Irisi e përqafoi. Dhe Ferdit ia tha menjëherë gjithë ç'pati menduar. Ajo nuk duhet ta braktiste shkollën! Ky veprim do të përbënte një vetëvrasje...Po të dëshironte, mund të vinte të banonte në vilën e tij dhe atje do gjente punë, me gjithë ata të huaj nëpër këmbë, që kishin nevojë për përkthyes, konsulentë e sekretarë. Ajo vetëm do kujdesej për Ferdin, të gatuar dhe t'ia lante teshat... Kaq!...Hëë?- e pyeti gjithë ankth ai...Irisi iu përgjigj se do të mendohej...Të shtunën Irisi erdhi në

stacion. I tha Ferdit se e pranonte ftesën e tij, e pritë tjetrin pa u mërziur, derisa të përfundonte turnin dhe shkuan të dy në shtëpi. Nga ajo ditë, në vilën e bukur rihyri jeta. Ferdi doli në pension para kohe. Tani kopshti të merrte sytë me gjithë ato lule e hapësira bari, gjellët mbushnin me aroma oreksndjellëse ajrin dhe Irisi merrej vesh mrekullisht me të gjithë. Ferdi iu lut që ajo të bënte jetën e saj, pa asnjë detyrim e turp, por Irisi, e terrorizuar nga nofka kobndjellëse, që, merret vesh, duhet ta dëgjonte rregullisht, dilte shumë rrallë mbasditeve e mbrëmjeve nga shtëpia. Tani për të gjendej boll punë, diçka fitonte e ca leksione private pa pagesë i merrte nga amerikanët. Edhe në anglisht po perfeksionohej. Pse duhej të dilte kot? Libra për të lexuar kishte sa të duash nëpër shtëpi...Ferd i ndihej i lumtur. Më në fund, kishte zbritur pak paqe në jetën e atij njeriu pa fat dhe kështu e gjeti vajza e tij në vjeshtë, kur erdhi për pushime bashkë me francezin e saj dhe Ferdinandon e vogël. Monikës i bëri përshtypje ndryshimi i të atit. Tani ai ishte i veshur bukur, me rroba të shtrenjta, mbahej pastër dhe kishte filluar të qeshte, me atë të qeshurën e harruar prej vitesh...Vajza u armiqësua menjëherë me Irisin, paçka se nuk hapi gojë. Ajo e kuptoi se babai i saj qe marrosur e kishte rrjedhur mbas kësaj bukurosheje pa vlerë, mbas kësaj bukurosheje të palarë shqiptare, që kush e di ç'era përç vinte në krevat, por, ngeli e shtangur, kur Ferdi iu lut t'i gjenin një bursë Irisit e ta merrnin me vete. Në këtë vend ajo nuk do të bënte hajër kurrë...

Monika ndjeu një lehtësim të madh. E përqafoi vrulltas të atin dhe i kërkoi falje për budallallëqet që pati menduar...Të ishte e vërtetë, të paktën gjysma, i shpëtojnë nga shpirti këto fjalë Ferdit... Pastaj qau, kur Ferdi i tregoi se si e kishte njohur Irisin, duke psherëtirë: "Kujtova se këtu ka lëvizur diçka! Po plehra paskemi mbetur!..." Ata ndenjën deri vonë në kopsht dhe, kur i thanë Irisit për planin e tyre, shtangën me përgjigjen e tjetrës:

- Unë nuk kam qejf të studioj jashtë!

Frynte një erë e ngrohtë, shatërvani vetëtinte nën hënë dhe hurmat kuqëlonin mbi kokat e tyre.

- Mos u bëj idiote!- tha Monika.

Irisi tundi kokën.

- Mua nuk më do njeri, veç babait tënd,- tha pastaj,- dhe unë veç për mirësi e dashuri kam nevojë...Kur unë vendosa ta braktis shkollën e të marr arratinë, ai m'u bë prind pa asnjë interes...Nuk iki, natyrisht, po nuk më përzuri Ferdi!...Sa për lek, tani nuk kam nevojë. Kur ta ndaj mendjen të bëhem e pasur, do kem, sepse kam ca njohuri si bëhet e pasur një vajzë sot...

Ishte e kotë të merreshe me të. Tek e fundit, ajo do t'i mbaronte studimet këtë vit shkollor, notat i kishte të mira, më shumë se të tjerët dinte, një punë do gjendej për të...

- Bëj si të duash!- tha Ferdi.- Një propozim të bëmë!

Monika iku, në kopsht filloi përsëri era, drurët u zhveshën dhe, tani, trishtimi e vetmija vërtiteshin si hije në atë shtëpi plot kujtime të pakujtueshme, që nuk i largonin as darkat plot muzikë të amerikanëve e as ngritja e shpejtë e mirëqënies së popullit. Ferdi pinte ndonjë kafe me shokët e tij të hershëm mbrëmjeve, pastaj kthehej ngadalë në shtëpi, me atë trupin elegant prej sportisti dhe Irisi gjithmonë do të vraponte për t'ia hapur derën. Pastaj ata bisedonin pranë oxhakut bubullues deri vonë, kujtonin njerëz e historira nga më të çuditshmet, që sikur mbusheshin me xixëllimat e herë pas hershme të drunjëve të zjarrit. Tani atij i shfaqej në ëndërr gjithmonë e më shpesh gruaja. Ai zgjohej i trishtuar dhe priste mëngjesin, duke kujtuar vuajtjet e pafundme të saj. I vinte keq që ajo nuk jetoi edhe pak, sa të gëzonte një ditë pa ankthin e borxheve, të vdekjeve e të internimeve. Dhe, sa herë që ajo do t'i dilte në ëndërr, Ferdi do ta mbante vrapin në mëngjes në varreza...Kështu, në jetën e tij u bë ritual edhe ajo rrugë plot gropa e pikëllim, që ishte një mister fatesh, fatkeqësish, lumturish e historish. Pa u këshilluar me kërkënd, Ferdi i ngriti një varr të madh gruas, ku gjysmën ia dhuroi vetes së tij, që ta fusnin pas vdekjes, dhe, nga dita kur varri përfundoi, edhe gruaja i rralloi vizitat, megjithëse ai ndjente mall dhe mezi priste ta takonte në gjumë.

Në fund të dhjetorit, ai vendosi më në fund të shkojë me Irisin në një koncert të madh bamirësije. Dhuroi diçka atje, duroi me heroizëm ato mesazhe që nga skena derdheshin në sallë për këdo, përjashto atë vetë, u kënaq që Irisi ndodhej në qendër të vëmendjes me pamjen magjepëse dhe, kur dolën, e ftoi tjetrën për darkë. U ulën në një restourant luksoz. Ferdi i tregoi Irisit të vërtetën, atë që tashmë nuk i shijonte më asgjë dhe se jetonte kot fare, vetëm se në këtë natë e pati kënaqur hiri i saj prej mbretëreshe. Irisi u prek.

- Unë pres kurajo nga ty, - i tha Ferdit,- ç'kuptim ka, nëse, ti, je pesimist? Atëherë, unë, pa lek, pa punë, pa shtëpi, me biografi të keqe, pa njeri, ku të mbytem?...

Kishte të drejtë, po Ferdi nuk ia jepte dot.

- Unë jam aq i lodhur tani, sa nuk mund të gënjej dot më!- tha ai.

U ngritën aty nga mesnata, po gjumi iu kishte kapërcyer të dyve nga mendimet ogurzeza për atë që quhet rëndom "e ardhme". Vonë, në orën dy mbasmesnate, teksa po përpëlitej në shtrat, Ferdi ndjeu si u hap dera dhe pa figurën e Irisit në prag. Ai u tremb nga ajo figurë e magjishme, e veshur me një këmishë të hollë nate, me kofshët dhe gjirin e bukur që vetëtinin edhe nëpër atë terr.

Nuk kishte ndodhur asgjë, vetëm se ajo nuk flinte dot vetëm. Ai nuk arriti të ngrihej, kur ajo i kishte hyrë në shtrat. Me duart rreth qafës së tij, me lotët që i rridhnin pa zhurmë faqeve, Iirisin iu lut me përgjërim mos ta përzinte.

- Nuk ka kuptim,- dënosi ajo,- përderisa vetëm, ti, më do pa hile!...Unë nuk besoj më te njeri tjetër e nuk dua t'i përkas dikujt tjetër!...

Ferdi ndjeu atë aromë dehëse vajzërije, të harruar tashmë nga shqisat e tij, ndjeu gjithë atë bukuri t'i përpëlitej në krahë dhe mbylli sytë.

- Të lutem, më mëso!- belbëzoi Irisi...

Dhe nuk nxori më nga goja as fjalë e as pasthirrma.

Nga ajo natë e çuditshme, me një hënë të plotë që e nguli hundën në dritare e nuk u largua deri në mëngjes, Irisi bashkoi shtratin me Ferdin. Ajo i shkruajti një letër të gjatë Monikës, ku i shpjegonte gjithçka. I tregonte se si kishte këmbëngulur që shtëpia të kalonte me prokurë në emër të Monikës, pas vdekjes së Ferdit, i shkruante se nuk donte asgjë nga pasuria e Ferdit dhe i lutej që të mos e keqkuptonte. I betohej se Ferdi nuk e kishte ngacmuar e se gjithçka, e mirë apo e keqe, erdhi prej saj.

...Unë nuk kam njeri tjetër në këtë botë pisanjose dhe as dua të kem më, përfundonte ajo letër.

Monika u përgjigj shkurt:

...Të lutem, kujdesu për babain! Tani unë jam e qetë. Po iu duk një lloj zgjidhje e arsyeshme, shiteni shtëpinë dhe hajdeni të jetoni në Londër...

Irisi e harroi në çast propozimin e tjetrës. Ajo ishte e lumtur që tani askush nuk guxonte më ta quante në sy "vajza e kurvës" dhe që po e bënte atë burrë të mrekullueshëm t'i harronte gjithë ato varre e vuajtje të pafundme, në atë lulëzim të vonë. Vërtet kurvë ishte nëna e saj e ajo e urrente kurvërinë bashkë me nënën, vërtet që ajo pati qenë fëmijë i pafajshëm e veç dru hëngrri, sa herë protestoi, megjithatë, Irisi ndihej borxhlije e duhej të lante një borxh. Le ta lante me Ferdin! Ky ishte më nevojtarë e bota le ta gjykonte veprimin e saj!

Atë e bëri të lumtur rinia e Ferdit, pamja e tij dhjetë vjet më e re dhe nuk vuante më nga asnjë lloj pendese.

Tani që ka hyrë plotësisht pranvera, Irisi pret e ulur në shkallët e oborrit me një libër në dorë Ferdin, të kthehet nga ajo kafja e tij rutinore dhe ajo t'i tregojë pastaj të rehat më të fundit, që janë gjithmonë histori të vjetra. Kurse ai mendon të gjejë një skulptor të mirë dhe ta paguajë, që t'i bëjë dy statujëza të bukura të Irisit, për t'i vendosur në të dy anët e shkallëve të mermerta të shtëpisë, ku ajo e pret me durim e pamje ëngjëlli.

PRILL, 1996

VEJUSHA

Ata hynë pas nesh në hollin e hotelit, kur ne qemë rehatuar në kolltukët e thellë e i kishim ngjitur me kohë plaçkat nëpër dhomat tona. I pamë me kuriozitet, siç vëzhgohen të huajt nëpër qytetet tona ta periferisë, tek paraqitën dokumentet. Ishte një çift zvicerianësh, që më pas dolën se qenë investitorë, dhe një shoqëruese shqiptare, një kaçurrelse aty te të tridhjetat, e veshur me një teeshirt të zi e me një palë xhinse të shtrenjta, po mos ta kishin fallco atë etiketën sipër xhepit të mbrapëm, nga e djathta e saj, ose e hemisferave të saj, që nuk dukeshin aspak keq.

Ne kishim ardhur në Sarandë për të kryer praktikën mësimore. Pjesa tjetër e kursit ishte ndarë ca në Durrës e ca në Lezhë, të gjithë nëpër ndërmarrje peshkimi, dhe do të na duhej të qëndronim një muaj të mirë mbi det, që dukej mikpritës me qetësinë e tij madhështore këtë prag qershori.

- Nuk jemi fare pa fat,- tha Mondit, gjithë duke kullotur sytë nga deti.

Tani po pinim nga një birrë në verandën e hotelit, që binte bash mbi det, dhe po na pëlqente muzgu manushaqe i varur mbi det e jargavanë. Atëherë ia mbërritën në verandë edhe çifti zvicerian me kaçurrelsen dhe Goni, më i pashmi ndër ne, tha se nuk po i dukej fort e keqe kjo çupa, megjithëse ajo i binte të ishte nja gjashtë- shtatë vjet më e madhe nga ai. Ai shtoi edhe se vdiste për moshat e pjekura, që nuk kanë nevojë për leksione gjuhënxjerrjeje e këmbëngritjeje, dhe duket ajo e dëgjoi, sepse unë e pashë mirë që në fytyrë iu përhap një nënqeshje tallëse. Kishte një portret interesant, nga ato që rëndom quhej "e gjitha sy", dy buzë mishtore e mollëza të kërcyera, flokë vërtet të çuditshëm për nga denduria dhe ç'rregullsia e krehjes dhe një bust të bukur, që i dilte më mirë në pah, kur ajo qëndronte këmbë mbi këmbë, me duart të lidhura mbas qafës e me vështrim të përhumur nga deti.

Unë i thashë Gonit se ai nuk ishte një peshkatar i rëndomtë pa shije dhe ai më ktheu një përgjigje kuptimplotë me kokë. Tani kishte rënë nata dhe ne të tre u ngritëm. Do hanim bukë në ndonjë nga ato tavernat e vogla, ku gatuanin mrekullisht amvisat e shtëpive. Mondit i pëlqente një lokal mbi rrugë, ku gatuhej shkëlqyeshëm tava e peshkut dhe ne nuk ia prishëm. Goni bëri sikur harroi cigaret me gjithë çakmak në tavolinë, priti që kaçurrelsja ta thërriste nga pas dhe, si e hëngri grepin tjetra, ai u kthye gjithë edukatë e tha "faleminderit", ljalën që përgjithësisht e përdorte më rrallë në zhargonin e tij.

Ndihej i lumtur dhe në tavernën e vogël u dend me verë shtëpije. I pat hyrë menjëherë në zemër kaçurrelsja dhe Mondit ia nisi me kunjat e tij e u tall me Gonin, sa i deshi kokrra e qejfit, po unë nuk e lashë ta bënte baltë, kur u hodha e thashë gjithë edukatë, se ishte i mjerë ai njeri që nuk shikonte ëndrra në këtë vend, qoftë edhe me sy hapur, si puna e Gonit...Po Goni nuk prishi rehatin. Tha vetëm frazën që unë prisja ta shqiptonte: Kot e kishte marrë me pishman Sarandën, bëhej praktika edhe këtu, bile, mirë fare, të merrije përvojë sa të hanin qentë!...

- Ky shkoj në fakultet për peshkatar dhe doli që andej gjahtar,- vërejtj Modi, duke mbytur të qeshurën me verë.

Mesnata ne na gjeti në tavernën e hotelit dhe, kur u ngritëm në orën dy të natës, të tre po mendonim të njëjtën gjë: duhej marrë në telefon shtëpija që të dërgonte ndonjë lek, se kishte rrezik të përfundonim te buka me arra!

1.

Në mëngjes ne u paraqitëm te zyrat e peshkimit. Na dhimbte koka të treve e sikur na përzihej pak, por përpara drejtorit të ndërrmarrjes, një 30- vjeçari vigan, u mbajtëm si burra në këmbë. Ai nuk na e zgjati shumë, na çoi për të marrë në magazinë rrobat e peshkimit dhe na hypi në peshkarexhën që po bëhej gati të dilte në det. I tha kapitenit të kujdesej për ne, pastaj ia mbathi. Tani në anije bëheshin tetë peshkatarë bashkë me ne dhe kapiteni na zbriti në dhomë të ndërroheshim...

- E mirë, ajo kaçurrelsja,- u tall Mondit.

Atij po i përzihej pa dalë mirë në det.

- Kush e di ku po shullehet tani!- thashë unë.- Kishte alamet gjoksi...

- Pse, kishe ndonjë të sharë për trupin e saj?- vazhdonte Mondit...

Dhe kështu, tallu e qesh, ne filluam udhëtimin e parë në det. Vetëm Goni s'po fliste e ai iu qep një peshkatari të vjetër. Qërronte peshkun me të, e gatuanin bashkë, hynte në malin e peshkut që kërcente në kuvertë, zgjidhte ato lloje që e urdhëronte tjetri dhe, mbas dy ditësh udhëtim, kishte mësuar sa katër vitet e fakultetit për defin, peshkun e zonat e gjuetisë.

Ne punuam derrçe ato dy ditë të lodhshme dhe kapitëni na tha që të mos ndërrojmë anije deri në fund të praktikës. Ai do nisej pas dy ditësh përsëri dhe ne e lamë të takoheshin në molo. Do jemi anës bregut këtë herë, tha ai, dhe do kenë boll gjëra të bukura për të parë...Ne morëm nja dy trasta me lloje të ndryshme peshku, ua bëmë me dorë peshkatarëve dhe ia mbathëm në hotel. Ishim zhul i gjallë dhe, kur na doli kaçurrelsja përpara në shkallë, Goni nuk e deshte veten. Ajo nënqeshi prapë lehtë e me një ironi të përmbajtur, kur Mondit tha se nuk do të ishte çudi sikur të ndodhte ndonjë sulm i maceve në hotel dhe u shkri fare kur unë u luta mos qenë maçokë, të paktën...Të mbeteshim të virgjër, po kush po pyeste për hallin tjetër...Po merrej vesh që ne i dukeshin kalamaj, nga mënyra se si e tundi kokën në atë ikje nëpër shkallë.

- Tani t'ia kërkoje!- i tha Mondit Goni.- Dukeshin tamam kllasë punëtore dhe shumë shqiptarë janë ende nostalgjikë për komunizmin...

- Po të jetë e persekutuar?- pyeta unë, duke hapur derën e dhomës sime.

- Aq më mirë,- ma ktheu Mondit,- ato janë mësuar të kenë respekt për djersën e ndershme të ballit...

Në fakt, ballet tona ishin blözë, por, nëpër dushet gurgullues, ne u bëmë sërisht si pëllumba dhe, kur u takuam në holl, Goni kishte avancuar më tej nga ne. Atij i kishte hyrë vërtet puna në gjak dhe pati pastruar nja tre kile peshk të mrekullueshëm. I pëlqente ideja se mund të hanim në breg të detit. Mua më urdhëroi të shkoja dhe të blija nja tre litra verë te taverna lart, kurse Mondin e nisi për dru, për gota e pjata dhe, kur u ktheva, e gjeta që po gatuante sipas mësimëve të peshkatarit plak me Mondin mbi kokë, që kishte shtruar një batanije mbi zallin e ngrohtë, ku degustonte herë pas here gatimet e Goni. Piq peshk, haje të ngrohtë e pi verë, ne po kënaqeshim vërtet. Atëherë pamë kaçurrelsën që po na kundronte nga rruga, tre metra sipër nesh dhe Goni e ftoi qetësisht. Ajo dymoi një çast, pastaj zbriti ngadalë, nëpër atë mërmërimën e Mondit "kjo qenka më trokë se ne!", dhe erdhi e ul mes meje e Goni. Fliste pak si thuthuqe, kur na pyeti se ç'përfaqësonim, dhe, kur i treguam se qemë inxhinierë peshkimi në prag të daljes në jetë, ajo tha se na kishte zili. I dukej privilegj i madh të punuarit në natyrën e virgjër. E veshur me të zeza e me ato flokë të shprishura, ajo dukej si një shkurre nëpër natën e errët, po mua më pëlqeu thjeshtësia me të cilën pranoi ftesën tonë dhe ajo e pirë e verës pa drojtje. Edhe ne e pyetëm atë dhe ajo na tha se quhej Miranda, se punonte në një agjenci turistike si shoqëuese e anglisht apo frengjisht folësve dhe, kur Goni e pyeti për familjen, ajo ia ktheu thjesht se ishte vejushë, me një vajzë tre vjeçe dhe se i shoqi e pati humbur jetën dy vjet më parë në një aksident automobilistik në Greqi, ku kishte shkuar të punonte...

- Halle-halle kjo hale dynja!- thashë unë një si biçim ngushëllimi, po ajo bëri një lëvizje me dorë e tha pastaj "e kalova tani" dhe vazhdoi të hante e të pinte

po aq qetësisht, duke lavdëruar gatimet e Goni e duke ngritur në qiell verën. Pak euforik Goni e ftoi të nesërmen të vinte me ne në Ksamil, ku do të bënim plazhin e do të gatuanim vetë dhe ajo e pranoi me kënaqësi ftesën. Do të vinte, nëqoftëse zvicerianët do ta kalonin ditën në plazhin para hotelit...

Kështu kaloi edhe ajo natë dhe, kur ne u ndamë me Mirandën, Goni tha se vejushat i kishin pëlqyer gjithmonë...Mondi u nxeh:

- Si flet? Sikur Shqipëria është e mbushur tumillas me vejusha!...A thua u vranë gjithë meshkujt e rinj në luftë!...

- Mos ia prish!- e këshillova unë.- Tani ai ngatërron aragostën me sardelen...E ka verbuar dashuria dhe po i bën vetes autosugjestion...

- Po edhe ajo, e fortë!- tha Mondit.- Top e kishte mendjen që mos vinte nesër dhe ia ngrefi këtij të shkretit mendjen kot! Pak budalla është ky!...Hajde, ç'gjumë do bëjë sonte vëllai! Poç do ta ketë syrin nesër, me bebzën e bukur të zbardhur paksa, ngaqë nuk do t'ia ndajë sytë tavanit!...

- Hani, mut, ju!- na tha Goni dhe ia mbathi në dhomën e tij.

Por të nesërmen, kur ne zbritëm aty nga ora nëntë e gjysmë për të ngrënë mëngjesin, e gjetëm vejushën tek priste në holl. Zvicerianët do të bënin plazh sot dhe ajo mund të vinte me ne, bile kishte edhe makinë në dispozicion për të na çuar e për të na kthyer nga Ksamili. Ne e lamë të niseshim në orën dhjetë dhe Goni na hodhi një nga ato vështrimet krenare, tipike për gjeneralët e perandorët.

- Mos u mërzisni, djema!- tha pastaj, duke iu futur me një barrë qejf paçes. Dhe as unë, as Mondit nuk gjetëm fjalë për t'ia kthyer. Ne hëngrëm me ngut, u ngjitëm në dhoma për t'u bërë gati dhe në orën dhjetë hypëm në xhipin e Mirandës. Pastaj në Ksamil vendosëm ta bënim plazhin në ishullin e vogël e të pabanuar përballë bregut dhe, si i futëm plaçkat në një qese plastike, i ramë me not asaj hapësire të vogël e dolëm në bregun e virgjër. Goni u kthye përsëri të merrte damixhanin e verës. E mbajti në gjoks in e gjerë atë peshë prej gati dhjetë kilesh, u kthye në shpinë dhe e riçau lehtësisht atë hapësirë ujërash me ca lëvizje të rregullta të këmbëve. Ishte vërtet një vend i magjishëm, i mbushur me pëllumba të egër e me ca guva, ku, mesiguri, qenë strehuar më parë heremitët. Uji kishte një pastërti marramendëse dhe unë pashë me trishtim trupin e bukur të vejushës, kur u hodh si peshk e u zhyt deri në fundin e detit, a thua po kërkonte ndonjë send të çmuar.

- E mirë!- tha Mondit.

- Po!- ia ktheva.

Mua më vinte keq që asaj i qëlloi një fat aq pa kuptim, në këtë kohë që njerëzit po fillonin të jetonin. Mondit ma ktheu se historikisht ne nuk kishim patur fat tjetër, përveçse që kishim lindur, natyrisht, nëse binim në konsensus që lindja ka më shumë vlera se hiçi. Përgjithësisht, ai ruante neverinë më klasike për botën

tonë, të cilën e quante “botë pa evolucion” dhe që çdo studim serioz e të dobishëm e vidhte nga filmat vizatimorë të Tomit me Xherrin...Por i lamë filozofitë tona. Goni na ftoi të bënim një dorë brixh dhe ne u mblodhëm nën diellmbajtësin e improvizuar me degë fieri. Goni zgjodhi për partnere vejushën dhe, kur ajo ia nisi ca deklaratave lojëprishëse, ne shqyem sytë. E luante mirë lojën dhe Goni deklaroi me ato fjalët e veta që nuk kishin kurrë një kuptim të vetëm, se ata merreshin vesh për bukuri me njëri-tjetrin, kishin lindur për njëri-tjetrin dhe se nuk do të ndaheshin më kurrë!...Mondi u përmbys me gjithë letra nga e qeshura mbi batanije...

- Ti je idiot, o i shkretë!- i tha Gonit pastaj, por mori një përgjigje edhe më pikante:

- Unë di t'i vlerësoj gjërat, nuk jam miop si puna jote, që e shkel me këmbë floririn dhe, nga ana tjetër, ankoresh se nuk ke lek të blesh një palo unazë...

- Më duket se po flet për mua?- pyeti gjithë edukata vejusha.

- Edhe për ty po flas,- ia ktheu Goni me një ton të akullt.- Më nervozojnë njerëzit pa shije! Njerëz koti!...

Atëherë i erdhi rradha vejushës të qeshte me lot dhe ashtu përfundoi ajo punë, derisa u kthyem mbasdite në hotel, duke qeshur si idiotër zëlëshuar. Mondi i qëndronte mendimit se gjithë kjo e qeshur nuk do të dilte për mirë. Ishalla nuk vdes njeri andej nga Tirana, përfundoi ai, se ndonjë kolerë e vockël do kishte rënë, por ajo është gjysma e të keqes... Ne e lamë të pinim ndonjë gjë mbas darke në tavernën e hotelit dhe u ndamë nëpër dhoma gjithë duke u zgërdhirë.

2.

Mondi nuk zbriti në tavernë. Atij i flihej. Me Gonin, unë hyra në sallën gjysmë të errët, me ca drita të fshehura nëpër qoshet e mureve dhe me një pistë të vogël në mes, gjithashtu të errët, ku çiftet ktheheshin në silueta. Ne pamë një dorë që u ngrit lart. Ishte vejusha me zvicerianët dhe u drejtua për nga tavolina e gjerë në cepin e sallës pranë tualetit. Nuk bëheshin më shumë se tre tavolina me klientë në sallë dhe, duket, kamarierit nuk i pëlqeu ardhja jonë, po Gonit aq i bëri që tjetri i ndejti gjithë turinj. Ne porositëm votka dhe unë fillova të bisedoj me zvicerianët. Mirandës i pëlqeu frengjishtja ime dhe ajo u lumturua që nuk do t'i ngelej asaj e gjithë barra e përkthimit. Goni e ftoi tjetrën të vallëzonin. Ata dolën në pistë dhe filluan të kërcëjnë nën ritmet e një kënge të njohur të Sinatrës. Unë i pashë ata, gjithë duke iu folur zvicerianëve për vendin tim, se si u afruan më shumë nga ç'lejohej zakonisht nën efektin e muzikës magjike, por pashë gjithashtu se pëllëmba e madhe e Gonit nuk po i linte shteg tjetrës të rikapte distancën serioze. Ata kërcëyen ashtu, të puqur, me kofshët që iu ngatërroheshin keq, edhe dy melodi të tjera, po aq intime e gjithë seks, për ters, dhe, kur u kthyen në tavolinë, ajo ishte

e përskuqur, ose, më saktë, i ndjehej përskuqja, se gjë formalisht nuk dukej. Rrinte si mbi gjemba pranë Gonit, pastaj, kur filloi vallëzimi i ri, nxitoi të më ftonte mua. Duket i trembej Gonit, një vallëzimi tjetër me të dhe, si e peshoi mirë e mirë, më tha se shoku im ishte pak më i hedhur nga ç'duhej.

- Nuk e di!- i thashë.

Dhe as që më interesonte ai muhabet.

- Ai duhet të më kuptojë mua,- tha ajo,- nuk duhet ta keqkuptojë mirësjelljen time...

Edhe unë ia ktheva gjithë mirësjellje se ajo i kishte pëlqyer që në fillim Gonit, se ai ishte një djalë i mrekullueshëm dhe se unë nuk përzihesha në shijet e të tjerëve...Sa për ekuilibrin e Gonit, ekuilibrin mund ta humbte edhe vetë Jezu Krishti dhe, tek e fundit, jeta jonë ishte krijuar nga një mungesë ekuilibri mes Evës dhe Adamit...

Ajo qeshi.

- Qartë,- tha,- po unë nuk jam ashtu dhe ai është shumë i vogël për mua...

Unë ia ktheva se kjo ishte puna e saj, varej nga etalonet që ajo kishte për të matur dimensionet e gjërave dhe se, për mua, Goni hynte në speciet me dimensione të pranueshme...I tregova, duke u përzierë nëpër terma latinë, se, pavarësisht nga dimensionet, ajo parapëlqente peshqit e vegjël në të ngrënë, gjë që e kisha parë me sytë e mi në drekë, dhe ajo u shkri fare, kur unë i fola për rolin e madh racëpërmirësues të rinisë në ndërzim...

- Atë kapitull e kam mbyllur,- qeshi ajo,- kështu që ti nuk ke më asnjë argument!

Mua po më vinte keq për Gonin, që po lodhej kot mbas vejushës, duke shpikur lloj-lloj majmunllëqesh në tavolinë, për t'ia tërhequr vëmendjen, por ai nuk bënte pjesë në racën e njerëzve të turpshëm. Me cipën, që kush e di se ku e kishte flakërirë, ai arriti ta bindë edhe një herë Mirandën për të vallzuar dhe, ja, tek ia nisi prapë nga e para palaçollëqeve të tij dhe kush e di ç'prekje e broçkulla provokuese i bëri, që e detyroi tjetrën t'ia mbathte në banjë. Kulmin e arriti kur u ndamë e kur e ftoi pas dy ditëve, si të ktheheshim nga peshkimi, për darkë! I këputi edhe një alamet të puthure, m'u pranë buzëve tjetrës në ndarje, që sa nuk la shenjë, dhe ia mbathi gjithë qejf në dhomë. Nuk e hapi më muhabetin e vejushës me ne, megjithëse na u mbaruan të gjitha muhabetet në anije, po unë e pashë si zhytej shpellave të magjishme për të gjetur ndonjë relik-dhuratë për vejushën e se si e zgjodhi peshkun copë për copë, para se të zbrisnim nga anija. Ai e pastroi peshkun me ujë deti në kuvertë, gjithë dukë fishkëllyer në hesap të vet dhe, kur ne zbritëm, çuditërisht atij i mbante erë sapun surrati i nxirrë.

- I është ngritur mendja keq, idiotit,- tha Mondì,- mos na bën ndonjë proçkë dhe hajde e merru me Katerinën e vet tani, apo nuk është një grifshë e

poshtër ajo!

Unë e sigurova të ruante qetësinë. Mbas dy ditësh ne do të peshkonim prapë dhe vejusha, ndërkohë, do t'ia mbathte...

- Ashtu qoftë!- uroi ai. Në darkë nuk denjoi të zbresë nga dhoma. Tha se do të gatuate vetë e se do të flinte, po unë e kuptova që ai nuk e shikonte dot Gonin me vejushën.

3.

Vejusha duket e mendoi gjatë punën e darkës, sepse u vonua aq shumë, sa ne vendosëm mos ta prisnim më. Kur po ia mbushja gotën Gonit të mërzhitur për vdekje, ajo po vrojtonte xixëllimet e cigareve tona dhe përshkënditjen e herë pas hershme të prushit. Na shihte nga ballkoni i dhomës së saj dhe ishte në mëdyshje, të zbriste apo jo. I pëlqente vëmendja e Gonit e ai guxim prej të marri i tij, por as që mendonte se ky djalë mund të hynte qoftë edhe një orë të vetme në jetën e saj. Nuk ishte problemi i moshës. Mirandës i dukej çudi të përfundonte në krahët e një mashkulli tjetër, që do të dihaste si derr sipër saj e që do të arrinte menjëherë në përfundimin idiot se me vejushat bëhet qejfi tamam! Kurse ajo vuante pikërisht këtë gjë: Ishte vejushë dhe nuk ndihej vejushë! Kurse Goni...Ehu, ishte ngopur ajo me këto ftesa! Megjithatë, gjatë dy ditëve të mungesës së Gonit, ajo e ndjeu një lloj vetmije e boshllëku. Llomotiste kot më kot me zvicerianët dhe sytë po nga deti i mbante. Kur rojet bregdetare nxorën një ditë më parë trupin e pa jetë të ndonjë refugjati klandesin, ajo vrapoi në breg zemërngirë dhe e shau veten "idiote", që ishte sjellë si kalama...Po më në fund ajo vendosi të zbriste. Tek e fundit, edhe i pihej një gotë verë me peshk të freskët e të ngrohtë, vetëm kaq, por as vetë nuk e kuptoi pse veshi një bluzë goxha dekolte, që ia nxirrte mirë në pah gjoksin e bukur e të detyronte ta mbaje vështrimin te ai shteg aq provokues. Ndoshta nuk e kuptoi çfarë zgjodhi për të veshur. Unë u habita kur e pashë figurën e saj gazmore, me bluzën e bardhë, të ngushtë në trup e që i jepte një formë të përsosur atij gjoksi pa reçipeta dhe me pantallonat e shkurtra, por më shumë do të më habiste Goni, me ngritje të vrullshme drejt tjetrës, që nuk fshinte asnjë lloj ndjenje e me atë puthje të përmallshme që shkëmbeu me vejushën, a thua ishin mish e thua e qenë bërë kaq kohë pa u parë.

Ajo kërkoi ndjesë për vonesën dhe u ul mes nesh, duke na pyetur si e kishim kaluar peshkimin. Pastaj filloi të hante ngadalë, gjithë duke dëgjuar shpjegimet e Gonit për aventurën e detit dhe, kur po afronte mesnata e Goni po lëshonte ato xhevahiret e tij me nga shtatëqind kuptime, unë u ngrita e ika. Nuk më flihej dhe ia mbatha një herë andej nga kampi, ku bëheshin ca mbrëmje të mira vallëzimi e ku mund të gjeje ndonjë studente romantike, po as andej nuk gjeta

prehje. Ishte një e natës kur mora rrugën e kthimit, që tani po më dukej e gjatë nëpër ato shkurret si lugetër e me nëpërka nëpër këmbë, dhe, me t'iu afruar hotelit, hodha një sy andej nga isha ulur një orë më parë. U habita kur dallova siluetat e tyre pranë e pranë dhe thashë t'i dëgjoj një herë. Atë çast ajo po i lutej Gonit ta linte të qetë. Zëri i saj ishte i lagur nga ndonjë vërshim ngashërimi, dhe mua më erdhi keq.

- Ti ke frikë,- i tha Goni,- ti kujton se të gjithë të shohin ty dhe harron se njeriun është më mirë ta ndjekin, se sa të ndjekë ai të tjerët...

I kishte hyrë filozofive, hajvani!

- Të lutem,- iu përgjërua ajo,- ti duhet ta kuptosh se ne nuk jemi për njëri-tjetrin...

Ajo bëri të ngrihej, por ai nuk ia lëshoi dorën. Tani vejusha ndodhej në prehërin e tij, përpëlitej t'i shpëtonte, por po përpiquej kot. Puthjet e Gonit kërcisnin si llamarina e vinin deri te veshët e mi dhe unë e ndjeva se rezistenca e vejushës po dobësohej gjithmonë e më shumë, derisa para syve të mi u shfaq një trup i bukur femre, i zhveshur nga mesi e lart, me ato kupa gjinjsh, që zbardhnin si dhëmbë zezaku në terr. Ajo u lut edhe nja dy herë gjithmonë e më dobët "mos, të lutem...Mos, jo këtu!...Do na shohin", por unë e dija se ai nuk do ta lëshonte. Ngaqë ua kishte me hile të gjithëve, mendonte se edhe të tjerët donin t'ia hidhnin. I ruhej ndonjë rrengu të vejushës dhe e mbante të shtrënguar në gjoks tjetrën, a thua kishte gjithë pasurinë e plakut atje. Unë e ndjeva nga përpëlitjet e tjetrës se ai po punonte poshtë tani, pastaj gjithçka u bë e qartë kur ai ia hapi këmbët rreth belit të tij, gjithë duke e mbajtur në prehër, dhe kur u dëgjua klithma e vejushës. Dy çaste më pas ishin bërë njësh të dy dhe ai, duket, nuk u ruajt gjatë aktit, derisa ajo shau "kafshë", kur mbaruan kush e di për të satën herë atë punë. Po Goni nuk e prishi qetësinë. Vetëm se i tha tjetrës "të dua", me një zë që po më dukej se ia dëgjoja për herë të parë, mbase ngaqë vinte era sinqeritet tragjik...Ajo u pastrua pas një shkurreje, pastaj u nis e para drejt hotelit. Po Goni nuk iu nda. Dëgjoja zërin e tij të ulët që i lutej tjetrës t'ia hapte derën, dëgjoja pastaj si u hap dera e vejushës, zërin e saj "Ti paske luajtur mendsh!" dhe e kuptova nga qetësia mortore që ai tani ndodhej në dhomën e saj...

Unë ia tregova gjithçka Mondit në mëngjes dhe ne pritëm të dy që Goni të fliste, duke u mburrur e tallur me ne, siç e kishte zakon në të tilla raste. Por ai që tjetërsuar menjëherë dhe nuk e zuri në gojë vejushën. Ne i pamë ata kur pinë kafë bashkë, e morëm vesh se ata e hëngrën edhe drekën bashkë në dhomën e saj, Mondit psherëtiu "Tani na la qeni edhe pa bukë!" dhe vendosëm mos ta ngacmojmë Gonin, pa folur ai i pari.

U ndamë me vejushën në darkën e fundit para nisjes me anije. Edhe Miranda do të largohej dhe ajo natë kaloi shkëlqyeshëm. Nuk i ramë në sy të

dyve, u treguam aq të kulturuar, sa prindërit tanë do të mahniteshin me transformimin radikal të fytyrave tona të dala boje, dhe e lamë të takoheshim për ndonjë kafe në Tiranë. Pastaj dolëm në det. Kur u kthyem, Goni i shpiku një gënjeshërë shpirtkëputëse drejtorit të peshkimit dhe ia mbathi në Tiranë. Nuk u kthye më. Tani kanë kaluar dy vjet dhe ai banon në shtëpinë e vejushës. Ne na bëri Katerina e tij për një lek e na i mori erzin m'u në mes të kafe "Evropës", që nuk e ndamë ëngjëllin e saj njomëzak nga ajo kurva plakë dhe na urdhëroi të çoheshin e të shkonim t'i merrnim gjallë-vdekur djalin e saj. Por kjo nuk ishte punë që bëhej. Ai nuk pranoi kurrë të fliste me ne për atë bukuri fatkeqe dhe vetëm Mondin ndoshta tha ndonjë të vërtetë, kur më shpjegoi mua se gjithmonë, kur bashkohej eksperiencia me axhamllëkun, ndodhnin katastrofa.

- Kush e di se si ia bën atë punë vejusha këtij buzëqumështit tonë pordhac,- përfundoi ai. Pastaj shtoi: Se mos e dimë ne, për veten tonë, se ç'fat do të kemi!...

PRILL, 1996

The bitch

bitch

PROSTITUTA

Në kafën e struktur mes shelgjeve, buzë atij uji të turbullt moçalor, vinte veç një zhurmërimë monotone ekspresi. Një fashë e bollshme drite vërshonte nga dritaret e mëdha, duke i rënë vajzës mbi shpinën e plotë e duke krijuar herë pas here ca figura të çuditshme. Merrej vesh që vajza ruante përbrenda ndonjë inat të madh. Veç vështirime egërsire hidhte përreth, bile edhe atë lëngun e portokallit e shihte me përçmim, a thua dikush i pat hedhur ndonjë helm aty brenda. As për të folur dukej që nuk ia kishte qejfi. Lëshonte herë pas here ndonjë hungërimë me prejardhje shtazore e pastaj po ajo kullotje sysh nga ujërat e pista përtej, pa një zog mbi vete e rrezik pa një peshk nën vete. Ia ruante inatin dhe ëngjëllit të ndershëm përballë, që pat zgjedhur këtë lokal në fund të botës, që mos ekspozohej, pra, para syve të botës me një femër si puna e saj. Dhe ç'lokal na kishte zgjedhur: bash atë të ndërtuar mbi " Gjirin e Kurvave " ! Asaj iu kujua edhe ajo bejtja që këndohej rëndom në shëtitoren e madhe " Në një botë mbushur me halle/ Kurva është shpikje e madhe...Ku do qemë pa kurvat ne?/ Pa flamur, fe e Atdhe..." dhe kaq duhej të shkalafitej përsëri. Ku e kishte hallin simboli i ndershmërisë, që e pat thirrur kaq papritur, si i ngritur nga ajo dynja?

- Si të shkojnë punët? - pyeti mashkullin përballë, po merrej vesh se nuk do ta priste barku edhe po mos merrte përgjigje. U tregua shpirtgjerë dhe formale, si në kurvëri, plotësoi me vete.

Tjetri rrotulloi në gisht unazën vetëtitëse të martesës, pastaj shkërmoqi në gojë një " Keq ".

- Domethënë, mut! - shtoi.

- Kush ta futi? - pyeti ajo.

Ishte po aq indiferente në dukje, ama, për brenda seç iu ndez me një

flakë të vrullshme dhe gati për zjarr qe.

- Goni, - tha ai.

Vajza u tendos në tryezë. Nuk pyeti fare për kamarierin që po afrohej dhe ja tek i uluriu tjetrit m'u në surrat:

- Po a nuk të pata paralajmëruar se ai është qelbanik? Po ku pret njeri mirë nga ai maskara, o i shkretë?...Ai ka shitur edhe gruan e vet në bixhoz, për dhjetë mijë lek!...Ai vazhdoi lojën në guzhinë, gruaja vet pallohej si lopë në dhomë!...Ah, ti je budalla, o i shkretë!...

Ajo nuk mund t'i tregonte, dhe as ia kishte qejfi, se në ç'rrethana të tjera e pat njohur nga afër Gonin, veçse, sa herë i kujtohej ky emër i urryer, në gjoks ndjente një përvëlím të llahtarshëm. Ia pati fikur dikur cigaren në gjoks Goni, andej nga mali i Dajtit, në pyllin e vogël poshtë kampit. Atëherë ishte mashtruar keq. Atë kohë i qe mbushur mendja top t'ia mbathte andej nga Zvicra e të shpëtonte nga jeta mizerje në këtë vend, ku solfezh ishte sherri e çelës sol pislleku, mirëpo s'i eci. Ai maskara ia premtoi vizën, ia bëri të mbaruar atë punë dhe e ndolli deri në Dajt. Atje vetëm u përcëllua, se as qejf nuk bëri e as vizë nuk mori. Ah, po! I qenë bërë edhe vithet copë, duke i marrë zvarrë ato lëndina të qelbura plot bajga e shkarpa, me ca kica e dhi vërdallë, që i shihnin duke bërë seks me ato sytë e tyre të kulluar dhe që nuk do të ishte çudi të vinin e t'i lëpinin, aq të kripur i kishin trupat nga pislleku tradicional. Dhe fill mbrapa kishte njohur Edin, këtë Ed që e pati patur klient në lokalín ku shërbente atëherë për një kothere bukë si kamariere dhe që ia lypi plaçkën vërtet bukur...Për sa lekë e ke ulur veten kaq keq, moj xhan?...Sa?...Mos u tall, zemra ime!...Hajde puno kamariere vetëm për mua dhe të paguan lali dhjetëfishin...Ky surrat, që tani i jargavitej përballë vërtet e pati mbajtur fjalën, por ia kishte futur më keq nga të gjithë. E mbajti tre vjet në pëllëmbë të dorës, e veshi dhe e bëri njeri, e ç'mësoi me poshtërsitë e para dhe, pikërisht atëherë kur ajo mendoi se ai e kuptoi se ç'njeri shpirtmirë e pa faj ishte ajo, i bëri tetshin. I erdhí mosha për martesë dhe ai s'mund të zgjidhte për shoqe të jetës një prostitutë, pra! A merren kurvat për gra? Fisnikët rregullojnë racën, zgjedhin gra të fisme...Fisnik, që vjen era mut, ironizoi me vete ajo, ama, kunj e kishte atë të lëshuar në mes të katër rrugëve...

Iu kujtuan të gjitha dhe ja tek u hap rubineti i lotëve. Ia kishte mbajtur krahun këtij Edi, sa s'ka më, jelek antiplumb i qe bërë, me dhëmbë i kishte ngrënë ata që kishin dashur ta futnin në kurth, milioner e bëri, deri edhe me ato zhdoganimet e ndyra të tij ajo ishte marrë, kurse ai...

- Po fillove me lot edhe qurre, ika! - e paralajmëroi ai.

- Një herë m'u largove nga sytë dhe e hëngre, o i shkretë, - psherëtiu duke ndjellë hundët ajo.

Edi e dinte më mirë se ajo këtë. E dinte se asaj nuk kishte perëndi t'ia

hidhte dhe se e nuhaste rrezikun një sahat larg, a thua rreziku kishte veshur ndonjë palë çorape të palara prej vitesh; ai e dinte mirë se sa lekë i afruan asaj atëherë për punën e miellit, vetëm që Edi të fundosej, dhe si i qëndroi besnike kjo vajzë që nuk kishte bukë të hante, por tani ishte e kotë t'i kujtoje të gjitha. Ai e pat marrë rrokullimën. Duhej lënë guri të binte në fund.

Ishte hera e parë që takoheshin, ngatë ndarja një vit e dy muaj e pesë ditë të shkuara në atë barin e qelbur buzë Lanës, ku ajo vetëm gëlltiste lotët dhe kafshonte gjuhën.

- Si e ke zonzushën? - pyeti ajo. Deshte të ndërronte bisedë dhe ja tek e bëri realitet ç'mendonte.

Edi bëri një shenjë të papërcaktuar me dorë.

- E ku merr vesh ajo nga këto hale punë, - tha pastaj.- Ajo nuk di ku ka brekët e veta e nuk i vjen era e gjellës kur digjet, jo më ta kuptojë fundosjen time...

Tjetra u kënaq. Vdiste për pak realizëm, edhe shpirtin e jepte, vetëm tjetri t'i hapte zemrën.

- E ndershme, pra!

Pastaj, si u nder në tavolinë drejt tij, me ato sytë që i shkëlqenin. shtoi gjithë qejf:

- Menebarem, a ta bën mirë atë punë? Ka shumë rëndësi përputhja seksuale...

- A më ha një mut! - u nxeh ai.

Dhe kishte plotësisht të drejtë që nxehej. Ehu, ikën e vajtën ato ditë legjendare seksi, kur s'kishte nevojë as të bëje banjë, se të lëpinte e të bënte xixë motra përballë, nga llapa e veshit deri te gishti i vogël i këmbës. Atij i shkoj vetiu dora te veshi i majtë, e krruajt i lehtë dhe dalloj, për fatkeqësinë e vet, se veshi kishte zënë dyllë. Po i thuheshin kësaj këto gjëra? Zot na ruaj!...

- Nuk ka gjë,- bëri sikur u pajtua tjetra.- Të paktën është e ndershme. Ndershmëria është kapital i madh...Do rriten fëmijët nesër, bythjashtë vërtet, ama, trashëgojnë emrin e mirë...Nuk është pak...Edhe po u bënë kurva, si puna ime, të paktën kanë një plus, që mua më mungon: Biografinë!...Nuk është pak!...

-Tall bythën,- i tha Edi,- s'ke faj. Të erdhi dita...Fajin e kam unë që qaj hall me ty...

Tjetra u fye. U vu në sedër ajo gjë e kolme, ajo kukull që ishte rritur fill e vetme, pa ia qarë hallin askush. Kurse duhej të bëhej një Nënë Terezë...Mbase dhe ajo e shkreta është rritur e varfër dhe pa dashuri, si puna ime, e ndau mendjen. Por qejf të tallej me Edin, megjithëse e fyer deri në palcë nga kjo fytyrë e poshtër, nuk kishte. Gjithçka do të jepte, vetëm t'ia hiqte litarin nga gryka edhe një herë këtij maskarai qaraman e tradhëtar e mashtrues e pisanjos, që i rrinte përballë si ato pikturat mizerje të realizmit socialist, me kokën si lopë e sytë gëlloq. Duket

këtu i punonte vërtet mendja, sepse befasi i shkëlqyen sytë.

- E di që edhe mund t'ia marrim lekët atij mikut tënd, që e hëngërt SIDA, ishallah!- tha befasi ajo.

Edi i besonte asaj, i besonte aq shumë sa mori para sysh edhe sherrin që mund të çudiste botën, po ta merre vesh e shoqja që ai ishte rrasur në këtë skutë me një...por e kuptonte edhe të vërtetën, që ato lekë tani s'merreshin më kurrë dhe se ato qenë konvertuar në një alamet borxhi frymëmarrës, që një Zot e di si mund t'i lante.

- Dëgjo,- ia nisi ai butë.- Unë nuk të thirra që ti të më ndihmosh për këtë punë. Ti, po munde, më ndihmo vetëm të siguroj ca lekë sa të filloj të punoj prapë, që të laj borxhet. E bën dot këtë punë? Po s'e bëre dot, hajde të flasim për gjëra të tjera, se kemi kohë pa biseduar...

Ajo e dëgjo me durim shembullor, pastaj tundi kokën mohueshëm. I erdhi në mendje ai komisari i policisë, që ia hidhte sytë si ujë nga makina e lëshonte herë pas here ndonjë fjalë tepër të këndueshme, si "O Zot, si nuk na vijnë ndonjëherë në Rajon këto ëngjëjt, por vetëm ca shëmtaraqe" dhe e ndau mendjen. Një ditë do ta kapte bosh ai komisari, pastaj, sa ta merre ndonjëherë forcërisht me furgon policije, më mirë po i afrohej vetë. Lante me këtë rast dy hesape: edhe ia merre lekët Gonit, edhe ia kthente atë restin e cigares.

- Sa përqind marr unë, po t'i ktheva lekët?- pyeti ajo.

- Sa të duash!

- Dhjetë?

- Njëzet?

- Dakort,- tha ajo,- me këtë punë po provoj të merrem unë...

Dhe i erdhi humori si me magji. Filloi t'i kujtojë Edi ca histori tunduese të kaluara dhe, si padashur, ia futi dorën në mes të kofshëve nja dy herë tjetrit, derisa Edi nuk duroi më dhe e ftoi të bënin një shëtitje përreth.

- Një herë tjetër,- qeshi ajo,- kur të kesh lekë. Jemi prostituta, apo jo?

Dhe ishte hera e parë që e braktiste qejfin e saj sublim me qejfin më të madh.

2.

Komisari hyri i përgjumur në klub. Gjithë natën e kaluar, deri në katër të mëngjesit ai kishte qenë në një vendngjarje vrasjeje dhe një e dy hapte gojën si shpellë. Porositi një kafë i mbështetur në banak, por kur pa në pasqyrë portretin e lakmuar, që sorrolletoj me një kapuçino përpara, kërkoi t'ia sillnin kafën në një tavolinë përballë saj. Ishte usta në këto delikatesa, i njihnte me hundë, siç i bënte keqbërësit ta hapnin gojën hap e mbyll sytë, që, sa e shihnin, i zinte korenti, dhe

nuk i erdhi vërdallë si adoleshent vajzës. E ftoi tjetrën në tryezë dhe pas gjysmë ore ia mbathën të dy nga klubi. Binte një vesë shi e qe një mjegull, që veç për seks ta çonte mendjen, dhe të dy nisën t'i flakërijnë plaçkat e trupit që në koridor. Ajo e la një herë tjetrin të çfryhej, pastaj ia nisi ledheve të saja, që edhe të vdekurin e ngjallnin dhe që ia hoqën lodhjen e mërzinë komisarit si me magji.

- Qenke në formë,- tha komisar.

Jastë binte gjithë ai shi qaraman dhe ajo i qëndronte strukur si kotele në gjoks.

- Sot edhe mund të të ha,- tha ajo.- Kam nja një vit pa bërë seks...

Dhe nuk gënjente. Që kur e braktisi Edi, nuk i bënte më zemra as për atë punë, përjashto ndonjë shëtitje formale interesi me njerëz që nuk ua mbante mend as fytyrën e që prisheshin hap e mbyll sytë.

- Zhgënjim?

- Dramë,- tha ajo.- Mjerisht, edhe ne populli i varfër kemi drama...

Komisari kërkonte të dinte më shumë. Po i pëlqente kjo vajzë që këtu të jepte përshtypjen e prostitutës dhe atje bëhej ëngjëllore si me magji. Por edhe asaj iu krijua ideja se ky djalë i fortë e nursëz nuk ia kishte me hile dhe nuk priti që tjetri t'i lutej dy herë. Ndjente edhe ajo nevojën për t'u shfryrë, për t'u kuptuar e për të qenë e mbrojtur. Këtu me zë të akullt, atje me lot në grykë, ajo ia nisi një rrëfimi të shtruar, të pacipë, nudo, me asnjë mister të fshehur. I kujtoi të gjitha: mbarimin e gjimnazit në 1990-tën, dashurinë për demokratët dhe pastaj si e kishte ngrënë derrin nga një demokrat hero në tapetin e pisët të zyrës së këtij të fundit, mizerjen familjare, pa brekë e pa bukë, të atin që vetëm pinte dhe dorën e tij të gjatë, fillimin e punës si kamarierë dhe përdhunimin nga pronari në banjën e pisët të lokalit, e ulur këmbëpërpetjetë mbi bide dhe prapanica që i dhembti një javë, pastaj orgjitë për dy lekë dhe një drekë a darkë nëpër male, kodra e plazhe, njerëzit e droguar me shiringa e llastiqe nëpër çorape dhe italianët legena me ca lireta të qelbura në xhep, qejfin për t'ia mbathur nga ky vend ku balta ishte çuditërisht më e ëmbël se mjalti, pastaj Edin, pastaj vetminë, atë vetmi që një shoku i tij i hershëm i gjimnazit e pati skalitur në vargjet e paharruar: " Gjithmonë të vetëm do të jemi./ Nga kjo sëmundje s'ka shpëtim./ Bota për ne do të kujtohet/ Vetëm një ditë: në varrim! "...

- Ja, kështu,- i dha fund ajo.- Edhe një kokërr leku s'kapëm, edhe ç'kishim na i rrubatën, edhe emri prostitutë na ngeli...Me një fjalë, se kush na i ka vjedhur kokrrën e hudhrës...

Ama, edhe atë që pati synim për t'ia xhvatur tjetrit, ia kërkoi dhe ia mori. Kishte qejf që ca njerëz t'ia lanin borxhet, le ta fillonte Goni i pari dhe ta provonte si vidhet dhe si digjet kriminalisht me cigare në gji tjetri...

Komisari ia puthi shenjëzën e përcëlluar mbi thithën e majtë dhe u betua

me vete se do t'ia nxirrte qumështin e nënës nga hundët atij palaçoje. Ishte njeri që e mbante fjalën. Askush nuk rekomandonte të hyje në dorën e tij, në atë putër që dukej ëngjëjlore, kur përkëdhelte trupin e kolmë të vajzës.

3.

Edin e lajmëruan se ajo po e priste te "Piazza" dhe, kur ai u shfaq në derë, dalloi tjetrën që ishte ulur në një skaj të restorantit dhe po hante me oreks të madh një antipastë me proshutë dhe pjepër. Nuk i pëlqeu ky takim kaq publik dhe nuk po dinte si ta hiqte qafe pa sherr e t'ia mbathte, por ajo ishte gjithë me oreks. Hante pa ndërprerje dhe vetëm sa i bëri tjetrit një shenjë me dorë të ulej.

- Merr ç'të duash!- urdhëroi pastaj.

Edi nuk ia ndante sytë. As qejf nuk kishte të rrinte e as lek në xhep për të paguar trillet luksoze të tjetrës.

- Ndonjë klient i pasur?- pyeti pastaj duke u ulur përtueshëm.

- Ti!- tha tjetra gjithë me bulçitë plot.- Pse nuk ke respekt për vehten, je gjithë ky djalë...

Kamarieri po vinte dhe ajo nuk ndjeu më kënaqësinë fillestare ta torturonte tjetrin. Nxori nga xhepi i pasmë i xhinseve kafe, i atyre xhinseve që ia pati blerë një djall e gjysmë-ky Ed, dhe hodhi mbi tryezë një zarf të trashë.

- Merri dollarët e tu!- i tha.- Unë e mbahta përqindjen time...Merret vesh, bashkë me atë që ia mori borxhin...

Edi ndjeu një të ftohtë përbrenda. Numuroi dhe rinumuroi lekët me duart që i dridheshin, pastaj pa si i goditur nga tjetra. Ishte e vetmja gjë që as e ëndërronte e as i shkonte nëpër mend ta mendonte. Dhe ashtu, fytyrë zverdhur e zë humbur mezi arriti e artikuloi:

- Si ia more?

Ishte vërtet ëndërr t'ia nxirrte kaq para nga dora atij mashtruesi e kriminelit bashkë. Ajo u përtyp mirë e mirë, i kërkoi edhe një birrë kamarierit, pastaj, si fshiu buzët gjithë delikatesë e si shtriu pirunin me thikën si zonjë e madhe në pjatën e boshatisur, tha shkoqur me një zë që donte vesh pipëz për ta kuptuar:

- Lekët nuk ishin të tuat. Ti kishe punuar duke lëvizur lekët e një shefi policije. Ky e dinte që ju kishit blerë ngrohëse dhe që këto qenë shitur. E dinte se malli pat kaluar pa doganë. Dinte sa qe derdhur në fillim dhe sa qe mbledhur në fund. Një zbritje e thjeshtë dhe... pjesa jote. Ai ia bëri të qartë të gjitha Gonit dhe ky ia ktheu dollarët...E thjeshtë, apo jo?

Edi e dinte se asgjë nuk kishte qenë e thjeshtë. Kjo femër gjigante do ta luante mendsh gjithmonë me mendjen e çuditshme që kishte dhe me kryeveprat që pillte orë e çast. Askush nuk mund ta kapte gafil këtë femër, as ai vetë, bile ai

vetë kishte rënë rob i braktisjes së saj, por Edit i përvëlooi gjeneza e kësaj historije të treguar qetësisht e normalisht: thjesht, ajo do t'i kishte mbajtur ndonjë leksion legjendar seksi atij komisarit dhe ai...A nuk ishte kështu?

Tjetra nuk fliste. Vetëm mbasi u mërzit nga këmbëngulja e Edit, s' duroi dot më e tha thatësisht:

- Ti i more lekët e tua. Të tjerat nuk të interesojnë...Dhe bën mirë t'ia mbathësh! Nuk është mirë të të shohin me prostituta në lokale të tilla...

Ai e ndjeu urdhërin e tjetrës. Asaj po i qahiej dhe po e mbante gulçin, vetëm mos ia jepte këtë kënaqësi atij. U ngrit pa guxuar të thotë as "faleminderit" e as "mirë u pafshim", u ngrit e iku si i dhjerë nga tryeza, i torturuar nga mendimi se ky ëngjëll, që e kishte dashur me gjithë shpirt, s'kishte asgjë të përbashkët me kurvërinë, me atë sëmundje që qenë përpjekur t'ia konstruktin tradhëtitë e kurvat e vërteta ishin qenie tejet serioze e fodulle në rrugë, njerëz që nuk kishin as më të voglën dijeni se ç' ishte lumturia dhe besnikëria. Shumë kohë ai e vuajti atë ikje idioteske nga "Piazza" dhe sërish u tregua idiot i pavlerë e i braktisur nga shoqëria, sepse përsëri nuk doli njeri që t'i tregonte, se, pak çaste pas largimit të tij, në lokal kishte hyrë komisar, ai djalë putërmadh, që dinte të përkëdhelte, por që dinte të bënte edhe ca gjëra të tjera...

JANAR, 1995

The Long night

NATA E GJATË

Taverna e hotel "Tiranës", e ndriçuar dobët, me ca drita të fshehura pas abazhurëve me veshje të errët, ishte pothuajse e boshatisur. Katër gjermanë porositën një shishe "Merlot" të kuqe dhe filluan ta pinin te tavolinat më këmbë, ngjitur me banakun. Ca grekër kishin bashkuar dy tryeza në mes të tavernës, kurse një çift çekësh pinin verë të bardhë të holluar me ujë mineral andej nga fundi i sallës, ku rrezik as muzika nuk dëgjohej kthjelltas.

Gjermanët qenë biondër e të rinj në moshë, veç atij thinjoshit me syze optike, që në atë zbehtësi nuk i merreshin vesh flokët se ç'ngjyrë i kishte pasur dikur. Ata qeshnin me njëri-tjetrin të mbështetur në tryezë e te kangjellat e hekurta dekorative, që i ndanin tryezat e larta buzë banakut me pistën e vallëzimit të sallës, dhe as ia hodhën qoftë edhe një herë të vetme sytë tavernasve të tjerë. E thanë shpejt e shpejt shishen e parë, seç pëshpëritën kokë më kokë, pastaj më i riu prej tyre, një flokëgjemb i shkurtër e i kallur në ca pantallona të bëshme bluxhins ia bëri me shenjë kamerierit të përsëriste porosinë.

-Do ta gdhijmë sonte, siç po duken bathët, - i tha kamerieri imcak e hollak banakierit, duke i hedhur kuponin e bonos në banak. - Një "Merlot" tjetër! Këta gjermanët nuk i mbërthen kollaj vera!

Banakieri e hapi shishen kinse me zhurmë dhe e vendosi me një gjest ustai në pjatancën vetëtitëse të kamerierit.

-Keq e kemi sonte, - bëri një grimasë dhe ai, - duken të ushqyer mirë!

Grekët porositën përsëri uzo "Metaksa" me bajame të kripura, pastaj se nga mbiu ai jugosllavi çalash i ambasadës, që hodhi sytë si një dhelpër ngadalë e shtruar nëpër skutat e errëta të tavernës dhe doli duke u lëkundur majtas-djathtas siç erdhi. Njëri nga gjermanët, me ta parë çalashin, preku një komçë metalike të

këmishës së shokut dhe e lëshoi metalin vetëm pasi jugosllavi humbi pas hyrjes daljes së tavernës, ama, për çdo siguri kërkoi nga banaku një lugë të vogël metalike dhe porositi menjëherë një "Merlot" tjetër.

-E mbërtheu të parin, - klithi duke fërkuar duart kamarieri, - edhe ata grekët po ia mbathin, nuk deshën më uzo...

-Atë e ke qiçër, - ia ktheu banakieri, - vetëm se besoka te magjtitë. Prandaj e kërkoi lugën!...

Banakieri, një kaçurrelas i bukur e i qetë, ishte ujk i vjetër në tavernë, kurse kamerieri ende motak në detyrë. Banakieri nuk ngazëllehej kollaj. Pikërisht kësaj qetësie të tavernës i trembej për vdekje. E dinte mirë se ekzistonte një takëm njerëzish që ua donte mideja të pinin në lokale të zbrazura, bile, parapaguanin gjithë xhiron e lokalit për ta mbyllur klubin për klientët e tjerë e për t'ua lënë në dispozicion atyre për gjithë natën. Edhe këta katër gjermanë nga ai brumë dukeshin, vetëm rrëmuja mund t'i detyronte të ngriheshin e t'ia mbathnin pa i mbaruar as gotat e verës në tryezë. Atij iu kujtuan holandezët e NPV-së që e gdhinin në tavernë sa herë e gjenin sallën e zbrazur, ato fytyrat e tyre të përflakura prej mjekrave të kuqe që u pushëzonin gjatë natës nga alkooli, mirëpo nuk qe e thënë t'i kujtonte imtësisht ata. Kamarieri fishkëlleu:

-Shikoje çeken! - tha me admirim. - Kalë, ëë?

Çekët kishin dalë në pistë të kërcenin dhe ajo vajza ishte një hyjni e vërtetë. Ç'trup fantastik kishte! Nazike, ajo i mbërtheu kokat e grekëve me kofshët e saj magjepëse dhe i rrotullonte ku shkelte e përdridhej. Vetëm gjermanët nuk u joshën. Ai më i vjetri mes tyre kërkoi të përsëritej porosia dhe, kur u vendos shishja e katërt në tryezë, nxori lekët e pagoi. Fytyrat e gjermanëve ishin të qeta, si fytyra nxënësish në orën e matematikës. Vetëm te këmbët iu zbërthehej temperamentit. Secili prej tyre, kush më vrulltas, kush më i frenuar, ndiqnin ritmin e muzikës me rrahjet e këpucëve të tyre me gomë në parket.

Grekërve filluan t'iu shkëlqejnë sytë dhe kuptohej një orë larg se ata fukarenjtë tani përpiqeshin seriozisht të depërtonin nën minifundin e zi të çekes.

-Keq e kemi! - përsëriti duke psherëtirë banakieri dhe fill pas trishtimit të tij që edhe sonte do ta kalonte natën pincë më këmbë, grekët porositen një shishe uzo "Metaksa".

-Dojçat do të bëhen dru sonte! - i tha banakieri prerë kamarierit. Nuk i pëlqeu akullsia e fytyrave të tyre dhe zjarrmia e këmbëve poshtë. Ishte pak a shumë një lloj me fytyrat e hirta të të dehurve me veshë flakë të kuq.

-Nuk kam parë gjerman të dehet me verë! - tundi kokën mohueshëm kamarieri.

-Ti dhjetë gjermanë ke parë në jetën tënde, - e qesëndisi tjetri, - sonte këta i ke kallup akulli!

Kamarierit iu shfaq para syve ai inxhinieri gjerman që punoi aq kohë në kombinatin ushqimor.

-E vemë me bast nga një shishe xhin? - pyeti pastaj gjithë duke kujtuar atë bosin që pinte një autobot dhe prapë qiqër e qiri më këmbë e kishe! Tamam gjerman! Si e hante darkën? Një proshutë të ftohtë dhe një shishe "Reisling". Pastaj një dopio raki në fund... Zotni!... Pastaj fundi, kur firmoste faturën, rakinë të paguante nga xhepi... Zoti Oto, s' duroi dot një natë kamerieri, ju jeni i ftuar, pse e paguani vetë rakinë?... Ushqim kam verën dhe proshutën. Këtë ma paguan firma. Rakinë e pi për qejfin tim. Qejfet duhet t'i paguajë secili që i bën për hesap të vet!... Ç'Otto ishte!

-Dakort, - pranoi banakieri me sytë të këmbët e gjermanëve, - veç do të rrënohesh!

-Të shohim, - ia ktheu tjetri në kohën kur orkestra pushoi dhe çekja, bashkë me kavalierin e saj, një tip mesatar i mbushur në trup, nuk u ulën në tryezë, por morën drejt daljes duke kaluar bri vështrimeve të betonuara të gjermanëve, që shihnin veç njëri-tjetrin e as ua hodhën sytë kaluesve përmbri.

-Po shkojnë në banjë! - tha banakieri për çekët.

Kalimthi i zuri sytë atë gjermanin e vogël që i bëri një shenjë "Vitoria" me dy gishtat e ngritur lart shokëve të tij. Nuk dukej tip i përmalluar e i thekur pas lirisë e demokracisë ai çunak. Vetëm desh t'iu linte të nënkuptonin atyre shokëve se çekja po shkonte në tualet dhe banakieri u ngroh.

-E humbe bastin! - i tha shokut. - Bëje gati që tani atë bonon e xhinit, se më vonë mund të jesh i lodhur, apo të mbarohet boja e stilolapsit...

-Qesh mirë kush qesh i fundit, - ia ktheu tjetri qetësisht, duke hetuar grekët andej matanë kangjellave të hekurta.

-Nuk më pëlqen optimizmi yt, - u tall banakieri, - nuk vure mend një herë!? Pse ke qenë optimist, prandaj ke ngelur me gisht në gojë gjithë jetën!

Mirëpo grekët nuk i lanë të futen në të thella. Kërkuan akull dhe kamarieri hyri vetë në banak e mbushi një gotë kristali plot me kallëpza të vogla vetëtitëse. Vuri në pjatancë edhe pincetën e argjendtë, pastaj u ngrit paksa mbi nivelin e aparatit të ekspresit dhe vështroi andej nga që zgjatur banakieri. Ishte shfaqur sërish çekja magjike në derë me kavalierin e saj të qetë përmbri, që buzëqeshte pak skajshëm duke u munduar të zgjedhë një rrugë kalimi në shpinë të gjermanëve. Po kot u rropat aq shumë, se fytyrat e gjermanëve ishin po aq të akullta, sa fare mirë mund ta shuanin uzon e grekërve përballë. Gjermanëve iu fëshfëriti trupi i çekes në shpinë, në kohën kur ata trokitën gotat.

-Gut! - tha me gjysmëpsherëtime balashi i vogël qimengritur dhe nuk u mor vesh se për cilën ofshau aq thellë, për atë gllënjë "Merlot" apo për çeken që ikte duke u tundur lehtas si varkë me vela.

Banakieri buzëqeshi në kohën që po shtrydhte dy kafe për grekët. Shishet e xhinit vezullonin si margaritarë, iu binte e iu thyhej drita e neonit për mrekulli, a thua inxhinieri elektrik e kishte vrarë mendjen posaçërisht për këtë lojë dritash në lëng e në qelq. Orkestra mori një tango nostalgjike dhe banakieri vuri bërrylat në syprinën bri ekspresit i përqendruar në pistën e vallëzimit. Çekja po vallëzonte sërish, joshëse e provokuese, sa grekët, pas një konsulte të shpejtë e ekzaltimi si bashkësi, porositën edhe një shishe tjetër uzo. Vetëm gjermanët ishin të akullt nga gjoksi e lart. Kurse nën tryezë... Duhej t'iu pëlqente të gjithëve vallëzimi, paçka se nuk morën mundimin t'i kapërcenin kangjellat përbri. Flokëgjembji më në fund s'duroi dot më e filloi të mbajë ritmin e vallëzimit edhe me një trokitje të gishtërinjve në syprinën e tryezës, por ktheu vulltas kokën thinjoshi, vetëm xhami i syzeve të tij vetëtiu dhe vogëlushi i tërhoqi duart e i zhduku nëpër xhepa. Pastaj i nxori prapë, i futi e prapë i nxori. Kishte filluar të lëkundej dhe ato drej duarsh të rrasura në xhepat e thellë nuk e ndihmonin të vendoste ekuilibrin. Dhe, ngaqë nuk dinte si ta fshihte dobësinë e vet, porositi një "Merlot" tjetër. E pagoi në çast dhe kamerieri u trishtua.

-Më duket se ma fute, - i tha banakierit, - ky zog u më la bakshish të majmë. Eshtë dehur...

-Bëj durim akoma, - tundi kokën tjetri, - do të të shohin syçkat çudira!...

Kurse çekja kukuriste duke u rrotulluar në pistë, me gjinjtë e ngjitur pas kraharorit të kavalierit të saj. Herë pas here ajo përkulej pas duke e ngritur lart këmbën e djathtë e duke i çmeritur tërësisht grekët syzgurdulluar tashmë, dhe orkestra e shpejtoi ritmin e vallëzimit. Pastaj menjëherë, me një marrëveshje të rrufeshme mori një samba.

-Thanks!- klithi çekja.

Hoqi këmishën e zezë dhe ja tek u shfaq në pistë me një kanotiere gjithaq të zezë, prej nga shpërthenin supet e saj të plotë që s'lypnin ndihmën e vatave nën suporet e këmishave a fustaneve.

Gjermanët ndoqën me sy fluturimin e këmishës që mbeti e varur në kangjella me fytyra po aq të akullta. Ndoshta e ndjenë se këmbët e prishën aleancën me portretet dhe pinë verë si me urdhër të katërt.

-Gut! - psherëtiu përsëri balashi i vogël.

Ku dini ju, o të mjerë, o trima të marrë budallenj, se ç'të bën "Merloti" i kuq kur e pi me inat e pa meze, i mëshiroi banakieri. Do t'iu përvëloj stomakun me gjithë zorrë, o trima të marrë, u tall prapë ai. Pastaj filloi të kontrollojë bonon e kamerierit dhe qeshi i lumtur kur pa se tjetri e kishte faturuar edhe shishen e xhinit.

-Më pëlqen realizimi yt! - i tha ngadalë, - kjo tregon se do bësh përpara! Do ta pimë shishen bashkë, - shtoi.

-Tani dua t'i shikoj barkas të gjithë, - tha kamarieri i mërzitur. - Ma jep pak bonon, - u zgjat mbi banak, - dua t'i qeras me një "Merlot" tjetër.

-Mos u bëj budalla, - e tërhoqi bonon banakieri, - ata do të porosisin prapë verë. Pse kërcen menjëherë si kanaçe karbiti?! Vetëm bëji një shenjë Gonit ta zgjasë pak më shumë këtë sambën...

Grekët duhet të ishin pushtuar skaj më skaj nga Metaksaja e tyre, sepse tani filluan ta mbanin ritmin me përplasje duarsh e fishkëllima barinjsh. Fytyrat e gjermanëve u mvrejtën nga sjellja jo e hijshme e grekëve. U ngjyen me neveri e ironi njëherësh, ama, këmbët nën tryezë e vithet bashkë me bel iu vallëzonin për mrekulli. Ai syzja mbante një palë këpucë me lëkurë të butë në ngjyrë mjalti që puthnin tokën ritmikiisht herë me majë e herë me thembër, bri këpucëve të hirta e sheshka të gjembit, të cilat ngriheshin e binin mbi parket, duke prekur thuajse në të gjithë sipërfaqen e tyre njëherësh, a thua ishte ndonjë valltar ballkanas.

Banakieri e hapi ngadalë shishen plloçake të xhinit.

-Mua mos më hidh! - i tha kamarieri.

Vështronte andej nga pista, ku çekja tundte vithe e bark me duart e nderura mbi supe, herë duke iu strukur në trup kavalierit të saj e herë duke e ndjellë në skajin e pistës.

-Llahtarë, ëë?- bëri kamerieri.

Gjermanët i kthyen gotat me eks duke qeshur befash me poterë. Tani kushedi ç'samba iu gjëmonte nëpër mendje, sepse këpucët poshtë tryezës përplaseshin me ritme të dyshimta. Kurse grekët atje tej sikur u esëlluan nga brohoritjet e fishkëllimat.

-Nxorën djersë! - tha banakieri.

Kamerieri psherëtiu. Iu mërzitën gjermanët. Më mirë t'ua kishte kërkuar likuidimin e parave grekëve kur qenë çakërçejf. Ky xhini tani duhej paguar nga xhepi. Befash syzja, me lëvizje prej xhezbandisti të këpucëve ngjyrë mjalti, u nxehe e porositë pesë shishe verë për orkestrantët.

-Mbaroi edhe ky! Dy në dorë! - mërmëriti banakieri duke hapur shishet e duke bërë kujdes mos t'i shihte gjermanët në sy. Bëheshin të rrezikshëm këta dreqër kur deheshin, iu ngjallej instinkti i luftës e i progromeve.

Me të parë shishet e verës orkestra mori zjarr, kur çekja e la partnerin dhe gjithë duke u tundur nën ritmin e muzikës erdhi e u ngul buzë kangjellave, përpara gjermanëve që tani dukeshin si spektatorë mjeranë kabaresh prapa hekurave të qelisë. Ajo rrotullohej plot hir, me shpatullën e djathtë të hapura paksa poshtë, pjerrtas, drejt parketit, kurse fytyrat e gjermanëve nuk qenë më të akullta. Veçse nga pista ende shihnin vetëm me bisht të syrit. Shkriheshin me ca të qeshura të eksituara duke vështruar me nënkuptim njëri-tjetrin, ndërkohë që kori antik i grekëve mbante nga krahu tjetër për mrekulli ritmin. Kamerierin vazhdonte ta

gryente gabimi fatal që nuk ua mori një gjysmë ore përpara lekët grekëve. Pastaj iu kujtuan nga "Iliada" nja dy vargje: "Një farë Daretit ndodhej mes trojanëve,/ burrë pasanik pajisur me çdo vlerë" dhe vendosi t'ua recitonte si me lezet grekëve. Mbase vargjet zbulonin ndonjë Daret të ri, hamendësoi kamerieri duke u tallur pa u marrë vesh se me cilin.

Më në fund samba dha shpirt dhe gjermanët në çast u mblodhën kokë më kokë. Çuquritën, pastaj gjembi u afrua duke u tundur lehtë në banak. Hapi pëllëmbën e dorës së djathtë, ngriti njëherësh nga grushti i të majtës gishtin e madh dhe hodhi një tufë kartmonedhash në banak.

-Filloi lufta! - mermëroi banakieri.

Gjashtë "Merlot" u vunë radhë në banak përpara gjermanëve të skuqur e me sy të zvogëluar, që prisnin me gotat e zbrazura në duar të merrnin porosinë.

Banakieri iu tregoi klientëve kamerierin, por gjermanët tundën kokat mohueshëm. Morën shishet dhe si ushtarë u nisën në rresht për andej nga gjysmëerrësira, kur preheshin të mbështetur në ndenjësë çift çek.

Tani iu dukeshin vetëm shpinat. Grekët qenë esëll. Ata e hodhën akullin në gotat me uzo, po lëngun nuk e futën nëpër vrimat e fytyrës. E kuptuan se nuk kishte kuptim më ta gdhije natën në këtë tavernë të errët e të veshur me dru në mure e tavanin e ulët dhe u ngritën. Ishin shoferë e tregëtarë e nuk e njihnin as Homerin e as Daretin, por kur numëroi shumë e lënë në banak, kamerieri mendoj se Daretit duhej të kishte qenë ndonjë xhins shoferi, qerrtar, për shembull. Banakieri i zgjati gotën e xhinut me pak akull që kërciti këndshëm në kristal dhe ata i përplasën gotat. Pastaj panë gjermanin e parë me kokën mbështetur mbi duart e shtrira në tryezë. Ai vulli i pari në parket, përballë çekes, duke qëndruar në atë pozicion për ta fshehur veprimin e vet. Çekja duket u spërkat nëpër këmbë nga stërkalat e të vjellave, sepse buzëqeshi lehtë e i tërhoqi ngadalë këmbët majtas. Kurse ata në banak i mbushën përsëri gotat me xhinin vezullues.

1988

The cigarette

CIGARJA

-Nuk më ke interesuar kurrë! - tha ftohtësisht Toni, duke e parë drejt e në sy Mirën dhe duke u lëkundur shpërfillshëm në karrigen e ngritur në hava përpara e të mbështetur vetëm në dy këmbëzat e pasme.

-E kam ditur prej kohësh, - ia ktheu ajo me vështrim diku nga e majta, fare pranë këmbëve të zgjatura shpërfillshëm nga Toni. Ja tek e pranoi me gojën e tij që nuk e deshte. S'fliste kot Ingridi.

Matanë dëgjoheshin ecejaket e tezes së saj, ndonjë përplasje ene për lavaman dhe ajo uroi me gjithë zemër e iu lut gjithë shenjtorëve të ngulur në kujtesë nga historia e pikturës që ai të binte me turi në dysheme e të thyente qafën me gjithë karrige. Dhe arriti të pendohej seriozisht që nuk e mësoi si duhet atëherë lëndën e historisë së pikturës. Do mbante mend më shumë emra shenjtorësh të pikturuar nga kolosët e artit figurativ e të përjetësuar në mermer dhe me siguri një perëndi do zgjohej e do t'ia dëgjonte lutjen e përgjëruar asaj, që t'ia shpjegonte një herë mirë e mirë anatominë e trupit këtij skulptori të dështuar, këtë herë me eshtrat e tij... E shikon këtë gollganin, djalë? Ky është... Po unë s'kisha ndërmend të përvetësoja lëndën atëherë, iu çkërmit vetes ajo, e flakja librin dhe bëja dashuri me këtë surratin!...

-Jo po ta dish mirë! - u tall Toni. Përfundimisht iu mërzi kjo femër, që shpikte farë-farë historish banale e cytur nga xhelozia. Ai ishte i bindur se njeriu lindi nga bashkimi rastësor e fatlum i dy majmunëve intelektualë, që, çuditërisht, nuk vuanin nga xhelozia.

-Kam qenë e përgatitur shpirtërisht prej kohësh, - u ngërdhesh ajo, - kush e la edukatën që ta trashëgoje ti!

-Mos dëshiron ndonjë flakurimë syçkave, - u nder Toni duke e lënë lodrën

me karrigen në mes. I dogji ajo puna e edukatës. E vërteta ishte se kjo femër hollake dhe elegante, si ato krijesat e Botiçelit, e pati mësuar me durim shembullor atëherë në plazhin e Durrësit, kur zhvillonin praktikën mësimore, të hante si njeri me thikë, lugë e pirun.

-Mos m'u lodh, - u tall ajo, - kushedi të duhen energjitë. As armikut nuk i urohet të bëhet pre i xhelozisë...

-Do ta qepësh? - iu hakërrua ai,

-Bëj durim, - ia ktheu qetësisht Mira, duke ia ngulur kësaj here ato sytë në gështenjë të thellë, - është hera e fundit që po më dëgjon. Të kam falur aq kënaqësi, besoj, sa të më durosh edhe pesë minuta...

-Më ke mësuar keq, bile, - tha Toni, mirëpo iu zbut zëri në çast dhe ra një heshtje e keqe në mes të dy ish-të dashurve. Atij iu kujtua shpirti i saj i mrekullueshëm, e qeshura tunduese me dorën e hollë para buzëve të vogla, pastaj ai dreq trupi fërgëllues i mermertë...

-Mos nuk ndiheni mirë? - e pyeti ironikisht ajo.

O zot, ç'ngrohtësi kishte pasur kjo femër, që të lidhej në trup e s'nxirrte asnjë fjalë e klithmë, vetëm të shtrëngonte e të puthte njerëzisht.

-Atë punë e bëje mirë, - psherëtiu ai, - tani do detyrohem të kthehem në asket. Nuk do shkoj dot me të tjera... Nuk ka më mizor nga sistemi i referimit!... Ty duhet të të kapë ligji për këtë krim të kryer ndaj një personi të pafajshëm dhe potent seksualisht, si puna ime!

-Nuk u bërë një herë njeri, o i shkretë! - psherëtiu ajo, ama ndihej që ishte pushtuar nga fyerja. Iu kujtuan ato qeramikat e mrekullueshme që ia kishte bërë Toni, qeramikat e varura në murin e kuzhinës së tezes, iu kujtua pastaj si i pati modeluar nudo me durim shembullor, puthjet e herëpashershme të Tonit në mes të punës, ato puthje që s'kishte perëndi t'i parashikonte ku do të bëheshin në gishtin e vogël të këmbës apo te thitha e gjirit, në kërtizë apo në kofshë, në gushë apo në sup; kujtoi pjatën e lajthive të qëruara, që ia sillte te koka Toni për t'u marrë me diçka gjatë kohës së modelimit dhe iu qa. U ngrit rrëmbimthi, doli nga dhoma duke e përplasur derën me tërbim, pastaj, kur u kthye, hapi dritaren dhe gjysmë e kthyer nga ai tregoi qeramikat e ndritura që rrezatonin magjishëm nën diell.

-Ja dhe kryeveprat e tua! - i tha duke ia flakur qeramikat nga dritarja.

U dëgjua një çast më pas kërcitja e qeramikave të thërrmuara poshtë në oborr, pastaj psherëtimja e Tonit:

-Ndonjë kushërira jote e vrau Pirron e Epirit! Ju jeni damar racor, pasuronit historinë! Mbase tregohesh shpirtndritur dhe më fut dhe mua në histori. Plastikën e njoh mirë...

-Tani mund të ikësh! - tha prerazi Mira.

-As mua nuk më preu barku të harxhoj kohën me ty, - ia ktheu ai i lumtur deri te qimet e gishtërinjve të këmbëve që arriti ta tërbojë Mirën, - vetëm ende nuk e kam marrë vesh pse u ndamë? Ne duheshim aq e aq shumë, sa dashurinë tonë s'mund ta qajë as edhe një lumë, i rrembyer e plot pruje, ëëë... Cili ishte shkaku, siç thuhet rëndom për raste analoge në veprat letrare?

-Shkak janë ato maskarallëqet e tua... Kot nuk thonë, guri që rri mbi dhe, rrënjë nuk ze!

-Thotë gjyshja jote, apo jo?

-Ç'rëndësi ka?

-Jo, kujtova se ia veshe mençurisë së popullit budallallëqet e gjyshes tënde?

Asaj iu qesh për një çast dhe kafshoi buzët për të mos e dorëzuar veten para dialogëve të tij. Tani ishte me rrezik puna, se atij po fillonte t'i përshkëndijonte ai gjenialitet prej idioti, që s'kishte zot t'ia përballonte me seriozitet. Si tha atëherë, kur ajo deshte të dilnin nga lokali, megjithëse binte shi? Prit të pushojë një herë ky shi, si qurra jevgu!...

-A ka mundësi të largohesh tani? Mos u hiq sikur t'u këput shpirti! Pak minuta më parë deklaruat pompozisht se unë nuk iu kam interesuar kurrë!

-Sinqeritetin e kam, - u tërhoq ai, - ti ma di këtë huq, unë vdes për pakëz sinqeritet!

-Atë që e ke, e ke, - pranoi ajo duke hapur krahët, - kur më betoheshe mua, vdes për ty, një gropë varri kishe para syve...

-E pra, - e ndërpreu Toni, - gropa duhej që të zhdukesh brenda saj me të urdhëruar ti: vdis!

-Më vjen keq që më ikën gjithë këto vjet kot, gjashtë vjet, - psherëtiu ajo. - Gjashtë vjet me një debil!

-Pse debil? - pyeti ai. - Asnjëherë nuk të lashë shtatzënë!

-Ti je i metë, o i shkretë! S'fole një herë seriozisht!

-Preshët sa më tepër rrallohen, aq më tepër trashen, - tha ai duke kundruar këmbët e tij, - dhe unë, tani që u ndava nga ty, fillova të rrjedh nga trutë...

Ajo e pa përhumbshtëm. Ishte krejtësisht mundim i kotë të merrej me këtë idiot.

-Vërtet, më ke dashur ndonjëherë? - e pyeti papritur.

Ai ngriti sytë, nuhati një herë si zagat përreth duke iu trembur ndonjë kurthi, pastaj uli sytë prapë mbi këmbët e tij me ato këpucët e mëdha.

-Punë tjetër s'kam pasur unë, - ia ktheu. - Femrën nuk duhet ta duash, sepse femra ka edhe ndarjen gjithmonë me vete dhe braktisja të luan nga mendtë e kokës, kur ke rënë brenda...

-Maskara! - e shau ajo dhe filloi të gërmojë me rrëmbim në çantën e

dorës. E flaku lapsin e syve në një cep të çantës, duke kujtuar gjithë ato vite magjike që kishin kaluar bashkë, plazhet e boshatisura dhe shëtitjet në mal, drekat e darkat në restorante dhe dashurinë marroqe në tualetin publik të lokalit nga liqeni artificial, pastaj përkujdesjet e tij kur asaj iu shfaq sëmundja e zemrës, pastaj ato vizatimet e mrekullueshme e të trillta që i pati bërë ai e që ia hodhi më pas në qeramikë, pastaj... Paketa e cigareve ishte në mes të çantës, por asaj nuk i shihnin sytë nga tërbimi e hidhërimi bashkë. Më në fund, mollëzat e gishtërinjve përcollën në mendim atë që nuk e bënë dot sytë dhe ajo nxori me duar të dridhura një cigare nga paketa. E futi mes buzëve, pastaj ia nisi rishtaz kërkimit të shkrepesë.

Toni u mbështet mirë në karrige dhe nuk po ia ndante sytë.

-Që kur e paskeni nisur cigare? - e pyeti më në fund me një ton provokues.

-Ti kërkoi llogari atyre dashnoreve të tua bythderre, që i mban në studio me net të tëra e që duhet t'ua bësh brekët me porosi speciale!

-Që kur e paske nisur cigaren?

-Nuk është puna jote! E ç'të kam unë ty? Hiç!

Vetëti shkrepesja, mirëpo Mira nuk arriti ta ndezë cigaren, sepse ai i kërcëu si tigër m'u në fytyrë. Ia fiku me tërbim fijen e shkrepesë dhe i ulëriu me sa kishte në kokë, a thua ajo ndodhej nja dhjetë pallate më tej:

-Që kur e ke nisur cigaren!

-Ty-s'të-njoh-fare! - rrokjzoi ajo edhe më e tërbuar akoma. Dhe bëri ta shtynte me parakrahët e ngritur para fytyrës e t'i shmangej për të ndezur sërish fijen tjetër të shkrepesë. I dridhej cigarja në buzët e bukura, pastaj u mpi, kur ai e mbërtheu për gryke dhe i ulëriu prapë:

-Kush ta dha cigaren e parë?

-Ty - s'të - njoh-fa-re! - ia ktheu përsëri egërsisht ajo, mirëpo një flakurimë e dhënë pa rezerva e flaku me gjithë karrige pranë dritares së hapur. Ajo mbeti e shtangur, ndërkohë që ai i erdhi mu mbi kokë me pëllëmbët e mëdha të mbledhura grusht e që mund të të thyenin eshtrat dhe i ulëriu përsëri si i marrë:

-Kush ta dha cigaren e parë?

-Ingridi, - belbëzoi Mira e tmerruar. - Ingrid...

-Ingrid kurva...! - ulëriu ai atë çast që u hap dera dhe u shfaq e prerë në portret tezja e Mirës. Po Toni as e ktheu kokën e as i mati fjalët. Vetëm e ngriti Mirën, e mbështeti për muri dhe i tha duke kërcëlluar dhëmbët mu në fytyrë:

-Të pashë më me cigare, të vdiqa! Do të ta fus surratit ku të jesh, në rrugë, në ekspozitë...

Pastaj zëri iu zbut:

-Po ku je për cigare ti, me atë zemër mizerje që ke? Të paktën, shoqërohu me njerëz që të duan të mirën, që të duan, aq, sa të denjojnë të dinë se si e ke shëndetin ti!...

Tha kështu dhe u kthye rrëmbimthi, shtyu vandalshe tezen e Mirës nga dera, doli në korridor, pastaj, një çast më pas u dëgjua se si u përplas dera e madhe me tërsëllimë. Mira ngriti papritur pëllëmbët në fytyrë dhe qau me gulçe të mëdha, qau si atëherë, kur i thanë mjekët se ajo kishte lindur me defekt në zemër.

1990

PËRRALLA

-Nëna, unë u mërzita! - tha vajza me një zë paksa të qaravitur, duke gërrmuar rërën e imët të plazhit me këmbë.

-Ah, jo! - ia ktheu butë gjyshja. - Si kemi thënë bashkë me gjyshin? Që të jesh njeri, detyrimisht edhe nuk duhet të mërzitësh! Njeriu i mërzitur jo vetëm nuk mund të kryejë asnjë punë të mirë, por iu fut mërzinë njerëzve të tjerë që e shohin. Ja, për shembull, po u mërzite shumë ti, unë mund të filloj të qaj.

Vajza ja nguli sytë e kaltër me kujdes.

-Si te varri i xhaxhi Kolit? - pyeti më në fund.

-Po! - ia ktheu me zë të mbytur gjyshja.

-Mirë! Unë nuk jam dhe aq e mërzitur! Vetëm, po nuk përtove, o nëna, më trego një përrallë, sa të vijë gjyshi.

Plakës iu kujtuan varrezat, varri i bukur i Kolit të saj, trëndafilat shumëngjyrësh pranë pllakës së bardhë prej mermeri dhe iu mblodh një komb në grykë.

-Do të tregojë nëna një përrallë të bukur, - i tha mbesës. - Një përrallë me njerëz të...

Ajo e ndërpreu kinse zërin e fjalinë bashkë me të.

-... Mirë! - plotësoi vajza.

-Të lumtë!

-T'ia tregoj edhe mësueses kur të shkoj në shtator në klasën e parë?

-Patjetër, - tha nëna, - ç'u kuptua po i mbajte për vete gjërat e bukura?! Si kemi thënë ne, njeriu nuk iu jep të tjerëve vetëm gjërat e shëmtuara, ato që i mërzisin njerëzit.

Mbesa tundi kokën dhe dy gërshetat hollake i ikën majtas-djathtas si

shpeze të trembur.

-Unë nuk do mbakam asgjë për veten time, vetëm do jepkam, - psherëtiu.
Plakës iu sajua një buzëqeshje, por e përmbajti me kujdes.

-Edhe do marrësh, Lira, se, ti, nuk do të bëhesh më e zgjuara nga të gjithë në botë, apo jo?

-Nga më të zgjuarat, - ra dakord vajza, - se unë do mësoj në shkollë dhe do dëgjoj ç'të më thotë nëna me gjyshin... Ma trego atë përrallën tani! - u kthye përsëri në origjinë të bisedës ajo. Atje po i rrinte mendja gjithë kohën.

-Mirë, - pranoi gjyshja. - Na ishte një herë, - ia nisi ngadalë pa ia hequr sytë detit që po thinjej e errej nëpër muzg, - një nënë, një baba dhe një djalë.

-Si i kishin emrat? - pyeti vajza.

Nëna tundi kokën butësisht.

-Në përrallë njerëzit nuk kanë emra, Lira, sepse në përrallë nuk hyn sjellja e një njeriu të vetëm, por e shumë njerëzve dhe atyre do t'iu mbetet hatri e do të ankoheshin: pse, kështu u solla unë atë dimër, që më quajnë Genci dhe jo si Artani i përrallës!...

-Mirë, - u tërhoq mbesa. - Pastaj?

-Të dy prindërit e donin si dritën e syrit djalin e tyre, sepse edhe ishte shumë i sjellshëm, edhe mësonte në shkollë, edhe njerëzit i donte e i ndihmonte, kur e shihte se kishin nevojë për ndihmë, e iu thoshte të gjithëve "mirëmëngjes", kur i takonte në mëngjes nëpër shkallë, e "shëndet", kur teshtinin...

-Po shitësve, iu thoshte "faleminderit", kur blinte ushqimet?

-Patjetër! Ajo ishte fjala e parë që shqiptonte në kësi rastesh. Ama, edhe djali i donte shumë prindërit. Ai iu dëgjonte gjithmonë fjalën dhe, kur ata nuk e kishin mirë, i korrigjonte me kujdes, edhe që mos t'u mbetet hatri e të mos tristoheshin, edhe që të bindeshin se më e udhës ishte të kryhej puna siç propozonte djali. Dhe që të tre ndjeheshin të lumtur, aq të lumtur, sa shumëpak - kush në botë. Një ditë djali solli në shtëpi një shoqe. Ajo ishte me fytyrë të pastër e trup të hajthëm, aq sa nëna e besoi kur djali i tha: "mama, kjo është e bukura e dheut"!

-Paska qenë si mami im, - kërcëu vajza, pastaj dalloj gjyshin, që po vinte ngadalë nëpër rruginën e klubit veror, dhe lëshoi zërin brisk: hajde shpejto, gjyshi, se nëna po tregon një përrallë fantastike!

-Po, si mami jot tamam ishte! - pranoi nëna, ama dukej qartë se ndodhej në mëdyshje, ta vazhdonte, apo ta linte përrallën në mes.

-Ç'është kjo përrallë fantastike? - pyeti gjyshi, duke puthur vajzën.

-Na ishte një mama, një baba dhe një djalë i mrekullueshëm, më i miri në botë, - tha rrëmbimthi vajza, - më në fund ai solli në shtëpi një vajzë të bukur si mami im, dhe, hë, tani, nëna, vazhdoje! - iu soll gjyshes fëmija.

Plaku ia nguli sytë vetëtimthi plakës.

-Nuk tregohen përralla tani, - i tha butësisht vajzës, - ato rrëfëhen natën, para gjumit. Harrove ti?

Vajza tundi këmbët me inat.

-Jo, - tha me zë kryeneç. - Ajo e nisi tani! Një punë e nisur çohet në fund! Vetë ke thënë kështu!

-Mirë, - tha, - pastaj ç'ndodhi kur erdhi vajza në shtëpi?

-Vazhdimin e di nëna, - u hodh vajza, - he, nëna!

-Vajza ishte vërtet përralla e bukur, si drita e hënës në majë të malit. atje ku i bën edhe gurët të luajnë nga vendi. Ajo ishte e urtë dhe të detyronte ta respektoje me mirësinë e saj, paçka se prindërit u mërziën pak që djali kishte vendosur të martohej me vajzën dhe, sidoqoftë, tani nuk do t'u qëndronte më edhe aq afër sa përpara, sepse do të rrinte shumë edhe me nusen. Ata qëndruan të mahnitur para vajzës, e puthën me radhë në ballë, e uruan të jetonte e lumtur në shtëpinë e tyre dhe menjëherë shtruan tryezën me të gjitha të mirat për festë...

-Akullore me bajame përsipër kishin bërë? - pyeti vajza.

Pleqtë u gëlltitën njëherësh.

-Patjetër! - tha gjyshja.

-Kishte ngrirë mirë apo vetëm anash? Të paktën, të mos jenë turpëruar!

Plakës iu var ngadalë një kokërr e madhe loti dhe iu rrukullis si ortek nëpër mollëza e nuk iu prish, derisa e priti me gjuhë, po vajza nuk vuri re gjë, sepse që e përpirë nga përralla dhe nuk i ngrinte sytë lart.

-Akullorja kishte ngrirë, por edhe sikur të ishte pak qull mes, nuk do të turpëroheshin, se turpi vjen atje ku ka njerëz që venë re, kurse ajo ishte kaq e edukuar dhe e sjellshme, sa bënte sikur nuk i shikonte gabimet e vogla që i hasim përditë... Ata u kënaqën atë natë, pastaj e bënë shprehi që ta hanin darkën gjithmonë bashkë e në fund të këndonin me kitarën, që i binte djali aq bukur, sa edhe zogjtë i vinte në gjumë...

-Edhe ne kemi një kitarë, - klithi vajza, - po nuk di t'i bjerë njeri!

-Do mësosh, ti! - i tha nëna duke u kapërdirë.

-Na lër rehat me gjithë kitarë! - u nxeh plaku. -Ajo nuk është për vajza, por për djem! Ke parë ti, Lira, vajza duke i rënë kitarës në televizor?

-Jo! - tha vajza duke ngritur supet. Duket s'e kishte me ndonjë qejf të madh mësimin e kitarës.

-... Dhe, kështu, derisa erdhi dita e martesës. Prindërit i bënë të gjitha përgatitjet, që festa të dilte sa më madhështore e t'i kënaqte të gjithë të ftuarit, mirëpo pikërisht atë kohë djali zuri shtratin dhe s'kishte fuqi të ngrihej. Iu mblodhën të gjithë te koka, prindërit, nusja, mjekët, shokët; sollën ilaçe nga e gjithë bota, po djalin nuk e shëruan dot. Në një agim ai i mbylli sytë përfundimisht dhe nuk i hapi dot më. Të gjithë qanë me të madhe, por më shumë nga të gjithë e vuri kujen

nusja. Asaj i erdhi keq që i vdiq i dashuri i zemrës, por i erdhi keq edhe për dy pleqtë që ngelën fillikat pa njeri në këtë botë...

-Nëna, mua më vjen për të qarë, - tha vajza dhe qau vërtet, kur dalloi përlotjen e gjyshit.

-Aq më mirë, - tha gjyshja, - ty të ka nëna njeri e jo dru, të dhemb edhe për gurin e jo më për njeriun. Gjithmonë të të vijë keq për njeriun fatkeq, se vetëm kështu e detyron veten ta ndihmosh pastaj e t'ia lehtësosh mjerimin e madh... Po prit, se ka edhe më!

-U ngjall? - thirri vajza. - Hë, nëna, u ngjall?

Gjyshja psherëtiu.

-Jo, - tha ngadalë, - ama, vajza nuk iku mbasi e varrosën djalin. Një natë, si qe zbrazur shtëpia nga njerëzit që vinin vazhdimisht për të ngushëlluar dy pleqtë e vetmuar, ajo iu lut me zë të dridhur ta bënë bijën e tyre e ta mbanin në shtëpi, se deshte të jetonte me ata. Pleqtë qanë nga gëzimi. Ata menjëherë ua kërkuan nusen prindërve të saj dhe iu betuan se do e mbanin më mirë se djali i tyre, në pëllëmbë të dorës e në majë të kokës do ta mbanin, dhe u bënë me krahë kur edhe prindërit e vajzës iu thanë: që sot e tutje vajza është juaja! Qofshi gjithmonë të gëzuar bashkë...

-Paskan qenë të gjithë njerëz të mirë, - i shkëlqyen sytë Lirës, - qenka alamet përralle!

Dhe u përqëndrua në kulm ta mbante mend deri në hollësitë më të vogla. Do të linte nam atje në klasën e parë!

-Dy pleqve filloi t'iu largohet mërzia. Ata vërtet shkonin dhe qanin në varreza, ama në shtëpi qeshnin e loznin me vajzën, e vishnin bukur dhe e detyronin gjithmonë të dilte e të mos mbyllej si kukudh, mes katër mureve të shtëpisë. Dhe vajza s'ua prishte. Një mbrëmje edhe ajo erdhi me një djalë të bukur si div. Pleqve iu rrahu zemra. Ata e kuptuan që vajza do të martohej dhe do të mbeteshin përsëri vetëm, prandaj iu mbushën sytë me lot dhe zunë kokën me duar për hidhërimin e madh që iu ra. Plaku u përpoq ta ngushëllonte plakën dhe i tha se kjo ditë patjetër do të vinte një herë, sado të shtyhej, po plaka nuk i mbante dot në zap lotët. Atëherë u hodh vajza e iu tha, duke iu rënë në gjunjë: o prindër, po unë kam biseduar me mikun që më do dhe kemi rënë dakort të banojmë bashkë me ju, edhe në dy apartamente përballë, edhe në një shtëpi, si të jetë më mirë për ju! Ky djali është njeri me zemër të madhe, do ta shihni vetë, më i mirë se sa unë!... Qoftë edhe se gjysma jote, e uruan të çelur prindërit, dhe i përqaftuan të dy të dashurit. Doli e vërtetë fjala e vajzës, djali ishte njeri me zemër të mbushur plot e përplot me mirësi dhe pleqtë iu blatuan dy të rinjve një dasmë të tillë, që s'mbahej mend prej kohësh në atë vend. Ata kënduan e kërcyen për herë të parë nga dita e sëmundjes së djalit të tyre dhe u gëzuan edhe më shumë kur nga të martuarit lindi një fëmijë

i bukur topolak me flokë të verdhë...

-Jo të verdhë, - u hodh plakuri duke parë shkarazi vezullimin e flokëve të artë të mbesës, - të zinj ishin!

Plaka e vështroi me dhëmbshuri.

-Ç'rëndësi ka? - e pyeti butë.

Vajza ua kishte ngulur sytë dhe nuk ua ndante.

-Po pastaj? - pyeti gjithë duke i vështruar m'u në kokërr të syrit.

-Pleqtë vendosën ta mbanin si ujët e pakët fëmijën dhe ta edukonin sa më mirë. Ata e shëtisnin vajzën e vogël, luanin me të, iknin në det e në mal, i bënin lloj-lloj ëmbëlsirash dhe të gjithë ndjeheshin të lumtur, sepse asnjëri nuk ngeli vetëm, pasi ndodhi fatkeqësia. Ata edhe sot e kësaj dite jetojnë të gjithë bashkë dhe janë të lumtur, sepse njeriut vetmia nuk i fut asnjë gjemb në këmbë, kur është i rrethuar nga të dashurit...

Vajza nuk e kishte mendjen te moralizimet e fundit. Ahu, nëna kështu i mbyllte përrallat gjithmonë. Diku tjetër i bridhte mendimi asaj krijese të brishtë me sy të zgjuar e vetëtitës.

-Po tani ku janë ata... gjyshërit, - u gëlltit, - me vajzën e bukur me flokë të verdhë...

-Kush e di! - tha gjyshi, - Përrallat jetojnë shumë, qindra mijëra vjet, prandaj edhe nuk dihen hollësisht se si e ka emrin njeriu apo ku gjendet ai tani...

-Po Lira kot pyeti, - ndërhyri nëna, duke i shkelur tinëz syrin plakut. - Ajo pyeti vetëm se i pëlqeu përralla! Apo jo, zemra?

-Ehë! - pohoi vajza.

Natën, kur gjyshi me gjyshen po pëshpërisnin buzë detit se tani nuk kishte më asnjë kuptim t'ia fshihnin të vërtetën vajzës së tyre të mrekullueshme, atë të ëndërr varrin e xhaxhi Kolit dhe mamën, duke qarë mbi varr, babin që rrinte larg, që përkëdhelnin mermerin e bardhë e që iu hidhnin ujë me grushte trëndafilave mbi petale e gjethe. Pastaj pa atë vajzën e vogël të përrallës dhe, megjithëse gjyshi ia bëri flokët e zeza, prapëseprapë ishte krejt si ajo. Pa tërë ato gjëra dhe nga ajo ditë s'ishte e vështirë ta kuptoje se qe rritur krejt befás, urtësuar e shtruar ajo vajzë që e ndiqnin deri dje nëpër plazhin e madh me bukë në dorë, duke iu lutur të hante. Dhe as kërkoi më t'ia përsëritnin përrallën e asaj pasditeje e as i tregoi kujt për ëndrrën që e torturoi një natë të gjithë.

The neighbours

FQINJËT ✕

Në oborr mbretëron qetësia, ajo qetësi magjike e malit me pak erë e me një fëshfëritje të vazhdueshme gjethesh. Kumbulla e gjymtuar në njërën kurorë dhe pema tjetër matanë gardhit gjithë aq e masakruar, pikërisht për të mos lejuar përqaftimin e degëve të dy trungjeve mbi gardh, të ndjell trishtim, një trishtim që t'i pret duart dhe të sjell vërdallë një të qarë vënçe, po s'është e thënë që Aleksandra të rrufisë lotët aty, pas dritares. Ja, tek kaloi atë gardh të shtrembër Lesi, qeni i saj i dashur, dhe ajo hap vrik dritaren gjysmë metri mbi oborr, flokët e thinjur i kthehen në krifë luaneshe dhe ulërin:

- Lesi, hajde orxhent këtej, se andej të ha murtaja!

Andej, matanë gardhit të quajtur nga të dy palët "klon", vjen një përgjigje e vendosur burrërore:

- Të hëngërt murtaja ty, pulat, qenin, macet dhe minjtë!

Ka dalë Sofoku në oborr, më i lashti i fshatit, bashkë me fqinjën e tij armike, Aleksandrën, dhe s'ka as më të voglën dëshirë të tërhiqet me kaq. Dy vejanët përballen me mëngjesin e mrekullueshëm në mes dhe gardhin e tyre të sofistikuar, të aftë të sinjalizojë çdo shkelje dypalëshe.

- S'passe ngordhur akoma?- pyet Aleksandra me duart të vendosura në brez dhe një ndjellje të vazhdueshme hundësh. -Çudi, se qelbej tërë fshati erë kërmë!

- Je, ti, kërmë, - ia kthen Sofoku, - që nuk je larë nga shën Gjergji i kaluar, kur kujtove se do të thyeje qafën, po ku të merr mortja ty!

- Plaç! - ia plas m'u në sy Aleksandra.

Kthehet të ikë e të mos harxhojë më frymë me këtë plak matuf, mirëpo kujtesa diç i vë përpara dhe xhindoset më keq nga ç'është.

- Dhe, o bëji zap ato pulat e harbuara, o do t'ua këpus kokën një nga një në sytë tënd! - i hakërrohet Sofokut, duke u kthyer drejt klonit. - S'do pastroj unë të dhjerat e tyre çdo mëngjes, more vesh, gërxfhua i djallit, apo je shurdhuar!

Atje, mbi klonin e punuar shkrifët, në anën e Aleksandrës, duken qartë dy glasa pule. Janë të përhimë dhe Sofoku heq gjyslyket me bisht llastiku vendosmërisht.

- Këtu mund të kesh dhjerë ti, po pulat e mia s'kanë fekale kaq të shëmtuara!

Dhe kthehet pas duke fshehur me zor buzëqeshjen e triumfit. Hyn brenda në shtëpinë e madhe e të errët, që mban erë mollë, dhe vendos të bëjë një kafe jashtë radhe. Më shumë nga çdo gjë e lumturon ajo ulërimë e vazhdueshme e Aleksandrës në gardh, që mallkon tërë shenjtorët për sklerozën e tyre.

- Si e kenë harruar këtë kërmë?! - pyet e çuditur qiellin ajo.

Po nuk i përgjigjet askush. Vetëm ca zile mushkash që kalojnë lart, në rrugën mbi shtëpinë, dhe fishkëllimat e lopçarëve s'mund të quhen zëra hyjnorë. Kaq duhet për të rënë sërish heshtja, ajo heshtje magjike me fëshfëritjen e vazhdueshme të fletëve, që krijojnë ndjesinë sikur dikush po të tund plot ëmbëlsi në djep.

Aleksandrës i kujtohet fëmijëria e saj në Amerikë, prindërit, gjyshërit, kthimi, ky Sofoku i ri e i fortë e moskokëçarës përtej gardhit, pastaj martesa e saj dhe e mëvonshmja, ohu, nja dhjetë vjet më pas, e Sofokut, kur ajo e mbylli lindjen e fëmijëve. I kujtohen pastaj fëmijët e saj me nipër, mbesa e stërnipër atje në Tiranë dhe trishtohet keqas. Shtrihet në shpinë në shtratin e drunjtë me dyshek kashte dhe i lidh duart pas zverkut si vajzë e re. Nga dantella e dritares duket pak kumbull e pak qiell blu, por ajo s'sheh asgjë. Pak përlotja, pak perdja e syve pleqërorë, dhe gjithçka humbet në turbullirë. Ç'është kjo jetë e menderosur, pyet hapësirën ajo, pastaj ndien se si i shtrihet Lesi te këmbët, ngrohet nga gëzofi i kafshës dhe fle. Fle duke parë ëndrra të çuditshme. E bija është gjyshe, kurse ajo foshnjë motake në duart e saj. Pastaj i shfaqet Fan Nolit, atje, në kishën e Bostonit, mjekrosh e ironik, me duar të nderura mbi kokën e saj, pastaj, pastaj i përballet Sofoku i ri, i madh se një ka, që se si i qesh ashtu, dhe ajo zgjohet e trembur. Po kjo e keqe, pyet veten. Ç'do ai i mallkuar në ëndrrat e mia, që i prefsha ditët ditënxirit. Dalëngadalë i ikën mjegulla nga sytë. Dëgjon zëra nga oborri tjetër dhe kthjellohet. Më është shtruar e po pi me atë turkun e mallkuar, skërmitet, po hajt, se ta shpie unë rakinë pas zverkut, hakërrohet. Një minutë më pas është në oborr, me fshesë në dorë, ama bie erë një orë larg se ajo më shumë se një pastruese nikoqire, ngjan më shumë me një mareshal të etur për luftë. Andej, matanë, provokacioni është shqeto fare. Është shtruar tavolina e vogël, që e sollë në pajë e ndjera e lugatit, është vënë pak gjizë, pak mëlçiçka dhe shishja e rakisë. Shto dhe

që turku e pyet Aleksandrën buzagaz:

- Aleksandra, si je gdhirë sot?

- S'kam qenë ndonjëherë ligisht, - ia kthen ajo, - do rroj dhe ca motë, sa të përcjell ca këрма si ju pijanikët e djallit!

Sofoku ngre gotën e rakisë, e përplas me mikun, pastaj e këshillon tjetrin në intimitet me sa zë ka në kokë:

- Ç' i kall datën! Mos i fol! Ku do njeri ajo! Ajo vetëm me qentë dhe pulat shkon përbukuri, edhe me ato jo se i do, po se nuk i kthejnë llaf!

O, zot i madh, ç'rrufe nisin nga oborri matanë! Fshesa tundet në ajër si një re e verdhë plot pluhur Afrike, flokët e bardhë valëvitën majtas-djathtas, rrëketë e mallkimeve arrijnë derisa ta kthejnë rakinë në ujë.

Turku mërzitet që pranoi ta pijë rakinë në oborr. Të qenë brenda në shtëpi, edhe veshët do t'i binin rehat, edhe mendjen do ta turbullonin një çikë. Kurse tani! Në vend të shërohesh nga uji i bekuar e të harrosh zullumet e kësaj bote, sëmuresh më keq. Po Sofoku s'prish qejf. Ai duron me heroizëm ligjëratat kriminale e kanibaleske, pastaj, me t'iu marrë fryma Aleksandrës e me të kuptuar se ajo kërkon patjetër të mbushet me ajër, kruan zërin e thërret si hoxha majë minares:

- Dhe ia venë fajin tufëzimit, kur pyesin pse nuk pëllasin më gomerët në fshat, o Hysen djali! Ç'punë ka, i ziu tufëzim këtu?! Nuk pëllasin me gomerët në fshat, se grindet e ulërin tërë ditën kjo marroqe me anëtarët e kooperativës dhe s'iu lë radhë gomerëve të lëshojnë zërin! Hajt, bromb- i jep fund ligjëratës Sofoku duke ftuar turkun të pijë, me të parë që Aleksandra e ka marrë veten, - do ta pi edhe këtë kupë, se rakia bën mirë për sytë!

- Ah, u qorrofsh! - mallkon që andej Aleksandra me zë të zbutur befas, - Pijaniku i djallit, saharosh, që do të vdesësh pa ditur njeri ç'ke, se ku të bëhen analizat ty, mor gërxo, që edhe gjakun, edhe shurrën i ke raki të zjerë dy herë!...

Kaq flet Aleksandra dhe hyn brenda në shtëpi. Grindet edhe atje brenda, por muret, dritaret dhe dyert e mbyllura mirë ua marrin kuptimin fjalëve.

Në oborr mbretëron përsëri ajo paqe e mrekullueshme, ajo qetësi mali dhe Hysenit tani i pihet raki me qejf, por Sofoku përmbys kupën e tij. Nuk i pihet më.

- Ik, - e urdhëron tjetrin, - merre rakinë me vete, unë s'dua më!

Hyseni ia njeht huqet plakut sherrxhi dhe s'ngul këmbë si mushka. E le rakinë mbi tavolinë, i thotë plakut se ia ka falur ta bëjë ponç në darkë, pastaj falet me pëllëmbën e madhe prej bujku të hapur mbi zemër dhe ngrihet e shkon.

Plaku se ç'ka. Edhe i flihet, edhe s'i flihet. Edhe i pihet, edhe i vjen ta thyej shishen. Ndjehet bosh, i zbrazur, fare i zbrazur, si oborri i vogël pa lule, si rrugina e shkretë pa njerëz, si ky fshat i braktisur me dhjetë pleq gjithë-gjithë, që vdisnin pa njeri te koka e i gjenin të vdekur pas kushedi sa ditësh, kur edhe muret

mbanin erë kërmë. Dhe për herë të parë Sofoku mendoi se kjo shtëpi pas shpine dhe ky fshat kishin qenë arkivoli i tij. Pështyn me neveri mbi pllloçat mbuluar me myshk e bar rrëshqitës dhe ngrihet të fusë tavolinën brenda. E mbërtheu atë send të vogël e të lehtë pupël me dy panxhat e tij të hekurta që as donin t'ia dinin për galopin e moshës, po atë çast rrëshqiti në myshqe dhe ra përmbys me gjithë tavolinë. Krisën pjatat e mezeve me gjithë shishe dhe Sofoku, gjëja e parë që mendoi, ishte dëmi material. Dy pjata, një shishe, 17 lekë, mërmëroi. Atë çast pa Aleksandrën të nderur mbi gardh. Skifter të qe, do vonohej pak, mendoi Sofoku i turbulluar nga turpi i çburrërimit.

- U vrave, o ditëzi? - pyeti plaka me zë të dhembshur. - U vrave, po ç'u bëre? - shtoi pastaj gjithnjë pa ia ndarë ato sytë e saj kaltëroshë.

- U kënaqe? - iu hakërrua ai, duke rënkuar në atë të ngritur të zorshme më këmbë.

U panë një çast sy ndër sy, pastaj Aleksandra se si psherëtiu. I ra me shkelm një pule që po përpiqej të kalonte klonin dhe foli pikëllueshëm:

- Rrëshqite në myshk, o i zi! Ku ma gjen plumbin para myshkut, se plumbi të merr pa vuajtje, kurse myshku të 4e sakat. Sikur të qemë martuar bashkë atëherë, pllakat do të qenë të paqta, sa të derdhje vajin e ta mblidhje. Po ti...

S'foli më, u kthye menjëherë dhe ia mbathi ashtu, çalë-çalë, drejt shtëpisë. Nuk donte t'ia shihte tjetrit përlojtjen, atë përlojtje që, për dreq, i turbullonte gjithçka dhe e bënte çupëlinë.

BUBURRECI

Duhet të ishte ora rreth pesë e gjysmë e mëngjesit, kur kërciti e ulëriu bashkë zilja e orës dhe Fredit gjëja e parë që i vetëtiu në mendje, pas asaj ëndrrës së ndërprerë brutalisht në mes, ku ai, gjysmë i zhveshur bashkë me Linën, bënin ushtrime fiskulturore te këmbët e shtratit matrimonial, ishte absurditeti i këtij emisionit të fiskulturës së mëngjesit në radio. Nga kush e di ç' megafon jashtë në rrugë jepeshin ca urdhëra prej idioti, një-dy, një-dy, shtrihe krahun, një - dy, në një kohë kur njerëzit s'kishin hapur akoma sytë e jo më t'i kishin larë. Ai zë monoton ia kishte prishur edhe atë pak lumturi të lakmueshme prej kohësh, atë lumturi ëndrre, ku mund të bëheshin realitet dëshirat e zjarra e munduese, pasionet e burgosura përmes frëngjive të brinjëve... Ishin zhveshur ngadalë me Linën, duke parë njëri-tjetrin drejt e në bebëzat e syrit, ishin zbërthyer me duar të dridhura nga shpërthimi i dashurive të ndrydhura, ia kishte parë fare qartë gjinjtë e fortë me thithat e ngritura lart, supin e bukur dhe qenë zgjatur ngadalë drejt njëri-tjetrit, si dy re të bardha në qiell, kur befaz patën shtangur në vend, ashtu, monumentalë nga një zë kumbues e i akullt: me një kërcim hapni duart dhe këmbët anash!... Qenë bindur, bile asaj i qe ngatërruar fundi i zbërthyer nëpër kofshët e lëmuara e të mermerta dhe ai do të ishte vërsulur ta priste në krahë, që mos rrëzohej, po mos buçiste qartas urdhëri i dytë: Tani përkuluni dy herë, duke prekur shputat e këmbëve, dhe tërhiquni lart dy herë për t'u shtriquer! Qartë! Fillojmë! Një-dy, tre-katër!...

Kishte filluar fiskultura e mallkuar dhe Fredi e kishte humbur përsëri Linën, atë engjëll brun, me buzët mishtore dhe vështrimin e zjarrtë prej femre, ecjen nazike dhe pafuqinë morale për t'i kundërshtuar preraz miklimet e tij.

U ngrit duke gogësitur, dhe i hodhi një vështrim brinjës së shoqes. Flinte

me gojën e hapur paksa, me buzët e zbardhura si me krem paste, e shëmtuar dhe e ftohtë dhe Fredi psherëtiu dhe u xhindos më keq akoma, kur mendoi se Linën ia përzuri një zë i mallkuar që ia prishte gjumin të tjerëve, kurse për vete flinte e gërhiste si derr!... Legeni, shau, është incizuar një herë para njëzet vjetëve dhe tani e hamë ne!... Në koridor e prisnin shishet e qumështit të futura në vjetëve dhe lekët mbi to. Kaq duhej që Fredi të tërbohej plotësisht. Ia kishte lënë në rrjetë dhe e shoqja, që ai mos t'ia prishte gjumin zonjës, ta linte të shihte ëndrrat deri në fund...

Ta tregoj unë fundin ty, u ckërmit dhe nisi t'i përplaste shishet, duke lëvizur kaotikisht rrjetën. U krijua një zhurmë e mrekullueshme, aq sa e shoqja brofi ndenjuri në shtrat me atë kurorë mbretërore bigutinash në ato flokët e saj me një ngjyrë aq të poshtër, sa as koloristi më i mirë nuk do të mund t'ua përcaktonte nuancën, i druajtur mos ofendonte ngjyrat e pafajshme.

- Theve gjë? - pyeti e alarmuar.

- Për pak, - ia ktheu Fredi shpërfillshëm.

- Si nuk bëre një punë tamam, - tha ajo dhe ia këputi gjumit përsëri, e pa nerva, a thua nëpër trup i shtriheshin spango e jo nerva. Kurse Lina, ishte e bindur si buka që hante, do t'i zgjaste atë krahët e zeshkët drejt tij dhe do t'i pëshpëriste ndjellëse:

- Fredi, s'ka gjë! Lëre atë drej qumështi! Eja këtu!...

O zot, ç'më bëre risk, turfulloi Fredi, duke përplasur derën e duke e kyçur me sa më tepër zhurmë që mund të përmbante ky veprim. ku shkove zgjidhe letrën me vrimë mes mijëra të tjerave pa vrimë?... E çmendte kjo grua, ia shkatërronte nervat, e hante pak e nga pak si ndryshku hekurin, kurse ai duronte...

Turfullonte, ndërkohë që dama flinte, e qetë, e patrazuar, e pa brejtur. Tek hynte në shtëpi i ngarkuar me qumësht e i nervozuar me gjithçka, iu kujtua ajo thënia e grarisë: "Keq me burrë, keq pa burrë, keq e pamartuar kurrë!". Hajde e jepi dum kësaj pune, tha me vete i zbutur diçka. Kush ia pati thënë këtë fjali? Ah, po, Vera, pastruesja e institutit. Ajo grua 50-vjeçare, e mbajtur ende, trupngjeshur e mishfortë, si vajzë kasapi, e kishte gjetur një herë, duke iu mikluar Linës në zyrë. Asaj nuk ia hidhje dot. Kishte përvojë të gjatë vetjake në këto kokë - më - kokët dhe atë ditë ua tha fjalinë. Fredit i qe shkrepur ta gërrmonte pak.

- A fle më mirë me burrin? - e kishte pyetur.

Vera e pat lënë fshesën e pluhurave në mes.

- As me burrin e as me të tjerët, - i qe përgjigjur, - U plaka tani. Qejfi do edhe barkun plot. Unë s'kam më oreks...

- Po përpara ke ngrënë? - e pyeti Lina çuditërisht me atë dinakërinë e saj femërore.

- Dy herë në ditë, - ia ktheu shpengueshëm Vera, - kur më hahej... Po kjo punë është e ngatërruar, kur e ke, s'të hahej, kur s'e ke, aty të rri mendja...

- Je penduar për ndonjë gjë?- e kishte pyetur Fredi.

Pati marrë një vështrim të përhumbur nga Vera, pastaj një tundje koke.

- Atë plaçkën dheu do ta tresë! Ç'ta ruash kot? T'ia falësh engjëjve? E ku ka engjëj? Të kishte një engjëll andej, do ringjallej një vajzë gjithë këto mijëra vjet!

- Pse?-qe hedhur Lina e habitur nga filozofia e tjetrës.

- Po do binte engjëlli një herë në dashuri dhe dashnori ç'nuk bën për të dashurën! Ç't'i kërkosh, ta jep! Ajo do t'i përkëdhelej "më ngjall" dhe ai gomari do ta ngjallte! E thjeshtë fare! Mua një oficer më ka falur revolen, vetëm t'i shkoja një natë në shtëpi! Alamet revoleje, me gjithë këllëf, fishekë e karikatorë!...

Kështu kishte thënë Vera atëherë dhe nënteksti qe i kthjellët fare: ty, Lina, në ta ka qejfi, mos u mendo shumë!..." Por Lina po mendohej pak si shumë dhe Fredi bënte gjimastikë në gjumë, si të ishte hipotent!

Uji i të rruajturit kishte zier ndërkohë dhe ai, teksa u fiksua me gjithë veglat e rrojes para pasqyrës, i kapi syri bri qelqit të ndritur një kafshëzë sa një kokërr orizi, një buburrec të kaftë, të vockël e të dalë nga kush e di ç'skutë e parabanjës. U ul, ngriti shapkën dhe u mat ta vriste, por u pendua në çast... Ky askujt nuk i bën keq, mendoi, kushedi për ku është nisur e ç'ëndrra sheh!... E uli shapkën përsëri në dysheme dhe mendoi turbull se as Lina nuk do ta vriste kafshëzën e pambrojtur dhe as një njeri i vërtetë gjithashtu nuk do ta vriste, por do të thoshte me një arsytim të denjë për intelektin njerëzor: kjo keq nuk bën, pas ca orësh apo ditësh, do vdesë nga natyra, pse u dashka ta vras unë?... Dhe as Fredi nuk e vrau.

U rruajt, pastaj ia liroi vendin së shoqes, që u ngrit para pasqyrës me ato pudrat, kremrat e tonet e saj që formonin maskën iluzore të femrës së bukur, por që atij ia neveritnin më shumë atë çalashë që më kot përpiqej të ecte në rrugë drejt, dhe u ul në kuzhinë të pinte kafe. Në radio kishin mbaruar me kohë e me vakt ato budallallëqet "një-dy" e "shtrije krahun" dhe po lexohej një reportazh i mërzitshëm për njerëzit e Mokrës, reportazh me shifra dhe pa njerëz, që s'merrej vesh për ç'kategori lexuesish ishte shkruar. Atëkohë, kur folësi, i mërzitur për vete nga reportazhi i mërzitshëm po lexonte me zë monoton një paragraf ku flitej për plakun 92 vjeç Niko Gulbi që paskësh futur 923 ditë pune në vit në kooperativë, gruaja e thirri nga parabanja:

- Fredi, vjen pak?

Ai u ngrit duke rruadur buzët dhe mori për andej, duke thënë me vete se do të qe divorcuar me kohë nga kjo pseudogrua, sikur mos të ishin në mes fëmijët, por i harroi të gjitha hakërrimet me të parë bri pasqyrës një njollë të vockël kafe në të kuqe në mur... E paska vrarë buburrecin!- tha me vete.

- Pse e vrave buburrecin?- e pyeti gruan, pa i lënë kohë asaj të shpjegohej pse e kishte thirrur në parabanjë.

Asaj i shkëlqyen vetëtimthi sytë, si copërat e detit natën të ndriçuara kalimthi nga prozhektorët e mëdhenj të kufirit. Asnjë nevojë nuk kishte për Fredin, e thirri vetëm ta shihte atë buburrecin, që iu dhimbs ta vriste, me zorrët jashtë atje në mur. E kishte parë burrin e saj të mërzhitur nga martesja e pafat, që nuk çante kokën për gruan e tij dhe jetën e saj, të përkujdesej për një buburrec të pështirë. Merre tani buburrecin, o engjëll mbrojtës!

- Si, pse e vrava?- pyeti me një zë të butë, të huazuar nga ato bashkëshortet e shtruara e antisherr, që e mbajnë kokën ulur mbi gjoks si qëmoti. - Po është turp një herë që të jetë apartamenti me buburrecë, mos themi pastaj që të vijnë zorrët në gojë kur i sheh...

Fredi i hodhi një vështrim të tërbuar, u kthye, veshi këpucët njëherësh me xhaketën dhe doli duke përplasur si i marrë derën... Kjo grua- bishë duhet ndarë urgjentisht, tha me vete duke çarë si i marrë në rrugë. Ç' i bëri ai buburrec, s' e marr vesh!... Dhe sa më shumë turfullonte, aq më tepër po i kristalizohet mendimi se nuk do përbënte ndonjë çudi sikur ajo kriminele ta therrte ndonjë natë në gjumë si berr... Lina, thirri nga shpirti ai, o zot, u lut, pse s' më martove me një njeri, me Linën, për shembull.

E gjeti Linën duke hapur dritaren, për të ajruar zyrën.

- Pse je shtrembëruar kështu?- e pyeti ajo dhe ai u përkëdhel në sedër. Ajo s' do ta konstatohte këtë prishje të gjendjes shpirtërore, kurse Lina, ajo që s' bashkëjetonte me të, por vetëm bashkëpunonte ca orë në ditë, e nuhati menjëherë mërzhinë. Dashuria... Dhe, për herë të parë, ia shau Linës gruan, duke i folur gati me ngashërim për vrasjen e buburrecit. Mrekullia e tij e zeshkët buzëqeshi ëmbël:

- Ama, Fredi, mjaft, se po më përzihet! Nuk ka mëshirë për buburrecat!

Ai mbeti gojëhapur, si Cezari i hershëm me kamën e Brutit në trup, dhe u bë gati të artikulonte diçka, mirëpo, atë çast, nëpër dritaren e hapur, erdhi që nga oborri i gjimnazit dy kilometra më tej, zëri diktatorial i një mësuesi fiskulture:

- Duart lart! Tani çohuni në majë të gishtave dhe zgjatuni sikur do kapni diçka të mrekullueshme!...

Edhe Fredi i ngriti në mënyrë të pavullnetshme duart lart dhe u zgjat në majë të gishtave. Lina, diçka e mrekullueshme, ëndrra... S' e kapi dot! Uli krahët krejtësisht i raskapitur dhe u këput në kolltukun e tavolinës së tij të punës, duke thënë me vete mjerisht: po unë nuk dua të bëj fiskulturë! Më pëlqen të shoh ëndrra! Atje i kam të gjitha që dua. Nuk dua të bëj fiskulturë. Pse më zgjoni me zor... Ç' duhen megafonët... Unë dua të fle, të shoh ëndrra! Atje..."

Kurse gruaja krihej në apartament, duke kënduar një këngë popullore. S' kam për ta lyer sivjet parabanjën, mendoi e lumtur sa s' ka më, ta shoh buburrecin e vrarë sa të hapë sytë, çdo ditë, ai zotnia i pakënaqur që na paska qejf të jetojë...

1987

ANKTHI

Merrej vesh që nervat i kishte në majë të kokës, derisa, me të hyrë në shtëpi, në atë shtëpi të vetmuar e të pluhrosur, shkoi e u shtri menjëherë në shtratin e shprishur me një portret të stërmadh fshatareje cicëlopë te koka. Mandi pati kaluar vërtet një ditë të keqe. Po i mërzitej në atë farë feje puna në spitalin pisanjos, që kishte mbetur siç kishte qenë, një ish-kazermë e ushtarëve italianë në Luftën e Dytë Botërore, jo luftuese mikrobesh, por difuzuese mikrobesh, sa ishte gati ta flakërinte bluzën e bardhë, si flamur kapitullimi, duke i braktisur me gjithë qejf, pa harruar edhe studimet universitare në Tiranë, edhe ato pasuniversitare në Paris, pa përjashtuar edhe një të dhjerë tamam mbi Betimin e Mjekut! Po ç't'iu bënte fëmijëve ...

I paxhveshur, i shtrirë në shtrat, me duart të lidhura mbas trurit të vogël, mbas asaj pjese të marrë të kokës, që bënte thirrje të vazhdueshme për drejtpeshim, ai ia kishte ngulur sytë tavanit. Mbushte plot 40 vjeç në 1 gusht të vitit 1982. I duheshin, pra, edhe tre muaj e 13 ditë të bëhej burrë i pjekur. Gjithë me sytë në tavanin e bardhë, ai filloi të shohë sekuenca nga jeta e tij...Ja, në bangat e shkollës, duke kopjuar në provimin e maturës hartimin, që ia shkruajti Beni....Si ishte tema? Ah, po, ç'ndjen kur lexon për jetën e një heroit partizan...Më vjen për të qarë që nuk jetoja atëherë, ta jepja edhe unë jetën time për Atdheun, kishte shkruajtur Beni...Tallej, siç tallej kur i përgjigjej mësueses së historisë se kryqëzatat mesjetare patën qarin që sollën në Evropë kikirikun dhe kajsinë... Beni kishte vrarë veten më pas, bash atë kohë kur u bë shkrimtar i madh. Thanë se nuk shkonte mirë me gruan, por ai e dinte se të gjithë miqtë e ngushtë të Benit përfunduan në burg me akuzën "Agjitacion e propogandë"...Ja edhe në Fakultet! Kundrimi i kufomës së parë në morg, pastaj një muaj pa vënë mish në gojë...Një kufomë fenomenale. Një djalë i ri, muskuloz, fizik gjigand, me një vrimë të vockël plumbi

mbas koke, që pastaj do të masakrohej barbarisht nga thikat profane të studentëve të zverdhur, aq sa s'do merrej vesh në fund se ku do të përfundonin organet. ku mishit e ku skeleti i atij trupi të krijuar aq mrekullisht nga natyra...Po kjo?... Vetëm Ana mund të pyeste kaq pafajësisht...Dhe Xhimi: Ka qenë i tepërt, si duket. E si mund të jetojë një kolos mes shkurtabiqëve?

...Xhimi vdiq nga leucemia. Vdiq i pa martuar, gjysma e të keqes...Kurse Ana, ah, po, ajo ishte që atëherë e vdekur. Bëri një gabim të "vockël" kur u martua, gabim që pritej prej saj: mori djalin e një të pushkatuari pas Konferencës së 1954-trës...E pse ta ndaj? Unë e dashuroj! Pastaj si ka thënë Stalini? Fëmija nuk përgjigjet për prindërin...Ashtu, ëëë? Mirë, ik vajzë! Ne të dolëm borxhit...Ja edhe dita e parë e punës...Hajde, siguri prej idioti, hajde!...Kura e parë, komplet gabim. Mirë që pacienti ishte kanceroz, me ditë të pakta. Po anatomopatologu? C'burrë palaço ishte!...Normal je, je ti, gomar? Me këto ilaçe kurohet një kanceroz...Dhe ai si guak: Më fal! Nuk do të ndodhë më!...E qartë që nuk do të ndodhë, se nuk kam ndërmend ta var veten me bluzën time!...Ja dhe profesor Hoti!...Hajde, miku im!...Leksionet e famshme në kafe, në rrugë, darkave, mbi mënyrat më efektive të diagnostikimit, kur të mungojnë laboratorët dhe pajisjet e domosdoshme...Ne jemi artizanë, miku im, veç botës, prandaj duhet të jemi gjenialë, të pagabueshëm që të ekzistojmë!...Ai ishte profesor gjigand! C'histori që tregonte! Gërshërë të harruara në barkun e pacientit, me garzat ndodhte rëndom, operacion dhe heqje veshke e njerëzve të lindur me një veshkë, i dhemb syri, krreja t'i shpëtojë tjetri! Adhamudh, dynjaja!...Si iu përgjigj atëherë ministrit, kur i bëri gjithë ato akuza të llahtarshme?... Puna ime zgjidhet edhe nesër, po, ti, ik shpejt në pavion, se ke botkin dhe do na infektosh të gjithëve!...Nga 20 metra larg e pa dhe e diagnostikoi! Komedia ishte kur ministri doli vërtet i sëmurë me botkin...Profesorin e kishin plasur brenda para dy viteve, pas një kalvari të vërtetë nëpër spitale provincash. Ai kishte mbaruar shkëlqyeshëm studimet në Moskë dhe, megjithë prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike, vazhdonin t'i vinin letra pune nga kolegët sovjetikë. 15 vjet i dha gjyqi profesorit...Del, s'del, del, s'del filloi ai monologun. Tani profesori ishte doktor burgu në Spaç dhe ai nuk guxonte, por, për të shpëtuar jetën e disa pacientëve të tij VIP, ishte e domosdoshme t'i çonte në Spaç te profesori...Zot, na ruaj, u tmerrua...Por iu kujtua Zoti dhe ja tek iu shfaq vetja si majmun majë këmbanores me qysqi në dorë në 1967. Pastaj romuzet e pleqve nga poshtë: Hap sytë, doktor, se mos na bie me gjithë këmbanë dhe s'ka kush na i shikon më zorrët e barkut pastaj...Pastaj Xhuli. Celebrimi. Mëcelebrim idiot, s'kishte! Me ca llokume të qelbura dhe dëshmitarë spiunë...Merrej vesh që nuk do të shkonte gjatë ajo martesë, ashtu siç e pagëzuan!...Plehrë!...Si ia bëri Genci, dëshmitari im i martesës, pra, kur ishte ngatërruar me Suzi infermieren? Atëherë për pak u nda me Xhulin. Dhe për çfarë? Për dy shfryrje seksuale në dhomën e mjekut roje, kur Xhuli ishte

në gravidancë të avancuar! Po pse, me dorë, në ato banjat e qelbura, do t'i binte ai? U bë xheloz ai quravec, prandaj llapi, ama, Suzi e mbrojtë. Cfarë alibije nxori ajo infermiere që dukej tra-a-la, zura një galë? Si e la Gencin? Si mut!...Po drejtori? Ja, dhe drejtori në zyrën e vet! Hajde, Mandi, hajde! Që ti ia ke futur asaj çupës, kjo merret vesh. Edhe që këtë herë ia hodhe, prapë ti e kupton. Por, po të kapa kur t'ia futësh ndonjë tjetre, dije mirë se do të ta fus ty, djalë, se mua shteti nuk më pagon si drejtor bordelloje, por si drejtor spitali!...Unë jam impotent, shef!...E qartë, tani që ia hodhe...Në fakt, ai drejtorit ia hodhi, por Xhuli i la tavën! Drejtori ia hapi gropën mirë, për së gjati e për së gjeri, kur e kapën herën e dytë me një paciente perri, që çdo tre muaj i shtrohej në pavion. I hapi një alamet grope estetike, që s'i gjeje dot një të metë, por ai ia futi. Atëkohë mbante gjallë një plak të Byrosë Politike, që hidhej në zjarr për Mandin, siç u hodh vërtet. Dhe Mandi jo vetëm nuk ia mbathi në prodhim, po i hypi avionit me një alamet burse për në Paris...Ja edhe Parisi! Ai me një Coca-Cola në dorë, me një kanaçe Coca-Cola në dorë, për herë të parë që shikonte dhe mbante një kanaçe Coca-Cola në dorë, pa ditur si ta hapte, me gozhdë, apo duke e përplasur për muri. Dhe profesori francez i pikëlluar: Hapet lehtë, djali im, ja!...Pastaj një lot i vogël në cepat e syve me bisht të profesorit...Ju keni mjekë të shkëlqyer, pra, duhet të keni një inteligjencie të shkëlqyer. Një popull që nxjerr mjekë brilantë është vetë margaritar! Unë kam lexuar një shkrimtar tuajin. Titan! Pse jeni kaq të izoluar, djali im? Do bëheni primitivë dhe mund t'iu dalë përsëri bishti...C't'i tregonte ai profesorit? Që me këto ljalë atje, në vendin e shqiptonjave, ku edhe shqiptonja e flamurit ishte me dy kokë, që të ruanin kokat e njëra-tjetrën nga ndonjë sulm tınzar synxjerrës, haje plumbin për këto filozofi?...Ja, edhe prishja me kinezët dhe Xhimi, që po i merre rrugët tashmë: Mbaj mend po nuk i pritën kalamajtë nesër me gazeta në maternitet, prandaj lindini kalamajtë që keni në plan, sa ka akoma edhe ca materiale rezervë nëpër depo...

Muri i sipërm ishte i bardhë, tepër i bardhë, dhe Mandi u tremb nga kuadrat e tjera që mund të projektoheshin atje. Kujtoi edhe një herë pacientin e Ilahtarshëm që po kuronte intensivisht, pastaj mbylli sytë dhe fjeti. Ndihej tepër i pafuqishëm.

L * * *

Mëngjesi e gjeti edhe më të dërrmuar. Mandi mendoi një mijë mënyra për t'i shpëtuar spitalit, por, edhe kur gjente shkakun më ideal për të mos u paraqitur në punë, ndjente se si do të trokiste dera aty nga ora tetë e mëngjesit, deri në thyerje. U ngrit duke mallkuar ditën që zgjodhi profesionin e mjekut, u rruajt, tha "Tregohu tolerant, o Zot! Të paktën merri gojën atij pacientit tim veteran!", mezi

gjeti çorapet dhe doli. Rruga deri në spital iu duk sikur po shkonte në varreza dhe nuk arriti as ta pijë deri në fund kafën më këmbë, kur ia behu me një frymë ajo infermierja e re me sy pakëz vëngëroshë e ca flokë të hatashëm.

VIP-i i tij ishte keq. Ata qenë bërë gati t'i dërgonin makinën në shtëpi...Mandi la kafën. Më dëgjoi Zoti më duket, belbëzoi me vete i lumtur, ama, tek dilte nga klubi i dha fytyrës një pamje aq të shqetësuar, sa edhe Lorenc Olivieri do ta kishte zili.

VIP-i vërtet s'ishte mirë. Kishte dhembje të forta mezi dhe s'deshte të shikonte njeri me sy, veç Mandit. Mandi u përpoq ta qetësonte, por për vete u shqetësua më keq. Fundi ishte akoma larg, çka do të thoshte se fundi i tij qe afër. Mandi i kërkoi gjysmë ore kohë VIP-it, sa të kryente një ekzaminim, dhe doli. S'kishte asnjë punë. Detyra e tij nga lart ishte vetëm të kujdesej për pacientin VIP, por ai deshte kohë të mendohej. Ndjehej vërtet i kapur në lak. Një ditë më parë, në atë gjendje gjysmë delirante nga dhembjet, plaku i kishte treguar në sy të infermieres së re se si e kishte vrarë Enver Hoxha Qemal Stafën...Mandi ishte trembur seriozisht. Ky hajvan, që edhe ca muaj jetë plot vuajtje kishte, e lëshonte gjulhën pa e vrarë mendjen se ata që e dëgjonin mund ta ngrysnin jetën në burg. Infermierja e re kishte kukuritur dhe i pat pëshpëritur në vesh, duke e ledhatuar me ato flokët e mrekullueshëm: Paska luajtur, i shkreti!...Unë si t'ia bëj që po luaj për vete, ia kishte kthyer ai, ky qenka kanibal! Gllabëroka jetë njerëzish...Mos po na provokon, qe trembur edhe bukuroshja...Atëherë Mandi ia pati plasur gazit. Për dhjeramanët e gjithë jeta dhe çdo shfaqje e saj është provokim...Por ishte penduar në çast për fjalët e lëshuara. Një Suzi kishte qenë besnike. Ku i dihej këtij zogut të vockël?...

Mandi shihte nga dritarja kopshtin e braktisur mes pavioneve, ato kaçube të rritura egërsisht, një mijë lloje barërash në një pëllëmbë vend, pislëqet hedhura nga pacientët prej dritareve dhe mendoi se edhe jeta e tij kështu ishte, e braktisur. Nuk e ndjeu infermierën kur hyri në dhomën e tij, vetëm prekja e lehtë e saj në sup e përmendi nga ëndrra e keqe. Edhe ajo kishte filluar të trembej. Në mëngjes VIP-i i kishte treguar se si i vriste Mehmet Shehu njerëzit në luftë, qe fashist, i pat vënë kapak plaku...Mirë Mehmeti, ai ka vrarë veten dhe është armik, tha Mandi, po si t'ia bëjmë kur ia fillon historive me heronjtë e lapidarët e gjallë?...Infermierja mblodhi buzët e plota, që të jepnin ndjesinë t'ia thithje e kafshoje njëherësh. Mbase ajo rrudhje buzësh e çoi Mandin te një lloj zgjidhje.

- Shiko,- tha ai,- me plakun nuk e kemi punën mirë. Të paktën le të grijë vetëm me ne! 24 orë në 24 orë nuk do të lejohet të futet asnjëri në dhomën e tij, as familjarët! Ai do vdesë, por deri sa të ndodhë kjo, edhe ti, edhe unë, do të flemë në pavion! Më mirë durojmë një muaj, sesa të ikim për dhjamë idioti. Ti, shtoi pastaj si shpërfillshëm, sa për t'a trembur pak tjetrën që ta qepte gojën, se unë kam emër, tituj e miq...

Ai u kthye në dhomën e plakut, vuri një letër në derë, që ndalonte kategorikisht hyrjen në dhomën e pacientit, hodhi në kartelë dyshimet për një infeksion tmerrfütës dhe u ul buzë shtratit. Tjetri flinte, gojëhapur, duke gërrhitur lehtë. E kishin bombarduar me qetësues dhe dhembje nuk do të kishte më, ama, gojën hapur e mbante dhe në gjumë. Mandit iu kujtua gjyshi i tij. Ja, kështu kishte ikur dhe ai plak i pafjalë, duke gërrhitur lehtë...Kur kishte vdekur gjyshi? Ai ishte 12 vjeç, domethënë më 1954-trën, po, atë vit kur pushkatuan një fqinjën e tyre dhe e zhdukën familjen në internim...Atij i erdhën në mendje ato vite, vajzat e lezetshme me gërsheta të holla të atij fakirit, që tani kush e di në ç'baltra qenë plakur, natyrisht, po të kishin fatin që të qenë gjallë e jashtë, pajtonet në rrugë, Pazarin e Vjetër plot me dyqane, qebaptoret gjithë tym...Iu kujtua kur filloi pastrimi i Parkut të Madh, mbrëmjet i gozhduar pranë radios shkatarrake ruse duke pritur fillimin e përrallës, pastaj vdekja e babait dhe varrimi i tij madhështor, rimartesa e nënës, njerku mizor, profecitë e çuditshme të njerkut, që shihte gjithë çdo të ndodhte nesër në tymin e cigares, bile edhe largimin e tij nga shtëpia, dhe strehimin e tij te gjyshja, pa harruar edhe parashikimin perspektiv, se martesja e Mandit do të ishte një lidhje me hanxhar mbi kokë... Oborri i madh i shtëpisë së gjyshes, gjithë kafshët e këtij vendi të mbledhura në këtë oborr dhe byreku me hithra...Femra e parë në atë shtëpi, kur ai sapo kishte mbaruar gjimnazin, ajo Meremja bullafiqe, që vetëm qeshte dhe që na doli se e dinte mirë si bëhej ajo punë...Prit, ja, fute këtu!...

Plaku gërrhiste. Kështu, mes gërrhimave të një sekretareje plakë të Gjykatës ishte ndarë edhe ai...Imoral!...E ç'kishte të keqe kjo fjalë? MORAL plus një i të qelbur! Dhe gjithë ai sherr e ajo thashethemmal absurde!...I kishte humbur të gjitha prej asaj pacientes bukuroshe epshamane, që kishte frikë ta prekje me dorë, se zgjonte gjithë pavionin me britmat hysterike. Llahtarë ishte! Nisej për të bërë atë punë në dhomën e mjekut të rojes dhe fillonte të xhvishej që në koridorin e pavionit e që puna më e vështirë ishte t'ia gjeje këpucët në fund...Gjithë jetën pa fat kishte qenë, ai i shkretë!...

* * *

Pacienti u zgjua aty nga ora katër e mbasdites. Një vajzë e re, mbesa e tij, e imët, por me një trup të kolmë, qëndronte prapa derës, me shpresë se mjeku do ta lejonte ta shihte gjyshin. VIP-i nuk dukej llafazan në zgjim dhe Mandi vendosi ta lejojë vajzën, që priste aq durueshëm. Ai u ul në tryezën e vogël në skaj të dhomës dhe filloi të hedhë në kartelë të dhënat e fundit të gjendjes së pacientit...Pulsi...Tensioni...Frymëmarrja...Atëherë plaku, me atë turbullësi të vazhdueshme sysh, ia nisi shtruar:

- Më hahet një çikë hallvasi, Flora, po si ajo që bëhej në Korçë pas luftës,

që pritej me latoshkë...Hëngra një herë një kile hallvasi në Pogradec...Atëherë kur vramë ata dy fukarenjtë...

- Si, si?- arriti e pyeti Flora dhe Mandit sa nuk i ra stilografi nga dora prej asaj pyetjeje idiote. Lere dreqin, mbase harron ku e kishte fjalën, mërmëriti ai.

- Ishin dy fshatarë në burgun e Elbasanit...I shpumë te Ura e Zaranikës...Qenë hapur dy gropa varresh atje...U lexuam emrat, u thamë se në emër të popullit duhet të pushkatoheshin si kualakë dhe ngritëm pushkët...Mirëpo njërin, vetëm njërin, e kishim marrë në vend të një tjetri...S'jam unë, tha ai i ziu. unë jam filani...Vajtën ta ndërrojnë me tjetrin dhe mua më lanë të ruaj plakun...Ai drodhi një cigare, pastaj ma hodhi kutinë edhe mua. Mbaje, më tha, se nuk më duhet më...Hoqi këpucët, lëkure i kishte, dhe i ndërroi me timet. As këto nuk më duhen, tha. Kishte edhe një sahat floriri me qostek. E pa orën për herë të fundit, pastaj ma fali edhe orën...Po ç'ke bërë, o xhaxha, e pyeta. Unë, tha ai, hiç! Kisha pak tokë dhe nja një qind kokë dhen dhe më thirrën kulak. Inatin e kanë se kam bërë shkollë për filozof në Angli dhe se nuk jam ngatërruar me këta. Po, ti, a do më bësh një nder?...Shko në shtëpinë time dhe thuaji se Sefëri u bën të fala e iku pa pishman atëherë kur duhej në atë vend ku do venë të gjithë. Kam nja dy nipër të veckël. Po ishe mirë, përpiqu t'ua japësh dorën, në ta kërkofshin...Edhe një llaf, o djalë: Sa të jenë ditët e Ramazanit, mos ia jep shpirtin shejtanit!...Pas gjysmë ore plaku qe mbuluar. Unë ia mbajta amanetin për t'i vajtur në shtëpi, po dorë s'u dhashë nipërve të tij kur ma kërkuan, kurse shejtanit ia dhashë jo shpirtin, po gjithë ç'kisha...Sa është ora?...

Ishte ora e plakut, e arte, me qostek. Një Lonzhin antik tashmë. Dhe, për çudi, punonte!

Flora nuk fliste. Vetëm plakut nuk ia ndante sytë. Pastaj i bëri një shenjë Mandit dhe doli në koridor. Shkuan në zyrën e tij përmes një heshtjeje të frikshme dhe atje ajo vajzë e lakmueshme hyri drejt e në temë...Ai nuk ka infeksion, doktor, apo jo?...Të lutem, mbajeni në karantinë...Ai nuk di ç'flet?...Po me ju, ka biseduar...E tmerrshme...Edhe sa mund të jetojë duke i punuar goja, pyeti pas një ngrirjeje të gjatë ajo...Edhe një muaj, po, tha Mandi...S'ekziston ndonjë mundësi më shpejt, pyeti prapë ajo...Nuk besoj, ia ktheu Mandi, por edhe ti, si puna ime, nuk ke dëgjuar gjë, apo jo?...

* * *

Plaku ra prapë në atë letargjinë e tij dhe infermierja e re, që doli se na i kishte emrin Bora, e ngopi deri në kufi plakun me injeksione...Ta shtyjme një natë të qetë, tha ajo. Mandi u mbyll në dhomën e tij me ca tregime të Shollohovit në duar, por, sa më shumë lexonte, aq më tepër i rritej një ankth i tmerrshëm,

frymëmarrës. Nuk dinte se ç'të bënte me këtë plak egoist llafazan, që po kërkonte ta thyente qafën si faraon, me gjithë farefis, doktor e infermiere me vete. Atij nuk i interesonte as politika e as shteti, as kishte nevojë të dinte nëse në pushtet kishte të ndershëm apo kriminelë, por edhe të dëgjonte, trembej. Ky ankth, kjo fatkeqësi që po i kanosej seriozisht, duke qenë më i larë se Papa, sikur po ia mbushte mendjen se në pushtet ishin vërtet ca pushta malinjë, që do ta bënin fajtor atë për përçartjet e plakut të rrjedhur. Kurse ai boll i kishte hallet e tija, atë vetmi të tmerrshme që dukej sikur nuk do të mbaronte kurrë dhe atë qeshje fallco prej kinezi, që po ia shtrembëronte gradualisht portretin e bukur e të zeshkët, që gjithmonë ia kishin krahasuar me të Alen Delonit. Atij iu kujtua ai pushkatimi absurd të Ura e Zaranikës dhe mendoi me tmerr se kështu, fare kot, duke bërë edhe një punë humane, mund ta hante edhe ai ndonjë plumb andej nga humbëtitat e Malit të Dajtit. Po unë, kujt ia kam dhënë shpirtin, pyeti befaz veten. U përpoq t'i mbushte mendjen vetes se ai nuk dinte as se cila parti ishte në pushtet e jo më emrat e shejtanëve, po nuk fitoi fare gjëje. Në ç'do lutje që kishte shkruar për shkollë, shtëpi, bursë, punë, televizor, frigorifer...i dilte PARTIA dhe SHOKU ENVER të shkruar me atë kaligrafinë e tij mizerabël. Po diç i përshkënditi në mendje dhe ai belbëzoi: A ma ha mutin, o plak kriminel?...Mori një letër të bardhë dhe pas një orë përpjekjesh heroike, ia doli të hartonte një kërkesë prekëse për t'u pranuar anëtar i Partisë së Punës. Shkruajti datën me kujdes në fund, e fallcifikoi edhe atë, sikur e kishte shkruajtur një muaj më parë lutjen, pastaj ngriti telefonin. Duhej të gjente rekomandimet e kolegëve deri në mëngjes dhe të njoftonte sekretarin e partisë për vendimin historik. Si i bëri të gjitha këto, u shtri i djersitur në shtrat dhe ai mjek, me një qerre tituj e i nderuar nga të gjithë, që shkonte gjithmonë i fundit në votime dhe s'dinte për ç'hajvan votonte, si tha edhe një herë, në mënyrë diçka më të zbutur, "A ma ha mutin tani, xhaxhi!" u kthye brinjas e fjeti. Fjeti keq, mes peripeive të togave pushkatuese dhe kengës së të vdekurit "SA TE JENE DITET E RAMAZANIT/MOS IA JEP SHPIRTIN SHEJTANIT", por fjeti dhe mëngjesi e gjeti të lumtur në klub, duke qerasur rekomanduesit me konjak e duke pritur të vinte sekretarin e partisë. Po që shkëlqen edhe dielli, ky palo diell, që, sipas latinëve, na le pa punë ne mjekëve, tha me vete. Eh, plak, o plak!...

* * *

Mandi i kaloi nja tre orë të mira zyrave të partisë me sekretarin, që ishte aq i lumtur pas vendimit historik të tjetrit, sa, thua i kishte lindur djali i shumëpritur pas tre vajzave. Ai e dinte se ishte gati e pamundur që Mandi të pranohej anëtar partije: ai shpejt do të mbushte 40 vjeç dhe ishte i divorcuar për fajin e tij, por sekretarit aq i bënte. Atij i interesonte që të paraqeste dokumentet e mjekut të

famshëm. Le ta merrnin vesh ata lart se ç'klas iu afronte ai, pikërisht gjenium, krenarinë e mjekësisë shqiptare, ajkën e trurit, atë që deri dje e quanin "problematik"...Pinë përsëri, raki të mirë fare pacientësh, dhe, kur u kthye në pavion, Mandi ishte në qejf. Por Bora qe zbardhur. Plaku kishte ligjëruar gjëra të tmerrshme...Po çfarë tha?...Nuk ta them dot! Të lutem, më hiq mua që këtej!- fliste ajo mes dënesave.

Ndjehej tërësisht e persekutuar. Dridhej dhe shihte e trembur përreth dhe Mandi, si mallkoi me një psherëtimë të thellë, mori tjetrën për krahu dhe e çoi në dhomën e tij. Atje e detyroi të pinte disa qetësues dhe, si e shtriu në shtratin portativ, e detyroi të flinte pak. Do merrej ai me plakun.

Ishte shkretëtirë në atë pavion të vogël special: ai, plaku, Bora. Një i çmendur, një e trembur, një që po çmendej...Vdis, o mortje, mallkoi ai duke hapur derën e dhomës së plakut. E gjeti plakun syhapur, duke parë kush e di ç'vegim në një skaj muri...

- Ishte nuri vetë,- ia nisi plakun...

Eh, ti do më bësh t'i laj gjithë gjynahet, psherëtiu Mandi.

- ...Kur ma sollën sekretare në Berat, ndriti zyra...Apo s'kishte dy sisë të vogla, përpjetë i rrinin...Eh, Merushe, Merushe!...Unë i ziu s'desha, po ajo edhe drurin e bënte me shpirt...Po sikur s'kishte lezet, se edhe kryetar isha, edhe komunist isha. Pyeta veten një ditë: po, mirë, qinë komunistët? Qinë, dihet! Po thotë gjë partija, po qive? Kur Enveri edhe qi edhe qihet, s'besoj se thotë gjë, i dhashë karar, se Enveri ishte dylber!...

Tani mbaroi gjithçka, i vuri kapak Mandi. Dha e mori heroikisht, që t'ia ndërronte bisedën plakut, e mbrojti Enverin me zjarr, si ta kishte baba, po mori vetëm një përgjigje të thatë: di dhia ç'është tagjia!...

- ...E vendosa! E thërras Merushen në zyrë. Isha serioz, ama, përbrenda dridhesha si qen. Mezi i mbaja dhëmbët zap! As në Luftë nuk kisha patur aq frikë...Ajo hyn. Diell, për perëndi!...Atëherë ishte koha e rusit dhe çupat vishnin delkotera...S'qenë bërë akoma borgjeze delkotetë. Unë lëshoj një letër te këmbët e mia dhe i them Merushes të ma marrë. Ajo ulet. I shoh sisët. S'i kish aq të vogla, sa dukeshin përballë. Mua m'u ngritën mishrat përpjetë...Rri ashtu, i jap urdhër, mos lëviz!...Ajo ngriti sytë, hajde sy të madh që kishte, dhe s'luajti, ama, ia hodhi një herë sytë gjoksit të saj që dukej gati i tëri, si vreshta të bardha në kodra, nën delkotenë e hapur gjer te supet. U skuq, se e mori vesh si ish historia. Ishte vajzë e zgjuar. Ndenji nja pesë minuta ashtu, nën këmbët e mija, pastaj ngriti kokën e bukur e më tha duke m'u lutur: Ta mbyll derën?...Kyçe, i thashë...U ngrit, mbylli derën e diç bëri matanë, se u vonua pak dhe unë e thirra vrazhdë...Erdha, belbëzoi ajo. Dhe hyri. E mora në prehër. Flori i fshehur në mushama ishte. Ia hoqa bluzën, ia hoqa edhe kanatieren, pastaj edhe fundin e gjatë me lule e me pala, pastaj edhe ç'i kish mbetur. Mermer dukej gollomesh!...Tani më xhvish ti, e urdhërova. Nisi

ajo të m'i hiqte plaçkat një nga një. Lulëkuq ish bërë...Brekët kish turp të m'i hiqte...Hiqi, i thashë unë. M'i hoqi dhe u zverdh, kur pa atë të shkretin përplotë, të madh, si hu gardhi. Zu dridhej, po unë ia hoqa frikën. Ai të do, i thashë, zere me dorë dhe përkëdhele...

Ra dera dhe Mandi ktheu kokën. Ishte infermierja. Dukej më e qetë dhe kishte ardhur të ndërronte Mandin. Ai ia bëri me dorë, "shët dhe , hajde dëgjo mrekullira" zberthehej ajo shenjë. Plaku shihte gjithë në skajin e tij, aty dukej qëndronte i hapur ditari i tij i kujtesës.

- ...Ma zuri me dorë, tërë frikë e merak. E kishte për herë të parë atë punë, e shkreta, kurse unë i kisha mësuar nga putanat e Korçës, ku linja paratë, që më 1942-shin...Avash, e mësova, fërkoja pak atë dellin poshtë, ja, ashtu!...Kish dorë të ngrohtë e të butë...Puthe pak tani!...Ajo e puthi, po i erdhi si për të vjellë...Po ku i ndahesha unë!...E mora këmbëhapur në prehër dhe ia kafshova ato sisët e forta gur e të djersitura kush e di pse, nga sikleti apo nga qejfi...E ke bërë më parë këtë punë, e pyeta...Jo, belbëzoi...Mos ki frikë, i dhashë zemër, është kollaj fare dhe do kënaqesh. Ja, ky hyn këtu...Dhe, si ia kisha terezitur kokën tamam, e tërhoqa drejt vetes. Ajo uluriu. I dhembti, të shkretës. S'kish faj, për herë të parë e kish! Po edhe unë ia bëra mirë. Ia prekja mitrën dhe ajo filloi të rënkojë nga qejfi...Pastaj u bë rrugë ajo punë, dy herë ditën, derisa filloi të dalë fjala dhe e martova me një inspektor gomar që kisha sjellë nga skërkat në Komitet...Pastaj u transferova dhe u tret edhe Merushja...O Perëndi, ç'kemi bërë, rënkoji plaku dhe fjeti.

- Na eksitoi, haleja!- tha Mandi.

Dhe nuk gënjeu.

- Edhe mua,- kukurisi e skuqur tjetra.

Mandi i hodhi një vështrim të gjatë e të thellë, depërtues e me një kuptim të vetëm infermieres dhe e ftoi në dhomë. Përshkruan pa fjalë, duke u dridhur të dy koridorin shkretan, hynë në dhomë dhe Mandi, si u ul në shtratin e ngrohtë ende nga trupi i infermieres, e thirri Borën pranë.

- Fillimi i historisë së plakut ishte kështu,- tha ai.- "Mbylle derën!"

Bora u ngrit si e hipnotizuar dhe mbylli derën me shul.

- Pastaj ai e xhveshi tjetrën ngadalë, ja, kështu!

Dhe Mandi nisi t'ia zberthente ngadalë, me gishtrinjtë që i dridheshin, përparsen e bardhë. Doli një trup i plotë femre të pjekur nën këmishën e hollë, me një gjoks të mrekullueshëm, pa rexhipeta, sepse nuk kishte nevojë për to, me flokët e dendur e të gjatë, që e mjegullonin dhe e bënë edhe më të mistershme atë pamje magjike dhe ai, si futi pëllëmbën e madhe e të fortë prej burri nën këmishë, ia hoqi ngadalë të mbathurat e pambukta.

-...Pastaj ai i tha...

- Vazhdimin e di vetë,- pëshpëriti Bora.

Ia hoqi edhe ajo ngadalë përparësen, këmishën, pantallonat, të mbathurat

dhe, e ulur në gjunjë, bëri si Merushja. Pastaj iu ul në prehër, krejt lakuriq tani, e la t'ia kafshonte deri në dhembje thithat e gjinjve, e la t'ia përkëdhelte ëmbëlsisht ijet, mollaqet e kërcyera, kofshët e lëmuara dhe priti që ai t'i bënte pyetjen e plakut. Kur ndjeu penisin e tij që po i afrohej, i madh e i fryrë, ajo i pëshpëriti e përskuqur:

- Të lutem, ngadalë, sepse e kam për herë të parë!

O Zot, thirri nga shpirti ai, s'po marr vesh asgjë! Pastaj ai hyri me kujdes brenda saj, dëgjoi klithmën e mbytur të Borës, ndjeu gjakun e saj të ngrohtë t'i rrëshqiste kofshëve dhe e shtrëngoi marrëzisht tjetrën. Nuk u ruajt dhe nuk doli nga seksi i tjetres as herën e parë, as herën e dytë e as herën e tretë. Pas gjysmë ore, i rraskapitur dhe i lumtur, iu lut Borës të pastrohej. Tjetra hyri këmbë hapur paksa në banjë, derdhi një kuintal spermë, u la dhe u stërfa dhe uroi mos kishte mbetur shtatzanë. Pastaj shkoi e u shtri bri Mandit.

- Doktor, ky plaku po më persekuton,- tha ajo e përlotur.- Sot ma mori virgjërinë kot fare, kur unë e ruaja për tjetër njeri. Edhe atë njeriun tani e humba...Ai është ushtar. Pra, edhe dashurinë e vetme që kisha, ma vrau! Tani ky do të më marrë edhe jetën! Unë nuk duroj dot më! Nuk duroj dot, më beso! Që tani do vishem dhe nuk do të vi më në punë, pa vdekur ai kriminel i tmerrshëm!...

Dënesi rëndë në krahët e Mandit, pastaj e priti tjetrin sa u pastrua e u vesh, u vesh edhe vetë me rrobat civile dhe, si e puthi dhembshurisht Mandin, i tha "do të kujtoj, doktor, ke qenë i mrekullueshëm me mua", hapi derën e jashtme të pavionit dhe iku. Mandi nuk iu lut të qëndronte. Ajo e kishte vendosur, por edhe ai ishte i kënaqur me zgjidhjen tragjike: Po të hante koka plakun, tani do të ishte një më pak!

I hodhi një sy kriminelit që vazhdonte të flinte i qetë, kërkoi që nesër në mëngjes të paraqitej në pavion një infermiere e re, që mos ishte familjare, sepse do t'i duhej të shërbente 24 orë pranë pacientit, dhe, si mbështeti kokën mbi krahun e shtrirë në tryezën e vogël të dhomës së vdekjes kolektive, dremiti pak. Në atë turbullirë, ai pa veten të varur kokëposhtë nga një lartësi e llahtarshme dhe dëgjonte gjithë tmerr një zë që i ulurinte në vesh: Fol, qen, ç'i mësoje tjetër plakut të nderuar të shpifte?...Po unë, belbëzonte ai gjithë llahtarë, duke parë atë lartësi marramendëse kokëposhtë, nuk kam asnjë faj, unë e mbrojta shokun Enver...Pyesni muret, po nuk më besuat...Unë kam qenë gjithmonë një ushtar besnik i Partisë...Më njeh mirë shoku...

* * *

Mandin do ta zgjonte nga ai gjumë i trishtuar e i rëndë pasditeje zilja e derës së pavionit. Ai u ngrit përtueshëm, duke i hedhur një sy indiferent kufomës

së gjallë, që tashmë i kishte sytë e hapura në tavan, pastaj shkoi të hapë derën. Ishte Flora. Kishte sjellë supë për plakun dhe iu lut Mandit që ta lejonte t'ia kjoje gjyshit me duart e saja. Tjetri i hapi rrugë.

- Hyr, - i tha,- sonte s'kam as infermiere. Ajo që ishte e la punën sapo mbaroi turnin. Zëvendësuesja vjen nesër...

- Pse e la punën?- pyeti Flora.

- Ushqeje një herë, pastaj bisedojmë. Unë po të pres në dhomën time,- tha ai.

Mandi ndjehej vërtet i lodhur nga kufoma e gjallë. Kurrë nuk kishte pasur të bënte me pacientë të tillë, as kur e çonin për ndonjë rast urgjent në spitalin e burgut, telat e të cilit dukeshin pikëllueshëm nga dritarja e tij. Atje ai kishte ekzaminuar armiq të përjetshëm të partisë, por s'kishte hasur në sharje të përbindshme, si të VIP-it. Por e keqja më e madhe Mandit nuk i dukej dëgjimi pasiv i një idioti të rrjedhur dhe pasojat e mosdenoncimit; atë e tmerronte fakti se kjo kufomë ende e gjallë po e infektonte edhe atë vetë. Seksi me Borën, ato historitë me pederastë, që ai i kishte dëgjuar dikur rrugëve të Tiranës, falsiteti dhe maska,- këto egzistonin, drejt ta hante, po përse duhej t'i zbuloje? Që të haje ndonjë plumb mbas koke dhe të përfundoje si kufomë mësimore në ndonjë morg, ku, veç vdekjes, të të bënin copa-copa studentët fillestarë?...Po edhe plumbi nuk i jepej kaq kollaj njeriut, ishte shumë kriminale e gjitha kjo...Gjithçka mund të shkonte shumë mirë, si në Francë, pa plumba e pa egërsi...Qartë, shtoi i kthjelluar befas, kufoma e gjallë filloi të ndikojë. Po shfaqeshin shenjat e para të kalbëzimit të ndërgjegjes proletare...

Ai duhej të kishte artikuluar ndonjë broçkull, sepse, kur Flora u shfaq në derë, ishte e zverdhur. Mandi kuptoi menjëherë gjithçka, që kur ajo propozoi fare shkoqur:

- Po sikur t'i shërbeja unë si infermiere gjyshit, në vend të infermieres së spitalit?

- E bën dot që të qëndrosh këtu 24 orë?- pyeti ai, megjithëse ishte i bindur se të dy po flisnin kodra mbas bregut.

- Po më shtruat ju si të sëmurë në këtë pavion, po!- tha ajo.

- Ndoshta po flasim kot,- vendosi t'i jepte fund absurdit Mandi.- Pastaj infermierja ka edhe detyrime të tjera, ajo duhet të kujdeset edhe për mjekun...

- Nuk jam aq e përkëdhelur sa dukem,- tha ajo.

- C'të tha plaku?- e pyeti befas Mandi.

Flora tundi dorën në ajër.

- Tmerr!- tha.- Duket, ka luajtur...

- Pse nuk e merrni në shtëpi?- propozoi befas ai.- Unë nuk mund ta ngre zërin, sepse as jam denoncator, pra, s'dua të jap shpjegime, edhe jam nën presion:

për gjyshin tuaj ka një urdhër që të kurohet me kujdesin më të madh...Por ai nuk ka shpëtim dhe, ç'është më e keqja për ne, unë i shtoj jetën atij, kurse ai, qoftë edhe në një ditë të vetme, mund të na groposë të gjithëve ne...Jemi në hall vërtet,- psherëtiu ai,- dhe, ç'është më e keqja, nuk mund t'ia qajmë askujt këtë hall...

Flora s'fliste. Për ters, sytë e saj shkuan andej nga telat me gjemba, ajo mori vesh se atje ndodhej spitali i burgut, dhe u bë sa një grusht.

- Të paktën, më prano mua si paciente në këtë pavion,- iu lut ajo,- lejen e siguroj vetë, ti vetëm më prano, ndoshta për një vizitë të përgjithshme. Mbase do të ishte më mirë që unë të isha gjithmonë e pranishme këtu...

- Merr lejen në drejtori dhe hajde që nesër,- tha ai.

Ajo kishte edhe një lutje tjetër tek ikte:

- Të lutem, doktor, mos lejo ndonjë personalitet, mikun e tij, që t'i hyjë në dhomë kur është zgjuar. Fut i tmerrin, siç po ia fus unë gjithë farefisit. Dhe unë nuk kam biseduar asgjë me ju...

- Kjo dihet!- tha ai.- Megjithëse, do të kisha shumë dëshirë të bisedoja me ju!

- Do kemi boll kohë,- buzëqeshi për herë të parë ajo.

Zbriti nëpër shkallët gjysmë të errëta. Vinte një erë e rëndë urine, por ajo pa përreth dhe s'ra në gjurmë të asnjë tualeti. Më duket se kutërbojmë ne të dy, që mut u bëfte kjo botë, mallkoi thekshëm ajo vajzë e diplomuar shkëlqyeshëm në arkitekturë.

* * *

Natën kufoma e gjallë nuk u ndje. Duket i kishte bërë mirë ai lëngu i supës, që ia ushqeu si bebes Flora. Ai nuk u ndje as kur erdhi infermierja e re, një rome mesogrua, që s'kishte shtëpi e lakmonte vetëm turnet e treta. Mandit i pëlqeu që fati i sollti pikërisht këtë infermiere. Ata patën punuar dikur bashkë dhe ai kënaqej jo vetëm nga e folura e saj me "ç", por edhe nga moskokëçarja tipike prej romi, që as i kërciste kë kishte përballë. Nuk vinte asnjë e keqe nga kjo grua. Ai e mori në dhomën e tij, i zgjati një cigare, pastaj i shpjegoi shkoqur se pacienti ishte i rëndësishëm, por nuk qe mirë nga trutë dhe shante shumë keq...

- E çin shan?- pyeti ajo.

- Ene Enverin,- i tha ai, duke folur pranë dialektit të saj, si për ta afruar diçka më shumë.

- Qyyy!- bëri ajo.- Kush e di si e ka hallin,- shtoi pastaj,- mase e kan lon fukarain si puna ime, pa kacolle...

U bë çerdhe antiparti këtu, tha me vete Mandi. Tani e ha brinjë më brinjë...

- Ti, dëgjoje plakun, po mos fut asgjë në kokë! More vesh?- ngriti zërin ai.

Tjetra u tremb. Edhe ajo e deshte Mandin. Ishte shpirt robi, ky dreç!...

- Ti më njef muve,- vuri paqen ajo,- e ça m' duhet muve politika? Kokën hongshin, ishalla! Una, po desh drejtori, i shpi du, sa me mledh kalamojt. Sina mo për rrugë, se veç koçet e tua me hongër masanej...Nuk nigjoj una!

- Puno, tani!- urdhëroi Mandi.- Do paguhesh edhe me orë jashtë orarit, po u solle si në vaktit. Dhe nuk do lejosh asnjëri, as Enver Hoxhën, me hyrë në dhomën e plakut, pa të dhënë lejen unë! More vesh?...

Merrej vesh që mori vesh, se edhe qeshi vesh më vesh. I kishte pëlqyer fort ajo puna e rrogës. Iu lut doktorit t'ia jepte këmishën, çorapet dhe të gjitha gjërat që kishte palarë t'ia lante shpejt e shpejt, i mblodhi plaçkat boçe dhe doli. Mandi bëri një bilanc. Frikë kishte, po karantinën e ndërtoi në mënyrën më perfekte. Gjysma e të keqes, mërmëriti. Tani në tavolinën e zyrës-dhomë ishin nja pesë vepra të Enver Hoxhës, të nënvizuara nga kush e di ç'pacient VIP e të harruara në një nga dhomat e pavionit, që ai i kishte gjetur rastësisht në mesnatë...Alibia, mendoj dhe u drodh...Pse duhet të bëj unë alibi, shtoi pastaj i trishtuar, as kam sharë e as kam vrrarë njeri...Dhe pikërisht kur Flora u shfaq me lejen e shtrimit në derën e pavionit, ai po mendonte si turbull se kufoma e gjallë njerëzngrenës nuk e kishte fort keq që tallte bythën me ca njerëz që terrorizonin një popull të gjithin...Po na ha të gjithëve, o plak qelbësirë e rrugaç, tha ai me vete tek i doli Florës përpara dhe e shoqëroi për në dhomën ngjitur me të plakut. I shpjegoi infermieres se kush ishte Flora, i tha se vetëm ajo lejohet të hynte kur të donte në dhomën e plakut dhe se vetëm ajo do ta ushqente, e urdhëroi ta lidhte sinjalin e alarmit të dhomës së plakut me të Florës dhe doli të pinte një kafe...Tha që do të vonohej pak dhe se po ta kërkonte njeri, ose po të kishin ndonjë urgjencë, ta kërkonin në kafen pranë pavionit, ose te drejtori.

* * *

L + E = LOVE

Kur Mandi hyri te drejtori, ky po bëhej gati t'ia telefononte. Nga lart kishte shumë interesim për shëndetin e kufomës së gjallë.

- Ai është i mbaruar,- tha Mandi.- Ka një rënie të plotë...

- Më bëj një relacion të shkurtër,- iu lut drejtori,- sa të mbaroj edhe unë këtë punën që kam në dorë...

Mandi kishte shkuar mirë me drejtorin. Ata patën qenë bashkë në Francë. Drejtori nuk hynte në kategorinë e atyre specieve që ta hapin gropën pas shpine. Ai dinte aq për Mandin atëherë, sa këtë të fundit ta sillnin pako postale në Shqipëri. Po ato historira ata i kujtonin vetëm kur qenë bashkë para ndonjë gote.

Drejtori e lexoi analizën e Mandit, ndërkohë që ky i fundit mendonte gjithë ankth se mos ndonjë anëtar i lartë partije kishte hyrë tani në dhomën e

kanibalit. Dhe, mendo, ta kapte zgjuar!...Të nisëj vetë për Burrel!...

- Po në masë karantine pse e ke vënë?- pyeti drejtori pa ia ndarë sytë.

- Nuk duhet shqetësuar,- tha Mandi.- Pastaj edhe mendërisht ai...ka rrijedhur. Pse ta dëgjojnë të tjerët kur flet kodra mbas bregu, kur as unë, që jam mjeku, nuk pranoj ta dëgjoj? Le t'i mbetet kujtimi i mirë i Heroit të Luftës dhe Punës...

- C'thotë?- pyeti tjetri. As mori mundimin t'i besonte Mandit. E njihnin mirë njëri-tjetrin.

Po Mandi nuk u dorëzua.

- Me mua nuk ka folur ndonjëherë, më shumë humbet, rrallë zgjohet...Ne kot e mbajmë në spital, e kam shkruajtur edhe në relacion...

- Nuk e merr familja,- tha tjetri.- Ata shpresojnë dhe ne nuk kemi luajtur mendsh ta çojmë në shtëpi, kur për atë interesohet vetë shoku Enver...

Tani e hëngra tamam, i hynë të dridhurat Mandit, të vijë për vizitë Enveri dhe të dëgjojë atë punën e pederastit dhe ta ha unë pse nuk kam bërë punë politike me atë matuf të surrifjaksur...

- Ky është realiteti,- këmbënguli me zë Mandi,- tani e deri sa të mbarojë, ai vetëm për qetësues ka nevojë. Ne mund t'i caktojmë kurën, t'ia japim falas dhe t'i lemë një infermiere te koka në shtëpi. Edhe me Myslym Pezën ne kështu e kemi zgjidhur...

- Nuk i zgjidhim ne këto punë, o Mand,- tha drejtori,- unë e marr vesh logjikën tënde, e kuptoj se as ti nuk e do si pacient, përderisa edhe infermierja braktisi punën, kur ishte nevojtare, se brekë në bythë s'ka...

...Brekë kishte, rexhipeta, po, nuk kishte, saktësoi me vete Mandi...Ai nuk e dëgjoji më drejtorin. I rrinte mendja te Enver Hoxha...Sikur të ishte i sëmurë, vetëm në pavion mos t'i shkelte! S'pyeste dot as mjekun e tij...Ai i propozoi drejtorit ta çonin plakun jashtë, mbase kurohej andej dhe, si u zgjat në tryezë, shtoi në fund të relacionit propozimin e tij. Të thyejë qafën, vetëm unë të shpëtoj, tha me vete, se mos janë lekët e mija. Veç e dinte mirë se plaku as deri në aeroportin e Rinastit nuk do të arrinte gjallë.

* * *

Ne pavion Mandi hyri përmes të alarmit të infermieres. Duhej të merrte drejtorin urgjent në telefon. Ai ngriti receptorin dhe dy çaste më pas drejtori i tha mos luante nga pavioni. Në orën 12 pacientin e tij njerëz shkatërrues, doktorngrënës më mirë, do ta vizitonte kryeministri...

Mandi u këput në kolltuk. Kapi kokën me duar ai Mand, që s'e pati vrarë mendjen kurrë dhe i tha vetes pa asnjë kompromis: "Tani mbarove, miku im i

dashur!” Krimineli e kishte syrin qiçër dhe as kishte ndërmend të flinte dhe, për çudi, as dhembje nuk ndjente.

- Në orën 12 do të vijë t'iu shohë kryeministri,- i tha Mandi, me shpresë që tjetri do kthjellohej disi.

Kufoma nuk u ndje. I kishte sytë në cepin e dhomës, te Merushja...10 vjet burg, Mandi, për atë kurvën plakë...Por, kur fjalët e doktorit ia përsëriti Flora, atëherë krimineli hungëroi:

- E mora vesh! Pse vjen? Që të më lutet “aman, mos trego që Lilon e vrava unë me dy plumba pas kurrizit më 1944-tër, se nuk e çante bithën për mua?...”

Gjyq special, Mandi, në i nxjerrtë nga ajo hale-gojë këto xhevahire, i dha pretencën vetë vetes së tij doktori, tek dilte nga dhoma.

Flora i erdhi pas. Ishte aq e zbehtë, sa ai mendoi t'i jepte ndonjë qetësues edhe kësaj pule që dridhej nga ankthi...Ajo e kapi për krahu intimisht dhe iu lut që t'i jepte gjyshit ndonjë luminal...Ti je për luminal për vete, moj xhan, tundi kokën Mandi...Po ideja e saj nuk dukej fort e keqe. Po i bënte të gjithë doktorë të mbaruar plaku, për të ta afruar sa më shpejt fundin, merrej vesh...Ai i dha dy kokrra lumial tjetrës dhe e porositi t'i jepte nga një kokërr në tetë orë. Ishte i sigurt që ajo do ta detyronte kriminelin t'i pinte të dyja njëherësh, siç ndodhi realisht.

- Kjo punë nuk shtyhet me luminale,- tha Mandi,- po ta heqim një herë këtë vizitën e kryeministrit, pastaj, në darkë, duhet të bisedojmë seriozisht...

E zverdhur, Flora vetëm tundi kokën. Ajo po mallkonte kryeministrin, që vinte në spital për të parë një plak të surrifjepsur, sikur s'kishte punë tjetër...Ik, o gomar, shiko të mbjellat në terren, se ka ngelur gruri sa një piç bythe!...Por edhe ajo, si Mandi, torturohej nga mendimi se mos kryeministri po vinte me qëllim në spital, për të dëgjuar xhevahiret e gjyshit...Kush t'i ketë raportuar?...Kjo ishte dilema e të dyve.

Mandi bënte ecejakje në dhomë, duke kërkuar denoncatorin e fëlliqur që iu pat hapur kaq siklete kot fare, si rrufe në qiell të kthjellët. Drejtori?...Ai nuk iu pat besuar fjalëve të Mandit, pra, diçka dinte. Po pse ta bënte tani, kur ai kishte gjithë atë emër si mjek, dhe nuk e bëri atëherë kur iu vërsulën një lukuni mjekësh si qen, gjatë divorcit me Xhulin?...Ky s'ka gisht, e ndau mendjen, po as Bora nuk mund të ishte...Po Flora? Se pse i trembej kësaj arkitektes, që edhe bythën duhet të jepte, vetëm të tregonte besnikëri, për te mos i ikur rehati tradicional nga dora...Për Florën Bora nuk egzistonte. Po doktori, po dyzonte atë çast dhe ajo, mos ky legen me emër donte të ruante rehatin e vet dhe po ua hapte gropën të gjithëve...Sa të ndyrë, janë bërë njerëzit, trishti ajo, një lukuni me hale janë bërë, që vdekshin në hale, ishalla!...

S'bëhen njerëz kjo racë e ndyrë parazitësh, po mallkonte Mandi, duke u dridhur nga tmerri dhe frika bashkë, tek kujtonte si ia kishte futur mbesa e

kriminelit, kriminelja e vockël dhe tek imagjinonte jo pa një takiokardi të lehtë se si do të kapte mbas një muaji qysqinë e do të hynte në tunelet e Spaçit, nga ku s'dihej në dilje i gjallë. Ai kujtoi me tmerr pastaj ato historitë e përdhunimeve në ato burgje të tmerrshëm, ku njeriu hynte njeri e dilte...po të dilte! Jo, ishte e vërtetë që kishin shpëtuar ata që patën vdekur a vranë veten. Dhe u bë gati për të qarë, kur kujtoi dhe fëmijët me biografi të keqe baltrave të Veriut, apo Jugut...Kurse Flora qante me kuje në dhomë. Mbaroi gjithçka në këtë vend të ndyrë, ku njerëzit ngjireshin si histerikë për ca homoseksualë perversë dhe pse? Sepse ajo idiotja, kafsha fare, mendoi se ka njerëz besnikë në këtë shoqëri të pabesë! Të ndjek të hija ime, o doktor, mallkoi ajo, që ma prishe jetën!...Ajo e dinte më mirë se doktori ç'do të thoshte burg e internim. Ku ishin shoqet e saj? Ca të pamartuara për jetë, ca të ndara nga burrat, pa kalamajtë e tyre, ca vranë veten, ca luajtën mendsh, që i luajtë tepeleku haleve!...

Një tmerr, një mallkimiadë, bridhte koridoreve të atij pavioni të vockël, pështyhej pushteti e shkërdhehej diktatori, aq sa nuk e kishin sharë të gjithë shqiptarët bashkë për 45 vjet, derisa erdhi ora 12 dhe në koridorin xixë u shfaq figura romaduce e kryeministrit...

Mes bukurisë, vdekja troket, tha Mandi, që atë çast, duke mbajtur me zor zemrën që mos ia mbathte nga kraharori i gjerë filloi të lerë amanetet, duke u betuar që nuk kishe asnjë faj. Flora mallkonte nga dhoma e plakut, që, megjithë dy luminalet, i mbante sytë hapur si qen, krimineli!...

Kryeministri ishte shumë i shqetësuar...Vetë shoku Enver...Shkenca jonë mjekësore duhet të bëjë mrekullira në këtë rast...Eh, luftëtarët trima të luftës dhe punës...Që i ranë rroçkës dhe sumës, plotësonte një më hu e një më kërcu Mandi, atje ku i ngelej copa e fjalisë, që tashmë i zverdhur, mendjendarë për fatin e kobshëm që e priste, shante mbarë e prapë, a thua e kishte marrë me akord realizimin e planit pesëvjeçar të sharjeve...Lufta që ka bërë gjyshi jot ka qenë epokale...Kështu thoni ju, qelbësira para se të të çoni në hale, plotësonte Flora për hesap të vet, po sytë nuk i ngrinte. Nuk dëshironte as t'ia shikonte surratin doktorit spiun, që, gjoja, ishte dhe human dhe ia futi kaq pabesisht...

- Si je?- e pyeti kryeministri plakun hero.

- Një çikë misërnike me djathë më hahej,- tha plaku,- po jo si ky djathi që bëni ju, ky s'mban erë...Djathë kish atëherë, para kolektivizimit...Hajde, djathë që kemi ngrënë...Po qull me djathë?...

Mbaje te djathi e qulli, o Zot, u lut Mandi, dhe e ndjeu që ishte bërë qull në djersë. Një napë djathi mund t'ia shpëtonte jetën. S'deshte as kalë e as dreq, deshte vetëm që plaku ta mbante mendjen te djathi...Po kryeministri ishte palaço, kryekriminel! Mandit dhe Florës iu pushoi zemra tërësisht, kur tartabiqi arriti e tha gjithë krenari, që po i groposte tamam:

- Shoku Enver të pret për kafë, më tha të shërohet sa më shpejt, pa edhe zaret do t'i hedhim një herë...

Po plaku ishte bërë magjishmërisht i mrekullueshëm.

- Thuaji, ta bëjë kafënë në prush, korenti e prish, hedh valë shpejt...Apo s'hahej i pjekur ai djathi!...

Kryeministri e ndjeu se plaku qe ndryshkur. Ai e mbaroi misionin e tij.

Doli me shpurën dhe doktorin përkrahu e nga krahu tjetër ngushëllonte Florën, dha ca porosi në hava dhe i ngriti veshët vetëm kur Mandi, me tension zero e me fytyrë bezhë, iu lut ta çonin pacientin jashtë për t'u kuar... Vetëm atje mund të shpëtojë!...Ke bërë kërkesë, tha kryeministri...Po, ndërhyri drejtori, ma ka dorëzuar mua...Të shkojë, urdhëroi kryeministri dhe Mandi u mbështet i rraskapitur te dera e madhe e hyrjes...Zot, falenderoi, ti i ndihmon dhe mëkatarët!...Flora qau, qau me lot të mëdhej e dënosa të rënda...Partia ka zemër të...po thoshte kryeministri, po tani askush nuk po vriste mendjen për hajvanllëqet që ai nxirrte nga goja...Merreni, të shpëtojmë të gjithë, ishte gati të ulurinte Mandi, në atë çast që Flora, e lumturuar siç ishte, harroi çdo protokoll dhe i këputi një të puthur të mirë kryeministrit...Të lutem, u përgjërua ëmbëlsisht ajo, vetëm niseni sa më shpejt, sepse ai është keq. Dje nuk më njohu as mua, që nuk më ka hequr kurrë nga prehëri...Dhe pikërisht atë që dëshironte me gjithë shpirt Mandi, një rërke lotësh, ajo e lëshoi...Edhe kryeministrit rrumaduc po i qahej...Nesër, tha prerë ai.

Iku. Ikën të gjithë. Iku dhe vdekja. Në pavion se nga hyri një dritë e ngrohtë. Mandi i dha tre orë leje infermieres, pastaj u shtri ngadalë në shtrat, si një i sëmurë nga zemra, që e ndjen fundin...Fundi kishte qenë kaq pranë! Dhe pse? Dhe pse duhej t'i vinte fundi atij?...Ankthi e kishte dërmuar, e kishte plakur, i kishte ngrënë jetën...Vend i qelbur, parti e pjerdhur, rimoi ai me vetëdije të plotë. Këtu një trill të merrte jetën, pa pyetur kush je ti dhe se jeta është e jotja...Profesor Hoti! Një paketë cigare nuk i kishte çuar në burg nga frika, ai, doktori i famshëm, dhjerramani, apo dhjersmeni me nam...

Trokiti lehtë dera, pastaj u hap dhe ai pa si shtojzovalle nëpër një fashë drite të bardhë që hynte nga dritaret e koridorit, Florën. Me siguri duhej të ndodhej në përrallë. Drita hynte në fustanin e hollë dhe e treste atë cohë, për të nxjerrë në pah ca linja të bukura, ijet e ngrohta, kofshët e hapura paksa...

Ai nuk lëvizti. Nuk kishte fuqi të lëvizte. As sytë nuk i shkëpuste dot nga ajo pamje gjysmë ëndërr e gjysmë shgjëndërr...E shihte gjithë i përhumur nga ai pozicion i shtrirë me kokën e ngritur paksa. Ndjehej tmerrësisht i lodhur...Plaku, tha me vete, po tani le të llapë ç't'i ketë kokrra e qejfit...

- Mund të hyj?- pyeti tjetra.

Mori nja "hajde" me dorë.

Ajo u afrua ngadalë, e veshur tashmë, dhe i erdhi te koka. U përkul paksa para se të fliste. Druhej? Kush e di! Veç flokët e zinj e të gjatë i ranë këtej shpatullave, si perçet e kalit mbi sy.

- Erdha t'iu kërkoj falje,- tha ngadalë ajo,- unë mendova keq për ju. Mendova se ju...

- Edhe unë, po për atë arsye, të kërkoj të falur,- tha indiferent ai.- edhe unë mendova keq për ty...

Ajo e pa gjatë, a thua ai po ikte përgjithmonë në varr apo Spaç, pastaj u përkul mbi shtrat dhe e puthi në buzë, në ato buzë të flohta e të tharra nga ankthi vrasës.

- Faleminderit!- tha ajo duke u ngritur, gati tani për t'ia mbathur.

Mandi zgjati dorën ngadalë, ajo e pa atë dorë që vinte drejt belit të saj e rraskapitur, dhe nuk iku. Ai e përfshiu belin e ngushtë, e tërhoqi vajzën lehtësisht drejt vetes, e shtriu përbri dhe nisi ta puthë gjithë aq ngadalë, sikur të ishin të dashur prej dhjetëra vitesh. Pa folur, pa as edhe një pyetje, pa shpjegime, ajo ndjeu si mbetej gjithmonë e më lakuriq, derisa s'kishte më asgjë në trup dhe u lumturua vërtet kur ndjeu atë peshë burri mbi vete. Iu dha e gjitha, pa asnjë pendesë, flaku turpin tej dhe jetoi ëndrën e saj, duke e kuptuar më në fund thellë se sa e bukur dhe e mrekullueshme ishte jeta...

Të pastruar, të veshur, tani ata qëndronin sërish përballë.

- Shpëtuam, më duket,- psherëtiu ajo qenie aq e brishtë dhe e pafajshme.

- Shpëtuam sot, po nesër gjithçka fillon nga e para, - psherëtiu ai, duke ndezur një cigare.- Dhe ne nuk kemi asnjë faj, dhe askush nga populli nuk ka asnjë faj, dhe, aq më shumë, fëmijët nuk kanë asnjë faj, që Ata kanë faj...

- Fatkeqësia jonë është se jemi pa faj. Ku s'ka faj, do gjehet faji dhe kështu sajohet fajtori...

- Qartë,- tha Mandi,- po sa kohë do të jetojmë kështu, nën gijotinën e njeriut pa faj, që ka bërë faj?

- Nuk e di,- tha ajo,- dhe as që dëshiroj të flas më për këtë temë tani që shpëtova nga vdekja!...

U dëgjua zilja e dhomës së plakut dhe ai u bë gati të ngruhej. Po ajo nuk e la. E tërhoqi përdhunshëm drejt vetes dhe, duke i futur dorën në qoshe të strehohej penisi i tij i mbledhur grusht nga ankthi e lodhja, e urdhëroi prerë:

- Tani, po të dojë të vdesë, po të dojë të rrojë! Unë dua të bëj qejf, dua të ha hallvën time, se e kam jetën për së dyti, dhe ai nuk ka punë më me ne!

Pastaj ajo u ul në gjunjë dhe Mandi ndjeu një ngrohtësi ta pushtonte të gjithin. 20 minuta më pas, gjithë duke u puthur e duke u ngacmuar në koridor, ata shkuan te kufoma e gjallë njerëzore...

...Edhe greku vinte e porosiste nga ai djathë te çobenët tanë,- dëgjuan

ata te dera.- O Perëndi, ç'djathë ish...

Po ai djathë iu kishte gllabëruar me atë ankthin e tmerrshëm jetë të dyve. Në vitin 1986 Flora do të vdiste nga kanceri në mushkëri. Do të vuante tmerrësisht dhe do të ishte po ky Mand që do t'i qëndronte deri në fund te koka, i pikëlluar për rininë që ikte me urdhër e hap rreshtor drejt varrit, mallkues biblik ndaj atyre, bujqve të polipeve në trupat e këtyre ëngjëjve të pafajshëm...Ku do ta gjente forcën ajo vajzë e brishtë, e zbrërthyer fije - fije nga vdekja në prag, që do t'ia shtrëngonte dorën aq fort, tek ikte përgjithmonë nga bota magjike? Çfarë kishte dashur t'i kumtonte, ç'amanet?...Kishte hyrë edhe ai shtrëngim i dhimbshëm dore në misteret e njerëzimit. Deri në fund Mandi mendoi se ajo deshte të fliste diçka dhe ishte në gjendje të fliste, por frika me ankthin ia mbyllën gojën edhe atë çast të skajshëm pa kthim pas, kur sytë mbushen me lule dhe njeriu trimërohet deri në atë masë, sa të përqafohet gjithë dinjitet me vdekjen. Askush nuk mund ta bindte se muret nuk kanë veshë...Dy vjet më pas do vdiste edhe Mandi nga infarkti. Do të vdiste komunist dhe do nderohej dyfish, pak nga shkenca e shumë nga Partija...Mbi varrin e tij do të fliste miku i tij i kohëve të vështira, drejtori. Me sytë mbi varr, ai do të mendonte gjëra krejt të tjera nga ato që goja artikulonte mekanikisht. Ai do dëgjonte qartë se si gropa këndonte atë këngën patriotike me pak modifikime: "Eja, mblidhuni këtu, këtu,/ kjo nuk diskutohet!/ Një gjë ta mbani vëth në vesh:/ I dhjeri nuk privilegjohet..."

Askush nuk e dinte tamam se pse vdiqën realisht ata...

MARS, 1996

The Love and ...

DASHURIA DHE...Vdekje

Për herë të parë dhe të fundit ata ishin takuar në një nga kafet e vjetra të Tiranës, në një nga ato klube ku mblidheshin nostalgjikët e pirjeve të hershme. Ai po pinte një verë të mirë artizanale Narte me një shokun e tij nga Vlora, kur kamarieri i tregoi një person që dëshironte ta takonte vetëm dy minuta. Qe kthyer kurioz dhe kishte parë një fytyrë të hequr, me sy ekspresivë e veshë të vegjël. Nuk e njohte. Megjithatë, ishte ngritur dhe qenë ulur në një tavolinë në fund të klubit. Atje mori vesh se bashkëbiseduesi na qenkesh Genci, i shoqi legal i Zanës, me të cilën ai kishte vendosur marrëdhënie dashurije gjashtë muaj të shkuara, dhe Ferdinandi qe ngurtësuar në tryezë. Faji nuk është i yti, i kishte thënë Genci atij, por, meqë unë kam dy fëmijë me atë grua, përpiqu, për hatër të atyre kalamajve, që mos ekspozohesh shumë...Nuk dua që nesër nëpër Tiranë të thonë për ata të pafajshëm "ja, kalamajtë e asaj kurvës".

Nandi ishte ndjerë tmerrësisht keq. Tjetri qe larguar gjithë xhentilesë e dinjitet dhe, pavarësisht se ai e dinte mirë që Genci nuk bashkëjetonte më me Zanën, përsëri pendesa e pat pushtuar të gjithin. As i pihej më ajo verë mjaltë e as mendje ta vazhdonte bisedën e lënë përgjysmë me mikun nuk kishte. U betua dhe stërbetua me vete që nuk do ta takonte më Zanën, hartoi strategjinë edhe se si do ta hiqte qafe pa asnjë mëdyshje dhe, kur ia tregoi vlonjatit se ç'hall e kishte gjetur e ç'djersë i pat rrjedhur në lugun e kurrizit pak çaste më parë, tjetri, një kriminel me damkë që s'i bënte syri dritë nga njeri e që flinte gushë më gushë me paturpësinë, ia pati kthyer me mërzi:

- E paske dhjerë fare, Nand vëllai!

- Po,- pranoi Nandi,- veç për shën Llesh do ma shohë prapë surratin ajo!
Por Nandi nuk u nda dot nga Zana, nga ajo grifshë që të thithte të gjithin

në shtrat dhe që s'njihte asnjë turp, kur flitej për atë plaçkën. Zana u bë bishë sapo kuptoi synimet e Nandit. Për Gencin e pati zënë turpi atë?! Për atë zagarr që harbonte si t'ia deshte kokrra e qejfit dhe as çante kokë se ishte edhe ajo, gruaja e tij, e gjallë në këtë botë?!...Ajo e urrente Gencin kush e di për ç'arsye, ndoshta nga cinizmi i tij i pashoq, apo nga inati se ai piktor i talentuar zhdukej nëpër ekspedita me muaj të tëra, se s'kishte, pra, diell, shi, pyll apo liqen në Tiranë, dhe i prishte lekët që fitonte me një barrë qejf me ato modelet e veta vogëlushe, pa llogaritur ndonjëherë se ajo nuk i kishte thyer këmbët akoma dhe që betuar dikur plot patetikë, si ato aktoret mizerabël të Teatrit Popullor, në Gjendjen Civile, se do ta donte gjithë jetën...Më ler rehat me gjithë atë egoist të qelbur, i pat vënë kapak bisedës ajo, por, me atë nuhatjen e saj që nuk e lejonte kurrë të gabonte, bëri si bëri, e futi Nandin në shtrat, i kërcëu sipër dhe, kur e lëshoi, tjetri e kishte ndarë mendjen se nuk ishte punë që bëhej të ndahej me Zanën. Kur ajo nuk pranonte të bisedonte me burrin e saj, ç'i duhej atij të ngatërrohej në këtë mes? Dhe kështu vazhdoi kjo histori, megjithëse Nandi tani ruhej diçka më tepër nga sytë e opinionit. Veç të gjithë e dinin si që e vërteta dhe s'kishte njeri t'i thoshte Nandit "mirë e ke, o vlla!" Tani, edhe sikur Genci të mos shkonte në shtëpi, atij nuk ia vinte fajin njeri. E gjithë plateja me gjithë llozhë ktheheshin nga Nandi...Atij nuk ia harronte njeri që kishte tre vjet duke ia hypur asaj kuçkës.

Genci nuk u ndje më pas asaj bisede të shkurtër. Ai thirri vjerrën e tij të banonte në apartamentin e tyre e të kujdesej për fëmijët dhe vetë zhdukej me muaj të tërë andej nga bregdeti, ku punonte vërtet ca peizazhe të ngrohta, plot dritë e trishtim. Kur nisën eksodet e mëdha e më pas, kur u vendos demokracia në Shqipëri, Zana iu lut Allahut, e shtrirë si lopë në dysheme, që ai të zhdukej në ndonjë cep të botës e mos bëhej më i gjallë. Ia dinte kokën dhe ai, bohemi patologjik, ia mbathi vërtet, por, kur u shfaq përsëri në kryeqytet, ishte bërë piktor i njohur edhe në atë dynja, me ekspozitat që pati hapur në Zvicër e Angli, dhe, siç flitej, tani kishte edhe depozita bankare. Duhet të ishte mirë fare, derisa ai u ul edhe një herë për të biseduar me Zanën. U bë ç'u bë, ia pati nisur ai, s'ka rëndësi i kujt është faji, hajde ta fillojmë nga e para gjithçka. Kemi dy fëmijë, të paktën për ata t'i kapërcejmë ca gjëra...Zana e dinte se ai nuk jetonte dot pa fëmijët. E dinte se ai nuk ishte tip që gëlltiste, por divorcin nuk e çonte në mendje vetëm për hatër të fëmijëve, ndaj e preu bisedën shpejt me Gencin...Unë të jetoj me ty, ishte ngërdheshur. Ti, shko bëj tablo e jeto me ato modelet e tua cicëmëdha dhe mos më gri veshët shumë, pat përfunduar brutalisht.

Genci nuk e kishte zgjatur më. Tani s'vinte më fare në shtëpi. Mblodhi kujtimet e rraquet e domosdoshme, që gjendeshin ende në apartament, dhe tani ajo dëgjonte diçka për këtë njeri vetëm nga fëmijët apo gazetatat. Megjithë urrejtjen e parrëfyer të asaj bishe për Gencin, fëmijët e deshën babanë e tyre, që kishte aq

shumë miq e shokë e që nuk i dilte kurrë fjala "s'ka" nga goja. Edhe në shkollë ata i mbante zap vetëm Genci, respekti për atë njeri që shfaqej atëherë kur nuk ta priste as imagjinata më e zhvilluar, se, po të ngelej kjo punë për Zanën, sado dorë të gjatë të kishte ajo, rrezik mur në këmbë nuk do të mbetej në shkollë! Ata nuk ia falnin nënës së tyre që ua pati sjellë jo pak herë Nandin në shtëpi, kur babai kush e di nga pikturonte, dhe qenë tmerruar nga ato britmat e klithmat që vinin nga shtrati i dhomës së gjumit, nga ai shtrat që babi ia kishte pikturuar ballinën aq bukur me duart e veta.

Vetë Nandi e ndjente se qe zhytur në gjynah, por nga kthetrat e Zanës nuk dilte dot, nga ato kthetra bishe që e ruanin atë, prenë, si sendin më jetik. Nandi u përpoq një herë ta bënte dalje, kur sajoi një shërbim të gjatë inspektimi andej nga Kukësi, po Zana i kërceu autobusit e erdhi deri në Kukës dhe të ketë ngritur një furtunë në atë qytet të vogël, që veç ai Zot e di se si Nandi nuk vdiq nga turpi. Ia kishte flakërirë ca shpulla një koleges së tij kot fare në mes të restorantit e faqe gjithë miletit, vetëm se dyshoi që Nandi ia pati mbathur nga Tirana që të bënte orgjira me këtë zogun e ri dhe nuk kishte shenjtor, që ajo besonte, t'ia mbushte mendjen se tjetra nuk ishte kurvë, si puna e asaj vetë...

Pas ngjarjes skandaloze në Kukës, Nandi qe dorëzuar e pat rënë rob i fatit të shkruar, veç, thellë-thellë, ai e ndjente se shokët e shumë të qenë larguar. Ata kishin gra dhe s' donin ta bënin pis emrin e tyre për hatër të një sentimentalizmi absurd. Kështu pat hyrë, si pa u marrë vesh, vetmia në jetën e këtij njeriu e më pas mëma natyrë i bëri peshqesh edhe sëmundjen e zemrës, një sëmundje e trashëguar, sipas mjekëve, e që e detyroi Nandin ta mbushte kokën e komodinës plot me ilaçe. Pavarësisht se ai la duhanin e alkoolin, Zana nuk iu zinte besë mjekëve. Ajo mendonte se ai kishte zemrën më të fortë në botë, që, po ta vije si motopompë në liqenin e Shkodrës, e hidhte naftën pa frikë deri në Mal të Zi! Ajo i kërcente sipër Nandit përballë shisheve e tabletave që të ngjallnin krypën dhe nuk zbriste pa ia thithur edhe forcat e fundit hamshorit të saj. Ishte xheloze e llahtarshme dhe veç në dy vende i punonte mendja ditë e natë: s'dinte si t'ia merrte penisin dhe ta mbante të mbyllur në shtatë kasaforta ajo vetë, pa harruar edhe armiqësinë me spermën e tij, që rigjenerohej si me magji... Por edhe ajo në shtrat ishte ustalleshë dhe të bënte t'i luteshe Zotit që, nëse i mbushej mendja të të merrte ndonjë ditë, le të të merrte në krevat, me Zanën...Ikje i ngopur, jo për gjë...Seksi e saj, tek e fundit, nuk e bënte shumë të vetmuar Nandin. Rrallë atij i kërcenin xhindet me këtë dosë të panginjur, me gjinjtë e ngritur lart nga epshi e vithet e kërcyera si strehë, dhe atëherë ai e kafshonte në gjinj e supe, sa e bënte gjak, po kjo e ngopte më shumë Zanën, që fillonte e klithte me të gjitha fjalët e pasthirrmat që kishte në kokë, sa eksitonte gjithë lagjen: "Ashtu, shpirti im! Më fort!..."

Ja, në këtë rutinë rrugëtonte jeta e tyre, e izoluar nga jeta e kryeqytetit, i

cili kishte filluar t'i ndryshonte vrellshëm tani sjelljet; kjo ishte jeta e tyre, një trëndafil që vinte aromë sperme, me një "ku rafsha, mos u vrafsha", qejf sot, se ku i dihet si e kemi të shkruar të nesërmen...Kështu, derisa arriti ajo pasmesnatë korriku, kur Zana i ra me alarm ziles së derës së Nandit e ku fjalët e saj ngatërroheshin me një këngë gjeli. Nandi shtangu, kur e pa. Jo ora e pazakontë, por edhe ajo huti e zbardhje e Zanës, e këtij njeriu që nuk e njihje prej kohësh zbardhjen e zverdhjen, ia çoi mendjen për keq Nandit.

- Kush ka vdekur?- pyeti na vetëdije ai. Dhe gati-gati i ra në të.

- Genci!- tha ajo dhe u këput në kolltuk. S'kishte fuqi të fliste, vetëm shihnte si idiote diku nga skaji i dhomës.

Nandi nuk lidhte dot asgjë. Tani mund të ndodhte gjithçka në këtë qytet, ku ishte bërë modë të vritej njeriu e, sa për grabitjet pa gjak, ato konsideroheshin lule.

- Fol, se s'po marr vesh asgjë!- tha Nandi.

- Genci, Genci,- përsëriti si e goditur dhe pa asnjë ndjenjë ajo. As po e vras mendjen për atë qelbanik, fliste ai ton, po si t'ia bëj hallit faqe botës. Genci ishte përplasur dy orë më parë me makinë, diku nga Vora. Mezi e kishin identifikuar. Tani ndodhej në koma dhe askush nuk besonte se ai mund t'ia hidhte kësaj rradhe...

Nandit iu përsërit ajo marrje fryme e ai shtrëngim në gjoks, që tani dukej si një gjë e kapërcyer. U ndje menjëherë i këputur e rraskapitur bashkë, por nuk u shtri, që mos merite gjë vesh tjetra. Veçse ai e dinte se me ç'heroizëm po mbahej më këmbë.

- Nisu urgjent në spital!- urdhëroi ai.

- Unë në spital? Mos e dhëntë Zoti!...

Nandit po i visheshin sytë dhe kjo femër e kolme përballë tani sikur kishte veshur ca rroba të gjelbëra në të verdhë. Ai u ul ngadalë në kolltuk, priti t'i largojë ajo dalldi e tmerrshme, pastaj shqiptoi edhe një herë shkoqur:

- Ik menjëherë në spital dhe mos u duk më këtu, pa u ndarë puna atje: do jetojë, apo do të vdesë! Ik!- dhe ai bëri një shenjë me dorë, si punë "qërrohu", që Zanën e tmerroi fare.

Ishte hera e parë që ai mashkull i zbutur tashmë e pajtimtar i fliste me këtë gjuhë dhe ajo e ndjeu se duhej ta dëgjonte, përndryshe...Duhej ta luante edhe një herë rolin e gruas së moralshme të atij maskarai me tru të shpërndara e hemisfera mangut në inventarin spitalor, që kush e di ç'broçkulla pralliste tani para mjekëve dhe infermiereve zuska. Psherëtiu një herë thellë, tha "mirë" dhe doli kokëulur, kurse Nandit, të mbaruar tashmë, i ngeli në mendje ajo fjala "mirë" e saj. Përse e kishte shqiptuar atë fjalë? Mirë, do të shkoj në spital? Mirë, që do na lerë shëndenë? Mirë, qetësohu, ti, se, më çpofshin mua, në vajtsha në spital? Apo, MIRE, se nuk

prisja gjë tjetër nga një sakat kristian si puna jote?...

I pranguar keqas nga këto fjali, Nandi nuk arriti të vinte gjumë në sy deri në agim. I kujtohej e stërkujtohej në dhjetëra variante ai takim vrastar me Gencin, xhentilesa dhe kavalierizmi i paimagjinueshëm i piktorit të briruar, flohtësia dhe mirësia e atij njeriu të rënë në mut, jo në hall, turpi dhe toleranca... Pastaj kujtonte veten se sa pis ishte treguar kur e ngacmonte me ato thumbat e tij helmues Zanën në rrugë, këtë Zanë që atëherë ecte kokëulur dhe nuk ta jepte kurrë përshtypjen se ç'pasion dhe hakmarrje fshihte brenda vetes. Duhej nuhatje zagari për të ndjerë se ç'gjah i majmë seksual fshihej paç asaj Zane, në dukje femër e zakonshme, gjë që atij nuk i kishte munguar kurrë. I kujtohej se si i pati ardhur vërdallë aq kohë, si i rrëshqiste tjetra pa folur, pastaj si ia kishte ngritur kurthin në autobusin e linjës së Kombinatit të mbushur plot e përplot, si kishte çarë me mundim të pashoq deri tek ajo, si i qe ngjitur tërësisht në trup, gjoja i shtyrë nga njerëzit e shumtë, si i pëshpëriti në vesh "po më luan mendsh" dhe si qe detyruar ajo ta dëgjonte pa bërë zë e pa pasur asnjë mundësi shpëtimi. Vetëm një fjali mëkatore pat lëshuar Zana, të cilën ai e kishte mbërthyer fluturimthi që në ajër, një fjali të shqiptuar gati me dënese: "Të lutem, pse më torturon kështu? Unë jam edhe e martuar..." Nuk vendoste distancë ajo fjali dhe Nandi i qe qepur më keq. Kudo i dilte para syve, iu bë shprehi, deri sa e bindi të pranonte një ftesë për të ndjekur së bashku një film në kinemanë "Ali Demi"... Ku bie kjo kinema, e pati pyetur e habitur ajo. Bie afër shtëpisë sime, i kishte thënë me vete ai, ndërkohë që i shpjegonte vendndodhjen e kinemasë tjetrës. Mëdyshja e madhe e Zanës, pritja e kotë herën e parë, pastaj figura e saj që vinte kokëulur nga ura e Lanës, një shenjzë e saj "futu, ti, i pari në kinema!", ajo hyrja në sallë ilegalshe e hajdutshe bashkë, bisedat dhe fillimi idiot i atij filmit rus të prodhuar në kohën e gurit, e qeshura me zor e të dyve, ajo fërgëllimë e përbashkët që mbushte edhe ajrin me elektricitet dhe ai përqaftim i egër i tij, lutjet e saj "Nandi, mos xhan, të lutem, ç'po bën, Nandi?...", pastaj lëshimi i plotë i Zanës në krahët e tij. E braktisën atë film pa filluar mirë dhe pas dy minutash ishin gjendur në apartamentin e tij. Ajo i kishte kërkuar premtimin më të shenjtë se po i shkonte në shtëpi vetëm për një kafe dhe për të mos e fyer dhe ai i qe përbetuar se nuk do ta ngacmonte, por, me t'u mbyllur dera e lyer me bojë vaji bezhë e me të kërcitur shuli i ndryshkur në të, ai i qe vërsulur si bishë. E kishte xhveshur hap e mbyll sytë, a thua ishte një veshës e xhveshës topmodelesh dhe, kur konstatoi se Zana ishte pa gjimbajtëse, e kishte ndjerë se Zana pati ardhur e përgatitur për të fjetur me të. E kishte dërrmuar atë paradite me aktet e një-pasnjëshme, ajo i qe dhënë bujarisht e tëra, kishte bërë gjithë ç'i kishte lypur brutalisht ai, e kishte lëpirë e qe kthyer si manekin në ç'do pozicion që kërkonte ai, pastaj, në fund, kur Nandi kishte lëshuar trupin e lodhur krahëhapur nga kënaqësija e triumfi në shtrat, Zana kishte shpërthyer në dënese të rënda. Atë kohë ajo nuk i

kishte fort të këqija marrëdhëniet me Gencin. Vërtet nuk e gëlltiste kollaj ftohtësinë dhe arratisjet e vazhdueshme të të shoqit, por, sidoqoftë, atë të gjithë e respektonin dhe ai nuk ishte negativ. Nandi ishte i pari princ i kaltër, me të cilin ajo përdhoste familjen. Ai ishte përpjekur ta qetësonte pendesën e rëndë të Zanës, ama, përbrenda, tek e shihte se si i binte ajo murit me kokë duke ulurirë “ç’bëra, unë, ç’bëra!”, pat menduar se ajo nuk do të vinte më. Mirëpo kishte gabuar. Ajo erdhi përsëri pas dy ditëve, me një pamje krejt tjetër dhe hyri në një mënyrë të tillë në shtrat, sa që Nandi ishte habitur. Atë ditë ishte bërë ai kukull në duart e saj dhe, kur ajo i kishte hypur sipër pas orgazmës së tij të tretë, ai kishte lutur Zotin të mbaronte sa më shpejt kjo punë, sa pa u turpëruar. Po ajo ishte aq delikate dhe e rafinuar, aq e ngrohtë e epshndjellëse, aq e vendosur për ta çuar të vetën deri në fund, sa...

E ku nuk i shkoi mendja dhe çfarë nuk mendoi ai njeri gjithë natën, duke kapërdirë gjithfarë ilaçesh e duke matur mijëra herë pulsën. Mendohej ta përfytyronte Gencin fashuar nga çdo anë në spital, uronte gjithë shenjtorët që ai të shpëtonte, duke u betuar e stërbetuar se në fund të botës do të shkonte dhe asaj femre nuk do t’i dilte më përpara, që sikur ishte bërë casus belli tragjik për konstruktimin e tragjedisë së Gencit. Në mijëra mënyra bëri alibinë e vetvetes dhe gjithmonë një zë i brendshëm i pëshpëriste se fajori ishte ai dhe gjynahet e kësaj natyre lahen shumë shpejt në këtë botë. Aty nga paraditja arriti ta qetësojë veten dhe puls i sikur iu normalizua, por ndjehej tmerrësisht i lodhur dhe as për t’u rruajtur nuk kishte fuqi. Ndoshta do ta kaptonte gjumi e kështu do t’i normalizoheshin disi gjërat, por pikërisht atëherë ia behën njëri pas tjetrit dy miq të tij...E more vesh?...Genci...Të kemi kërkuar në gjithë Tiranën...Ne menduam se e dije...

Ata e dërrmuan fare Nandin.

Përse duhet të trokisnin në derën e tij për t’i dhënë lajmin kobzi pikërisht atij të parit, se Genci po vdiste në spital? C’punë kishte ai me piktorin?...Ai pyeste e ripyste vetveten, përpiquej të justifikohet me njëqind filozofime, por e vërteta apo e gënjeshtra tani ishte solide dhe qëndronte si Sfinks para tij: shokët e tij i kishin ardhur në shtëpi, pra, ai lidhej në një mënyrë themelore me atë që po i ndodhte Gencit. Kjo u shpall! Ishte fare e qartë! Tani e gjithë Tirana po përgojonte emrin e tij si shtytsin e vdekjes së Gencit...

Kaq duhej që atij t’i fillonin përsëri dhimbjet torturuese e tmerrfutëse të kraharorit. Nga ky çast ai filloi të bashkëjetojë me Gencin. Iu krijua ideja fikse se vdekja e tjetrit do ta merrte edhe atë dhe u lut e u përgjërua që tjetri t’ia hidhte vdekjes. I vetmuar, i shurdhër ndaj ziles, që binte herë pas here, Nandi nuk u çua më nga shtrati. Ndihej i pafuqishëm dhe i dukej vetja sikur ndodhej mbi kokën e Gencit e s’duhej ta linte në asnjë mënyrë vetëm. Edhe një herë që tentoi të ngrihej për të marrë një gotë ujë, kur iu krijua përshtypja se tjetri lypu ujë, u përmbys në mes të dhomës. Atje urinoi në mënyrë të pavullnetshme, në mes të dhomës, pastaj,

kur po errej, zvarrë-zvarrë shkoi deri në shtrat. Kur e gjetën të nesërmen miqtë e tij, që vendosën të shqyejnë derën, kthetrat e duarve i kishte të mbledhura në gjoks. a thua kishte dashur të çante kraharorin për t'u mbushur me frymë. Mjekët e përcaktuan vdekjen nga një infarkt tepër i gjerë rreth orës pesë të mëngjesit. Kishte mbaruar afërsisht në atë orë e minutë kur ishte dorëzuar edhe Genci në atë pavion urgjence në periferi të kryeqytetit. Kufomat qëndruan tridhjetë orë afër njëra-tjetrës në morg dhe një Zot e di nëse arritën të komunikojnë mes tyre dy trupat pa jetë. I varrosën në të njëjtën ditë e në të njëjtën orë në të njëjtën varrezë, por në parcela të ndryshme. Zana, e cila nuk mori pjesë në asnjë prej funeraleve që tronditën kryeqytetin e përgjumur, dëgjoji më pas se, ndërsa te Nandi nuk kishin qenë më shumë se njëzet njerëz, te Genci kishte qenë një funeral madhështor, ku mijëra njerëz kishin përcjellë atë që shtypi e kishte cilësuar si diellin e shkëlqyer të pikturës shqiptare.

Brenda pak muajsh Zana u tkurr e u plak. Kishte qenë si biçim femër leshi dhe, me ta futur një herë në ujë të përvëluar, ishte mbledhur e bërë grusht. Tani nuk dukej më asnjë shenjë nga ajo femër deri dje me seks të tatuazhuar mbi ballë dhe, ajo më e keqja, askush nuk dëshironte t'i fliste në rrugë. Dy muaj pas apokalipsit zanor, ajo shkoi te varri i Nandit. Ishte një muzg i ngrohtë, nga ata që i pëlqenin Gencit dhe ajo, si e gjeti varrin e Nandit, u ul, ia puthi dheun me gurin e kokës, pastaj u shtri mbi varr dhe vuri kujen...C'më bëre, o i miri im, përsëriste vazhdimisht si e goditur, ku të mbytem unë tani?...Ja tregoi shtruar gjithë ç'po hiqte, iu lut tjetrit ta merrte atje brenda me vete, por vetëm heshtje dhe një flakërimë qirinjsh mbretëronte përreth.

Te Genci nuk u kthye. Vazhdonte ta urrente pafundësisht atë mashkull cinik e të pandreqshëm, që edhe i vdekur po ia nxinte jetën. I qe mbushur mendja se ai aksident idiot pijanecësh e vrau Nandin, që ishte mirë e bukur. Po, ai flijim idiot e primitiv ia mori jetën Nandit të saj!...E urrente përjetësisht Gencin! Ai i kishte bërë të gjitha llogaritë deri më një që ta shkatërronte atë, i kishte bërë në mënyrë të përsosur, sikur ta dinte se vdekja do të vinte shumë shpejt dhe atë duhet ta gjente me një arsenal të tërë poshtërsish për ta çuar deri në fund shkatërrimin e madh të stërendërruar...

“ Pikturat e mia të mbahen në ruajtje në Galerinë Kombëtare të Arteve dhe t'iu kalojnë në pronësi e administrim të plotë fëmijëve të mi Alban dhe Mirela Genc Kondo, pasi ata të kenë mbushur moshën 25 vjeç. Ndarja e pikurave të bëhet si vijon...-shkruhej qartë në testamentin e tij.- Rrjedhjet e mia bankare të depozituara në Shqipëri dhe në Zvicër të ndahen mes fëmijëve të mi, pasi ata të kenë përfunduar studimet universitare, ose, në rast se...Gruas sime, Zana Kondo(Plaku) i jap bekimin tim të bashkëjetojë me kë të dëshirojë, deri sa ajo ta shohë të arsyeshme...”

Këto ishin fjalët e fundit të atij testamenti pis. Fjalët u lexuan thatë nga avokati i Gencit. Ai nuk i ngriti sytë asnjëherë për ta parë Zanën.

KANË, KORRIK 1995

PLAKU I MARTINIT

Jaku duhet të kishte lindur në fund të shekullit të kaluar, ose në zgrip të këtij shekulli, saktësisht askush nuk dinte gjë. Ai ia kishte mbathur herët nga fshati i lindjes, i strukur mes Alpeve dhe, vonë, kur u prishën kishat e xhamitë, u dogjën edhe regjistrat e famullisë, ku qe regjistruar nga një pater plak edhe lindja e Jakut, plakut të Martinit. Martini ishte fjalëpak, por vetëm për të atin i hapej goja dhe ai më pat treguar me orë të tëra në galeri e në kapanonin e burgut për atë burrë të çuditshëm. Më vonë, unë e njoha personalisht plakun e tij, kur u lirova nga burgu e i çova një letër të Martinit. Atëherë ai ishte keq, me cerozë, dhe mjeku më tregoi se Jaku po sfidonte vdekjen, që duhej ta kishte marrë me kohë, vetëm sepse priste Martinin. Dhe më e bukura ishte, se ai vazhdonte të pinte alkool, si gjithmonë!

Martini ishte fëmija i shtatë i atij burri, që organizonte jetën e asaj familjeje të varfër në mënyrën më perfekte. Ai kishte lindur për t'u bërë gjeneral e parashikues bashkë. Vështirë ta kapje gafil e ta çudisje, për mos thënë pastaj atë idealen, që nuk ia pati hedhur kush në jetë. Që fëmijë, ende pa e hedhur mirë pushkën në sup, ai hartoi një plan të tërë magjik se si mund t'i zhdukte të gjithë meshkujt e fisit në gjak me fisin e tij dhe e realizoi pa iu dridhur as syri e as gishti. U ngop me gjak e, kur s'kishte nga t'ia mbante më, veshi vëllanë xhandar e vetë ia mbathi ushtar në Himarë. Kështu shpëtuan nga ajo masakër, që nuk do të mbaronte kurrë nëpër ato pyje e shpella pa fund, ku nuk kishte perëndi ta merrje vesh se nga të vinte plumbi e ku këmbanat binin për të prekur pyjet e bredhave.

Në Himarë Jaku shkoi pa një napolon flori në qese, por, si e studjoi terrenin me ato sytë e vet të përgjumur në pamje, pas një muaji iu ngriti fill i vetëm pusi ca

kontrabandistë grekë. Atij i pëlqenin grackat pa dëshmitarë, i dukeshin më të lehta për t'i harruar. Ishte e kotë të ushqeje shpresa se mund t'i shpëtoje Jakut! Ai i xhveshi grekët, siç dinte Jaku, natyrisht, mbathjet ua la, dhe i paralajmëroi mos t'i gënjente mendja se mund të bënin tregti në këto anë, pa i lënë më parë taksën atij. Ai fjalën ia jepte vetëm vetvetes dhe asaj i qëndronte besnik. Dhe kështu i shkuan punët fjollë në atë qytezë plot njerëz të shkolluar e vajza të bukura. Jakut i pëlqenin të dyja këto gjëra, bashkë me verën me nam të Himarës dhe ai gjeni i pashkollë vendosi të paguajë një mësues, për të mësuar shkrim e këndim. Vuajti pak, pagoi një garruzhde me napolona flori, qorroi sytë mbas shkronjave, por pas një viti ai dinte të lexonte si bilbil. Kjo puna e leximit iu duk arritje e madhe. Ai e preu me radaken e vet se tani nuk i mungonte asgjë dhe e ndau mendjen të martoej. Në Himarë shumë vajza e njihnin mirë portretin e tij hollak, si prej cigani, që iu shfaqej si maçok mesnatave në dritare e të kërcente drejt e brenda në shtresa, edhe sikur ta kishe pushkën çarkngrehur. Ku kish tym e ku lehte qen, do ta gjeje Jakun! Jaku e dinte se në këto anë e haje plumbin tak-fak për këto lodra, po atij i shijonte dashurija, kur rrezikonte! Nuk bëhej dashuri pa e pasur një vesh te dera, një sy në oborr e një të dhjerë nga frika në majë të bythës! Për Jakun, dashurija e vërtetë ishte si puna e kukurecit, shijonte, kur mbante pak era ashtu!...

Po edhe himarioteve iu pëlqente ky djalë trim, që fliste një gjuhë gati të pakuptueshme e që, ta vrisje, nuk përgojonte asnjëherë. Por, që ishte lugat, lugat ishte, e as në kishë nuk duhej të bëje gabim t'i uleshe pranë, se në çast ia ndjeje dorën poshtë fustanit, pa llogaritur pastaj se ai nuk mund të bëhej me faj, po të flije me dritare hapur natën!... Të mira ishin himariotet dhe Jaku, jo vetëm nuk i shante, po ua dinte edhe për falemners për atë goxha plaçkë, që ia jepnin bujarisht me qera, sa herë ua lypte, veç atë nuk e ngrohnin për kurorë. Ai e mendoj gjatë punën e vajzës së priftit, një belhollë e gjatë, që bënte edhe këmbanat të kumbonin vetë, kur bënte atë punë, po Jaku e gjykoi veten se nuk ishte qen, që të dhiste në derë të kishës, dhe kështu ia dha duart edhe asaj...

Harram i paç ndjenjat e mia për ty, e mallkoi vajza e priftit atë natë, kur Jaku ia bëri të qartë vendimin e tij...

Jaku mendoj se tjetra e shau dhe, ja, tek e mallkoi edhe ai, kundër zakonit të tij paqtor:

- Harram edhe, ti, spermën që kam harxhuar për ty!...

I fluturonte mendja andej nga ato malësoret e tij syulura dhe, si u lirua nga ushtria, Jaku u kthye në Shkodër me ca lekë. Bleu pak tokë e një pajton, ngriti një si biçim barake, iu lut një prifti, mik me kokë i babait të tij të ndjerë, që t'i gjente një nuse dhe, merret vesh, u martua. Po veshët i mbante ngritur nga frika e hasmit. Andej, nga stanet e tyre nuk ndjente lehurina qensh dhe atij nuk i pëlqente kjo gjë. S'ia vlente të pirdhje si ujk në mes të Shkodrës, kur lart, në male, hasmit

e merrnin kafën nën gju...Ja ndjente erën pusisë rreth vetes dhe e dinte mirë se hasmi kishte të drejtë mos t'ia harronte surratin Jakut, që e pati pasuruar varrezën e famullisë së fshatit me katër burra nga fisi i armiqve tradicionalë të fisit të tij. Në atë zymtësi lufte, me gjermanë, ballistë e partizanë nëpër këmbë, Jakun e kërkuan një natë ca malësorë t'iu transportonte me pajton një pajë deri në Pulaj. Nuk i njihnte, por kur i treguan shumë që do paguhej, ai njeri i rritur me ujqërit në male e peshkaqenët në det, dyshoi. Ishte trefishi nga ç'paguhej rëndom dhe Jaku nuk tha "Jo", ama, pushkën e futi nën sedilje. Ushqeu mirë kalin dhe në mesnatë u nis. I mbajti veshët ngritur si lepur gjithë rrugës, paqsa se duhej t'ijepete muhabet edhe shoqëruesit. Pa dalë mirë nga bregu i Liqenit, sytë e tij prej maceje në shkurt panë që shkurret po lëviznin dhe, pa u ngritur mirë tytat kundër tij, ai e kishte vrarë me një plumb të vetëm në gojë shoqëruesin përbri e ia kishte përmbledhur edhe hijes së parë në rrugë. Dëgjoji një klithëm "më vrau, he, burra!" dhe nuk iu drodh gishtit hiç, kur shtiu edhe mbi tjetrin, që po tërhiqte të shituarin nga rruga. Pastaj preu rrypat e karrocës me bajonetë, i kërcëu kalit sipër e u kthye drejt e në shtëpi.

Hasmët nuk u dukën më. Tani atyre u ngeli gjaku ndër vedi e Jaku filloi ta bëjë gjumin tamam. Kishte mbaruar Lufta e trimat e lahutave patën cofur. Edhe Jaku uli kokën. Iu shtrua punës, pinte raki përnatë e në vitin 1952, me Martinin, iu bënë shtatë kalamaj.

- Boll, Jak!- i tha nuni i Martinit.- U lodha duke gjetur emra për kalamajtë e tu!

- T'i kisha bërë edhe tre,- ia ktheu Jaku,- mbase na falte partija ndonjë lopë...

Por i vuri kapak asaj pune. Nja dy napolona i kishte veç, djemtë filluan të rriten me rradhë dhe nga një gjë e sillnin në shtëpi, kështu që Jaku nuk bëhej shumë pesimist për jetën. Tani, që nuk i ruhej hasmëve më, ai dilte çdo ditë për peshk e ca herë me rrjetë, një herë me dinamit, jo rrallë sillte ndonjë krap sa një foshnje në shtëpi, që e shoqja e gatuante tavë, e ku ngelej për të ngrënë edhe qentë me macet e oborrit. Me politikë Jaku nuk merrej. Ia dinin të gjithë hyqin dhe kush nuk pipëtinte për asi gjërash, kur pinin raki. Jaku i trembej për vdekje komunistave..."Këta s'kanë mëshirë, të rrjepin si keç, po i ngave", pati thënë një herë fill mbas Luftës dhe i ngeli besnik asaj fjale. Ai njeri, që pati dërguar me dorën e vet jo pak njerëz te i madhi Zot, nuk i harronte të vrarët e Postribës fill mbas Luftës. Gjithë ata burra i pati sharruar mitrolozi, pa i lënë të thonë edhe fjalën e fundit dhe, tek i kishte parë ashtu, të pavarrosur, të shqyer nga korbat, Jaku e ndau mendjen të hiqte dorë nga shakatë me zarr.

Po Jakun nuk e cyste, nga ana tjetër, ndonjë inat të madh me komunistët. Tek e fundit, ata ia bënë zap hasmit e llogaritë tani i dilnin mirë. Nja gjashtë a shtatë prej tyre ai i kishte kalb ne dhe, për larje gjaku, mbahej mend si ai, vetë po

i ngryste ditët në paqe me një tufë kalamaj, si kërrkush tjetër në botë, një copë pension ia jepnin, tokë ai s'kishte pasur kurrë e farë gjëje nuk i patën marrë komunistët, po të kishte qejf për liri shtypi, dëgjonte në radio "Zërin e Amerikës"...

Dhe kështu ai, plak tani, e pati bërë mendjen e vet diabolike zap! Por në shtëpi ankthi për të ardhmen e fëmijëve e bëri tiran. Po të vonohej ndonjëri, apo t'i jepte gjuhës më shumë nga ç' duhej, mund ta hante ndonjë shishe rakije kokës...

Kështu eci ajo familje e madhe, ku zëri nuk i ndihej askujt, mes martesash të një-pas-njëshme e me nipër që çapiteshin në oborr, derisa Martini i bëri gjëmën, kur ia kapën tek po kapërcente kufirin në Shirokë.

Jaku ia dhanë lajmin në klub, tek po kryente ritin tradicional të së pirës. Po këndonte atë çast me zërin e tij prej basi një këngë ashikësh...Lere këngën, Jak, i tha një polic, mik i vjetër i familjes së tij, Martini është në hall..

Ai ngeli i goditur disa çaste, pastaj mërmëriti dy-tre herë me sytë kuturu:
- Pse, mër Martin?

Dhe u ngrit i dërrmuar e mori për shtëpi. E donte veçmas të voglin, që s'hapte kurrë gojë e shkonte shkëlqyeshëm me mësimë në gjimnaz. E donte, se i dukej kopja e tij, veç zakonisht të të pirit, dhe sepse veç atij mund t'i besoje një punë për ta qepur, siç duhej...I dukej e çuditshme se si pati rënë djali i vet në grackë, ai biçim zagari me një qerre mend e me një nuhatje për ta pasur zili...

Jaku vendosi mos e kapërcëjë më pragun e shtëpisë. I urreu menjëherë komunistët, që ia futën për jetë atë filiz në ato hapsllahanet e tmerrshme, vetëm pse deshi me pa botë me sy, dhe nuk pranoi më t'ua dëgjonte emrin. Martinin ia dënuan 11 vjet...

-Kriminelat!- mallkoi Jaku, kur ia thanë...

Njëmbëdhjetë vjet! Iu dukën shumë, por ai e ndau mendjen se duhej të jetonte. Tani gruaja nuk ishte më as për punë e as për t'u urdhëruar. Ajo veç qante dhe nuk merrej vesh se ku i pati fshehur gjithë ato lotë...Fëmijët ishin me biografi të keqe dhe, po mos qëndronte kollonë ai, për 24 orë do ta merrte lumi gjithçka.

Një mbrëmje, kur gjyqet patën mbaruar e Martinin e kishin çuar në Spaç, ai mblodhi të gjithë fëmijët dhe nipërit e rritur. E vëzhgonte gjithë atë familje që i qëndronte më këmbë përballë, e vështronte ashtu, i ulur në sofër vetëm, me shishen përpara, duke menduar se kjo shtëpi për habi veç meshkuj sillte në jetë, sikur përgatitej për luftë të madhe, pastaj vendosi të flasë dhe mbajti fjalimin më të gjatë të jetës së tij:

- Tani ne jemi armiq, prandaj mbyllni gojën, se na kanë futur në shqekëz! Martinin do t'ia çojë bukën një herë në muaj Marku! Asnjë tjetër! Kushdo që t'iu pyesë për Martinin, thuajini se ai ka dërguar haber dhe është mirë. Kaq! Mos bëni zë në punë! Atë që ata do ta përzënë nga puna prej jush, e kam bërë haram dhe mos shkeli më këtu!...

Familja e uli kokën. Gjithë ai batalion meshkujsh, që ta merrnin erzin për një fjalë goje, erdhën e u urtësuan në atë farë feje, sa dukeshin si njerëz të Zotit. E morën vesh që ndodheshin në buzë të varrit dhe vendosën t'i ruhen asaj dorës që të jep të shtyrën e fundit nga mbrapa.

Tani pragun e derës së Jakut e kapërcenin veç dy miq me kokë të tij. Ata uleshin në sofër dhe pinin nga dy aranaxhata plot me raki, çukisnin nga pak djathë e ndonjë kokërr ulli dhe bënë ato bisedat e tyre të përhershme, ku asgjë nuk thuhej dhe gjithçka nënkuptohej. Po Jaku kishte rënë. Ceroza kishte avancuar shumë dhe më e keqja ishte ajo, që në tryezë tani uleshin edhe dy djemtë e mëdhej të Jakut. Edhe ata pinin dhe kështu i gjeta unë, kur dola nga burgu.

Plaku e lexoi letrën e Martinit në sofër, duke lëvizur buzët ngadalë, dhe unë e kuptova se ai duhet të kishte kohë pa lexuar më. Letra ishte pa zarf. Ajo ishte një letër e

shkruajtur nga një njeri i mençur, si Martini, që tani pati bërë nëntë vjet burg, kishte parë me sytë e vet zi, sa nuk kishte më, dhe, merret vesh, tani as i shkonte nëpër mendje ta gjykonte, se zgjidhja e vetme mbetej arratisja.

Plaku e mori vesh se Martini nuk do të bënte më krushqi me komunistët, ia nuhati gjithë mallkimet mes gërmave që formonin fjali malli, po mori vesh edhe atë tjetrën, që unë isha mik besnik i djalit të tij, dhe kështu, pa e tërrhallur vendimin gjatë, pranoi të më ulte në sofër.

- Si është?- më pyeti duke më mbushur një gotë.

- Si div,- ia ktheva,- nuk do ta njohësh...

- Po ma kthyen,- tha ai.

- Do vijë,- e sigurova,- ai nuk është budalla...Nuk i nxjerr nga goja ato që mendon...

- Qenka rritur!- vërejtí Jaku...

Nga ajo ditë, fillova ta vizitoj shpesh. Unë i qeshë kthyer zanatit tim të vjetër të kontrabandës dhe herë pas here i çoja ndonjë lek, apo damixhan me raki plakut, kështu që ne u bëmë shumë miq, por ceroza atij po ia mernte shpirtin dhe, kur e çova për vizitë në Tiranë, mjekët u habitën se si e mbante shpirtin gjallë.

- Kam një djalë në burg,- shpjegoi ftohtë Jaku.

Mjekët më panë vetëtimthi.

Unë pohova me kokë. Pastaj, në atë heshtje bezdisëse, iu tregova shkurt të vërtetën. Jaku qëndronte i ulur në shtratin e vizitave dhe kërkonte nëpër xhepa kutinë e duhanit.

- Mirë nuk je, por, po e rrallove rakinë, do ta takosh djalin!...- i tha, si mbarova unë, me zë të tjetërsuar njëri nga mjekët.- Dhe nuk duhet të mërzhitesh, xhaxha, nëqoftëse nuk do që të ikësh pa e parë më djalin, megjithë hallin e madh që ke!

- Qofsh i bekuar!- e uroi Jaku dhe ne u ngritëm.

Merret vesh, Jaku e shtoi të pirën. Tani edhe i shpëtonte ndonjë lot, kur më shihte në prag dhe një ditë e pashë që kishte veshur rrobat e Martinit. Ato ishin të një mode të vjetër e binin era ilaç kundra molës dhe dukeshin nga palat e thella e të shpërndara kuturu, që sapo ishin nxjerrë nga sënduku.

- Në 12 prill Martinin do ta sjell në shtëpi!- i thashë plakut, me ta parë në atë gjendje aq të dëshpëruar. E shkela betimin e bërë se, pa e futur Martinin në makinë, nuk do ta lajmëroja familjen e tij. Pata frikë se Jaku po mbaronte.

Ai ishte keq, aq keq, sa nuk do të habitesha, po të ishte duke biseduar me vdekjen atë çast.

- Plakun nuk duhet ta gënjejë njeri!- më tha ai.- Nuk ia vlen, biri im!...

Unë iu betova se nuk po e gënjeja. Kisha ruajtur një lloj miqësie me komandantin e burgut dhe ai më dërgoi lajm që t'i përgatisja familjarët e Martinit.

- Jezu Krishti na dëgjon,- tha plakun,- qoftë i lëvduem, po ma solli djalin në shtëpi!...

Një pragmatist fanatik deri në vdekje kishte mbetur Jaku dhe ia ktheva me të qeshur, se po hynte në mëkat, duke folur ashtu...

- Edhe ai bëri mëkat, kur ma mori Martinin,- m'u kthye Jaku,- ai i di dhe i shikon të gjitha. Atëherë, pse nuk ia tha një fjalë në vesh?...Mirë, ta zemë se Martinin nuk pati qejf t'ia kumtonte lajmin, po policëve pse nuk ua tha?...

Unë i luta mos e tepëronte me raki deri më 12 prill. Martini nuk do t'ia falte, po mos ta gjente gjallë. Po Jaku më siguroi se nuk e kishte bërë ndërmend të vdiste. Donte t'i thoshte diçka Martinit kokë më kokë, pastaj, Zoti i madh e dinte...

Më 12 prill unë e prita Martinin me taksì te dera e burgut, e atij burgu, që më bënte të më rrëngqethej trupi, kur ia kujtoja erën...I durova gardianët, bile edhe i qerasa me cigare, kur u tallën e më thanë se këtë herë paskam ardhur vullnetarisht në burg, dhe më erdhi për të qarë, kur pashë gjithë atë Martin, kokërruajtur, tek po vinte me një trastë krahaqafë drejt meje. E përqafova, i thashë që nga shtëpia qenë të gjithë gjallë e po e prisnin, e dëgjova kur u përshëndet me gardianët e i uroi "iu priftë e mara", i dëgjova edhe ata, kur e uruan mos kthehej më në atë ferr dhe mora frymë i lehtësuar, kur dëgjova zhurmën e motorit të taksisë.

Martini u ruajt nga shoferi dhe gojën e hapi veç në Milot, kur ne ndaluam për të pirë një kafe. Ai më tregoi për gjithë ata që kishin vdekur, gjatë mungesës sime në burg, më tregoi duke gëlltitur lotët se si patën mbaruar burrat të thyer më dysh nga torturat, si qenë tretur pleqtë pa një aspirinë në atë hapësirë dërrasash, që quhej shtrat, m'u lut mos harroja se ata qenë varrosur poshtë gorricës së egër, buzë humnerës së kampit, dhe unë mendova se ai qe kthyer prapë te mendja e parë, arratisja. Po Martini më qetësoi, kur më tha se nuk donte të qëndronte më në Shkodër...Për me ik, nuk bëhet fjalë, shtoi, dhe ai nuk qe burrë që mashtronte!

- Druhem se do më marrin prapë,- më tha.- Më mirë të humbas andej nga Tirana...Kam dhe do miq atje, besoj se do ma japin një dorë...

Kishte të drejtë dhe po këtë fjalë pati ruajtur për t'ia thënë edhe Jaku. Kurrë nuk e kuptova se si kishte arritur në këtë përfundim një plak, që po bënte mbi dhjetë vjet pa e kapërcyer pragun e shtëpisë. Ata i dhanë dorën njëri-tjetrit në oborr, si të qenë ndarë dy orë më parë, Jaku i kumtoi gjithë ç'kishte për t'i thënë në dhjetë hapa rrugë dhe, kur ne hymë brenda, Martini dinte gjithçka.

Brenda prillit plaku ra menjëherë. Unë e rregullova me miqtë e mi që Martini të fejohej në Tiranë. Ai hyri në një shtëpi të mirë , gjeti një palo punë, sa mos figuronte më si parazit, dhe ia mbathi pa zhurmë nga Shkodra. U kthye vetëm kur e lajmëruan se plaku po mbaronte. I ndejti tre ditë te koka, e lau vetë dhe, pas funeralit, më mori veç:

- La ndonjë amanet?- më pyeti mua.

- Jo!- i thashë.- Vetëm kohët e fundit ishte bërë shumë i butë, sikur t'i rëndonte një ndjenjë të madhe faji, dhe, kur i thashë se s'kishte pse me u bë pishman, kur gjithë Shkodra e kujtonte për mirë, e di si m'u përgjigj? "Boll i keq kam qenë, Matish, po burrë më të mirë se veten nuk hasa kund në këtë vend!"

Martini qeshi.

- Më qafsh, si tha?- m'u lut t'ia përsërisja edhe një herë fjalët e të atit. Ia përsërita, duke qeshur edhe unë.

Martini u var në një degë mani për të shkrifur kokat, ndejti një hop ashtu, në hava, në një pozicion, ku jeta e kishte mësuar të qëndronte në ekuilibër perfekt, pastaj u lëshua në tokë dhe qeshi prapë, duke tundur kokën me admirim.

- Na i paska futur sa krahu!- tha pastaj.

PRILL, 1996

NON SENS

Katër vjet më parë, kur Kolit i vdiq nëna e ai ngeli qyqar vetëm me të atin, një burrë që nuk kishte skuqur një vezë në jetën e tij plot historira, unë i dëgjova lutjet e të atit të tij dhe hyra mbles për Kolin, duke menduar se familja e shokut tim të fëminisë e të shkollës do të kishte nevojë për një dorë të fortë gruaje. Koli, një kopje me kopjativ e të atit, i mbeti besnik origjinës së tij: më tha se, po të më pëlqente mua nusja, ai ishte dakort, pa e parë fare, bile, për atë do të ishte lumturi edhe sikur ajo mos pranonte ta njihje para martesë dhe se ai ishte gati ta fuste në shtëpi edhe po t'ia çoja mbi kalë me një duvak mbi kokë! Nga Sokolinua priteshin këto përgjigje tejet serioze, megjithëse ishim nga 30 vjeç. Ai ishte realisht kaq absurd, sa mua më dukej se kishte ardhur në jetë, duke dalë nga prapanica e Joneskos. Por, kur shqiptonte "po", qoftë edhe "po"-në më idiote të botës, qëndronte çuditërisht besnik në fjalë. Dhe unë i hyra kështu me seriozitet rirregullimit të familjes aq të dashur për mua. Tre muaj pas vdekjes së nënës kishin hyrë në borxh deri në fyt, duke ngrënë restoranteve babë e bir, dhe, sa për t'u larë e ndërruar, ata, duket, e kishin lënë këtë rit borgjez ta bënin vetëm ditën e çlirimit të Atdheut. Unë ia vura syrin një farmacistjeje të kolme 26-vjeçare. Ajo ishte ordokokse, me një edukatë të mirë, e pastër, fodulle dhe, për gjithë atë kallup, si Koli, që të merrte në qafë me ato sytë gri dhe vëzhgimet e pafundme shvejckjane, m'u duk se mund të formohej një kopje e mirë. Mirëpo i ati i Kolit kishte hyrë në histori me emër e mbiemër real, kur e pati këshilluar të birin mos e rrihte qenin, se edhe ai kishte shpirt...Pse, ka shpirt qeni, mër babë, e pati pyetur Koli dhe i ati, ia kishte kthyer gjithë aq butësisht se shpirt ka edhe kaurri, mër bir, e jo më qeni...Me ata myslimanë të fëlliqur nuk merrem, sa të jetë jeta, ma preu shkurt atëherë farmacistja, megjithë

nënë e saj, dhe unë nuk i tregova Kolit për dështimin e parë. Fundja, faji ishte imi, që nuk i vura rëndësi asaj ikonës së varur në murin e shtëpisë së tjetrës. Koli ishte një financier i shkëlqyer. Ai e kapí veten shpejt me tregtinë e bimëve medicinale dhe tani shfaqej më rrallë në skenë. Duket, pare kishte boll e seksi nuk duhej t'i mungonte në këtë kohë me bollëk femrash e eksod meshkujsh, përderisa ai nuk tregonte asnjë interes për martesën. Tani ai kishte nja dy sekretare kofshëgjata, që të bënin të harroje jo punët, por edhe familjen tënde, dhe, kur ne u rimblodhëm për të festuar Vitin e Ri në hotel "Rogner", pisanjosi i djeshëm neglizhent nuk njihej më. Ishte qethur si Robert Retfordi dhe, me veshjen shik, dukej si babë Tereza mes varfanjakësh në tryezën tonë të madhe.

- Do ta kapni veten edhe, ju, çuna,- na dha zemër ai,- me intelektin që dispononi, me siguri një ditë do t'iu pjellë gomari i kuq!...

Ivi vërejti se bosi tani kishte nevojë vetëm për nuse, fëmijët nuk duhej t'i mungonin... Po Koli nuk prishte qejf, derisa unë vura re i mahnitur e çoroditur bashkë se në tavolinën tonë u ul edhe farmacistja, që na ishte kushurirë e gruas së Ivit. Ajo i hidhte herë pas herë nga një vështrim djallëzor Kolit dhe dukej që rrinte si mbi gjemba, po unë e dija mirë se ai nuk kishte as idenë më të vogël se ç'përfaqësonte ajo dhe, kur ia tregova të vërtetën farmacistes në vallëzimin më të parë, vajza psherëtiu e lehtësuar. M'u lut mos ta hapja atë muhabet lepurash dhe unë ia dhashë fjalën.

Nata po shkonte bukuri dhe Koli vërejti aty pas mesnate se farmacistet kishin biznes të shkëlqyer. Në injorancën totale shqiptare ato kishin arritur ta kuronin kancerin me angina dhe grykët me transfuzione... Asgjë nuk ngelej pa shitur!... Pastaj ai hyri në ato filozofimet e tij mishrapurues mbi rolin e sistemit nervor në kurim dhe arriti në konkluzionin, që pritej prej tij, se farmacistë ishin një shpikje e kotë, aspak dobiprurëse, si puna e pastës së dhëmbëve në vendet pa asnjë pikë uji... Farmacistja nuk dukej tip që hapte rrugë, mirëpo ajo nuk foli e as e hoqi atë buzëqeshjen djallëzore nga fytyra dhe, kur të gjithë qenë arritur nga vera, birra e rakija e pafund, unë i pashë që po kërcenin bashkë në një intimitet të plotë. Më vinte për të qeshur me atë kopje absurde në pistë dhe mundohesha të imagjinoja se ç'mund të ndodhte, po ta dinte Koli se kë kishte partnere atë çast, mirëpo nuk ma mbante, sepse sytë e farmacistes i kisha gjithë si pullë poste mbi vete. Pataj unë i pashë ata, kur u ulën në stolat e banakut me nga një tomate xhus, me kush e di ç'pisllek alkoolik brenda dhe e ndava mendjen se do të ishte më mirë t'ia mbathja.

1.

Në dhomë ishte rrëmujë. Mbulesat kishin rënë në dysHEME dhe, në shtratin

e madh gërhisnin njëri rëndë e tjetri lehtë, dy trupa të xhveshur. Një thithë e gjirit të farmacistes shilte ende lart dhe sipër vitheve të saj të kërcyera qëndronte një këmbë leshtore e Kolit. Ai ia kishte dalë t'ia prishte mendjen tjetrës, pas vodkës së tretë. Pastaj qenë përlëshur kafshërisht në shtratin e madh, pa marrë vesh se ç'po bënin, dhe tani po flinin. Aty nga ora dymbëdhjetë u zgjua e para farmacistja. Ajo nuk mbante mend gjë dhe, kur pa veten në shtratin e Kolit lakuriq, u tmerrua fare. Mallkoi veten e, në atë panik të plotë, mendoi të ngrihej e t'ia mbathte, por andej nga guzhina dëgjohej kolla e plakut të Kolit dhe as që bëhej fjalë për t'u ngritur. Priti derisa dëgjoji kërcitjen e derës, mbylljen e saj me çelës nga jashtë dhe u ngrit. Por pikërisht atëherë ndjeu se tjetri ishte zgjuar dhe po e vëzhgonte nga pas.

- Po unë, ç'dua këtu?- pyeti ajo duke ngritur një mbulesë në trupin e xhveshur.

I qahej.

- Ku e di unë,- ia ktheu tjetri,- tani po të shikoj për herë të parë!

Ai i hodhi një vështrim të kujdesshëm, si për t'ia mbushur mendjen tjetrës se po e shihte vërtet për herë të parë, pastaj zgjati dorën dhe e tërhoqi në shtrat.

- Më lësho!- tha tjetra.- Më dhemb koka tmerrësisht!...

- Di unë një ilaç të mirë,- tha ai dhe ia nisi kafshimeve të shpatullave e të gjinjve të saj, derisa e ndjeu se tjetra u njom. Mbas nja çerek ore, të dy dihasnin të lodhur në shtratin e madh. Asaj nuk dhimbte më dhe aq shumë koka dhe ai iu rikthye filozofimeve të darkës. A nuk i pati thënë që ajo kishte një zanat koti? Ja, gjithçka ishte vërtetuar!

Nga ajo ditë, pa i thënë njëri - tjetrit "të dua" e të përbetime vulgare të kësaj natyre, ata filluan ta frenkuentojnë rregullisht njëri-tjetrin. Qenë vendosur ca marrëdhënie të çuditshme mes tyre, me një seks pa parime e me një logjikë shtyje e mos e këput, derisa ajo, aty nga fundi i pranverës, vendosi të bisedojë një herë seriozisht me tjetrin. I tregoi për refuzimin ndaj propozimit tim katër vjet të shkuara dhe ai ia ktheu se ajo kishte marrë vendimin më të mençur të jetës së saj. Nuk ia vlente të krijonte martesë me të! Ai nuk ishte aq kriminel, sa t'i merrte në qafë të tjerët...

Tallej, merrej vesh.

- Po si i bëhet që unë po filloj të ndjej diçka për ty?- e pyeti tjetra.

- ~~Nuk duhet të jesh mirë me jashtëqitjen,- vërejt ai,- fut ndonjë supost nga mbrapa dhe do ta harrosh në çast surratin tim!..~~

Tjetra rrëmbeu çantën, mërmëriti një "pis" nëpër dhëmbë dhe ia mbathi. Po bëheshin gjashtë muaj që bashkëjetonte me këtë njeri dhe një herë nuk e dëgjoji të fliste seriozisht. Dukej, i pati rënë vërtet pikës atëherë.

Ajo vendosi ta harronte dhe e harroi. Tani e shihte ndonjëherë kur i kalonte

para farmacisë, dëgjonte ndonjë fjalë për ato flirtet e tij, por gjithçka i binte në një vesh të shurdhër. Nuk e lidhte më asgjë me tjetrin. Kështu, derisa një ditë ai iu shfaq në farmaci. I zgjati tjetrës një recetë ilaçësh dhe ajo vuri syzet për ta lexuar. "Të dua!" lexoi ajo diagnozën më të çuditshme të botës dhe lart, adresën e saktë të pacientit: Sokol Bërdulla, 35 vjeç, rruga "Asim Vokshi", numur 14...Kur ngriti sytë për t'i dhënë një bërdaft tjetrit, ai kishte ikur.

Farmacistja u mendua gjatë me recetën në xhep. Një mbrëmje i tha të jëmës se kishte vendosur të martohej me një mysliman, dëgjoji qetësisht të gjitha kundërshtimet, pastaj mblodhi rraqet e veta dhe trokiti në derën e Kollit. Tani është shtatzanë dhe dëgjon me durim filozofimet idioteske të tjetrit mbi degradimin estetik të foshnjës nga leximet e pakontrolluara të nënës. Ai ka lexuar dyzet e tre herë vetëm romanin "Ushtari i mirë Shvejck" dhe mendon se shembulli i tij mund të ndiqet, në këtë botë që ecën kryesisht së prapthi. Ja, a nuk ishte edhe martesja e tyre e vonuar një nonsens?...Dhe ajo gjithmonë i thotë vetes me zë: Po unë idiotja, pse ia hapa gjithë këtë sherr vetes?

I TURPSHMI

Unë gjithmonë kam qenë i turpshëm. Kush e di ç'instikt i lashtë autokton më ka belbëzuar se në këtë vend është mirë të kesh turp dhe unë prej kohësh kam jashtëzakonisht turp. Në fillim turpi im ishte i mundimshëm për mua: unë nuk mbaja mend fytyrat e njerëzve dhe shpesh isha i padrejtë me ta, kur nuk iu flisja, apo kur bëja, siç më akuzonin, sikur nuk i mbaja mend, por, me kohë, si tip pavllolian, m'u bë shprehi t'i mbaja sytë ulur, shumë ulët, dhe sot e quaj veprim të tmerrshëm për moralin tim sikur t'ia ngul sytë në sy dikujt. Shumë -shumë unë mund t'i kulloj sytë përreth, apo të shoh pas shpinës së tjetrit, kur bashkëbisedoj me dikë, ama, në kokërr të syrit, as që bëhet fjalë të shoh dikë.

Unë e di me intuitë se me këtë popull për një të parë hyn në sherr...Jo, pse e pe gruan apo shoqen time, jo pse më pe mua ashtu...Ky është shherri më absurd, po të llogarisësh në ç'fytyra pa vlerë has përreth! Dhe unë sy përdhe! Kjo më jep kënaqësinë të njoh pak njerëz nga afër, pra, çdo njeri për mua është interesant, sepse është fytyrë e panjohur. Kështu, i turpshëm, unë shpëtoj mrekullisht nga shherri zinxhir dhe masakra dhe them se jam vërtet me fat që kam lindur njeri i turpshëm. Sinqerisht, tani nuk besoj se kam më turp, mirëpo sytë e mi tani janë në prangat e shprehisë. Ato nuk ngrihen më dhe dhe kaq e vërtetë është kjo, sa nuk ka njeri ta njohë më mirë se unë cilësinë e pllakave të dyshemesë, apo difektet djallëzore të moketeve që shiten me çmime astronomike.

Por dje mua më ndodhi një diçka e tmerrshme, një çudi e paimagjinueshme, që e ka ç'organizuar totalisht mënyrën time të jetesës. Dje mua më kapi një orar i keq në punë dhe u detyrova të drekoj në vetmi të plotë në një restorant luksoz të kryeqytetit, ose, po e heq qafe turpin, duhet të drekoja me një mikun tim të hershëm, mirëpo ai nuk erdhi për kush e di ç'arsye. Dhe tani them se

ndoshta gjithëçka ndodhi ngaqë unë kam qenë tmerrësisht i dobët në histori, më keq se gjyshja ime shekullore në gatim, apo ngatërrim epokash e datash, dhe, kësisoj, nuk kam arritur të kuptoj dot asnjëherë ç'janë strukturat historike, kur evoluojnë ato, si duket ndryshimi, kërkojnë prej nesh, individëve, përshtatshmëri, ku dallohen revolucionet...e kështu me rradhë. Ishte e qartë: kjo mungesë e theksuar kulturore do të paguhej një ditë. Unë e pagova dje.

Dje, pra, i veshur shik dhe serioz, i pasur dhe i turpshëm, sapo zura vend në tryezën luksoze, ula sytë poshtë. Restoranti ishte shtruar me një pllakë bezhë. Mua m'u rrit respekti për pronarin e këtij restoranti: atij nuk ia kishin hedhur dhe kjo nuk është pak në kohën tonë. Vështrimi im ra në një paralele diku te një metër mbi tokë dhe unë s'dija ç'ndodhte më lart, në atë pjesë që për mua është po aq misterioze sa stratosfera. I vetëm, ia nisa një dialogu me subkoshiençën time, që ndërkohë jepte ca përgjigje kaq idiote për gjërat më serioze të botës, sa mua më hypën nervat në çast. Kulmi ishte kur unë e pyeta gjithë mirësjellje se si i dukej ky restorant dhe ajo, e mendoni se ç'përgjigje më dha? Mizerje, m'u përgjigj, një çerdhe hajdutësh është!...Po unë as vetveten nuk e shoh në sy. Më duket fare e kotë të merresh me ca monstra që fshihen gjithë jetën pas ca brinjëve e organeve të mbushura me urinë dhe mezi presin të hedhin helm mbi botën tonë plot drita. I thashë gjithë edukatë vetvetes që mos më çante më bythën me broçkulla të kësaj natyre dhe ajo më kuptoi. Hungëroi një herë si qen "idiot" e shtoi "bëj unë gabim që nuk ndahem nga një kërmë si ty", po, tek e fundit, vendosi të më lerë të qetë në atë botën time me limit një metër vertikal mbi tokë. Dhe, kështu, kur ia nisi servirja, unë ndihesha tmerrësisht i qetë, me cigaren në buzë e me pllakat e dashura reflektuese e të pastra përpara.

Sinqerisht, po kënaqesha, bile po uroja mikun tim të hershëm që nuk e sollti kokën, por pikërisht atëherë filloi të ndodhë katastrofa. Sa herë që unë fikja cigaren, kur, si zakonisht më binte pa dashur ndonjë pirun apo thikë në tokë, apo kur duheshin mbushur gotat me verë e ujë mineral, në paralelin tim të vështrimit shfaqeshin dy kofshë të gjata e elegante të mbuluara paksa nga një minifund i zi. As vetë nuk e kuptova se si sytë e mi filluan të lëvizin nga aksi fillestar. Ato herë shoqëronin tinëzisht kofshët e bukura, herë shtriheshin në mënyrën më martire poshtë tyre, teksa ato afroheshin e largoheshin. Unë i bëra thirrje turpit tim që t'i bënte zap pronat e tij, ato dy zara larushë të indisiplinuar, por turpi ma ktheu në mënyrën më cinike që edhe unë do të bëja mirë ta rralloja pak duhanin. Dhe kishte të drejtë: tani unë po i pija cigaret si i babëzitur, njëra pas tjetrës, dhe i fikja pa arritur akoma në gjysmë. E kisha kuptuar se kofshët do ta ndërroinin në çast tavllën e bërë pis dhe...Turp!

Vendosa të mos pi më cigare dhe t'ia mbath sa më shpejt që të jetë e

mundur nga lokali, mirëpo bash atë kohë që mora vendimin historik turprespektues, ndjeva që kofshët e saj, duke u fërkuar lehtas me njëra tjetrën, më thanë me pëshpërimë: “Pse gjithë ky garamet? Ne nuk hamë njeri. Ne jemi vetëm kundër pickimeve dhe ti dukesh djalë i edukuar...”

U detyrova të ndez një cigare, ta thith nja tre herë e ta fik me ngut. Kofshët erdhën, ndërruan tavllën dhe, tek po largoheshin, në atë kthim nazik, gjithë duke u fërkuar me njëra-tjetrën, si për të më treguar se sa të bashkuara ishin, më thanë: “Faleminderit për respektin. Ne e kuptuam që ju jeni sa serioz, aq edhe xhentil...”

U habita vërtet. Në kohën time kofshët nuk belbëzonin, jo më të flisnin, kurse tani kohët paskëshin ndryshuar. Iu përgjigja gjithë arrogancë vetvetes që diç po më këshillonte të ruhesha gjithmonë në fund të shekullit, sepse pikërisht atë çast kofshët më pëshpëritën intimisht se unë edhe mund t'i ngrija pak më lart sytë, pasi kjo nuk përbënte krim. Unë e dëgjova zërin hyjnor dhe gjithë turp e mundim i ngrita zaret e mi larushë, duke bërë kështu krimin më të madh të jetës sime modeste. Ajo që pashë ishte një gjë e mrekullueshme, krejtësisht e re për mua: një fytyrë ovale, me mollëza të hequra paksa e dy sy që të gozhdonin me ëmbëlsinë e tyre. Ishte edhe diçka mishtore, që duhej të qe goja, një send që mua më ngjethi dhe më bëri të mendoj dhjetëra turpe të tjera të parrëfyera. Mora një shenjzë të lehtë me kokë, një përshëndetje njëqind herë më të ngrohtë se ato të mbushura plot me fjalë të bukura besnikërije që iu drejtojnë presidentët e vendeve miq njëri-tjetrit, dhe u lumturova deri në gjymtyrët e mia prej kohësh të fjetura.

Ndeza edhe një cigare. Nuk kam ndjerë lumturi më të madhe se sa kur e fika. Kofshët erdhën sërisht. Tani ato qëndruan pak më gjatë para syve të mi të robëtuar. Duket mendoheshin apo dyzonin të shqiptonin diçka. Më në fund unë e dëgjova fare shqeto që ato thanë ngadalë, duke ndërprerë njëra-tjetrën. “Turpi është varri jonë...” Mallkova sytë e mi që s'qenë bilbil nga goja, si kofshët magjike, pastaj guxova e pyeta vetveten se ç'po ndodhte. Asgjë, tha thatë ajo, vetëm kanë ndërruar kohët. Të pata paralajmëruar që në gjimnaz mos merreshe me pulla, por të studioje historinë...

I thashë formalisht “ke plotësisht të drejtë” vetvetes dhe, si kërkova leje për të shkuar deri në banjë, u ngrita i raskapitur e dinjitoz nga tavolina. Këmbët e bukura ishin përballë, të kryqëzuara me njëra-tjetrën tashmë, a thua trembeshin se mos dikush iu rrëmbente thesarin që e mbanin mes tyre pak më lart, të fshehur nën minifundin e zi. Ndjehej frika e paniku i tyre, por atë çast iu erdhi goja syve të mi të paturpshëm tashmë. Pse nuk na shoqëroni, pyetën naivisht të poshtërit sytë e mi. Fytyra hyjnore nënqeshi lehtas, por ajo nuk fliste.

Zemërdridhur u drejtova drejt tualetit dhe prita një çast, symbyllur, si për të qetësuar rrahjet e zemrës sime, në koridorin gjysmë të errët që të çonte në

tualet. Isha duke mallkuar sytë e mi që i shpëtuan turpit tim nga duart dhe më bënë këtë hata, kur ndjeva pas shpine afrimin e figurës elegante mbi kofshët e bukura. U ktheva rrufeshëm, e pushtova pa i belbëritur as edhe një fjalë. ndjeva gojën e saj të humbte si me magji brenda times, gjuhën e saj të lagur e gudulisëse, që nuk dinte e shkreta në ç'dhëmballë të shpartalluara rrotullohej, pastaj arrita e thashë:

-Unë kam shumë turp!

-Edhe unë,- ma ktheu mbytur ajo.

Kurse unë, nga dita e djeshme jam ç'orientuar tërësisht: nuk di ku t'i mbaj sytë. Që kohët kanë ndryshuar, këtë e mora vesh, po sytë dhe vetveten ku t'i çoj? Isha tmerrësisht i qetë i turpshëm, tani nuk jam i qetë, por i kënaqur. Dhe hajde zgjidh kush ka më shumë vlerë për mua: qetësia apo kënaqësia?

MARS, 1996

ZGJIM NË MESNATË

Ne u ndamë në dimrin e ashpër të vitit 1990, nëpër një baltë e ca lule të fishkura, dhe unë mendova se këtu u mbyll një herë e përgjithmonë miqësija jonë. Megjithë respektin e shenjtë që ruaj për të vdekurit, për mua, ata nuk lidhen më me të gjallët. Kështu, ai kapitull që vulosur e dyllosur përfundimisht dhe, pa llogaritur ato rastet komike, kur më kujtohej humori i tij legjendar, Andi figuronte i zhdukur nga jeta ime. Nga ai dimër patën rrjedhur shumë ujëra dhe kishte ndryshuar thujtë gjithçka, nga luku im, deri te perënditë, dhe natën e parë që Andi m'u shfaq në gjumë, ashtu, gjysmë i çartallosur, siç ishte sa gjallonte, unë u zgjova e ndejta i ulur në shtrat si budalla. Nuk e mora vesh se ç'deshi të më kumtonte fytyrëkuqi im i shtrenjtë, që m'u shfaq i mbështetur në parazin e derës, me ato sytë e tij ironikë dhe me një cigare të pa ndezur në buzë. Motra më këshilloi të shkoja në varreza e t'i çoja një tufë lule, meqë ateizmi im nuk më lejonte të ndizja qiri. E dëgjova dhe të nesërmen, duke u tundur e shkundur në rrugën gjithë gropa të varrezave, krevatit e lashtë. Mirëpo në mesnatë a ku di unë sa që ora, ai m'u shfaq përsëri. Mendova se nuk do t'i kishin pëlqyer lulet. Këtë herë rrinim bashkë në një klub gjysmë të errët me nga një xhin përpara, pije e çuditshme kjo, po të kishe parasysh se ai nuk kishte pirë kurrë xhin, meqë vdiq para lejimit të klubeve private dhe tregimit të xhinit.

“Ç'kemi, zoti deputet?”, më pyeti.

Megjithëse në gjumë, isha në gjendje ta kuptoja se ai nuk kishte nga ta dinte ç'rrjedhë pati marrë jeta ime katër muaj pas ikjes së madhe të tij.

“Më ler rehat!”, ia ktheva, duke rrotulluar gotën në gishtrinj.

“ Të shoh të mërzhitur”, më tha.

“ Rrihet në atë Parlament të qelbur? Vjen era derr...”

“ Përse nuk e shpreh këtë goxha mendim publikisht?”, më pyeti ai. “ Akoma keni frikë ju të gjallët?! Tek e fundit, mund të vdesësh, si puna ime, por, për kokën tënde, këtë nuk kalohet keq: nuk të shkel njeri me këmbë e “mos” nuk të dëgjojnë veshët...Ka edhe ashtu, të mira fare...”

“ Nuk është punë frike. Krijohen keqkuptime. Pastaj, unë mund të jap dorëheqjen, po të dëshiroj...”

Andi nuk m’i ndante sytë. Kishte një keqardhje në atë vështrim të spërkatur me naivitet shtazor.

“ Jefe!”, më këshilloi butë.” Natyrisht, nëqoftëse e njihni këtë nocion. Por nuk do ta bësh! Ti je i sëmurë keq nga frikofilia...”

Dhe u zhduk, ose, më saktë, u zgjova unë. Nuk e kuptoja se ç’deshte ky njeri, nuk e shpjegoja dot se përse ishte bërë i gjallë përsëri dhe agimi më gjeti duke pirë cigare në ballkon, cigare një pas një me lloj-lloj mendimesh të zymta, nga ato mendime që të ngjallin trishtime pa fund, kur kupton se sa dhjeraman i vockël je dhe kur e sheh qartas portretin tënd pa dinjitet, të shëmtuar, si një radiografi kafke plot fraktura e pa një kualicion dhëmbësh në organikën e asaj që është bërë zakon të quhet nga njerëzimi “gojë”.

Ardhja e ditës më gjeti në ballkon, të rrasur në poltronë, me një vështrim të arratisur nga mali plot diell tashmë, me supe të mbledhur e me një çudi të madhe për gjithë ç’po ndodhte brenda vetes. Më vinte vërdallë prej kohësh mendimi që të jepja dorëheqjen nga Parlamenti, nga ai vend që vetëm të hante kohë e të fuste në gjynah. Desha të merresha seriozisht me dorëshkrimet e mija, të pluhrosura tashmë, por nga njëra anë rroga e parlamentarit, nga ana tjetër frika e reaksionit të partisë mëmë ndaj vendimit tim, më kishin bërë t’i dredhoja vazhdimisht mendimit të dorëheqjes. Mirë, unë i di këto gjëra, pëshpërta si i letuar, po Kuqi nga i di?! Ndoshta jam i lodhur, mendova, sherr në Parlament, sherr në gazeta, sharje pa hesap...Ndoshta, vazhdova mëdyshjen gjithë aq i përhumbur. Më kishte marrë malli befaz për Kuqin e dashur, që e dinte të gjithë librin “Ushtari i mirë Shvejtk” përmendësh dhe që e luante aq bukur rolin e budallait. M’u shfaq në zyrat e hetuesisë atëherë, kur Genci ia mbathi në Greqi e ku Andi sajoi gjithë atë gënjeshtëri, sikur Genci ia kishte bërë prej kohësh borxh, me atë shprehjen “Kuqi më i mirë ka vrrarë babën e vet” dhe ai as që donte t’ia dëgjonte emrin, bile, po ta mbërthente kund Sigurimi, le t’ia linte atij në dorë nja 24 orë, se ruante ca hesape të vjetra për të larë...Atëherë arriti ta luajë mendsh edhe vetë hetuesin dhe kështu na shpëtoi edhe ne të tjerëve nga pyetjet torturuese e gjakprishëse, që qenë kodra mbas bregu, se Genci rrezik as vetes së vet nuk ia kishte treguar planin e arratisjes. Kush e di ç’iu punonte shenjtorëve në atë botë Kuqi dhe mua m’u qesh seriozisht, kur e

pashë duke pirë kafe e luajtur bilardo me shën Pjetrin, e duke u zënë për bilën e fundit...

Mes këtyre kujtimeve sikur e harrova Kuqin. Po diç më grryente gjithë ditën në shpirt, një acid a helm, kush dreqin e merrte vesh se ç' ishte. Në darkë m' u kujtua përsëri dhe u sorollata me ca palo punë koti, që ta shtyja gjumin sa më shumë të qe e mundur. Pashë edhe nja dy filma në TV dhe, kur rashë të fle, ora ishte dy pas mesnate. Kuqi nuk më gjente dot më. Kështu rashë në shtrat, me qejf, si një njeri që ka hequr qafe një person të bezdisshëm, por gjumi nuk po më afrohej. Se si m' u kujtua jeta ime dhe as vetë nuk e mora vesh pse e hapa atë kapitull, që veç trishtime të sillte. Shumë keq kishte ardhur kjo jeta ime pas vdekjes së Kuqit. Kot pata hyrë atëherë në politikë, në këtë çorbë derrash e vorbull kënetore, që, mesiguri, duhej të ishte shpikur diçka përpara biznesit fitimprurës të prostitucionit e shtëpive publike. Gjithë ai revolucion më kishte gllabëruar kohë e vite, nerva e dinjitet dhe tani, i shtrirë si lopë në shtratin e madh, shihja gjithë ato portrete politikanësh të palarë, që sikur e meritonin të laheshin me pështymën time shkumore. Po gojën e kisha të tharrë, pa pikë sekrecioni. Ke frikë, prandaj, i thashë gjithë cinizëm vetes sime. Edhe pështyma ishte fshehur diku poshtë nofullave, e trembur nga ndonjë dalje jashtë kontrolli e vetes sime, jashtë atij kontrolli të trembur e të tredhur, që kishte harruar në vite ta shihte të vërtetën në sy...Kështu iku kjo natë, pa gjumë, me një zbehje të plotë në mëngjes e me një këputje të përgjithshme nga gjithë ai film i gjatë e i zymtë i parë pas mesnate në murin e errët e të shoqëruar me ca lehurina të pafundme qensh dhe me një fishëllimë lirike mushkonjash. Pastaj, në ditën e gjatë, se pse m' u bë mendja havale që gjithë atë pagjumësi të pazakontë për qenien time pa nerva, e kisha peshqesh nga Kuqi. Gjysmë i pirë, në mbrëmje i futa një të pështyrë ekranit të TV-së, ku po gënjente pa pikë turpi një spikere spitullaqe me emër luleje a qeni, s' më kujtohet mirë, dhe ia mbatha në shtrat. Kishte filluar të më grryente e të më grricte prapë gënjeshtra, si në atë fillim të vitit 1990 dhe, me ta vënë kokën në shtrat, më kaptoi gjumi. Njëpër atë gjumë të keq nga mendimet e alkooli, u gjenda në një kopsht zoologjik, duke kundruar ca gjarpërinj të neveritshëm stër- të- mëdhenj. Pas meje zgjatej si lake një portret tullac me mustaqe, që iu hidhte zvarranikëve dollarë e stërlina vezulluese, dhe unë u bëra gati t' ia këpus një të mirë surratit asaj monstre që tallej me kafshët e mjera fitimsjellëse, por dora më ngriu në ajër. Ishte një ish-miku im i hershëm, tani funksionar i lartë, që më zgërdhihej pas atyre mustaqeve gjithë lyrë dhe syve prej gjarpëri, që i vetëtinin nën syzet e florinjta. Dora ime ngriu në ajër, por bash atë çast u shfaq në skaj ironik Andi, me kokën si pyll hurmash në vjeshtë.

“ Bjeri!”, më uluriu.

“ Po ai është...”

“ Bjeri, dhjeraman!”

Dora ime ishte betonuar në atë pozicion monumental tashmë. Ajo nuk luante dot.

“Nuk kam fuqi...”

Kuqi ia mori në çast asaj që i trembesha më shumë për vdekje, këngës së tij të preferuar të aksioneve:

“Po more çiften të shkosh për gjah./ Zagar si unë në botë s’ka!/ Nuhatje kam e nuk jam burrë./ Në derë të kishës s’kam dhjerë kurrë...”

“Ti ke mbetur një qelbësirë!”, i thashë i kreshpëruar nga slida e kantautorit memorial.

“Kurajua jote nuk ka benzinë, ti, veç kur dhjet, e bën kërdrinë...”, vazhdoi ai. Dhe nuk kishte ndërmend të pushonte. “Bjери, shtoi përsëri, të paktën, tregoi se ç’mendon për të, edhe po nuk pate të drejtë...”

“Po ky nuk harron”, u mbrojta unë.

“Mos e lini Atdheun tonë të shtrenjtë pa dëshmorë!”, këshilloi Andi dhe unë u ndodha i zgjuar, me një gojë tmerrësisht të hidhur. Futa kokën në frigorifer për të gjetur ndonjë lëng të ftohtë dhe e qava gjumin. Po agonte përsëri, një agim i mrekullueshëm po shfaqej mbi mal, me një spektër dritash që buronin nga pas shpinës së tij, prej nga, duket, po ngjitej në kupën e qiellit një diell i ri. Unë pashë atë rozë të mrekullueshme në hapësirën blu dhe m’u kujtua sërisht Andi. Ja, kështu e kishte kokën flokëgjemb, rozë, dhe surratin gjithë quka, a thua ishte xhins kasapësh i spërkatur përjetësisht nga gjaku i kafshëve të mjera. M’u kujtua në zbor, kur organizonte kampionatin e gazralëshuesit më të fortë, duke i ulërirë nëpër terrin e kapanonit gjigant flakëvënësit “shpejt, shpejt”, pastaj ndezja e çakmakut pas të ndenjurrave të plota që vetëtinin si poç, një krisëm, një flakë e gjatë e mrekullueshme dhe ulurimat “dy metra!”. Ai u shpall kampion, sapo vdiq Mao Ce Duni, dhe arriti e tha atëherë se titullin ia dedikonte kujtimit të Kryetarit të Madh, të cilit, si padashje, i ndryshonte një “t” me “k”, kur shqiptonte emrin “kryetar”... Tani më ishte qepur mua. Donte vërtet dëshmorë, apo tallej? Serioz kurrë nuk kishte qenë e as në ëndërr nuk i vinte era seriozitet, por gjuha helm i pati mbetur dhe mua arriti të ma prishte përfundimisht gjumin bashkë me rehatin, atë pak rehat të mbledhur me kujdes nga kjo botë e qelbur që më rrethon.

E ndjeva se ai do t’i hiqte si padashje nja dy shkronja edhe mbiemrit të Presidentit, pa harruar ndonjë modifikim, që mund t’i bënte emrit të tij, dhe po me ikte dëshira për të qeshur. Një inat idiot më buronte përbrenda, më kujtonte gjithfarë historish, ku unë isha i humburi, vetëm sepse nuk ruaja aq kurajo, sa ta shprehja hapur mendimin tim, më fokusonte në sallën e vjetër të Parlamentit, ku dominonte e kuqja, si për ta përfruar me bordellon, ku unë qëndroja i heshtur, duke shkarravitur fletët e projektligjeve, dhe heshtja përpara ligjeve që miratoheshin me ngut, duke paralajmëruar kasaphanat. Si koketë më shfaqej vetja në ca kokteje

shkërdhatë, duke iu qeshur ca kuçkave të parfumuara mirë, vetëm sepse burrat e tyre ishin në pozitë, në vend që t'i ftoja gjithë edukatë në Tualet dhe atje t'ua varja breçkat e vocka në qafë...Por guximi im dhe subkonshi duket patën dhënë shpirt. Maskara, shava Andin nëpër dhëmbë dhe ia mbatha në klub. As kafja e as bisedat e miqve nuk më qetësuan. Më vinte ta shqyeja atë Kuq qelbësirë, ose qelbësirë të kuqe,që më dërdëlliste nga bota tjetër kaluar, nga ajo botë ku s'ke ç'humb, sepse nuk ke as ç'fiton, po ku ta gjeja? Ai përkëdhelte krimbat tani, që po ia lëpinin eshtrat fosforeshente, kurse unë...Në atë tërbim e shkumbëzim, sytë e mi të kuq nga pagjumësija dalluan trupin e bukur të asaj sekretares së italianit fodull, që përmbyste tregun me pula të qelbura e verë të thartuar. Merrte kafe në termos për atë pis burrë dhe s'di pse, i tunduar nga vithet e saj të kërcyera, e thirra e i afrova një kafe. U pendova në çast, se kjo bukuri me siguri përdorte në vend të kontraktivëve 100 mijë liretëshat, llogari që mua nuk më dilte fiks, mirëpo s'kishte më kohë për pendesë. Ajo erdhi e ul gjithë qejf dhe ja ku na doli se ishte admiruese e librave të mij.

“ Më jep ndonjë dorëshkrim ta lexoj unë e para”, m'u lut.

Ia ktheva brutalisht se kjo që po më kërkonte ishte një hiç gjë, para planeve të hartuara paraprakisht prej meje. E pashë që çapleu sytë e u skuq.

“ Të ftova, sepse më ka lindur në zemër të të kushtoj një libër, i thashë, por tani, për ta mbyllur librin, më duhet një vajzë sensuale për model. Ti je brenda shijeve të mija adapt për këtë punë...”

U skuq dhe pranoi idiotja, pranoi me një barrë qejf, siç thuhet, sikur do të përjetësohej në art nga pena e Floberit apo Dostojevskijt. Pastaj, pasdite vonë, kur unë lëpija kurmin e saj të magjishëm e të fortë çuditërisht, po të merrje parasysh se me bukë e gjizë ishte rritur, e kisha harruar Kuqin. Dëgjoja me kënaqësi rënkimet dhe britmat e tjetrës, uroja Zotin që isha në formë e po ia bëja tamam atë punë dhe, kur u ndamë të raskapitur e plot kujtime të mira për njëri-tjetrin, ndërgjegjen e kisha fare të qetë. I këputa një të rruajtur te berberi, për të hequr aromën e parfumit të tjetrës, dhe, me ta vënë kokën në shtrat, fjeta si qingj. Pashë goxha ëndrra të bukura, nga ato të mirat fare, ëndrra pa lëkurëkuq gjakprishës.

“ Dje jam kënaqur”, më tha fytyrëpurpur sekretarja e italianit në mëngjes.

Gjërbe e trishtuar një kapuçino me sytë e trembur e të pikëlluar që i bridhnin përreth.

“ Unë shkruajta mbrëmë”, e mashtrova.

Ajo u lumturua për një çast. Pastaj pikëllimi e pushtoi sërish.

“ E di sa të poshtër e kam pronarin?”, më pyeti befas.

“ E di, ia ktheva, e di që mashtron me taksat dhe që përdhunon nëpunëset e tij...”

“ Atëherë bën gabim që hesht”, ma ktheu ajo. “Unë mendoja se ti nuk

kishe idenë se ç'na punojnë ne këta maskarenj pa dy lek në xhep. Kisha iluzione se, po ta njihje të vërtetën, do flisje dy fjalë në Parlament, që mos them se duhej të propozoje dekretimin e një ligji kundër abuzimeve seksuale...”

“ Një ligj i tillë egziston”, i thashë dhe m’u qesh, sepse m’u kujtua që ligji ishte miratuar vetëm për funksionarët e lartë dhe se ai mbronte edhe burrat nga ngacmimet seksuale të grave drejtuese. Isha kurioz të njihja nga afër ndonjë ngacmim seksual të një femre drejtuese, po nami të bëhej dhe denoncim. edhe copa të ma grinin mishin, nuk do të paraqitja në Prokurori...Duhej të ishte gjë e bukur...

Ajo më ndoqi pa e patur mendjen, nuk qeshi me karagjozllëqet e mija dhe, pa e zgjatur shumë u ngrit e iku. Dukej s’kishte më qejf të qëndronte me mua, ndërkohë që në vendin e saj e pashë fare kthjelltas Kuqin të ulej. Ai s’fliste. Tek e fundit, pse duhej të llapte kot, kur e posangritura kërkoi nga unë të vërtetën, pohimin e saj, që unë e dija si drita e diellit?

“ Ti je mut!”, dëgjova Kuqin të më thotë, dhe, me të kthyer sytë e mi të tërbuar nga ai, nuk e pashë më.

Ç’keni me mua, uluriva përbrenda, nuk e them të vërtetën, sepse ajo në këtë vend të ekzekuton me vdekje! Mirëpo çirresha kot. Askush nuk më dëgjonte dhe, kur e mora sekretaren sërish pasdite, as ajo nuk dëshironte të bisedonte më me mua. U zhvesh ngadalë, ma futi kokën mes gjinjve të saj të plotë, më vuri ta përkëdhelja e ta ndizja mirë, pastaj më futi mes kofshëve të saj të ngrohta e të vesuara paksa. Se pse pata një parandjenjë idiote që edhe ajo ma kishte hequr vizën si qenie humane produktive në aspektin intelektual. Fizikisht ndoshta ekzistojta, si kafshët në pyll dhe mendja m’u mbush top që kështu duhej të ishte e vërteta, kur dëgjoja edhe ato klithmat shtazarake që shpërthenin nga trupat tanë. Nuk ndihesha fort keq. Të paktën, nuk qeshë i mbaruar krejtësisht. Ndodhesha, tek e fundit, në origjinë. Me pak shans e vullnet, edhe mund ta kapja evolucionin. Ndoshta tmerri i primitivitetit më shtyu t’i them Emanuelës, tek laheshim në dush, se unë nuk do t’ia harroja kurrë këto çaste prehjeje e lumturije të afruar aq bujarisht.

“ Faleminderit!”, ma ktheu mbytur ajo.

Ujërat i kullonin nëpër fytyrë e trupin e bukur dhe unë nuk e kuptova në qante ajo, thithat e gjinjve të saj, flokët e zinj apo qante gjithësisja, natyrë e teknologji bashkë.

Duhej të ndihesha i lumtur e i qetë. Në të vërtetë, isha i lodhur e i trishtuar. Më dukej sikur Emanuela nuk do të vinte më, sikur dikush do ta grabiste në rrugë dhe do ta degdiste me ato skafet ilegalë rrugëve të Italisë, duke bërë prostitutën e lirë. Isha fare vetëm, një revolucionar dhjeraman i vetmuar isha, as guxim të martohesha nuk disponoja dhe gjithë ç’mund të quhej fitore gjatë gjashtë viteve pa And kuqin, përmbidhej te një apartament luksoz dhe te një mandat deputetit.

S'di pse vargëzova nën vrushkujt e ujit "Çfarë të bëj me k'të mandat? Tarator apo sallat'?..."

Pa Emanuelën vetmia m'u duk edhe më mbytëse. Në TV lajmëroheshin deputetët të paraqitëshin në seancë plenare, por unë e pështyva përsëri gënjeshtaren e pa skrupull, duke i hedhur një sy rrëshqitazi në mur motivacionit presidencial që më akordohej mua për merita të shquara trimërije. Më kishte mërziur maskarada dhe prostitucioni politik. Tani dëgjoja kthjelltas një zë, i cili më përsëriste papushim se po nuk fitove dinjitetin, ke humbur lirinë. Ngjante pak me zërin e Andit, po nuk ishte ai. Kështu, nën vetminë dhe mërzinë e pafund, më kaptoi gjumi. Andi më **doli sërish përpara, por nuk arriti të më zgjonte dot. Ndoshta i erdhi keq për vuajtjen time, për vuajtjen graduale që po më hante pak nga pak e po m'i hirmoste ditët e mija të konservuara me aq përkujdesje në qetësi.**

Emanuela po më priste në kafe dhe, kur hyra, ma bëri me dorë.

"Do të iki ca ditë në Itali", më tha.

"Me shefin", shtoi, kur vuri re se unë nuk lëviza asnjë muskul të fytyrës.

M'u duk e lumtur, e lumtur në qetësinë e saj, në atë qetësi që dukej sikur thoshte "të shpëtoj ca ditë nga ky batak", nga ky batak moçalor.

"Mirë", ia ktheva.

Edhe unë duhej të shkoja në Gjeorgji, me një delegacion parlamentar. Kështu u ndamë, me një gjysmë premtimi për t'u riparë me t'u kthyer e me ca biseda lepurash e karotash nëpër të.

Nuk më shqetësonte shumë ndarja e përkohshme me Emanuelën, megjithë konsideratat më të larta për paraqitjen dhe sensualizmin e saj. Ishte diçka tjetër që ma hiqte si me dorë humorin, një irritim i brendshëm me gjithçka, një ngritje nervash e gatshme, një lloj neverije e lehtë, por e gjithëndjeshme, ndaj vetes sime...Ishte një shtrëngatë që ndjehet nga kush e di ç'instikt në qiell të kaltër e paqe tokësore. Ishte diçka që më bënte t'i tërhiqja këmbët zvarrë e të kundroja me sy të vdekur peizazhin para kafesë, atë peizazh aq të njohur e aq të palëvizshëm, me po ata policë, me po ata të dehur, me po ata pokeristë, me po ato vajza të gjata që kalonin duke u tundur joshëse përballë, si në pazarin e gjësë së gjallë...

Andi, frika, Emanuela, formalizmi...

Duket po dremisja sy hapur në kafe, kur dëgjoja zërin e Andit:

"Emanuelën e shiti italian!"

"Ku e di, ti, o profet?"

"Edhe, ti, e di..."

"Unë di që, ti, ke qenë dhe ke mbetur idiot!"

"U shit! Është në logjikën e gjërave! Por, ti, nuk ke qenë kurrë logjik...Të kujtohet në qershor të 1981-shit? Ushtrimet e matematikës në provimet e maturës i kopjove nga unë..."

“ Emanuela nuk hyn në këtë mes!”

“ Hyn, tha ai, vetëm se një dhits si puna jote nuk dëshiron t’ia pohojë vetes, sepse ndryshe do të vihet në siklet, ngaqë nuk e mbron dot!”

“ Dëgjo, i thashë shtruar, ti je i vdekur, miku im, dhe nuk e di se sa e vështirë është t’i thuash bukës bukë, gurit gur e drurit dru këtu...”

“ Prandaj ju do të hani gurë e dru gjithë jetën, si sorrat e pulat e Kurveleshit, sepse edhe artistët tuaj nuk shkruajnë e nuk pohojnë të vërtetën! Kur mashtroni edhe ju, gjoja tipat impulsivo-realistë, është për të vënë ulurimën!”

“ Çfarë të bëj, sipas mendjes tënde?”, e pyeta jo pa ironi.

“ Fol dhe, po nuk të dëgjuan, uluri, dhe po nuk të dëgjuan prapë, vrit ndonjë kërmë njerëzore! Je i detyruar t’iu hapësh sytë njerëzve, ato sy të palarë prej vitesh, që tani ua kanë ngjitur me mastiç sklepat dhe as me pincë nuk ua hap dot!...”

“ S’paske gjetur ndonjë shok bilardoje andej”, i thashë për ta qërruar.

“ Këtë kalohet mirë, më tha, bile bëra mirë që vdiqa aq shpejt. Tani që ua shoh ç’fytyra seriale keni, si pulla poste, them se jam më rehat këtë! Më vrau ca kohë ndërgjegjia, që paskështa qenë edhe unë një biçim plehre, që nuk vlen më shumë se pesëmbëdhjetë qindarka ...”

Nuk foli më. Në kafë ishte gjithë aq monotoni, varrezë fare ishte! Vetëm lulet mungonin, se qirinj kishte sa të hanin qentë nëpër tavolina. S’di pse vajta e ndeza qiririn e tavolinës sime, por, kur u kujtova se ç’kisha menduar dy çaste më parë, i mbusha bulçitë me ajër dhe nxora frymën me aq inat, sa ajo copë dylli shkoi e u përbys me gjithë mbajtësen e qelqtë.

I.

Në Gjeorgji Andi nuk po kujtohej. Ndoshta më kërkonte, por nuk më gjente dot, ndoshta Kaukazi e trembte me fatin kobzi të Prometeut, me atë mëlçi që as mbaronte e as tepronte, por e vërteta ishte se po më linte më në fund të qetë. Rruga e gjatë, ushtarët e pafund në Tbilis, varfërija,- ndoshta të gjitha këto më kishin lodhur aq, sa të transformohesha edhe unë në një gjysmë të vdekur, të plasur në një dhomë luksoze hoteli, ku Andi nuk dukej se kishte shumë qejf të vinte thjesht për të biseduar me mua. Duke vëzhguar qytetin e madh të shkretë pas mesnate nga dritarja e hotelit, m’u rikujtua Emanuela. Kush e di ku ndodhej tani? Me siguri, me atë italianin e qelbur mbi vete, ose në ndonjë nga ato restorantet komode italiane, gjysmë e dehur nga vera, ku pronari i saj u tregonte si me lezet miqve të tij, duke fërkuar kofshët e bukura të Emanuelës, se sa mirë kalohej në Shqipëri. Shtet i qelbur, qelbësirë shtet, shava shtetin tim për herë të parë me gojën plot. Ndihesha keq që edhe unë isha pak shtet dhe nuk kisha mundur të bëja

asgjë për fatin e njeriut. Nuk e desha Emanuelën, por gjithçka do të jepja ta kisha pranë tani, ta largoja nga ai vend që i kafshonte brutalisht gjinjtë dhe ia mblidhte lotët në fyt. M'u kujtuan heronjtë e hershëm të Lermontovit, që, me siguri, duhej t'i kishin lënë stërnipërit këtyre skërkave, dhe m'u duk absurde që unë, pas një shekulli e gjysmë afërsisht isha më dhjeraman se sa ata. Hajde merre vesh këtë botë, mërmërita, shkon përpara apo së prapthi. Me këtë pyetje për pak sa nuk pata ngelur dikur në provimin e letërsisë antike në fakultet. Me ty ikën vërtet së prapthi, më kishte thënë atëherë profesori plak i letërsisë antike. Me ty ikën së prapthi, më tha përsëri tani një zë. Ishte zëri im. Nuk i hakërroheshja dot, si Ad kuqit. Dhe nuk tallesha dot, si atëherë me profesorin e hutuar nga gjithë ai kiamet të vrarësh e heronjsh të xhinsit të tij antik. Ky zë më njihte mirë. Po ç'të bëj unë, pyeta zërin tim gjysmë i përlotur në dritare. Diçka mund të bësh, m'u përgjigj gjysma tjetër e vetvetes, ajo pjesë që gjithmonë ishte e vdekur brenda meje. Diçka mund të bësh...Një njeri që e njeh zakonin e të ulurit në tavolinën e bukës dhe të të shkuarit në tualet, është i gatshëm të bëjë diçka. Të pastrosh botën nga e keqja, do të thotë të duash fëmijët e tu realisht, vazhdonte ky zë, tashmë më patetik e me ca nota prometeane brenda. Thashë t'ia kthej edhe unë këtij zëri antik me tone korale dhe ja tek vargëzova qetësisht:

*Shqipëria shkoi, u dhje,
Fati jonë.
Mbase nuk e hamë dhe ne,
Si kjo zonjë!...*

Atëkohë ndjeva një duartrokitje...Bam-bam, bam-bam...Ishte Kuqi në fund të dhomës, që përplaste duart i mrekulluar pas recitimit tim.

"E shikon, që, me pak guxim, ti mund të bësh gjëra vërtet të mira, bile, të mirka fare? Po t'u desh të mbash ritmin, si latinët e lashtë, hiq breçkat dhe mbaje ritmin duke goditur me shuplaka mollaqet e tua...Nuk e ke idenë sa tinguj të ëmbël prodhohen!..."

II.

Emanuela nuk ishte kthyer ende në Tiranë. Unë takova pronarin e saj një mbrëmje në një piceri të njohur të kryeqytetit dhe ai më tha qetësisht se Emanuela pati qëndruar te disa shoqe në Milano. Shpresonte të gjente ndonjë punë të mirë andej. Dokumentet i kishte të rregullta...S'kisha asnjë arsye mos ta besoja, megjithatë, isha i bindur se po më mashtronte me atë gjuhën e tij prej nëpërke dhe vështrimin xhentil plot me ironi e sarkazëm. Në të gdhirë, tek rrotullohesha në një

gjumë të keq në shtrat, pashë befaz veten time, duke luajtur tavëll me Andin.

“ Të thashë që Emanuelën e shitën?”, më pyeti befaz ai.

“ E mora vesh”, ia ktheva.

“ Kot fola”, ma ktheu, duke hedhur zaret.

“ Më erdhi shumë keq...”

“ Nuk hahet keqardhja!”

“ Çfarë mund të bëj, sipas teje?”, e pyeta.

“ Ler çdo punë dhe shko gjeje, më urdhëroi, ajo është keq, po të pret”.

“ Ku ta gjej? T’i bie me gomar Italisë kryq e tërthor dhe t’i them “buongiorno” çdo italiani?...Emanuelën desha, mos ua kanë zënë sytë gjëkund, a mos keni shkuar rastësisht me të?...”

“ Po!”, ma ktheu thatë Andi. Dhe iku.

Unë e prita sërish mëngjesin në ballkon. Tani po më shqetësonte seriozisht Emanuela. Se pse m’u bë havale mendja, sikur i gjithë faji ishte i imi, te goja ime e qepur me shtatë tegela filispanje nga frikofilia. Portreti i saj qëndronte i varur në qiell, i madh dhe shumë më i madh se ai i klasikëve të marksizëm-leninizmit, portreti i saj që sikur më kërkonte ndihmë. Buzët plotë i kishte të kafshuara, poshtë syve rrathët e zinj ishin si pranga...Gjithçka ulurinte e kërkonte ndihmë. Mua nuk më lidhte asgjë me atë portret interesant. Nuk e desha dhe, tek e fundit, nuk ushqejja ndonjë iluzion që më dashuronte, apo ndjehej e lidhur pas meje.

“ Ik!”, i thashë portretit.

“ Unë nuk iki, më tha ajo, dhe, ti, s’ke asnjë punë me mua. Mua më pëlqen të rri në qiell. Qielli nuk ka pronar!...”

“ Të lutem, ik, i thashë, portreti yt më krijon shumë shqetësime.”

“ Nuk je nga ata që shqetësohesh, ma ktheu. Po të ishe i tillë, do flisje dy fjalë në atë sallën e shenjtë për armatën e prostitutave, që ngrenë këmbët me dhunë rrugëve të Italisë. Të paktën, abortet të na i bënin falas...”

“ Kam folur një herë, u mbrojta, dhe kryetari i Parlamentit më nxori jashtë. Më preu edhe rrogën dy javë...”

“ Kur?- pyeti ajo.- Atëherë kur kërkove edhe, ti, liçensën e prostitutës, apo atëherë kur kryeministri të tha se nuk ka ndërrim sistemi pa prostitucion?”

“ Pak më intereson logjika jote, i thashë. Ti je tendencioze! Ti nuk e mendon se ai është një Parlament homoseksual...”

“ Edhe mua pak më intereson, ose aspak, shqetësimi që të sjell portreti im! Sa për atë përcaktimin tënd, faleminderit! Tani e kuptova qartë se ju luftoni vetëm për bythën tuaj!”

Ai portret erdhi e u bë i madh, sa gjithë hapësira qiellore para meje. Tani i dukeshin qartë shenjat e dhunës dhe të dhimbjeve në fytyrë.

“ Sa fiton?”, e pyeta.

“ 100 mijë lireta në orë”, më tha.

Nuk m’u duk shifër e vogël. Pesë orë, ta zemë, ç’do natë...Unë merrja shumë më pak.

“ Sa të mbeten, ty?”

“ Pesëdhjetë përqind...Jo fort keq. Ti, bëre revolucionin blu dhe fitove vetëm një apartament, një medalje dhe një gojë që e ktheve në tualet modern...”

“ Më bëhet qejfi, që i kupton saktë ca gjëra, i thashë. Konkluzionet e tua rrjedhin kaq harmonikisht, si një diare...”

Ajo qeshi me të madhe, pastaj, befas, qau. Qau shtruar. I këputi një të qarë intelektuale, pa zhurmë e me një ndjellje të vazhdueshme elegante hundësh. Jashtë kishte filluar shiu. Qava edhe unë. M’u kujtua fare kthjelltas që asnjëherë nuk kisha thënë të vërtetën, ndoshta që në lindje. Kisha pasur dhe kisha tmerrësisht frikë. Tani e vërteta më dukej një kuçedër, që lëshonte flakë e digjte këdo që fliste. Unë e pashë veten time të shkelur me këmbë në gjimnaz, kur na qethnin në rradhë, si deshët, e pashë mirë personin tim të dhjerë me një goxha jashtëqitje m’u në toç të kokës në fakultet. E pashë të masakruar në gazetë, fije-fije në Parlament, të vdekur nesër, me një zog që bënte glasa mbi varrin tim.

“ Më prit, i thashë befas Emanuelës. Unë i vdekur se i vdekur jam, ty nuk do të le të vuash...”

Ajo vazhdonte të qante.

“ Faleminderit!- më tha.- Të lutem, hajde shpejt! Ti nuk e kupton sa keq jam...”

Unë u vesha dhe dola. Italianin e gjeta në kafen mbrapa muzeut. Kush e di ç’mashtrime po iu këpuste nja dy shqiptarëve, që po e ndiqnin ligjëratën e tij gojëhapur.

“ Mirëmëngjes, honorevole!”, më përshëndeti qesënditës.

“ Ku është Emanuela?”, e pyeta.

“ Mua më tha se do të qëndrojë në Milano, honorevole. Ne biseduam një herë...”

Më cingëriste nervat ajo fjala “honorevole”. Se pse më përngjasonte me “nevojtores”.

“ Unë dua Emanuelën, i thashë, sot do shkoj ta marr në Itali. Po nuk më tregove se ku është, ke mbaruar, miku im!”

Duhet të isha bërë i zi në fytyrë, ndonjë tip Otello duhej të ngjaja. Italiani e uli pa m’i ndarë sytë filxhanin e kafesë në tavolinë.

“ Çfarë të lidh me Emanuelën?”, më pyeti.

“ Ajo duhet të lindë një fëmijë me mua”, e gënjeva. E hëngri, se veç gënjeshtren e bëja me një barrë art, aq sa e besoja edhe vetë deri në atë masë, sa

m' u duk sikur Emanuela tani po ndjente lëvizjet e foshnjes në bark.

Më pa edhe një herë. Haje rrenën, iu luta pa zë me gjithë zemër. Fytyrën e kisha të akullt, sikur sapo kishte dalë nga frizeri, por përbrenda dridhesha si një qenush i sapolindur.

“ E ke në Rimini, tha pastaj. Dje ma thanë në telefon që gjendet në plazhet e Riminit, por emrin tim mos e zer në gojë...”

E sigurova se nuk do të flisja me njeri dhe që nuk më interesonte asgjë tjetër, veç Emanuelës. Ishte fjalë që mund të mbahej.

Emanuelën e gjeta vërtet në Rimini. Ajo u afrua ngadalë te makina ime, e veshur me një mini dhe me delkote tunduese. Ishte e bukur, tmerrësisht e bukur dhe e rraskapitur. Kur më pa, vuri duart në fytyrë dhe qau. Unë i bëra një shenjë të hypte në makinë. Ajo hyri pa folur. Një muaj qëndroi në spital. Unë i qëndroja te koka, e ushqeja me duart e mija dhe bëra një mijë majmunllëqe, që t'ia mbushja mendjen se gjithçka pati qenë një ëndërr e keqe, që nuk do të përsëritej më. Më priste me ankth, sa herë largohesha, dhe unë ia ndjeja gëzimin, kur më rishihte në derë. Kur e lamë spitalin, ishte një tjetër Emanuelë. Ishte një vajzë e bukur, vajzë ende e vogël dhe e padjallëzuar, e pastër, me flokët e lidhur pas me një kordele të kuqe dhe me një vështrim të pafajshëm. Por nuk kishte qejf të fliste. Unë i tregova asaj për Andin, i tregova vuajtjet e mija, ëndrrat idiote dhe ato gdhirjet mëngjeseve në ballkon.

Më në fund ajo foli:

“ Për mua e bëre, apo për shpirtin tënd?”

Nuk kishte kuptim ta gënjeja.

“ Për shpirtin tim, i thashë, vetëm për shpirtin tim! Tani jam shumë më i qetë.”

“ Mirë, më tha. Faleminderit!”

Pastaj shtoi gjithë pikëllim:

“ Sa shumë vajza ka si puna ime!...”

“ Të lutem, harroji!”, i thashë.

“ Nuk i harroj dot, ma ktheu e pikëlluar. Më duket sikur unë ua rrëmbeva të gjithë fatin, që ëndërronin e prisnin së bashku. Ti nuk e di se me ç'ankth e presin shpëtimin ato vajza...”

Ajo erdhi në shtëpinë time dhe unë nuk shkova më në Parlament. Askush nuk e mori vesh të vërtetën. Edhe Kuqi nuk u shfaq më. Vetëm se mua tani shumica e njerëzve më cilësojnë “idiot”, për vendimin absurd të marrë, dhe një muaj më pas Emanuela dalloj që ne të dy ishim thinjur në mënyrën më të çuditshme, si me magji.

QIEJT E VETMISË

FRAGMENT NGA ROMANI ME TË NJËJTIN TITULL,
KAPITULLI I PARË

VITI 1985

Kur Emën e thirrën atë fillim pranvere në hetuesi, ajo ishte e bindur se tani dielli i saj, ai palo diell, që, më shumë të ftohte se të ngrohte, kishte perënduar një herë e përgjithmonë. Ajo firmosi thirrjen e shkurtër e të prerë, me një firmë të palexueshme në fund dhe ra e sharruar në karrige. Nuk doli 24 orë nga shtëpia, u bë e shurdhër kur binte dera dhe vetëm fqinjës, një gruaje të moshuar me vështrim të butë prej nëne, i tregoi ç' i kish ndodhur. Ajo grua e urtë nuk e pati lënë të vdiste për bukë, kur qe keq. Ajo grua i kishte dhënë gjithmonë zemër. Po tani?...lu lut tjetrës t'ia mbante fëmijën deri sa të kthehej nga Hetuesia dhe, si fshiu sytë e përskuqur me shpinën e dorës së djathtë, dëneşi e tha me një psherëtimë të thellë:

- Më mirë të kisha vdekur!...Unë e vdekur kam qenë, po më vjen keq për Lorenin. Do ta shohë burgun që tani...

Fqinja u përlot. E deshte këtë nuse të re. Fati i keq e hodhi në mes të katër rrugëve pa nisur jetën akoma. E ç' faj i mbetej kësaj, kur e martuan derr në thes, e martuan si në kohën kur s'njihej shteti, edhe për çarçafët me gjak bënë sherr e sa

s'u vranë me njëri-tjetrin, për t'ia varur në tel, që ta shihnin të gjithë ndershmërinë e nuses!...Jetohej me ata njerëz?...Deshte edhe kjo vajzë t'i gëzonte ditët e saj, paçka se nuk e gjeti rrugën e duhur...Ajo u ngrit të bënte nga një kafë, megjithëse në atë kohë zije, kafaja mezi sigurohej, por më shumë u ngrit, sepse nuk deshte që Ema ta shihte të përlotur. Atëherë kush e di ç'do të ndodhte...Kur i solli kafetë, sytë i kishte të thatë dhe tjetrës po kaq thatë i tha ca fjalë:

- Ti kishe hyrë në bata, po Perëndia do të shikojë dhe mbase të ndihmon...

Ema mohoi e vendosur me kokë. Nuk ka Perëndi në këtë vend. Gjithmonë pa fat kishte qenë. Le që ajo e kishte mbushur plot me duart e saja kupën...

- Ishte mbushur,- tha tjetra,- por ajo zbrazet, po t'u mbush me mirësi shpirti!

E ku dinë proverba ata të hetuesisë, u ckërmit me vete Ema. Ata përsërisnin si papagallë vetëm atë proverbën që e dinë edhe qentë: kush i bën gropën tjetrit, bie vetë brenda!...Dhe ajo prandaj qante, se ky proverb e plaste drejt e brenda...

Ajo i la një autorizim fqinjës, që të merrtë të gjitha ushqimet e saj me tullon, derisa t'ia jepnin, merrej vesh, la djalin në gjumë, mori bekimet e fqinjës, qau edhe një herë me kuje dhe u nis për në Hetuesi. Ishte 20 mars i vitit 1985. Ditë e martë. Ters. Me rrugët shkretane, me ca makina që shpërndanin dru e jevgj që këndonin sipër druve. Në atë udhëtim drejt fundit, Ema ndjente një frikë të llahtarshme. Turpi i përzjerë me ankthin dhe tmerrin, e bënte të dridhej dhe të mendonte tmerre shtesë, a thua nuk i dilnin ato që e prisnin. Një herë mendoi të vriste veten më mirë. Kështu, do shpëtonte nga gjithçka, nga turpi, nga burgu dhe nga fundi...Do ta burgosnin, do t'ia merrnin apartamentin, do t'ia merrnin Lorenin njëzet muajsh, i vëllai do zbriste nga mali me sëpatë, fytyrë të dilte në rrugë nuk kishte më, punë s'do gjente, lekë për bukë jo, strehë jo, atëherë...

* * *

Xhixhi rrinte i ulur te bordurat përballë hotel "Dajtit", shullohej në atë diell të ngrohtë pranvere dhe fishkëllente në qejf të vet melodinë e filmi "Doktor Zhivago". S'dëgjonte asnjë fjalë ç'nxirrnin nga goja çunat afër tij, tundte këmbët pas ritmit të muzikës dhe kështu nja një orë të mirë, po ajo fishkëllimë e po ai studim indiferent i rrugës, derisa i kapi veshi emrin e Emushkës.

- Ç'ka bërë vaki?

Në sy e kish atë portret me seks të fshehur mirë e të dalë si poç në ballë, ecjen nazike duke tundur vithet provokueshëm, jo se donte, po se e tillë kishte lindur, limon, për të ta mbushur gojën me lëng e syçkën plot me ato ëndrrat që të prishin natën. E njihte mirë, që atje në gjyq, kur u divorcua me Ard idiotin...

- E ka thirrur Hetuesia,- u zgërdhi Tosi.- Motra e kishte kthyer shtëpinë

në bordello...Lironte shtëpinë për çiftet ilegalë me qera...

Tosi ishte kriminel. Kot s'thonë, mendoj Xhixhi, kuqi më i mirë ka vrarë babën e vet...Ky pis edhe sytë i kishte të kuq...E pse mos tallej syzjarri me Emën? Plaku i vet i qethte mirë robt atje në Komitet, edhe atë kaishin që mpref briskun ua fuste në llogari berberëve që kërkonin punë, kurse Ema...Ema rrezik ishte nja 100 mijë lek borxh, që kur u nda...

- Ti ia fut kot!- i tha tjetrit mosbesues.

Në të vërtetë, ishte kurioz, po nuk deshte ta ulte hundën, atë hundë si poç, që nuk dilje kur huq, po t'i gjuaje.

- Vdeksha në vend!- u betua Tosi.- Edhe me dollarë e ka lëshuar shtëpinë!...Kuçkë e fortë! I seleksiononte çiftet. Atyre që ishin të martuar, iu kërkonte më shumë...Më tregoi plaku...Kur nuk e mora vesh dy muaj përpara,- psherëtiu i trishtuar ai,- lash nam me Letën rrugëve...

Xhixhi ngriti duart lart. Allah-Allah, shqipërohej ajo shenjë. Do dëgjonin gjëra të çuditshme në këtë vend, vetëm durim të bëje. Ai e mbylli gojën e nuk llapi më, vetëm nga brenda e mallkoi veten që nuk i doli një herë përpara Emës, mbasi ajo u nda nga Ardi, në atë gjyq store, ku ajo ndihmës gjyqtarja plakë psherëtiu: Qyy, sa shpejt i heqin brekët këto gocat e reja!...

Iu kujtua se si e vështroi Ema në koridorin e gjykatës, si ia ngriti sytë rrëshqanthi tek i kaloi ngjitur fare në kalesën e ngushtë, si ia ngjeshi gjirin e fryrë nga qumështi në shpatull, si i tha " më fal " me një nënqeshje e tallje të lehtë e si u largua duke e parë edhe një herë, kokëkthyer tani, m'u në dritë të syrit...Ishte treguar një krimbush i sterilizuar atëherë! Ik gjeje në burg, tani, kërkoje nëpër ato hekurat e kryqëzuar të mbushur me brekë, napa e rexpipeta grash!...Pastaj vendosi ta linte kurvën në punë të vet. Filloi të kundrojë monumentin e Leninit përballë, e shau atë qelbësirën që ua kishte bërë gjysmës së globit mendjen revolucion dhe jetën tullon, brodhi vështrimin nëpër bredhat para hotelit, numuroi një kohë turistët e huaj që hynin në hotel, pastaj kundroi si mekanik profesionist makinat e parkuara karshi dhe krejt befás e kapi veten duke bërë llogaritë e Emës...

Sa lekë e ka shitur një seancë dashurije?...E zemë, një mijë lek...Sa herë në ditë?...Më shumë se dy herë, jo, se ta kap kokën me derë vigjilenca e shokëve të lagjes që në fillim...Ba, sa të poshtër janë kalecat vullnetarë!...Sa kohë ka që e bën këtë punë?...Gjashtë muaj...Mirë. Kemi 180 ditë herë dy mijë lekë, 360 mijë lekë...Shoferët e TIR-it i lamë veç, meqë ata lenë më shumë, pa harruar edhe plaçkat, apo ndonjë gjë tjetër...S'qe fort keq, llogarija dilte...

- Varfërija,- shqiptoi me zë pastaj.

- Tafmaja,- ia ktheu Tosi.

Edhe Tosi po mendonte për Emën. Nuk ishte e keqe për një natë. Ai ia pati kërkuar një herë, ca muaj të shkuar, por ajo e pati larguar thjesht fare: shko,

lau një herë...Zhuls!...Po askush nuk e dinte këtë histori.

Ata s'folën më. Melodia e "Doktor Zhivago", mbushur trishtim pa hesap, u përhap përsëri dhe Xhixhi u hap në fytyrë dhe nisi ta fërshëllejë gjithë art melodinë, kur pa që po afroreshin tre vajza të konservatorit. Ato e hëngrën grepin. Ndaluan të ngrira në rrugë dhe njëra prej tyre pyeti si me turp:

- Ej, çuni, kush e ka kompozuar këtë muzikën?

* * *

Hetuesi nuk e la Emën të priste gjatë në koridorin e errët të ndërtesës pranë burgut. E pandehura nuk pati kohë as ta gjente dritaren e qelisë ku do të izolohej si fillim. Dëgjoji kumbimin e emrit të saj.

Ai 30-vjeçar, kishte një fytyrë të egër kalldatëse. Heshtaman dhe i prerë, ai e tmerrroi Emën pa u ulur mirë akoma. Ajo kishte dëgjuar për këta bisha, që ta bënë mishin copa-copa dhe ta jepnin ta haje ti vetë pastaj, kishte dëgjuar gjëra të tmerrshme, që nuk ndodhnin kurrë dhe iu lut Zotit që hetuesi t'ia pëlqente pamjen. Mbase sillej më mirë...Ajo priti me ankth, me atë nuhatjen e njohur të koketës të kapte ndonjë sinjal tundimi, po shqisat e saj nuk nuhatën gjë dhe u tmerrua fare e iu vajt në banjë, kur mendoi se ky hetuesi mund të ishte ndonjë nga ato tipat me fiksime, që i ruhen femrave me nam të keq, të cytur nga neveria apo nga frika se mos marrin gjatë kontaktit ndonjë sëmundje veneriane...Po unë jam e pastër, s'kam asnjë shenjë, dënesi ajo, kam edhe prezervativë...Po as bëhej fjalë t'i shqiptonte me zë këto fjalë e ta provokonte tjetrin.

- Ti e di mirë pse je thirrur këtu. Të të pyes unë, apo do të rrëfesh vetë?- foli me bezdi hetuesi, duke i rënë lehtë me mollzat e gishtrinjve tastove të makinës së shkrimit, që rrinte gati si qen-ujk për të hamëruar e për të hedhur në letër bëmat e saj.

O Zot, të shpëtoj një minutë e më parë, u lut e qaravitur Ema dhe i hapi në çast zorrët e barkut. Këtu qaj, atje fshij hundët, thuaj një emër e thuaj "më fal", ajo mërzi keqas tjetrin. I bëri çorbë derri të gjitha përmes trokitjeve të makinës së shkrimit dhe, më në fund, kur mbërriti te emri i shokut Pertef, pa një copë letër të bardhë që i ishte zgjatur përballë.

- Prit! Shkruaji në këtë letrën emrat e të gjithë meshkujve që kanë ardhur të shoqëruar në apartamentin tënd. Mendohu mirë! Nuk dua të më thuash në fund "harrova"! Për bri secilit, shëno sa herë ka ardhur dhe sa lekë, apo mall, ke marrë...

- Po unë nuk i di emrat e të gjithëve,- belbëzoi Ema.- Te disa unë njihja femrën...

- Te çiftet që njihje femrën, shëno femrën, - i ra shkurt ai,- por edhe një herë: mendohu mirë!

Ema ia nguli sytë përhumbshëm letrës së bardhë. Varr i bardhë, thuaj më mirë...Ja, kështu e deshte varrin nëna, me mermer të bardhë, po ajo mbeti me një gur të pa skalitur mirë te koka, se kush kishte lek t'ia bënte?...Leri varret, fliste letra...Ajo ishte kthyer tani në një ekran kinemaje, ku, për dreq, as aparati i projektimit nuk prishej si rëndom e as filmi nuk këputej në asnjë vend...Ja, Ardi! Te ndarja me këtë surrat, që e rrafte kot fare, kishte filluar katrahura...E pse hante dru? Sepse dukej femër e mirë dhe ai bëhej xheloz! Rrihet si kafshë njeriu për ditë kot?...Jo pse u lave, jo pse ndërrova të mbathurat...Edhe ajo, debilja, vajti e u ngatërrua nga inatit me Maksin dhe e futi në krevat, a thua po flinte me Lorenin...Si rrapëlliu dera, kur e kapën?...Si e shqyen kanatash kafshët dhe e nxorën lakuriq nëpër shkallë...Mezi arriti të vishej...Po Maksi? Ai mbante kanatieren shuk para organit mashkullor dhe s'e lëshonte për një qind vjet, sikur të ishte molë, jo njeri...Po Maksi e ndihmoi, kur e qëlluan...Atëherë ia ia hyri të tre vëllezërve dhe i flakaroj nëpër shkallë, si këlysha maceje...Adi e meritonte shpagimin, por ajo gaboi që shkoi me Maksin. Asgjë nuk mund të fitoje në këtë vend, po të kërkoje drejtësi e dinjitet! Kjo dihej me kohë e vaft...Ah, po, fitoi turpin dhe varfërinë, se të gjithë asaj i thirrën "kurva" dhe, sa për drurin që hante mëngjes, drekë, darkë, bile, jo rrallë edhe për zemër, as çante kokën njeri. Se mos ishin torturuar ata, morracakët e fëlliqur të rrugës, që gjithë natën shihnin ëndrra me dashnore e dashnorë dhe në mëngjes kishin frikë t'i bënin realitet...Divoci kishte qenë i tmerrshëm në gjykatë. Hajde shpjegohu para pesëdhjetë spektatorëve!...Atje filloi katrahura e madhe...Po ai gjykatësi ia mbajti krahun. Kur ajo dëshmoi duke gëlltitur lotët se si e kishin martuar derr në thes e se ç'dru kishte ngrënë prej Ardit, u mor vesh se atij i hypën nervat...Nuk e gërrmoi shumë dhe apartamentin ia la, kur mori vesh pastaj edhe atë tjetrën, se rroga e saj qe 4 200 lek të vjetra...Ema Fistani, e lindur në 13 tetor 1971, në Librazhd, do mbajë apartamentin një dhomë e guzhinë dhe do të kujdeset për djalin, derisa ky të arrijë moshën e ...Iu kujtua pensioni qesharak i Ardit për Lorenin, pastaj shuma në total, pastaj ato minuset e frikshme: qeraja e shtëpisë, korenti, drutë, pagesa e çerdhes, qumështi i Lorenit, bukë për çdo ditë...Stop! Mbaruan lekët! Si kemi thënë që në fëmëni: mos marrim borxh!...Muhalebi, për Lorenin, bukë me ullinj, për vete...Ajo e ndejtura në rradhë me orë për të marrë atë peshkun e vogël, më të lirin, që t'i bënte duart copë kur e haje e jo më kur e laje!...Pastaj ajo kafja e pirë më këmbë me Marizën e bukur, qarja e hallit, mallkimet në hapësirë për këtë jetë pa pak dritë dhe pëshpëritja shpëtimtare e tjetrës m'u në rrëzë të veshit:

- Ti jë budallaqe! Me atë apartament fantastik që ke, ti bëhesh milionere dhe i thua halleve "pa m'u qërroni nga shtëpia ime!"...

- Unë, milionere?!- qe letuar ajo.

- Ti!...Pak qeflinj ka, që s'e bëjnë atë punë, vetëm se nuk kanë një çelës

apartamenti? Pasurinë falin ata për një çelës! Kurse ti, qahesh...

Pastaj ajo pyetja fatale e të uriturës "po ku janë" dhe përgjigjia e Marizës: "T'i gjen, motra, ty, po edhe unë kam pjesë! Ne do të fusim lekët në xhep dhe nuk mbajmë mend gjë prej gjëje!..."

Tani dilte që njeriu detyrohet të mbajë mend...Kush më spiunoi, vrau mendjen ajo, para se të fillonte të shkruante, por ishte aq e trembur, sa nuk bënte dot njeri fajtor. Të gjithë spiunë janë në këtë vend, popull spiun, që thotë hëngra djathë, kur ha sapun, që spiunon veten e vet, kur s'ka kujt ia fut!...

* * *

Fqinjës po i binin pjatat nga duart...C'ke, hungëroi, i shoqi, një punëtor i vjetër partije, që ishte ulur të hante bukë...Më vjen keq për Emën, tha më në fund ajo...Dhe i tregoi tjetrit gjithë ç'kishte ndodhur...Atij nuk i vinte keq. Kush ia kishte fajin? Nuk jetohet me kurvëllëqe! Po sikur të shkonte edhe vajza jonë e martuar atje?...Nuk them se bënte punë të mirë, u ngashërye tjetra, po edhe njeriu nuk lihet ashtu, në mes të katër rrugëve për bukën e gojës. Do hante një copë kothere edhe ajo dhe, po mos ia jepje, do ta vidhte, domosdo...

I shoqi të egër kishte pamjen, po shpirtin, flori e kishte dhe, si fshiu pjatën, në fund tha se ata nuk e ndihmonin dot Emën. E vetmja e mirë që mund t'i bënin asaj, ishte që, po t'i kërkonin për dëshmitarë, të thonin se Emën e njihnin për vajzë të urtë e gjë me sy nuk kishin parë...Bëj edhe ndonjë telefon, iu përgjërue e shoqja, kush e di, bie në vesh që dëgjon...Ai nuk iu përgjigj...

Kurse në atë kohë, në zyrën e mobiluar varfër, Ema u mendua edhe një hop para se të shkruante emrin e parë në letër. Pastaj u mbush me frymë dhe shkruajti me një kaligrafi të rregullt MARIZA SHEQI.

Dera kishte trokëllitur tinëzisht një paradreke të mjegullt shkurti, me një pastërri marramendëse në dhomë, me një shtrat të rregulluar simetrikisht me çarçafët e pajës së shtruar me ca qëndisma flurore në krye, me reflektorin e ndezur në skaj të dhomës, që jepte një ngrohtësi gjumëndjellëse...

Ajo pati fluturuar në koridor, kur një dorë e kujdesshme prej njeriu veshngritur qe shfaqur si i bukuri shejtan në derën e apartamentit të kredhur në heshtje dhe Ema qe përballur me një mesoburrë rondokop e kaçurrel, që printe para Marizës. Ema nuk e njihje mashkullin përballë, as i interesonte ta njihje, por një vështrim i shpejtë mbi xhinset, xhupin e meshintë, pulovrin e butë dhe këpucët e ngrohta ngjyrë mjalti të tjetrit, i pëshpëriti në vesh se tjetri duhej të ishte ndonjë nga shoferët e parkut të eksportit...

Ema i priti si zonjë shtëpije. Iu priu në guzhinë, iu nxori arra të thyera e

nga një gotë pije dhe ruajti një çast heshtjeje, me portretin e përndezur të Marizës përbri, që ajo t'iu propozonte, duke belbëzuar nga turpi, se ata edhe mund të bisedonin matanë të pashqetësuar, pasi ajo do merrej me ca punë shtëpije...

Mariza u ngrit e para, ndërkohë që tjetri kundronte me trishtim e kuriozitet bashkë muret e boshatisur me ndonjë fotografi aty-këtu, sobën e vjetër dhe radion shkatarraqe, që, rrezik, as Radio Tiranën nuk kapte, bufenë e shpartalluar dhe qilimin e vjetër e të tejdukshëm, që bënte sikur e mbulonte e i jepte jetë asaj shkretije...

U ngrit edhe ai. Pastaj ndaloi te dera. Gërmoi në një nga xhepat e xhupit, nxori më në fund një pako të vogël, nuk e vuri Emën në pozitë turpi, por e hodhi pakon mbi kolltukun e vetëm dhe mërmëriti duke u zhdukur në koridor: "Me këto që na u ndodhën...Me këmbë të mbarë!..." Me cilën këmbë, pyeti ajo koketërisht me vete, po merrej vesh se nuk ishte idiote ta lëshonte zërin. Ama, po vdiste nga kurioziteti sa të gërmonte pakon! Priti me durim e si zagar, derisa dhomës së gjumit iu vu çelësi nga brenda, pastaj shqeu në çast letrën mbështjellëse. I shkau një zinxhir i hollë qafe në gishtrinjë, dy çokollata zviceriane dhe një top me çamçakiza, pastaj një kartmonedhë. E re, fringo e re. Një mijë lek. Drutë dhe çerdhja, u lumturua ajo me lot gëzimi në skajet e syve...

Kështu kishte nisur historia që tani po shndërrohej në tragjedi. Me lot gëzimi, me klithma epshi, që lëshonte Mariza nga dhoma e gjumit...Më fort!...Tani, xhan, tani, taaniii!...Oh, mos, xhan, moosss!...-klithte e lutej Mariza andej matanë dhe, pavarësisht se Ema e dinte mirë kujt dhe pse i përgjërohej Mariza, ajo e mallkoi veten në dhomën e ftohtë të hetuesisë që nuk i dëgjoi që ditën e parë përdëllimet e shoqes së saj.

Mos, të lutem, mos, i qe përdëlluar e i pati rënë në gjunjë nja katër muaj më pas edhe ajo vetë rondokopit, kur ai i pati zënë derën e shtëpisë një mbrëmje vonë, krejt i vetëm, me një pako në dorën e djathtë, ku vetëtinte një unazë e mrekullueshme platini. Ai kishte hyrë drejt e në guzhinë me një mërmëritje " më ra rruga këtej " dhe ajo qe detyruar ta priste. Kurrë nuk kishte qenë kafshë, të përzinte njerëzit si rrugaçe. Shoferi veç buzëqeshte, edhe kur gjerbte kafenë, edhe kur kthente me hurba të vogla gotën e rakisë. Asaj diç i thërriste papushim brenda kurmit të bënte kujdes nga kjo vizitë e papritur. Dhe nuk ishte gabuar. Një herë të vetme iu afrua, për të hequr fîlxhanin e kafesë nga mbajtësja e vogël dhe fîlxhanin ishte bërë copa-copa. Ai e pati përmbledhur nga mbrapa me ato duart e tij të forta në bel, të pushtetshme, sa nuk kishte Perëndi t'iu shpëtoje dhe e kishte ulur në prehërin e tij, mbi një penis të fryrë që të çponte e të jepte siklet. Me duart e tjetrit si ganxha mbi gjinj, ajo i qe lutur e qaravitur ta lëshonte, por tjetri vazhdonte t'ia bënte brinjë çaçkë me shtrëngimin e tij prej burri. Kur po e ndjente që po mbetej lakuriq, Ema do ngrinte kurthin e fundit: "Eshte dera hapur!", me shpresë

se ai do të ngrihej për ta rrotulluar çelësin në bravë, por përsëri dështoi. Kur ai i pëshpëriti i ndezur e tallës: “Ky është avantazhi i shoqërisë socialiste, që nuk ka kriminalitet!”, ajo e kuptoi se me ç’ mjeshtria i qe puqur ylli...I ishte lutur edhe një herë në shtratin e madh, siç e kishte bërë nëna tani, ta lëshonte, bile, ta falte, pati thënë ekzaktësisht, por e dinte edhe vetë se dy njerëz lakuriq s’heqin më dorë nga ajo punë...Atë natë ajo mallkoi veten që nuk ishte marrë nga pak me fiskulturë. Pas gjithë atyre stileve që pati vënë në jetë shoferi, në mëngjes asaj i dhimbte i tërë trupi...Ti je seks fantastik, i kishte vënë notën barbari në ikje, dhe mos u mërzit e mos u shpërnda, se do mendoj unë për ty. Të premtën që vjen do kthehem direkt nga Viena te ty, mos thirr njeri në darkë!...

Emë ishte betuar t’i vinte derës një sy magjik. Por nuk e mbajti betimin. Pakua e shoferit qe blatur vërtet tepër bujarisht. Mund të konsideroheshin të mbyllura përfundimisht disa halle dhe, të premtën e ardhshme, do të kopsiteshin edhe shumë të tjera, kështu që nuk ia vlente të hapje kot vrima. Ai derr i fëlliqur do të sillej vërtet mrekullisht me Emën. Do ta vishte nga koka te këmbët, do ta bënte zonjë të madhe, do t’i jepte sahatë kontrabandë për t’i shitur e do t’i thoshte bujarisht “Mbaji lekët për vetë!” Dhe si shkëmbim, një muaj më parë do t’i kërkonte mos shkonte me të tjerë, sa kohë do të mbetej ai në mes...Deri tani ke bërë sikur ke jetuar, që sot do jetosh si të kem qejf unë!...Emë vetëm kishte mbështetur kokën në gjoksin leshtor të përdhunuesit të saj. Dhe nuk i pati shkuar në mendje ta tradhëtonte...U betua mos ia shkruante emrin as në listën që po hartonte, në atë listë si varrezë, që kush e di sa njerëz do kallte ne dhe...

* * *

- As kaqkë xhanëm s’dini?!- bëri të habiturin Xhixhi, duke imituar dialektin korçar.

E dinte mirë se ajo vajza ëngjëllore, që bëri gabimin e të pyeturit, ishte nga Korça.

- Ç’ne,- vazhdoi ai, me rudimentin e të folurë së gjyshes në mend.- Kam thënë unë, dy para nuk na bën Konservatori! Hyn njeriu injorant e del idiot...

Vajzat u errën në portret e u bënë gati të hidhen në sulm, mirëpo i ç’ mobilizoi Xhixhi me atë urtësinë e tij të pashoqe, kur lëvizti nga vendi e ia nisi shpjegimeve shtruar, se kjo ishte muzika e filmi “Doktor Zhivago”, që, domosdo, ato s’e kishin parë, se qe i ndaluar, pra, dhe kompozitori ishte një si biçim rus i bardhë me banim në Amerikë...Tha pastaj diçka për Omar Sherifin, që e pati zbuluar mes mijëra aktorëve xaxa një regjisor anglez, jo si puna jonë, që ju tre jeni dhe tjetri s’di të thotë cila është më e mira, e bëri muhabetin çorap dhe arriti të bashkohet dora-dorës me vajzat. Sytë i mbante te ajo korçarja flokëgështenjë, me dy jeshil,

që vetëm një zot e dinte se si bëheshin kur puthte ndonjë mashkull...Mbase i shoh unë i pari, uroi ai me tolerancë veten e tij. Tjetra se pse i dukej si punë virgjëreshë...Kush e di sa vështirë do të jetë ta prishësh këtë, vazhdonte ai fantazitë e tij erotike pa kufi dhe erdhi e iu ngrit mendja keq. Kishte edhe në këtë pisllek plot fuksa e kaleca ca lule orkide, si puna e kësaj dhe pse mos ta këpuste ai? Babain anëtar partije, profesor marksizmi në universitet, mamin anëtare partije, doktoreshë, familje e lidhur me Luftërat, nga e Vlorës deri tek e ajo kundër karkalecit!...Kishte dhënë edhe ai kaq, sa për për të marrë një copë! Le të merre këtë çupën, po nami të bëhej, edhe sikur të dilte me humbje! Të gjithë nuk do të fitonin, tek e fundit!...

- Ti do të ecësh!- iu drejtua me besim absolut korçares.- Si para syve të kam, kur do të interpretosh "Aidën" në Teatrin e Operas dhe Baletit...Po që e shikoj edhe veten time, duke të dhuruar një buqetë me lule në skenë!...

Ato u shkrinë fare.

- Nga e kuptuat, profesor?

- Ka shumë pranverë, në zërin tënd,- ia nisi ai i pashqetësuar, atë kohë kur Tosi uluriu e tha: ku e morën vesh, që je profesor, mër jahu!...Mua të gjithë më marrin për druvar!...

Syjeshilja nuk ia pati harruar fyerjen dhe duket nuk pati durim ta priste deri sa t'i dilte tamam në shteg.

- Shoqëria ta kupton me shpirtgjerësi dhe tolerancë, aq karakteristike për ne, talentin,- tha ëmbëlsisht, a thua po i shprehte dashurinë tjetrit,- ajo të ndihmon, të jep dorën përmes dashamirësve të kulturuar ta gjesh vetveten, kur bën sikur të pyet: mos jeni gjë druvar ju, shok?...

Vajzat dhe Xhixhi qeshën me lot.

- Fantastike!- përplasi duart Xhixhi.- Më pëlqeve! Po të duash mund të ta jap kasetën me muzikën e filmit ta studiosh ca ditë...Tani ai fytyrëpisha do t'i vjedhë sopatën plakës dhe, he, në mal, te të parët e mban vrapin vëllai...

- Nuk më gënjen për kasetën?- pyeti mikluese vajza.

- Sonte, në orën 7 këtu!- tha Xhixhi.

Iu dha dorën të trejave, si për të thënë "Qe besa!", pastaj ia mbathi për te vendi i tij në bordurë, pa i lënë kohë syjeshiles të thotë diçka të përafërt me "sonte kam punë..."

Tani nuk kishte më as më të voglën dëshirë të fishkëllente e as të kundronte rrugën. I pëlqeu shumë syjeshilja, me zëthin në gjininë e soprano ve e atë gjoksin e bukur pordhac kryelart. Iu lut edhe një herë Zotit që t'i nxirrte vajzën sonte në mbrëmje, duke varur vështrimin qaraman andej nga minareja, pastaj le t'i ngelej atij puna tjetër...Nuk donte më shumë nga Zoti i madh...Veç ta shikonte Zoti këtë herë, mbase i fuste ndonjë lek në xhep deri në darkë e kush e di i ngrefej t'i

tregonte korçares që ai ishte me biografi të mirë...

U kujtua që dje kishte humbur dy lojë të mëdha në tavëll me gjyshin dhe sikur i erdhi mirë që kishte ndodhur kështu. Proverbi në këtë vend, që t'i jepte gjërat me kompesim, thoshte se kush nuk ka fat në bixhoz, ka fat në dashuri...

* * *

ILIR GURAZIU shkruajti Ema në letër dhe në çast u pendua për tradhëtinë që i bëri piktorit moskokëçarës. Po emrin nuk dyzoi ta hiqte nga lista. Në atë tmerr që po jetonte në pritje të pretencës, asaj nuk do t'i dukej ndonjë çudi e madhe sikur edhe piktori të kishte qenë denoncuesi varrmihës. Hetuesi i qëndronte përballë, katër pëllëmbë të mëdha larg në vijë ajrore, i zhytur në leximin e gazetës "Drita".

Ema shënoi pranë emrit të porsashkruar "dy herë". Kishte paguar vetëm dy herë me lekë në dorë piktori, një herë kur erdhi me atë studenten njomëzake nga Shkodra, që vetëm qeshte kur bënte atë punë, sa tundeshin muret e shtëpisë, dhe një herë kur iu lut asaj t'ia zëvendësonte studenten. Herën e tretë kishte sjellë një akuaREL fantastik, por ky ishte tjetër muhabet...Atë ditë piktori i kishte thënë duke fërkuar kokën tullace se, po të donte ajo, ai e paguante t'i pozonte një seancë si model...Asaj iu ngroh shpirti nga vëmendja e tjetrit. Kishte edhe ajo vlera, nuk qe vetëm ashtu. Tha "këtu jemi" dhe e priti me padurim piktorin, derisa ai erdhi një mëngjes të diele i ngarkuar me tavaloc, telajo e kartona...E kishte hapur me kujdes tavalocin në skajin e dhomës, pat nxjerrë bojërat dhe e kishte urdhëruar tjetrën të xhvishej nudo e të qëndronte e shtrirë në shtratin e madh...Tre orë kishte pritur me durim shembullor Ema, që tjetri të mbaronte, derisa kishte ardhur çasti kur piktori fshiu duart me leckën e pistë, i lau mirë e mirë në banjë dhe erdhi i xhveshur në dhomë dhe iu hodh si majmun përsipër...E kishte dashur me gjithë shpirt atë ditë, e kishte thithur të gjithin në atë ekstazë, që ia jepte më shumë piktura e bukur e pa tharrë ende në skaj, sesa seksi i tij...Tani ishte edhe ajo heroinë, personazh si thonë, dhe kush e di ç'do shkruanin pas pesëdhjetë vjetëve kritikët për këtë pikturë të mrekullueshme...Ai dashuronte një vajzë të thjeshtë, që quhej Ema Fistani, e cila...Qejf, ëëë?...Kjo kishte qenë hera e katërt dhe e fundit e frenkuentimit të piktorit. Po dy herët e fundit kishin qenë të diela, ditë pushimi të dhëna nga Qeveria, lek s'kishte marrë dhe për këto gjëra ajo nuk i jepte llogari askujt!...

Emës i ngeli në sy piktori. I dukej sikur po bënte mëkat, mëkat të madh, bile, por. ngushëlloi veten, artistët dihet që janë qejflin, mbase nuk do ta varrosnin, si të tjerët...E pa veten të mbledhur kutullaç në gjoksin e madh të tjetrit. Atje ajo po ç'lodhej e po mendonte njëherësh se si qenë ngatërruar punët kaq keqas...Po e

bënte për herë të dytë mëkatin dhe pabesinë e të rënit në krevat me dashnorët e të tjerave. Siç po dukeshin bathët, do bënte mirë të priste flokët shkurt, të paktën, sa pa ia dhënë ndonjëra nga të grabitura në dorë me gjithë skalp!...Ajo dëgjoji zërin e përhumbur të piktorit:

- I ke bërë llogaritë mirë, që e ke kthyer shtëpinë në bordello?

Ema qe ftohur. Përse fliste kaq barbarisht, vandali i dreqit!...Bordello!...E tendosur në çast si tel nga fyerja që s'mbahej në shpinë, ajo buzëqeshi ëmbël:

- Epo, unë nuk kam talent për pikturë dhe, ç'është poshtërsija më e madhe, sikur më hahet edhe bukë...

- Nuk e dija që ishte çështje ekzistence,- ia ktheu po aq indiferent piktori.

Dukej se kishte folur kot, pasi ai muhabet nuk i interesonte absolutisht fare.

Dhe qëndronte firifiu me sytë në tavan, a thua harroi ç'llapi e tani po kundronte ndonjë afresk gjysmë të rrënuar...Engjell...Anxhelo blu, murmuroi gjithë në tërbim e sipër Ema, duke vëzhguar me bisht syri atë portret idiot prej jargavitësi andikapat...Iu kujtua vetëtimthi emri i një këngë italiane të kohës së gjimnazit, kur ajo me shoqet linin orën e fundit të premtëve dhe vraponin në shtëpinë e Mondës përmes të vetmes rrugë të qytetit të vogël për ta dëgjuar në Hit Parejdin italian...Vetëm Monda kishte radio...Në atë kohë, në qytetin e vogël kishin ardhur specialistë muzike nga Tirana, për t'iu mësuar mësuesve të muzikës së qytetit të saj këngën kineze "Kuç është nga perëndon"...Ajo qe ndodhur vërtet në një skenë të rrallë, kur shkoi të kërkonte nënën në Pallatin e Kulturës dhe pati hyrë nga dera anësore drejt-e në prapaskenën e sallës së koncerteve...Një dirigjent në skenë ulurinte me megafon para sallës së mbushur tumllas me mësues muzike: "Edhe një herë, shokë mësues: Tre-katër: Dum Fa Ju, Mao Tze Tung..." dhe tundja e kokës e dy rrokopoçëve kinezë: "Këndojnë me shpirt shokët shqiptarë!..." Majmunët shqiptarë, trishti ajo dhe shti gjithë aq e pikëlluar, duke kujtuar atë jetë mizerje të provincës, me qiellin e kapur me dorë kur haje një copë mish në gjellë e kur të linte Monda të dëgjoje radio: sa budallallëk është të pyesësh!...PSE?...A ka fjalë më idiote në botë?...Vetëm një qar kishte parë bota nga kjo fjalë: kishte shpikur profesionin e kirurgut!...PSE?...E ç'punë ke ti të hapësh barkun tim, ç'interes ke të shohësh ca zorrë gjithë mut, që vetëm t'i sjellin zorrët e tua në gojë...Kësaj i thonë të paguash për t'i nxjerrë telashe vetvetes! Po, xhanëm, ky millet kështu kishte qenë gjithmonë: Edhe kur e linin rehat, s'rrinte dot vetë i qetë, pa i krijuar probleme vetes...Ku ishte shitësi hajdut i ushqimores?...Në Kombinat?...Nga Kinostudio në Kombinat do të shkonte peshku për të blerë ato dy ushqime të qelbura me tullon!...PSE?...

- Ti je më i mirë se shumë të tjerë,- tha ajo me një zë të mbytur, edhe ngaqë i mbante buzët të puthitura pas gjoksit të piktorit.- Unë mund të kem edhe

halle...Ta zemë, nuk më dalin lekët e rrogës për bukë, askush nuk më ndihmon...C'të bëj? Të vdes heroikisht si Shkurte Pal Vata?...Po unë edhe ty, përshembull, të ndihmoj...Ti do të bësh dashuri me mua, që nesër të pikturosh gjëra me vlera...Unë të pranoj...Ti nesër bën një alamet pikturë, e shet, fiton gjithë ato lek, bëhesh i njohur, të gjithë të duan, i çon ca lek gruas në shtëpi, edhe me atë e rregullon, se ndryshe të lë ajo...Më jep edhe mua ndonjë thërrime...

Piktori pyeti a thua s'kishte dëgjuar gjë prej gjëje:

- Sa vjeç je?

- Njëzet e dy! *12 mars 23 vjeç*

- Shumë shpejt për të bërë llogari të tilla...

- Ik, atëherë, o artist! Qërrohu!- uluriu ajo me një brofje lakuriq nga shtrati.

Tërhoqi mbulesat, e zbuloi tërësisht tjetrin dhe uluriu përsëri: Zhduku! Dhe mos trokit më këtu!...

Ishte e diel. Ditë pushimi. Me ligj. E pa qartas piktorin tek mërmëriste "mirë-mirë", duke mbathur brekët te cep i shtratit...Pamje e mjerueshme! As armikun nuk do të uronte ta shihte ashtu, koqevanur e bythëjashtë...Dhe shkruajti emrin tjetër në fletë.

* * *

Korçaren e quanin Margarita dhe nuk e kishte atë guxim in e paradites, paçka se pranoi mes mëdyshjeve të ulej në bordurë me Xhixhin. Ajo nuk protestoi kur ai ia preku nja dy herë si pa dashje gjirin e majtë me pjesën e sipërme të krahut. Nuk iu përgjigj as kunjave të tij të holla të thëna ashtu si kot, vetëm aty nga ora 7 e gjysmë vendosi të ngrihej dhe ia ktheu përsëri kasetën që rrotullonte nëpër duar Xhixhit.

- Nuk po ta marr kot,- i tha butësisht,- unë nuk kam kasetofon në konvikt...

Shiko, zogu, klithi ai përbrenda me flokët të ngritura sakaq gjemb. Po kam unë, moj zemër, jo një, po dyckë magnetofonë të mirkë fare!...

- Pse nuk më the që paradite,- ia ktheu i fyer.- Unë mund të kisha marrë magnetofonin tim me vete. Nuk ka asnjë problem! Ti nuk do t'ia haje as butonat e as kokën-manjetike...

- Nuk më shkoi mendja,- u justifikua tjetra, ama, binte erë një orë larg që e kishte marrë me shumë frikë këtë takim. Deshte t'ia mbathte me dinjitet e pa prishur qejfin reciprok, mirëpo nuk po dinte si.

- A ke dëshirë ta dëgjosh kasetën?- e pyeti indiferent në pamje Xhixhi.

Vajza rrotullonte sytë si qengji para thikës së kasapit.

- Po ku ta dëgjoj?- pyeti me një zë të shuar.

- S'ka asnjë problem!- i tha tjetri dhe sakaq ishte në këmbë me vajzën që

mbante për krahu, gjithë frikë se mos i shpëtonte pikërisht tani, kur ishte kaq pranë.

Ai e tërhoqi në rrugën plot blire të Shallvareve, hyri në vertikalen që të nxirrte në Unazë, pastaj u kthye te hyrja e një pallati të kuq. Kishte në xhep çelësin e shtëpisë së motrës, që ishte prej dy vitesh në ambasadën shqiptare në Suedi dhe ç'e ku vadiste ndonjëherë lulet në këtë apartament. Giti nguli këmbët si mushkë para pallatit dhe s'pranoi të ngjitej lart. Ishte e terrorizuar fare...Nuk ngjitem, i dha zemër vetes...Po as Xhixhi nuk qe tip që dorëzohej...Jo, pse më fyen, jo lam nam, jo, na shikon gjithë pallati, jo, kush e di ç'po thonë tani, plus që nuk la shenjtor pa u betuar dhe Giti nuk e mori vesh as vetë si u ngjit në katin e dytë të atij pallati e si u gjet brenda një apartamenti të mobiluar mrekullisht, si në ato filmat që ajo shikonte në Korçë te greku...

Ai vuri kasetën në magnetofon, me duart që i dridheshin, po nuk arritën ta dëgjonin dot atë muzikë hyjnore, sepse Xhixhi i ra sipër në atë skaj divani ku qe strukur e po ia merrte frymën fare. Giti u mundua me të mirë e me të keq ta hiqte qafe, e puthi, sa herë kërkoi tjetri, vetëm t'i shpëtonte nga thonjtë, po dora dorës ai u bë më i guximshëm dhe ajo më e pafuqishme, derisa ngeli lakuriq nga mesë e sipër. me dhëmbët e tij nëpër sisë e me duar të lidhura fort mes kofshëve, që të shpëtonte, të paktën, më të madhen...Po edhe Xhixhi e mori shtruar punën. Filloi ta lëpijë e ta puthë me një barrë qejf tjetrën, derisa e ndjeu se ajo po djersitej e gjoksi i qe bërë gur dhe me një lëvizje të vendosur e brutale prej mashkulli të sprovuar, ia hoqi fundin me të mbathurat, që gati po grisëshin. Ajo iu lut edhe një herë, po flitet me njerëz të shurdhër? Pastaj, kur tjetri hyri lehtësisht në atë masë të lagur, që i kishte takuar një tjetri më parë, ajo u dorëzua gojëkryçur...I erdhi shumë inat me veten, që ishte treguar aq torollaçkë, po kush e di shkante mirë kjo punë...Dhe, si e shau mirë e mirë Xhixhin në fund, iu lut vetëm për një gjë: mos vinte tellallin nëpër Tiranë!...

Xhixhi ia dha fjalën, vetëm pasi ajo i premtoi se nesër në drekë do të vinte përsëri. Tani ishin të qetë dhe mund ta dëgjonin muzikën, po ajo tha "nesër". Ishte vonuar shumë...

* * *

Ishte hera e tretë që Ema paraqitej në hetuesi. Me listën përpara, hetuesi shihte emrat dhe pyeste si shpërfillshëm për secilin. Nuk e mbante shumë gjatë, vetëm se as harronte ta thërriste shumë shpejt.

- Më fol pak për këtë Kiço Kumen!- tha ai.

Asaj ia kishte rekomanduar Mariza, ajo vetëm një përhëndetje të thatë kishte shkëmbyer me të në koridor...Kaq tha me gojë, kurse përbrenda iu ngjall

ajo nusja e bukur që hyri në shtrat me të, ajo bukur që nuk dinte nga t'i hidhte sytë dhe që të kujtonte proverbin "Nusja e bukur e keqja e të zotit!". Aq e bukur ishte ajo grua e re, sa Ema kishte vendosur t'i përgjonte prapa derës, nga vrima e vogël e ngelur në derë, që kur Ardi e hapí një herë gabim me trapano vendin e bravës. Kishte shkuar majë gishtave prapa derës, kishte vënë syrin në të çarën, kishte parë një trup të mermertë gruaje që xhvishej e drojtur, duke pyetur herë pas here tjetrin "Po sikur të na ketë parë njeri?", kishte dëgjuar përgjigjet moskokëçarëse të tjetrit, që, mesiguri, duhej të qe shef i bukuroshes, pastaj qe dridhur për vete, kur kishte parë se si e kishte ulur në gjunjë tjetrën Kiçua dhe se si ia kishte zgjatur gjithë atë organ t'ia puthte e lëpinte. Ema pat ndjerë siklet e qe eksituar e tëra, tek shihte si fryhej ngadalë penisi i tjetrit, pastaj kishte mbytur një britmë, kur ai e kishte hypur sipër vetes bukuroshen dhe e kishte mbushur atë dhomë me rënkime. I qenë marrë mendtë, si të fikët i kishte ardhur dhe ia pat mbathur në guzhinë, ku...

- Me cilën vinte?- pyeti hetuesi.

Këtë herë i doli përballë dhe po e zhbironte me sy.

Edhe ajo, fatkeqe si unë ishte, mendoí Ema dhe me zë tha përvuajtshëm:

- Atë nuk arrita ta shoh. Shumica e atyre që sillte Mariza vinin si kusht që unë të mbyllesha në guzhinë, sa të vinte i pari që paguante...Pastaj, ata vinin dhe dilnin një nga një, që mos i shikonin as njerëzit...

- Ti po mashtron, apo jo?- e pyeti gjithë mirësjellje hetuesi.

- Unë nuk po ju gënjej,- u mbrojt ajo,- po të ishte se desha të mashtroja, ca emra nuk i shkruaja fare...

- Po, ti, je idiote,- u nder në tryezë tjetri,- je idiote, sepse nuk e kupton me ç'lloje plehrash ke pasur të bësh dhe harron që edhe unë i di ca gjëra, që të kam thirrur këtu...Ti nuk e di se asnjë nga këta emrat këtu nuk i pranon fjalët e tua e se treçereku pohon që kanë qenë dashnorët e tu...Ke një të kafshuarë në sup ti?...Ke!...E, pra, kush e di këtë detaj?...Ai që ka fjetur me ty, e di, ai që të ka pasur lakuriq në duar e di, dhe dhjetë nga këta thonë që ti ke një shenjë të kafshuare me dhëmbë njeriu në supin e majtë!...Ti mendon se unë ha bar?...

Vetëtimthi ajo mendoí në atë tmerr, turp e ankth, në atë poshtërim që i krijoi idenë se ndodhej lakuriq në këtë dhomë, se hetuesi po bënte një gabim të rëndë politik...Ne edhe bar hamë, dhe nuk dorëzohemi, gjëmonte zëri hyjnor i Enver Hoxhës në veshët e saj...Po edhe kjo akuzë i duhej që t'i bënte hetuesit! 25 vjet në byçë kishte pastaj!...Veç edhe që njëri i binte gozhdës e tjetri patkoit, në këtë vend ku njerëzit bëheshin bashkë vetëm kur brohorisnin e duartrokisnin si majmunë dhe atëherë kur e thyenin qafën në varreza, kjo qe e vërtetë e s'kishte perëndi të të jepte mendje se me kë të bëheshe, pa rrezikuar...

- Të betohem!- dënosi me zë Ema.- Ata i fshihnin dashnorët...Ata kishin frikë nga unë, po edhe unë kisha frikë, nuk desha t'i shikoja vetë...

- Mirë-mirë,- u mërzit hetuesi,- po edhe unë po të them sot diçka, që ta mbash me vete: me mua tregohu e sinqertë, sepse unë dua të të shpëtoj! Mos e harro këtë! Tani,ik, dhe do të vish më 30 prill, në orën tetë!...

Ema belbëzoi një "faleminderit" dhe doli në rrugë. Nuk dinte nga të shkonte e çfarë të bënte. Uroi me gjithë shpirt që ai hetuesi mos ta kishte mashtruar dhe u nis për në punë. Bëhu dhe një herë me mua, o Zot, u lut ajo, në kohën kur hetuesi po bisedonte pikërisht me shefin e Rajonit për problemin e saj...

- Si duket?- e pyeti shefi.

- Ajo tregon çdo gjë...Cështja është e qartë, ka lëshuar banesën me qira për ushtrim raportesh seksuale ilegale...Atje ka pastaj marrëdhënie të martuar me të martuar, të martuar me beqarë, beqarë me beqarë...Problemi është se ç'do bëjmë me këtë bukuroshen. Ata qiraxhinjtë qeflij s'pranojnë asgjë, disa emra as që mendohet se mund t'i thërrasim apo t'i publikojmë, dhe gjithë mëkatet i mbeten, si kopili në derë, kësaj ... Pretendojnë se kanë patur raporte dashurije...Kjo është keq ekonomikisht, ka një fëmijë 20 muajsh. Po e futëm brenda, do t'ia marrin shtëpinë, duket prandaj ia ka nxirë në atë farë feje karakteristikën ai i Frontit, do ngelet edhe pa punë...Ata të shtëpisë së saj as bëhet fjalë t'i afrojnë strehë...T'ia kalosh fëmijën të atit, ai është më zi akoma, barbar! Ai duhet të jetë i pari në listë për t'u ndjekur penalisht për ushtrim huri sistematik ndaj të shoqes...Me dy fjalë, unë jam që të gjejmë një zgjidhje që edhe ta dënojë Emën, edhe mos ta rrenojë përfundimisht...

- Po ai kryetari i Frontit, ç'thotë?- pyeti shefi.

- Ta shpjegova, sterrë fare! A thua kjo na qenka truri i prostitucionit shqiptar...Unë nuk bisedoj me atë,- ia preu hetuesi.- Ai është një palaço, që kush e di ku e ka syrin e që kur hante dru kjo, s'pipërinte hiç, a thua druri nuk është shkelje ligjore...Kurse kur kjo filloi nga loja e vet, ia futi sa krahu, edhe asaj, edhe neve...

- Mirë, me atë po bisedoj unë, po ti gjej ndonjë banor të shkallës së saj, ndonjë fqinj, që ta lehtësojë...Punë muti!- shau shefi dhe e ftoi tjetrin për një kafë. Po të gjenin, kuptohet...Kurse atij kryetarit të Frontit, e dinte ai...

* * *

Xhixhi ia kishte ngulur sytë trupit të mrekullueshëm të Gitit që po vishej ngadalë, si për t'ia zgjatur sa më shumë mikut të saj kënaqësinë e asaj pamjeje aq intime. Xhind ishte kjo femër, të kujtonte atë vargun e famshëm "Hanko, mos bridh nëpër varre, se të vdekurit i ngjalle, të vdekurit i vdiqe fare..."

Pata fat, mendoj Xhixhi. Kot fare i kishte hyrë kësaj aventure, po dita me ditë kjo kukull po i futej më shumë në zemër e, tani që i pati dalë pak edhe turpi,

të kënaqte shpirtin!...Ai mendoj me tmerr, po edhe qejf seksin që kishin bërë ditën që vdiq Enver Hoxha, atë thënien lapidare "I vdekuri me të vdekurit, i gjalli me të gjallët!", atë prishjen, që ta shkripte trupin, kur spikeri i radios lexonte i pikëlluar lajmin kobzi e tra-la-la e tri-li-li, pastaj ato ledhatimet e ngadalta e gjithë epsh, nën ritmin e muzikës funebre ditën e varrimit, dhe tha me vete se zinë kombëtare e kishte kaluar për mrekulli e nuk do që keq të ishte i gjithë viti vit zije kombëtare...Edhe Giti mendonte se në zi bëhet më shumë qejf...Kur nuk vdesin edhe ca të tjerë, po thoshte me vete Xhixhi teksa Giti lyente lehtas sytë e gjelbër, që në shtrat bëheshin aq të thellë e aq të ngrohtë, sa të krijonin në çast ndjesinë e një pranvere pas shiut...Ndihej mirë me Gitin. Apo nuk formonin një duet! Ajo me zë e ai me fishkëllimë, ca pare mund t'i fitonin, po të jepnin ndonjë koncert...Nuk kishin nevojë as për t'u hapur bythësh, për të siguruar një orkestër të mirë...

Edhe Ema mendonte të njëjtën gjë e trishtuar në dhomë: po të vriste veten, nuk do të kishte nevojë për orkestër, që t'ia mernte marsheve funebre, natyrisht, po të qenë orkestrantët esëll!...Asgjë nuk i jepte më shpresë në këtë jetë. Mbase do të ishte më mirë të ikte me këmbët e veta. Ata hajvanët e shtëpisë i kishin marrë vesh të gjitha dhe vëllai i kishte dërguar dy gisht letër: Për ne, ti nuk ekziston më!...Nuk qenë fajtorë as ata njerëz të drobitur, që nuk kishin lënë hekurudhë e hidrocentral e taraca pa ndërtuar me punë vullnetare, punë që ajo ua shkalafiti hap e mbyll sytë me ato pëslleqet e bëra...Sytë e Emës vinin vërdallë nëpër dhomë si derra të dehur dhe kudo që ndalonin, diçka të trishtueshme do të kujtonin...Ja, atje që ulur Gasperi atë ditë, pasi mbaroi punë me balerinën hollake të Operës, që tundej si patok...Gasperin ajo nuk e shiti. Boll i kishte i shkreti në kurriz 9 vjet burg dhe, po ta denonconte ajo, ai do të ishte i pari që do rrasej brenda...Ma baj një kafë të randë, i qe lutur Gasperi atë ditë...Ema që trembur...Mos kërkonte ta kapte me zor...Po Gasperi tjetër gjë mendonte...Desha me të thanë veç të kesh kujdes, e pati këshilluar tek gjerbte kafen me hurba të vogla, me këta nuk lozet kollaj. Kanë boll spiunë. Unë e marr vesh se ti s'ke bukë me hangër, po ata s'e çajnë kokën fort për këtë punë, se vetë janë të ngi...

Ajo bëri një llogari me mendje se edhe sa lek i kishin mbetur vrimave, mendoj se sa do të harxhonte derisa ta fushin në burg, sa do t'i mbeteshin për t'i lënë djalit dhe vendosi t'i kërkonte ndihmë Gasperit...Tjetri do t'i përgjigjej...Do t'ia dërgonte lekët me një mikun e tij dhe do t'i shkruante një pusullë: Mua nuk më ke asnjë borxh! Të priftë e mara...

Pastaj hoqi bluzën dhe kundroi shenjzën në sup. E kuqerreme në vishnje edhe shenjza e shihte. Kush na ka spiunuar, pyeti Ema përhumbshtëm. Ardi? Jo!...Maksi?...Shoferi, apo piktori?...Njëri nga këta ishte, me tjetër njeri ajo nuk kishte rënë në shtrat, ajo pra, kurva e madhe...Po do ta gjente, edhe në gropën e varrit të fshihej!...

Hetuesi nuk e priti Emën në fund të prillit. Ai i tha të vinte më 7 maj dhe, kur ajo iu ul përballë, tjetri i shpjegoi se kjo ishte hera e fundit që merrej në pyetje. Ai deshte të dinte diçka më shumë për Pertefin, për numurin 21, pat saktësur, duke iu referuar listës, dhe kështu mbaronin çdo punë bashkë...

Pertefi! Ky ishte klienti më i rregullt i saj dhe çdo herë vinte me femra të ndryshme... Ai duhet të ishte ipotent...Ajo e kishte përgjuar skuthin dinak, me barkun sa një mal, që, sidoqoftë, dallohej për shije në përzgjedhjen e seksit, dhe e kishte parë me sytë e saj që ai pëlqente veçmas seksin oral...Rënkonte si derrkuc kur e lëpinin dhe kurrë nuk hypi sipër ndonjë femre, a thua trembej nga ndonjë sëmundje veneriane...Por ajo nuk mund t'i tregonte tjetrit se si qëndronte e përkulur pas derës, me syrin rrasur te një palo brimë e vithet në hava si saç, a thua ishte regjisore dhe duhej të studionte nga kamera sheshin e xhirimit...Ajo tha vetëm që Pertefi kishte ardhur gjashtë herë dhe kishte paguar rregullisht tarifën...Dhe hetuesi nuk e zgjati...Tjetri punoi pak, pastaj i dha për të firmosur një nga një letrat e deponimit të saj...Lexoqi edhe një herë me kujdes, e urdhëroi...Ema lexoi ato gjëra të ndyra...Në vesh i vinin britmat ephshore, nga më të ndryshmet e nga më të veçantat...Ato "Mos"-et në dhjetëra variacione dhe hungërimat, që ta mbushnin mendjen top për prejardhjen shtazore të njeriut...Po, të gjitha qenë deponimet e saj...Firmosi pa fjalë dhe e ndau mendjen se tani do ta çonin direkt e në birucë...Po pikërisht atë çast hetuesi e ftoi për një kafe.

Në kafën përballë hetuesisë ishte qetësi. Ata pritën sa ua servirën kafetë, pastaj hetuesi ia nisi shtruar një bisede, që, siç paralajmëroi, për të mirën e saj, nuk duhet t'ia tregonte askujt...

Punët e tua nuk janë mirë, po unë i kuptoj edhe shtysat e tu, e di mirë, gjithashtu, se ç'do të ndodhë, nëqoftëse futesh në burg, në burgun që ti e meriton!...Po mua nuk më dukesh njeri i keq, e keqja jote është vetëm që dorëzohesh shpejt para halleve, prandaj dua të të ndihmoj. Si e qysh e tek, kjo është puna ime, ti duhet të bësh vetëm kaq: duhet të martohesh sa më shpejt, që mos të ta marrin shtëpinë...Ne po punojmë që ti mos hysh në burg. Ky do të ishte shkatërimi jot!...Por edhe internimit, të paktën, një vit internimi, nuk i shpëton dot...Të është qepur keq kryetari i bllokut, ai Sotiri...Po u internove si beqare, do të ta marrin edhe shtëpinë, edhe djalin! Po u celebrove shpejt, shpëton! Tani mendohu dhe vendos, por ki parasysh se kërkesa që ti të internohesh është firmosur. Vendimi merret më 20 qershor. Domethënë, celebrimin duhet ta kesh bërë deri më 20 qershor, më vonë, nuk të shpëton...

- Po kush më merr mua,- belbëzoi ajo,- pastaj, as unë nuk dua të martohem

më, mbas gjithë atyre që hoqa një herë...

- Të ka mbetur ndonjë lek?

- Kam pak, i ruaj për djalin...

- Jepi ndonjë lek dikujt dhe bëj një celebrim formal, me kusht që të ndaheni pas një viti, kur të lirohesh...Por unë nuk kam folur me ty për këtë gjë!...

Ema u përlot. Ajo u zgjat befás, e puthi tjetrin në faqe dhe, si i pëshpëriti një "faleminderit" të mbytur, kërkoi leje të largohej.

- Dëgjo,- i tha hetuesi para se të ndaheshin,- po e bëre celebrimin, do vish urgjent tek unë në zyrë!...Edhe internimin mos e merr me tmerr! Do kujdesem unë që ta kalosh e qetë...Kurse ata fqinjët përballë i ke njerëz që të duan, mos e prish kurrë me ata!...

Ai e kundroi tjetrën tek ikte kokëulur dhe i erdhi vërtet keq për këtë njeri të braktisur, që, me ligj, hynte fishek brenda, kurse me logjikë...duhet të hynin ca të tjerë...Krim, Gac, i kishte mërmëritur e shoqja në shtëpi, kur ky i kishte folur gjerë e gjatë për Emën. Po, ti, shtet, që i kërkon llogari deri në një tani qytetares tënde, ç'bëre kur qytetarja jote ngordhte për bukë me gjithë foshnjën e gjirit dhe i ngryste netët pa drita, ngaqë ia kishte prerë energjinë ndërrmarja elektrike, meqë ajo s'paguante dot qeranë?...Harxhojnë një hale me lek për të varrosur një njeri dhe lenë miliona në mjerim!...

Ai u drodh, kur kujtoi atë urrejtje patologjike të Zanushës për këta "legena", siç i quante ajo, dhe uroi Zotin që mallkimet t'i dëgjonte veç ai...

* * *

Në mbrëmje Ema iu lut fqinjëve ta pranoin dy minuta për vizitë...C'është ajo fjalë, tha Nahilja...Të vish sa herë të kesh nevojë, shtoi Naimi dhe ajo kishte hyrë brenda. Nuk dinte ku t'i çonte as sytë e as duart dhe s'gjente dot fjalën e parë, nga t'ia niste, pastaj, si mori frymë thellë, arriti e tha "faleminderit".

- Pse?- pyeti Naimi.

I ra menjëherë një hije e keqe në çere.

- Ju më shpëtuat!- belbëzoi ajo.

- Ne thamë të vërtetën! Thamë: ajo ka gabuar rëndë, por është shumë e re, të rinjtë edhe gabojnë...Thamë edhe që ti ke pasur shumë halle këto kohë dhe që askush, duke filluar nga ne, nuk të ka ndihmuar t'i kapërcesh...A janë të vërteta këto?...

- Mund të jenë, po sot njerëzit sikur nuk kanë qejf të tregojnë të vërtetën...Unë prandaj erdha t'iu falenderoj...

Dhe i ra një lot i madh drejt e në fllxhanin e kafesë, që po i dridhej në dorë...

- Ne të kemi vajzën tonë,- i tha Nahilja,- po të jemi ne në hall, edhe ti do të hidhesh në prush për ne...Pije kafënë tani se t'u ftoh e mos qaj...Pa më thuaj se ç' do bësh me djalin, po të çuan gjëkund...

- Do ta marr me vete,- tha ajo,- më duket se e kam si mbrojtje...

- Mirë e ke menduar,- foli Naimi,- tani rëndësi ka të mos bësh më budallallëqe...Mos harro, të gjithë jemi hallexhinj në këtë vend...

- Pse, xhanëm?- pyeti Nahilja.

Ai bëri një shenjë me dorë...A nuk më le rehat me këto pyetje, apo kërkon ta shoqërojmë edhe ne Emën nëpër ato baltra, ku do ta syrgjynosin?...Ema e kuptoi mesazhin e shenjës së tjetrit dhe i dha të drejtë. Ajo vendosi ta nxjerrë një shetitje djalin dhe kërkoi leje e u ngrit.

Në rrugë ishte një mbrëmje e bukur, një nga ato mbrëmje që nuk ta çon në mendje të kthehesh në shtëpi e të mbyllesh mes katër mureve, po Ema ikte si sonambul, pa arritur të shijojë asgjë përreth. I qe prishur gjaku pa dalë mirë nga shtëpia. Doktoresha që banonte sipër saj, një prostitutë e hershme, siç thoshin, nuk i kishte folur në mënyrë deklarative në shkallë dhe nuk qe mjaftuar vetëm me këtë fyerje, por i pati thënë me zë të lartë të shoqit dhe vajzave: Kur do shpëtojmë nga këto qelbësirat!...

I erdhi goja, trishti ajo dhe shtoi me vete: O i ka mbetur hatri që nuk erdhi për vete ndonjë seancë, o i paska veshur më në fund brekët kurva dhe tani na mban leksione...

Atë çast i doli përpara Gasperi. Ai e ftoi për një akullore në lokalin pranë, një lokal i ndriçuar keq, me ca peizazhe të akullta e të pista nëpër mure, dhe atje, tek fuste mekanikisht lugën me ca copëra akulli të bardha në gojë, ajo i tregoi gjithë ç' i kishte ndodhur...

- Për ty nuk fola,- e siguroi.

Gasperit i ranë djersë...Në qoftëse nuk ke folur vërtet, më ke bërë nderin më të madh të jetës, i tha pa i ndarë sytë...Për ty nuk e hapa gojën, e siguroi edhe një herë ajo...Ata nuk dinin asgjë për ty. Tjetërkush ka qenë spiuni, ju unë...Flisnin me zë të ulët, me ankthin se mos i dëgjonte kush. Ajo iu hap tjetrit edhe për hallin e celebrimit...Të shoh unë një herë, tha Gasperi...Ai kishte fituar një dorë të mirë në poker, ia kishte kapur kokën me një kare atij pogradecarit të qelbur, që vinte era peshk, dhe iu lut të pranonte një ndihmë prej tij...I la një grusht lekësh në dorë me premtimin se do ta takonte shumë shpejt...

Ema e zgjati shëtitjen deri në qendër dhe, tek po kthehej për në shtëpi, dëgjoi nga pas një fishkëllimë habije dhe një zë naiv që pyeti:

- As do ta besoja kurrë që kjo bukuri është nga kryeqyteti ynë i ngordhur!...Të isha unë si Ornela Muti, kisha vrarë veten, për nur të Allahut!...

Ishte Xhixhi. E mbante mend këtë tip karagozi që para se të ndahej me

Ardin. Dukej që atij ia kishte qejfi, po diç e frenonte mos t'i afrohej...Kurse tani...

- Epo raca rregullohet.- ia ktheu ajo me një frenim të lehtë.

Xhixhi ndodhej si me magji në krah.

- Na jep recetën, të paktën,- vazhdoi ai,- mbase zbukurohemì edhe ne të tjerët...

- Në mëngjes, trahana...

- Trahani der te hani...-plotësoi ai.

- Në drekë, përshesh...

- Përsheshi gjer te sheshi...

- Në darkë, bukë me djathë...

- Ah, djathi është vitaminoz!...Buka me djathë deri në vathë,- improvizoi tani ai.- Goxha dietë!...Ty të del djathi, se dy vetë jeni, po ne, si t'i ndajmë 300 gram djathë në shtatë ditë për gjashtë persona nepsqarë?...

Ema kukurisi me llogarinë e komplikuar të tjetrit, s'arriti ta pjesëtojë 300-tën me 42 dhe ja, tek dëgjoì tjetrin ta pyeste se kishte dëgjuar që ajo ishte në hall...Po, tha Ema pa dhënë shpjegime...Por më vonë, rrugës për në shtëpi, ajo do t'ia tregonte gjysma-gjysma historinë...Ah, këta janë të poshtër, mut nga palo bythë janë, tha Xhixhi, keq e paske punën me ata të pashpirt...Keq e kam, përsëriti Ema mekanikisht...Kishte arritur te hyrja e pallatit. I zgjati dorën tjetrit dhe bëri të ndahej...A mund të ngjitem lart, iu lut Xhixhi...Ajo e vëzhgoi një herë, gjatë...Mos po kërkonte pikërisht Xhixhin në këtë natë pa gjumë?...Ndihej fare vetëm, fare bosh...Hajde në orën 10, i tha pastaj pa asnjë lloj ndjenje, tani do ve djalin në gjumë. Derën po e le hapur...

Dhe po ashtu, pa asnjë drithërimë, e priti tjetrin tek hyri si hajdut majë gishtrinjve, me një rrjetë në dorën e majtë, ku kishte futur një gjysmë pule dhe dy shishe verë të kuqe Librazhdi. I kishte mashtruar prindërit sikur do të shkonte në një nrbrëmje...

U ulën të dy përballë në tryezë, çukisnin si zogj ushqimet, pa e pasur mendjen atje dhe flisnin për të ardhmen, për atë të ardhme që nuk egzistonte realisht dhe që dukej më e zezë se e tashmja, po t'i bëje llogaritë me laps në dorë...E ardhmja dukej si hëna në Bajram. S'merrej vesh gjëkundì!...

- S'kemi gjë në terezi,- tha Xhimi duke tundur kokën pikëllueshëm,- dje dënuar dhjetë vjet plakun e një shokut tonë...E pse? Se kishte thënë tapë në klub: ky Enveri boll i mirë është, po pse nuk na ndërton edhe ca shtëpi!...Ata janë dhjetë rob në një dhomë e guzhinë!...Edhe Enveri vdiq, edhe plakun e rrasën brenda...S'del më ai, kurse ne flasim për të ardhmen...

- Mua asgjë nuk më tremb, veç llogarisë.- tha ajo...

- E pe varrimin e Enverit?- pyeti zëulët tjetri.

Jo, ajo nuk e kishte parë, s'kishte ku ta shikonte...Nuk i tha se s'deshi ta

shikojë e se e urrente atë mortje, që veç llafë e dajak dinte...

- Skandal,- tha Xhimi,- u dhje gjithë Tirana duke qarë, a thua humbën pasurinë rrjepacakët e qelbët...

Pastaj ai shkoi pranë Emës, e mori në prehër dhe filloi ta ushqejë me dorën e tij... Vera po e bënte efektin... Dy minuta më pas ata qenë shtrirë në minderin e guzhinës dhe ajo i hypi sipër. Kishte qejf që Xhixhi t'ia shtrëngonte gjoksin fort me ato pëllëmbët e tij të mëdha... Ajo nuk mendoi më për hallet, ishin aq shumë, sa nuk ia vlente, edhe sikur të shkarkoje ca, dhe u fut e gjitha brenda tjetrit... Ia ndjeu gjuhën tek rrotullohej mbi thithat e gjinjve dhe u shkri e gjitha... Mos, ik, iu lut, kur e ndjeu fryrjen e penisit të tij. Dhe iu lidh kulpër në trup... Fundja një hall më shumë do kishte... Nuk e hante meraku për kaq gjë...

Në mesnatë, të lodhur e të djersitur, krahëhapur si Krishti, të kryqëzuar në shtrat, ajo i tha përhumbshëm:

- Përse nuk më bën edhe ti një nder...

Dhe i tregoi për celebrimin...

- Nuk dua të ma marrin shtëpinë... Pa shtëpi unë vdes një herë e përgjithmonë, nuk ngjallet më!... Sa të kthehem unë, nga i ktheftë Zoti me arkivol qelbësirat, ne ndahemi menjëherë... Po të duash, të lëshoj edhe deklaratë...

- Do mendohem dhe do të kthej përgjigje të shtunën në darkë,- tha Xhixhi.- Të shtunën hamë bashkë, e sjell darkën unë...

- Mirë,- pranoi butësisht ajo. Sepse i ngjalli besim ky Xhixh, që, pa e njohur sagllam, dukej se veç për biseda serioze nuk e pat bërë nëna...

* * *

Giti ndihej e shqetësuar. Ata të shtëpisë e kishin marrë vesh për Xhixhin dhe babai do të vinte nesër në Tiranë. Cfarë t'i thoshte ajo?...

Xhixhit nuk i dukej një zgjidhje e keqe Giti. Tek e fundit, ai po mbushte 28 vjeç, një palo punë e kishte në ujësjellës, katër kova klor në ditë hidhte në depozitë dhe pastaj, hë, rrugëve... Giti e bukur ishte, një punë të mirë, do ta kapte, se zë kishte për të shembur muret, plakun e kishte alamet drejtori në Korçë, po, ca lek, do t'i jepnin gocës, se korçarët kanë pare, pra...

- Po mirë,- tha befas ai,- po të ketë qejf plaku jot, le të takohet me mua nesër... Unë do t'i dal borxhit, do t'i shpreh gjithë dashurinë dhe respektin tim për ty... Unë e kam ndarë mendjen... Tani le të vrasim veten ai!...

Giti u përplot. As kishte besuar që Xhixhi do pranonte të martohej me të... Ajo e puthi si e marrë dhe, të nesërmen, u lumturua, kur pa Xhixhin që po i priste me durim shembullor te "Drini", i ruajtur e i veshur bukur, serioz e korrekt...

Babait të saj i pëlqeu Xhixhi. Pastaj, edhe sikur mos t'i pëlqente, ç'të

bënte, kur vajza harbonte me këtë bandill e kur ajo duhej të qëndronte patjetër pas përfundimit të shkollës në Tiranë...Ku të këndonte në Korçë? Te çobanët e Drenovës?...Nuk i pëlqeu që tjetri ishte pa shkollë të lartë e i fesë myslimane, po në Tiranë njerëzit qenë ndryshe e ai burrë fytyrëkuq nga pija e vodkës pa hesap, e pranoi tjetrin...E lanë që të shkëmbenin nishanet në fillim të korrikut, pastaj Xhixhi i tha se edhe prindërit e tij qenë gati të bisedonin...Ishallah, mblidhet hajvani, kishte thënë i ati, një avokat i njohur në kohën e avokatisë e që tani punonte jurist në Bankë...Do mblidhet, ç' do bëjë, kishte shtuar e ëma, ja, siç u mblodhe ti!...Bah, sa thumba hidhte ajo. Helm e kishte gojën!...

Dhe kështu, në harmoni të plotë e në paqe, ata u ndanë. Ishte e premtë. Nesër Giti do të shkonte në Korçë dhe Xhixhit iu kujtua Ema...Po shkoj t'i fus një tegel, ndau mendjen ai dhe ia mbathi për nga bordura. Pat treguar dinjitet e moralin e kundërt të një njeriu që nuk ishte zagar rrugësh që s'ka parë mish me sy, kur e refuzoi gjithë delikatesë ftesën e tjetrit për darkë. Ia pat rruajtur Gitit një 250 leksh dhe do t'i fuste ndonjë birrë për qejf të vet te "Rinia"...Atje, me birrë përpara, Xhixhi do trishtonte për jetën e vet, duke kundruar fytyrat idiote përballë, që i luteshin kamarierëve t'ua bënin bërçollat sade e që lumturoheshin si epileptikë, kur iu servirej birra e ftohtë...Jetë e poshtër, ishte!...Nuk ia mbathi atëherë dhjeramani, kur hapnin tokat e reja në kufi, se mos e zinte gripin mamin me babin...28 vjeç pa asnjë ditë të lumtur!...Spiunët mbas bythe...Qep gojën!...U qep goja!...Grup armiqësor!...Ul kokën!...U ul koka!...Thuaj para kutisë së votimit "Vota ime plumb për armikun!"...Do ta thuash, edhe sikur mos ta artikulosh dot "r"-në!...Priti flokët shkurt!...Dac koka te berberi!...Mos mbaj pantallona kauboj!...Mbaji, po ta mbajti!...T'i gris në mes të rrugës kontrolli i rinisë apo ai punëtor!...Të le me brekë para monumentit të Skënderbeut, sa të habitet e të dhitet vetë heroi sypatrembur kombëtar!...Ti fikson takimin në pesë mbasdite, mami të thotë në orën tre të shkosh të blesh vajgurin...Ti shkon dhe je i 149-ti në rradhë nga burrat...Një burrë, një grua...Shkon ora 7 e gjysëm. E more më në fund vajgurin, po takimit i ha mutin! Kot i grise këpucët, duke i gjymuar atij zogut nga mbrapa gjashtë muaj rresht e duke i qeshur si kinez, sa të ka ikur surrati shtrembër...Ehu, bëri ai, duke kthyer shishen e dytë të birrës. Ja, sot zere se u fejua. Duhet të qeshte. Atij i vjen për të qarë...Si për dreq, atë çast nga altoparlanti i lokalit i lidhur me radion, ia nisi një këngë partizane...Martohet njeriu me këto këngë?- pyeti veten ai. Po pastaj shtoi: Gjysma e të keqes. Menebarem është muzikë, se mund të ishin edhe lajme, si ai i Shkodrës, ku Komiteti i partisë së rrethit njoftonte me gëzim shokun Enver, se brenda një javë ishin mbledhur në zbatim të direktivës shumë të rëndësishme të Tij mijëra ton plehra organike, ç'ka do të thoshte, sipas llogarive të sakta të Kolit, që një shkodran kishte dhjerë 102 kile mut përgjatë javës...Mut, u bëfshi, mallkoi ai duke mbytur të qeshurën, në atë çast kur Ministri i Komunales,

mik i ngushtë feminije i babait të tij, po i hakërrohej drejtorit të gjelbërimit:

- Pse nuk ka bar kjo lulishtja përballë dritares sime?

Drejtori, një shkodran i gjatë, që ishte bërë grusht nga frika, belbëzoi:

- S'kemi pleh organik!

- Ashtu,ëëë?...Po, sa punëtorë ka zotnija jote në punë?

- 700, shef!

- Mirë, pra, nesër në orën shtatë të mëngjesit dua t'iu shoh të 700-tëve duke dhjerë në lulishte!...S'paska pleh, bytha jote!...

Eh! Këtu është estradë e gjallë, po thoshte me vete Xhixhi, tek priste kamarierin t'i kthente kusurin. Po mirë që ishte ky karagjozllëk, se ndryshe do kishin vrrarë veten treçerekun!...

* * *

Të gjitha dritaret ishin zënë me perde të rënda dhe brenda në dhomë mbizotëronte një smog i tmerrshëm duhani. Por nuk hapnin dot asnjë dritare e derë. Kishin frikë mos dukej drita jashtë e druhashin mos i dëgjonin fqinjët. Kishte një hale spiunë nëpër shkallë, plus ata që paguheshin përditë për t'i përgjuar e, rrezik, ndonjë është edhe në tavolinë, tha me vete Gasperi.

Ai hapi pod me një tris damash dhe i lëshoi letrat shpërfillshëm mbi batanijen e errët të tryezës në pritje të partnerëve. Qorri erdhi menjëherë. Ai ishte një hisër e keqe. Qe divorcuar me gruan vetëm nga ky bixhoz i mallkuar, por ishte doktor i zoti. Më mirë nga të gjithë njihte policët. Dhjetëra herë e kishin ndaluar, derisa i bënë edhe fotografinë e famshme me letra në qafë. Cuku u tërhoq. C'fytirë që ishte! Gunga-gunga e brima-brima, një sy te veshi e një sy te goja...

- Ore, shumë dollarë fallco ka në qarkullim,- tha ai duke flakur letrat mizerabël,- si nuk po i bëjnë fajde kësaj pune ata amerikanët...

- Duhet vënë surrati jot te dollari, në vend të presidentëve amerikanë, pastaj nuk ka këlysh kurve ta fallcifikojë dollarin!- u hodh dhëmbi i bardhë, që po priste të tërhiqej ndonjëri nga tavolina.

Duke u zgërdhirë, hyri në lojë edhe avokati. Gasperi kishte qenë në burg me të. Ai kishte një zë të ngjirur dhe nuk e pati ngrënë tamam fare prej bixhozit. Ky mbetej shkaku, arsyeja ishte se ai bënte pjesë në klasën e ish-pasanikëve...

- Visto!- pranoi lojën edhe artisti.

Gasperi kërkoi dy kartë, kapi karenë me një fant brenda, si lëshoi një shtatë e një dhjetë...S'kishte asnjë ide ç'bëhej andej nga asat dhe derrat, po e ndau mendjen që do ta luante lojën deri në fund.

Mbas tre minutash në tavolinë ndodhej një mal me fisha. Ai i lëshoi të gjitha ç'kishte. dëgjoi qorrin që tha "drua të relans", e pa tek kreu ritin e të vajturit

në banjë, ku vetëm do ta shkundte atë mikun, se asgjë nuk i bëhej, dhe në atë pritje të ankthshme, iu kujtua Ema. Se pse i vinte keq për atë vajzë të kolme. Jo se e pati mbrojtur, ishte diçka tjetër... Po qorri erdhi dhe ai u përqëndrua prapë në lojë. Nga mbrapa i shkuan vetëm avokati me Cukun dhe, kur u hapën letrat, ai ishte më i pasuri i fryezës.

- Kot e ndoqe! - i tha artisti avokatit. Edhe ky priste të ngritej ndonjëri. Ishte një mashkull elegant, gati transparent, finok e thumbaxhi.

- Kam faj unë që luaj me burgaxhinj. - mallkoi veten avokati. - Bëj, o gomar, luftë kllasash...

- Ti ke florinj të e plakut, - tha Cuku duke u ngritur pa brekë në bythë tani, - po unë pse nuk vuna mend, kur u tërhoq qorri me grand ful në dorë!...

- Me kohë do mësohesh edhe ti, - u hodh dhëmbi i bardhë që tani po zinte vendin e Cukut. - Hidhu deri nga shtëpia, mos na bie ndonjë qofte... I qan plaka jote, qoftet! Veç kujdes, mos harron t'i hedhë pak piper të kuq!...

Pastaj i prenë të qeshurat. Letrat po hapeshin prapë. Ishte ulur edhe artisti në vend të avokatit dhe loja po bëhej e kujdesshme. Po ikin duart thjeshtë, me "pas"-e pa "bujo" dhe Gasperi tregoi historinë e Emës.

! Gjynah! - tha dhëmbi i bardhë. - Edhe bukë nuk i jep, edhe e urdhëron "jeto"!

- Ajo e ka në gjak kurvërinë, - e ndërpreu artisti. - Ja, edhe ti je pa punë, pse nuk e kthen shtëpinë në bordello?

- Pse, pak herë ka luajtur surrati jot me përqindje poker në shtëpinë time? Edhe kjo bordello është!...

Ai ishte inxhinier pyjesh dhe pat mbaruar shkëlqyeshëm studimet, po në Pukë nuk pranoi të punonte... Nuk kam jetë të tepërt unë, e kishte ndarë trurin, dhe nuk shkoj që nuk shkoj...

- Krimi i kësaj vajzës dënohet në çdo vend të botës, - i vuri pikën avokati

- Andej kanë të drejtë të të dënojnë, - u hodh Cuku, - se të kanë ushqyer mirë e mirë, si gjel deti, kurse këtu je si ata maçokët që kërkojnë bukë nëpër qeglla!...

- Do luajmë? - pyeti qorri.

Ai i ruhej si dreqi këtyre bisedave. Dhe nuk kishte faj. Emrin e kishin të shkruajtur me bojë të kuqe në polici... Gati ishin ata!... Edhe kjo shtëpi ku po luanin ishte ndërtuar mbi vend ters. Qe tokë e mallkuar kjo, që kur ia morën me gjak Xhavitit të shkretë, që tani askush nuk e dinte ishte gjallë apo pat cofur në ato burgjet pa fund. I fundit që e kishte parë ishte Gasperi. Pat thënë se Xhaviti dukej i mbaruar...

Gasperit tani nuk i luhej më. I hypi inati me artistin e me avokatin, me ajkën intelektuale, pra, që flisnin badjava për robin e gjallë dhe tha me vete se në

këtë vend s' do ketë hajër kurrë, sa mos ketë keqardhje e besim...Ujqër, vëllezër ujqër ishin të gjithë! Edhe në Opera, kur këndonin, si kor qensh të përngjasonin!

* * *

Xhixhi po kënaqej. Kafshonte lehtas thithat e Emës dhe, kur i dilte jo rrallë ngapak qumësht, shkrihej i gjithi...Si është, pyeste Ema, po aq e eksituar sa ai...Mjaltë, i përgjigjej tjetri...Ma mbarove të gjithin, përkëdhel pastaj ajo dhe, ja, tek vinte prapë ajo fuqi hyjnore që e hidhte sërisht sipër saj...

Ishte e mirë dreqi! Seç e ngatërronte seksin me një si punë përuljeje e me një butësi, që, mos e fol! Apo nuk që e mbledhur, me mishin gur e një bel që ia përfshije me dy pëllëmbë nga fillimi deri në fund...

Ai e ndau mendjen t'ia bënte nderin e celebrimit. Askush nuk do ta merrte vesh, po edhe një nder do ta bënte dhe nuk pendohej: nuk bënte fajtoje Emën për bordellon, por ata qelbësirat lart, që e kishin kthyer gjithë vendin në bordello dhe gjithë popullin në një kurvë kolektive, seks me dritë të kuqe ndriçuese në ballë e në botë!...

Ema qau. Ajo nuk besonte se do të egzistonin më njerëz dashamirës në këto 28 mijë kilometra katrore dhe as besonte që kjo ndjenjë rudimentare, e trashëguar nga kush e di ç'majmun i fisëm, të jetonte edhe nëpër rruzullin tokësor. Po, ja, Xhixhi shqiptoi një "po" dhe, kur të deklaronte para nëpunësve pleq të Gjendjes Civile, në mënyrën më serioze "e dual!" për Emën, ajo do qeshte me lot...Po ç't'iu tosha, u mbrojti më pas ai, tek pinin kafënë e lamtumirës...E deklarove shumë seriozisht betimin e shenjtë, vazhdonte të qeshte ajo...Unë gjithmonë i marr punët seriozisht, tha ai, po aq gënjeshtar sa në atë recitim në Gjendjen Civile dhe i dha fjalën tjetrës se do vinte ta shikonte ndonjëherë atje, në internim, pra...Faleminderit, i tha me gjithë shpirt ajo dhe kështu u ndanë.

Dhjetë ditë më pas, më 2 korrik, një të dielë me nxehtësi mbytëse, Ema u nis për në Lushnje. Tek treni e kishte shoqëruar Nahilja me Gasperin. Qenë ndarë mes lotëve. Nahilja i kishte dhënë me vete një pulë të pjekur dhe një byrek, kurse Gasperi një grusht me mijëshe...Ka edhe më keq, e kishte ngushëlluar ai dhe ajo, tek kujtoi kalvarin e tjetrit, i tha vetes: "Nuk jam fare pa fat..."

Gjithë atë rrugë troshitëse, me djaln në prehër, ajo kujtoi dhe një herë jetën e saj. I kishte ikur fluturimthi, pa lënë gjurmë, si këto peizazhe e shtylla tensioni që mbeteshin pas dhe tani nuk e imagjinonte dot në mënyrën më absolute se si do të ishte e ardhmja. Nuk e dinte se ku do të qëndronte, ku do të punonte dhe sa do të qëndronte në këtë qytet pa asnjë të njohur...Kafshë! Ndihej vërtet si një kafshë e hypur në një karroceri makine që e çojnë ku të kenë qejf...Kështu kishte qenë gjithë jeta e saj...Donte t'ia bënte pushimet në plazh, e çonin në katundin

gjithë pluhur, te gjyshja, ku vetëm ajër të pastër nuk gjeje...Donte të lexonte natën, i fiknin dritën se harxhohej korenti...Donte të shkonte në Universitet, e fejuan me idiotin e parë që gjetën në rrugë...Donte t'ia vinte djalit emrin Mark, ia vunë Loren...U mundua të gjente një ditë të lumtur në jetën e saj. E vetmja që i doli, ishte vdekja e babait...Një racion druri më pak!...Mirë ç'iku ishte e zezë, po ç'më pret?- pyeti veten ajo.

Nuk e dinte, po mund ta gjente lehtësisht, po ta vinte trurin në punë. E priste një polic në Rajon, që e çoi pa folur te shefi. Ema u habit dhe u gëzua njëherësh, kur gjeti në zyrë edhe hetuesin me një civil tjetër. Harroi ku ndodhej dhe iu hodh përfaqë tjetrit, pastaj belbëzoi "më falni, më falni" dhe fshiu një lot të madh që i shkau nëpër faqe...Civilin ishte operativi i saj dhe ajo u mundua ta gjente ku e kishte parë...Ah, po! Ky ishte ai basketbollisti i njohur...Ajo duhej të paraqitej çdo mbrëmje në rajon, do punonte në serrat e fermës dhe do të banonte në një garsonier pranë rajonit...Po të kishte plaçka për të marrë nga shtëpia e Tiranës, mund të kërkonte leje për të shkuar...Nuk duhej të largohej asnjëherë pa leje, përndryshe internimi kthehej automatikisht në burg...

Kështu filloi dita e parë e internimit të Emës, një ditë me vapë torturuese në apartamentin e vogël e të palyer dhe, puna e parë që bëri Ema, ishte kërkimi i një bojaxhiu. Gjetei dy burra të rraskapitur me karrocën e tyre të vjetër dhe bëri pazarin që t'i jepnin një pompë me gëlqere të bardhë mureve të shtëpisë. Mbasdite shtëpia vetëtinte, po s'kishte as shtrat e as karrige. Dhe ishte e dielë. Vendosi të kalojë edhe një herë nga Rajoni...Je shpejt, i tha dezurni, duhet të paraqitesh në orën shtatë...E di, belbëzoi ajo, po s'kam ku të gjej një krevat...Pse, ne do ta gjejmë krevatin, ty, hungërroi tjetri. Kurvat flenë edhe në tokë, u zgërdhi pastaj ai dhe natën e parë Ema fjeti vërtet në tokë...

Mbase burgu do të ishte më i mirë!

* * *

Internimi ishte si një muzikë funebre për Emën. Ajo punonte dhjetë orë në ditë në serra, po lek sa për ta mbajtur frymën gjallë mernte dhe betimin për të mos e kapërcyer pragun e shtëpisë mbas pune, e mbajti. I vetmi njeri që i foli si prind në atë skëterrë baltrash e vuajtjesh ishte prifti katolik, një plak i vogël, i flakërirë që nga viti 1967 këtu e që punonte bujk në një parcelë buzë serrës. Asaj i bëri që në fillim përshtypje kujdesi me të cilin punonte plaku i drobitur pa njeri në botë, bukurija e asaj parcele, rreshtat e drejtë dhe ngjyrat e kombinuara bukur të të mbjellave të tij në vjeshtë. Të shlodhte ajo pamje!...Plaku banonte në pallatin e saj dhe darkave filluan të shkonin gjithmonë e më shpesh te njëri -tjetri. Kështu, Ema filloi të përsosë anglishten e mësuar shatra-patra në shkollë, duke mbajtur shënim mësimet e plakut. Pastaj pinin nga një kafë me shumë qumësht brenda dhe tjetri ia niste atyre historive

të tij pa fund për njerëzit e mjerë të këtij vendi. Nuk shante kërkënd dhe as Emën nuk e lejonte ta bënte këtë krim...Ne jemi grigjë, thoshte butë, nuk jemi lukuni ujqërish. Të marrët shajnë...Me lek nuk qenë keq. Gasperi dukej herë pas here dhe gjithmonë do të linte ushqime të zgjedhura e lekë. Ai kishte miq në këto anë, shumica të internuar, që i patën transferuar në humbëtitë drejt e nga burgu dhe, gjithmonë do të largohej i ngrysur...E pikëllonte gjithçka, njerëzit e mjerë, gjysma të diplomuar jashtë vendit, prifti, Ema, kalamajtë pisanjosë e të rreckosur të lindur nëpër kanale e fusha, egërsia dhe pabesia e këtyre njerëzve që tani kundronin me dyshim gjithçka...Mos fol me këta, do ta paralajmëronte gjithmonë ai, sepse shumica do të të spiunojnë, që t'i marrë me sy të mirë operativi...Ishin të mjerë.

Në tetor erdhi edhe Xhixhi. Më 16 tetor erdhi dhe tha se i pëlqente t'i bënte vizitat me raste festash...Tallej, qeni!...Ai njihej mirë me operativin e Emës që në Tiranë, kur luante vetë futboll, dhe në drekë kishte pirë me tjetrin andej nga plazhet e Divjakës...E kishte pyetur mikun e tij për Emën dhe qe kënaqur, kur operativi i tha se kjo vajzë ose ishte internuar gabimisht në vend të ndonjë tjetre, ose qe zgjuar nga gjumi dhe s'mbante mend farë gjëje nga ç'kishte bërë andej nga Tirana...Mos i bjer në qafë, i qe lutur Xhixhi...Sa të jem unë, nuk i hyn gjëmb në këmbë, ia pati prerë tjetri, dhe nuk je ti i pari që më hyn mik për Emën...

Xhixhi solli një trastë peshk e nja dy pula të gjalla, që se kujt ia rrubati operativi në Divjakë, dhe, në darkë, ata u shtruan me gjithë priftin në tryezë. Prifti kishte gatuar një tavë peshku madhështore dhe paralajmëroi të prisnin thonjtë, para se të uleshin në tryezë!...Pinë një verë të kuqe, ia shtruan muhabetit dhe, aty nga mesnata, Xhixhi tha i pikëlluar: Shumë vuajtje paska krijuar Zoti për robin e gjallë, padre! Unë nuk do besoj kurrë në një Zot kaq të poshtër!...Ai i ka bërë mirë të gjitha, u përgjigj plaku, fajin e kanë njerëzit që nuk zbatojnë këshillat e tij...Në këtë vend dhjetë njerëz e kanë fajin, tha Xhixhi me një bindje që s'hapte shteg për diskutime, pse nuk i vret ata qelbësira në emër të vendosjes së paradisit tokësor?...Joo!- bëri prifti...Ku ka kristianizëm budalla, ka krim harbut!- i vuri kapakun Xhixhi. Dhe kështu u ndanë.

Xhixhi vendosi ta kalonte natën me Emën. Në plan e kishte të kthehej, po sepse i erdhi keq ta linte tjetrën vetëm në atë humbëtitë. Edhe vera e bëri punën e vet...

- Sot ka ditëlindjen Komandanti,- deklaroi para Emës, që nuk po dinte ç'të bënte me tjetrin.- Hajde, ta festojmë!...

E tërhoqi tjetrën në prehër dhe ia nisi ledheve të kombinuara me karagjozllëqet e veta klasike, sa Ema u shkri fare.

Vonë, tek rrinte shtrirë pranë tjetrit, mendoi se kishte kaluar vërtet një mbrëmje të mrekullueshme. Shumë pak kërkon njeriu i shkretë për të qenë i kënaqur: pak bukë, pak verë, pak dashuri...

- Unë u fejoval!- tha atë çast me sytë në tavan Xhixhi.

- Me cilën?- pyeti e befasuar ajo.

- Me një vajzë korçare në Konservator...Soprano...

- Shumë mirë!- tha ajo, por përbrenda seç ndjeu një pickim. Mbase e mbushi me zili fati i asaj korçares, mbase i erdhi keq që nuk do ta kishte më kaq afër këtë Xhixh me zemër të madhe, që gjallë në botë nuk e vriste mendjen për asgjë...

- Mos hajde më!- iu lut ajo.- Do t'i hapësh telashe edhe vetes, edhe mua...Gati janë këta!...

- Ke të drejtë,- tha ai, gjithë duke kullotur sytë në hapësirën e bardhë mbi vete. Pastaj, sikur mos kishte ndodhur asgjë, mbylli sytë dhe fjeti.

Ema priti sa tjetri të hynte në gjumin e parë, pastaj u ngrit përgjysmë e mbështetur në bërryl dhe filloi ta vëzhgojë. Nuk i dha Zoti një burrë të mençur e bujar si Xhixhin, por i dha atë idiotin që...Kishte të drejtë ky që deklaronte se nuk do besonte kurrë në Zot. Zot bythe, ishte!...Asnjëherë nuk ia pati zgjatur dorën, kurrë nuk ia pati parë surratin, asnjëherë nuk ia dëgjoji zërin t'i pipëtinte e kishte mirë apo keq...Zot spektator! Spektatorë ka një qerre në këtë botë! Një miliard spektatorë bëhen për të parë vetëm një ndeshje futbollit!...

* * *

Filluan shirat dhe në nëntor u përmyt gjithçka. Rrugët ishin plot me pellgje dhe fusha ishte fshehur nën hapësira ujërash të turbullta...Apokalips, mërmëriste prifti, tek shihte i trishtuar të mbjellat e tij nën atë hapësirë ujërash...Gjithçka duhej mbjellë nga e para...Tani të gjithë të internuarit mblidheshin në serrat që po i rezistonin akoma rrebeshit të pafund. Nën vështirimin e kamxhiktë të brigadierit, ata përkulnin shpinën me orë të tëra, edhe sikur mos kishte më asnjë fije bari të keq për t'u shkukur...Ishin të gjithë të raskapitur, pa shpresë dhe zymtinë e shtonin më shumë vdekjet e një pas njëshme në rradhët e këtyre njerëzve, me një arsenal sëmundjesh në trup, tashmë...Atë dimër mori të ftohtë edhe Loreni. Askush nuk kujdesej për atë fëmijë të pafajshëm në çerdhe e ambulancë, askush nuk i akordoi raport mjekësor Emës, që të rrinte pranë djalit...Ishin të persekutuar, gjak i zi, kolerëpërhapës, lebrozë, plehra ishin dhe, në dhjetor, Loreni u bë keq. Ai fëmijë i bukur nuk mbushej dot me frymë, zgurdullonte sytë e përlotur nga mungesa e ajrit dhe kolla torturuese, belbëzonte përçarë nën temperaturën e lartë përcëlluese kush e di se ç'fjalë, me atë gjuhën e tij ende të brishtë e të pakuptueshme, dhe Ema kërkoi urgjent Gasperin me Nahilen...Erdhën të nesërmen dhe Gasperi nuk foli gjatë:

- Po e marrim djalin dhe do kujdesemi ne për atë! Ti, rri e qetë!...

E morën djalin në krah dhe ikën me një mërmurimë "kriminelët", që

Ema nuk e kuptoi se kush e shqiptoi, po, kur operativi e thirri në zyrë dhe i tha duke i rrotulluar sytë si fajtor vërdallë, se ajo duhej të nisej urgjent në Tiranë, Ema kuptoi gjithëcka. Lëshoi një "Jo" të llahtarshme, pastaj, filloi të godasë si e çmendur me kokë murin e zyrës. Kur tjetri arriti ta shtrëngonte në krahët e vet të fortë atë femër me fuqi të përbindshme, ajo ishte mbuluar nga gjaku. Dihaste rëndë tani, qante pa lot, dhe mërmëriste: "Kriminelë, kriminelë..."

Operativit iu qa. Kishte ai më shumë frikë nga kushdo prej kësaj fjale që po dëgjonte, por edhe kriminel vetja i dukej! Mund ta kishin shpëtuar këtë fëmijë, dreqi ta hante, por të gjithë ishin dhjeramanë!...Ai thirri urgjent mjekun, e urdhëroi t'i bënte ndonjë qetësues tjetrës dhe priti, deri sa ajo ra në apatinë e ilaceve...Pastaj vendosi ta shoqëronte deri në Tiranë. Në morg Ema nuk priti të hapej i gjithë sirtari i gjatë për ta njohur Lorenin. E dalloi nga gishtrinjtë e këmbëve dhe u këput e ra mbi çimenton e flohtë. Operativi qau. Zanat muti i kishte rënë për hise!

Ai mori pjesë edhe në varrimin e foshnjës. Shtatë njerëz merrnin pjesë në atë funeral, shtatë ekstreme të çuditshme: Ema, hetuesi, operativi, Xhixhi, Gasperi, Nahilja dhe i shoqi i saj, një burrë i ashpër që ndillte lotët papushim...

Babai i fëmijës nuk erdhi...Luftë klasash, mendonin të gjithë një lloj ato çaste. që të vinte të futeshe vetë në gropë, për mos parë me sytë e tu atë llahtari, në kohën kur Ema mërmëriste papushim: Të vranë, o ëngjëll...

- Mbyll gojën!- u nxeh Gasperi.

Patën fat! Ema e dëgjoi, u tremb dhe nuk foli më. Ata u kthyen në shtëpi, ku Gasperi kishte bërë gati drekën dhe u ulën përreth tryezës pa fjalë. Gasperi ndodhej pranë hetuesit.

- Bini kushurinjtë?- e pyeti hetuesi.

- Jo,- iu përgjigj tjetri. Pastaj, si e peshoi një çast burrërinë e tjetrit, tha zëulët i përkulur mbi pjatë: Unë kam ardhur një herë me pagesë në këtë shtëpi, kur Ema bënte ato lodrat...Ajo më mbrojti, nuk ta tregoi emrin tim, meqë unë kam qenë nja dhjetë vjet brenda për tentativë arratisjeje...Dy vjet kam që jam liruar...

- Paske shpëtuar mirë,- iu përgjigj nën zë hetuesi.- Te ty do të mbetej dopio gjashta...

Atë kohë Ema u betua se e kishte harruar djalin dhe ata mund të bënin muhabet lirshëm.

Ema u lejua të qendronte nëntë ditë në shtëpi. Askush nuk e ngushëlloi nga shkalla, veç Nahiles dhe inxhinierit në katin e pestë. Ajo i kaloi ditët e vetmuar në atë hapësirë të ngushtë e mbushur me kujtime ngjethëse dhe mezi priti të vinte dita e nisjes për në Lushnje. Donte të takonte priftin...